

**RAPORTIM  
PER VEPRIMTARINE FINANCIARE DHE ZBATIMIN E  
BUXHETIT TE VITIT 2016 BASHKIA E SHKODRËS**

**MARS 2017**

## **PËRMBAJTJA**

<b>REALIZIMI I BUXHETIT TE VITIT 2016</b>	<b>5</b>
Transferta e pakushtezuar dhe te ardhurat e veta vendore	11
Transferta specifike	17
Transferta e kushtëzuar	20
Detyrimet e prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore	25
Të ardhurat e veta vendore	26
Kategorizimi i të ardhurave	27
Analiza e realizimit të të ardhurave nga burimet e veta vendore	28
Analiza e peshës specifike të seicilës njësi administrative në realizimin e të ardhurave	30
Pesha specifike e zërave kryesorë sipas të ardhurave të krijuara	31
Cash Flow i të ardhurave, sipas muajve	33
Realizimi i të ardhurave krahasuar me vitin 2015	33
Analiza e zërave kryesore që kanë ndikuar tek të ardhurat e veta të bashkisë nga viti në vit	34
Realizimi i të ardhurave në lidhje me planin	39
<b>P1 PROGRAMI I ADMINISTRATËS VENDORE</b>	<b>55</b>
I Pershkrimi i funksioneve dhe objektivave	55
II Produktet për vitin 2016	55
III Fondet e financimit te programeve	65
IV Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave te buxhetit te programit.	69
<b>P.2 PLANIFIKIMI URBAN</b>	<b>70</b>
I Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave	71
II Produktet për vitin 2016	71
III Fondet e financimit të programeve	73
IV Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave te buxhetit te programit.	75
<b>P.3 INFRASTRUKTURA RRUGORE</b>	<b>75</b>
I Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave	76

II	Produktet për vitin 2016	76
III	Fondet e financimit të programeve	80
IV	Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.	82
<b>P.4</b>	<b>SHËRBIMET PUBLIKE</b>	<b>82</b>
I	Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave	82
II	Produktet për vitin 2016	83
III	Fondet e financimit të programeve	88
IV	Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.	89
<b>P.5</b>	<b>TRANSPORTI PUBLIK DHE LËVIZSHMËRIA</b>	<b>90</b>
I	Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave.	90
II	Produktet për vitin 2016	90
III	Fondet e financimit të programeve	91
IV	Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.	91
<b>P.6</b>	<b>ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE TURIZMIT</b>	<b>91</b>
I	Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave	92
II	Produktet për vitin 2016	93
III	Fondet e financimit të programeve	99
IV	Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.	101
<b>P.7</b>	<b>BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL</b>	<b>103</b>
I	Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave	103
II	Produktet për vitin 2016	103
III	Fondet e financimit të programeve	106
IV	Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.	107
<b>P.8.</b>	<b>MJEDISI DHE MBROJTJA E PYJEVE DHE KULLOTAVE</b>	<b>108</b>
I	Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave	108
II	Produktet për vitin 2016	109
III	Fondet e financimit të programeve	112

IV	Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.	113
<b>P.9</b>	<b>ARSIMI PARAUNIVERSITAR DHE PARASHKOLLOR</b>	<b>115</b>
I	Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave	115
II	Produktet për vitin 2016	115
III	Fondet e financimit të programeve	126
IV	Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.	129
<b>P.10</b>	<b>STREHIMI DHE SHËRBIMET SOCIALE</b>	<b>131</b>
I	Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave	131
II	Produktet për vitin 2016	132
III	Fondet e financimit të programeve	137
IV	Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.	140
<b>P11</b>	<b>KULTURA DHE SHËRBIMET REKREACIONALE</b>	<b>141</b>
I	Përshkrimi i funksioneve dhe i objektivave	141
II	Produktet për vitin 2016	142
III	Fondet e financimit të programeve	154
IV	Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.	159
<b>P12</b>	<b>RINIA DHE SPORTET</b>	<b>160</b>
I	Përshkrimi i funksioneve dhe i objektivave	160
II	Produktet për vitin 2016	160
III	Fonde të financimit të programit	164
IV	Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.	166
	<b>RISHPERNDARJA E FONDEVE TË TRASHEGUARA</b>	<b>167</b>

## Realizimi i buxhetit te vitit 2016

Realizimi i buxhetit te viti 2016 eshte bere duke respektuar ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “ Per menaxhimit e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar , ligjin nr. 10296 date 8.7.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar , udhezimin nr. 2 date 6.2.2012 “ Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit” i ndryshuar , Udhezim plotesues i Ministrise se Financave nr.01 date 15.01.2016 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2016 “i ndryshuar , ligjin 147/2015“ Per buxhetin e vitit 2016 “ dhe aktet normative perkatese , VKB nr. 17 date 28.4.2016 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2016 te Bashkise Shkoder” te ndryshuar .


**Bashkia Shkoder, administron dhe menaxhon fondet, sipas 12 programeve të miratuara, të listuar me poshtë:**

1. Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”.
2. Programi “Planifikimi urban”.
3. Programi “Infrastruktura rrugore”.
4. Programi “Sherbime Publike”.
5. Programi “Transporti publik dhe levizshmeria (mobiliteti)”.
6. Programi “Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit”.
7. Programi “Bujqesia dhe zhvillimi rural”.
8. Programi “Mjedisi dhe mbrojtja e pyjeve e kullotave”.
9. Programi “Arsimi parauniversitar dhe edukimi”.
10. Programi “Strehimi dhe Shërbimet sociale”.
11. Programi “Kultura dhe sherbimet rekreacionale”.
12. Programi “Rinia dhe Sportet”.


Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, të vitit 2016, nga te gjitha burimet e financimit, arritën në 2,309,504 mije lekë me një nivel realizimi prej 90.6 për qind.

Emertimi	Plani fillestar	Plani i korigjuar	000/leke	
			Fakti	Realizimi ne %
Paga dhe Sigurime	573,447	578,100	497,738	86.1%
Shpenz.Operative	543,727	536,386	478,261	89.2%
Subvencione	12,000	10,500	4,988	47.5%
Transferime	262,962	1,066,184	1,057,170	99.2%
Investime	263,317	357,650	271,347	75.9%
<b>Totali</b>	<b>1,655,453</b>	<b>2,548,820</b>	<b>2,309,504</b>	<b>90.6%</b>

**Realizimi i shpenzimeve te buxhetit 2016, ne krahasim me planin,  
000/leke sipas artikujve**




**Realizimi i shpenzimeve te buxhetit 2016 ne %,ne krahasim me planin**



Peshen me te madhe te realizimit ne perqindje e zene transferimet ne masen 99.2 % ku perfshihen ndihmat ekonomike dhe pagesa e personave me aftesi ndryshe ne shumen 962 342 mije leke si transferte e kushtezuar .

**Pesha specifike e shpenzimeve viti 2016, ne raport me totalin e buxhetit**



**Buxheti i vitit 2016, ne total me te gjitha burimet e financimit te realizuara, paraqitet si me poshte:**

*000/ lekë*

Nr	TE HYRAT DHE FINANCIMET	Plan	Fakt	Diferenca
<b>I</b>	<b>TE ARDHURAT E VETA</b>	<b>603,710</b>	<b>507,146</b>	<b>(96,564)</b>
1	Te ardhurat tatimore	366,259	250,258	(116,001)
2	Te ardhur jotatimore	237,451	256,888	19,437
2.a	Te ardhura nga tarifa vendore	199,096	219,200	20,104
2.b	Te ardhura te tjera	31,130	32,510	1,380
2.c	Donacioni	7,225	5,095	(2,130)
2.d	Renta minerare	-	83	83
<b>II</b>	<b>TRANSFERTAT</b>	<b>1,033,460</b>	<b>1,925,376</b>	<b>891,916</b>
1	Transferte e Pakushtezuar	490,679	490,679	-
2	Transferte Specifike	306,941	310,459	3,518
3	Transferte e kushtezuar	235,840	1,124,238	888,398
<b>III</b>	<b>TE TRASHEGUARA</b>	<b>21,892</b>	<b>21,892</b>	<b>-</b>
1	Transferte e Pakushtezuar	20,983	20,983	-
2	Donacione	909	909	-
	<b>TOTALI</b>	<b>1,655,453</b>	<b>2,453,505</b>	<b>798,052</b>

Shpenzimet per paga rreth 53 % jane realizuar me burim financimi Burimet e Veta , rreth 43.9 me Transferte Specifike dhe 3.1 % me Transferte te Kushtezuar.

Shpenzimet operative rreth 81.32% jane realizuar me Burimet e veta, 12% me Transferte Specifike dhe 6.8% me Transferte te Kushtezuar.


Shpenzimet per transferime jane realizuar me transferte te kushtezuar me rreth 91.3% ,me Burimet e veta 7% dhe 1.7% me transferte specifike.

Shpenzimet per subvencione jane realizuar vetem me Burimet e Veta dhe zene peshe specifike relativisht te ulet ne totalin e shpenzimeve per vitin 2016.


Shpenzimet per investime rreth 77.1% jane realizuar me Burimet e Veta , 22.4 % me transferte te kushtezuar dhe 0.5% me donacione.

Realizimi i shpenzimeve sipas burimeve te financimit paraqitet si me poshte:


**Paga dhe Sigurime**




**Shpenzime Operative**




**Subvencione**



**Transferime**



**Investime**



Fondi rezerve eshte planifikuar ne shumen prej 6 000 mije leke dhe eshte perdorur 5 486 mije leke, ne masen 91.4% . Perdorimi i tij eshte realizuar me 8 vendime te keshillit bashkiak si me poshte:



Vendimi		Emertimi	Shuma
Nr	date		000/leke
21	01.06.2016	Dhenia e ndihmes financiare familjeve te Z. Gezim Alija, Znj. Marija Melaj, Znj. Vera Gucija per demet e shkaktuara nga zjarri.	180
38	18.08.2016	Per dhenie ndihme financiare lagjeve Hasanbeg, Haraçine, çair, Smilkovc dhe Stajkovc te Shkupit ne Republiken e Maqedonise, si solidarizim ne perballimin e fatkeqesive nga permbytjet te ndodhura ne fillim te Gushtit 2016.	1,220
45	03.10.2016	Per dhenien e ndihmes financiare per fatkeqesi te shkaktuara nga zjarri.	360
rikonf.64	rikonf 30.12.2016		
59	30.11.2016	Per miratim fondi per shperblim per ekipet dhe sportistet fitues ne veprimtarite kombetare me vlere 780,000 leke.	780
50	2.11.2016	Per nje shtese ne fondin e pagave dhe sigurimeve shoqerore te Institucionit "Drejtoria e Cerdhe Kopshteve" dhe shtese ne fondin e pagave te "Drejtoria e Emergjencave Civile, mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi" per vitin 2016.	1,534
51	2.11.2016	Per miratim fondi si ndihme per anetaret e shoqates se jetimeve per festat e fundvitit 2016.	352
60	30.11.2016	Per nje shtese ne fondin e pagave te "Drejtoria e Emergjencave civile, Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit" per vitin 2016.	900
65	30.12.2016	Per dhenien e ndihmes financiare per familjet qe kane pesuar deme, te shkaktuara nga zjarri.	160
<b>TOTALI</b>			<b>5,486</b>

Fondi i kontigjences ne shumen 6 000 mijeleke nuk është përdorur.

Realizimi i fondeve per te gjitha programet, per vitin 2016 paraqitet si me poshte:

**REALIZIMI VITI 2016**

000/leke

Programe	Paga + Sigurime			Shpenzime Operative			Subvencioni			Transferta			Investime			Totali		
	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi
P1.	247,494	248,027	205,452	64,062	62,127	45,484	-	-	-	1,137	6,751	6,433	27,358	30,663	24,752	340,051	347,567	282,121
P2.	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	10,957	10,679	10,088	10,957	10,679	10,088
P3.	-	-	-	21,554	21,554	16,936	-	-	-	-	-	-	122,486	151,056	138,883	144,040	172,610	155,819
P4.	28,238	28,216	19,332	253,496	253,496	240,336	5,000	5,000	4,988	360	382	62	26,707	26,707	22,541	313,801	313,801	287,259
P.5	-	-	-	3,876	3,876	2,687	7,000	5,500	-	-	-	-	3,500	5,000	4,998	14,376	14,376	7,685
P.6	-	-	-	5,520	5,520	2,574	-	-	-	1,600	1,600	1,600	-	-	-	7,120	7,120	4,174
P7	8,035	8,035	4,182	13,994	13,994	12,077	-	-	-	-	-	-	15,000	79,567	31,557	37,030	101,597	47,816
P8	5,691	5,691	3,076	1,589	1,589	558	-	-	-	-	-	-	1,015	1,015	670	8,294	8,294	4,304
P9	207,909	210,988	197,199	105,402	104,202	96,141	-	-	-	2,000	2,440	2,415	32,880	32,880	26,264	348,191	350,509	322,018
P10	25,673	27,180	23,121	14,108	14,283	11,809	-	-	-	184,128	979,852	979,671	6,947	4,838	4,580	230,857	1,026,153	1,019,181
P11	40,965	40,500	36,173	20,547	26,189	21,942	-	-	-	11,655	5,700	4,163	13,367	14,144	6,229	86,534	86,533	68,507
P12	9,442	9,464	9,204	39,579	29,557	27,716	-	-	-	50,082	62,862	62,826	3,100	1,100	786	102,203	102,983	100,532
<b>TOTALI</b>	<b>573,447</b>	<b>578,100</b>	<b>497,738</b>	<b>543,727</b>	<b>536,386</b>	<b>478,261</b>	<b>12,000</b>	<b>10,500</b>	<b>4,988</b>	<b>250,962</b>	<b>1,059,587</b>	<b>1,057,170</b>	<b>263,317</b>	<b>357,650</b>	<b>271,347</b>	<b>1,643,453</b>	<b>2,542,223</b>	<b>2,309,504</b>
F.Rez.+ Konting +R,min er										12,000	6,597					12,000	6,597	
<b>TOTALI</b>	<b>573,447</b>	<b>578,100</b>	<b>497,738</b>	<b>543,727</b>	<b>536,386</b>	<b>478,261</b>	<b>12,000</b>	<b>10,500</b>	<b>4,988</b>	<b>262,962</b>	<b>1,066,184</b>	<b>1,057,170</b>	<b>263,317</b>	<b>357,650</b>	<b>271,347</b>	<b>1,655,453</b>	<b>2,548,820</b>	<b>2,309,504</b>

## Transferta e pakushtezuar dhe te ardhurat e veta vendore


Të ardhurat e veta përfshijnë transfertën e pakushtezuar, te ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore dhe te ardhura nga burime të tjera. Këto burime të ardhurash, janë burimi kryesor i buxhetit të bashkise dhe zene 42% të totalit të buxhetit. Bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Gjatë vitit 2016 përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve.

Totali i shpenzimeve të realizuara me burim financimi transfertën e pakushtezuar dhe te ardhurat e veta vendore është 85 %, pagat janë realizuar në masën 79%, shpenzimet operative 89%, subvencionet në masën 48 %, transferimet në masën 89 % dhe investimet në masën 84 % .


*000/leke*

Emertimi	Plani fillestar	Plani i korigjuar	Fakti	Realizimi në %
Paga dhe Sigurime	331,962	334,260	264,197	79 %
Shpenz. Operative	441,800	435,660	388,424	89 %
Subvencione	12,000	10,500	4,988	48 %
Transferime	78,641	82,751	73,911	89 %
Investime	243,744	250,953	210,488	84 %
<b>Totali</b>	<b>1,108,147</b>	<b>1,114,124</b>	<b>942,008</b>	<b>85%</b>

Realizimi i shpenzimeve 2016 , në 000/leke, me burim financimi transfertën e pakushtezuar dhe te ardhurat e veta




**Realizimi i shpenzimeve 2016, ne %, ne krahasim me planin, me burim financimi transferten e pakushtezuar dhe te ardhurat e veta vendore**



Ne totalin e shpenzimeve të realizuara me burim financimi transferten e pakushtezuar dhe te ardhurat e veta vendore Shpenzimet per paga zene rreth 28.1% , shpenzimet operative zene rreth 41.3 % , Shpenzimet per subvencione zene 0.5%, shpenzimet per transferime zene 7.9 % dhe shpenzimet per investime zene rreth 22.2 % te totalit te realizuar nga ky burim.

**Pesha specifike e shpenzimeve 2016, ne raport me burimin e financimit transferte e pakushtezuar dhe te ardhura te veta vendore**



**REALIZIMI I INVESTIMEVE VITI 2016 ME BURIM FINANCIMI TRANSFERTEN E PAKUSHTEZUAR & ARDHURA VETA VENDORE**

000/leke

Pershkrimi	Plani	Fakti
Blerje pajisje te ndryshme	1,176	1,173
Rikonstrukcion rrjeti elektrik godina e Bashkise Shkoder	4,781	94
Ristrukturim fizik dhe teknik të Dhomës së Server-ave	244	198
Implementimi I Sistemit te Menaxhimit te Dokumentave ne nje Baze te Dhenash Qendrore te Qenderzuar dhe te Integruaar ((Integrated Active Directory System) ( Bashkia Qender dhe Njesite Administrative Rrethinat, Gur I Zi, Berdice, Ana Malit, Postribe Velipoje Dajç)	644	-


Zgjerimi i rrjetit kompjuterik (Intranet) për komunikimin elektronik të brendshëm, implementimi i Sistemit të Kontrollit të Aksesit dhe Sistemit të Vëzhgimit (Bashkin Qendër)	6,050	6,049
Implemtimi i sistemit të informacionit për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore	5,000	4,920
Blerje Paisje TIK	4,432	4,417
Ndertim I rrjetit tre brendshem te komunikimit elektronik (intranet) ne 5 Njesi Administrative	274	274
Ndertim I sistemit dixhital te konferences dhe rregjistrimit audio ne sallen e keshillit Bashkiak Shkoder	3,948	3,948
Rikonstruksion I godines Nj A Gur I zi	2,744	2,309
Ndertim I rrjetit tre brendshem te komunikimit elektronik (intranet) ne 5 Njesi Administrative	1,370	1,370
<b>Totali“ Planifikim Menaxhim Administrim”</b>	<b>30,664</b>	<b>24,752</b>
Projekte teknike te ndryshme per riaftesimin e kanaleve kulluese	5,000	-
<b>Totali“Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes”</b>	<b>5,000</b>	<b>-</b>
Zbatimi i projektit per ndertimin e leres se ujit kullota -Zogaj	1,015	670
<b>Totali“ Administrimi i Pyjeve”</b>	<b>1,015</b>	<b>670</b>
Rikonstruksion rruge Degëzim "Isuf Sokoli"	118	118
Rikonstruksion rruge "Qazim Llazani"	5,230	5,154
Rikonstruksion degezim rruge "Draçin"	16,209	16,182
Rikualifikim Urban blloqe banimi "Qemal Draçini" ; (Pallati me hark)	514	514
Rikualifikim Urban blloqe banimi "Bardeleve"(Pogej)	326	324
Rikualifikim Urban blloqe banimi"Tepe-te fusha e druve"	1,102	1,102
Rikontruksion i rruges hidrovorit-Dobrac NJA Rrethina Projektim	3,011	3,011
Rikonstruksion rruga Bulevardi Skenderbeg (ish rajoni 4)	560	560
Rikonstruksion rruga Osja e Falltores(blloqe pallatesh)	394	394
Rikonstruksion rruga Edith Durham (tek shkolla Martin Camaj)	287	228
Rikonstruksion rruga Mandave	447	447
Rikonstruksion rruga Smakej	134	107
Rikualifikim urban blloqe banimi Zogu I Pare (Xhabije)	640	639
Rikonstruksion rruga memorandumi I Greces	348	348
Rikualifikim urban blloqe banimi "Qemal Draçini" (Tek sahati)	1,256	1,255

Projekt i plote Rehabilitimi i sheshit Gjon Pali 50% e 1333124 e marreveshjes me FSHZH	667	667
Projekt i plote "Rikualifikim urban i rrugicave ne Qendren Historike ( kthimi i tyre me i tyre ne dyer druri karakteristike) 50% e 2883796 sipas marreveshjes me FSHZH	1,445	1,445
Rikualifikim urban i rrugicave historike ne Qendren Historike ( Rikonstruksion i sistemit ujsjelles kanalizime)	18,260	17,464
Rikonstruksion rruga Oblike-Velinaj-Ali Metaj (segmenti Fusha e Cunit-Kryqezim Lagjja Garuc)	351	120
Rikonstruksion rruga Gjomarkaj	432	162
Rikonstruksion rruge Degëzim "Isuf Sokoli"	3,416	2,551
Rikualifikim Urban blloqe banimi "Qemal Draçini" ; (Pallati me hark)	13,002	9,248
Rikualifikim Urban blloqe banimi "Bardeleve"(Pogej)	7,105	5,244
Rikualifikim Urban blloqe banimi"Tepe-te fusha e druve"	35,548	35,492
Rikonstruksion sheshe plazhi Velipoje	4,370	2,943
Mbikqyrje Rikonstruksion blloqe pallatet Xhabiej	697	292
Rikonstruksion rruga Oblike-Velinaj-Ali Metaj (segmenti Fusha e Cunit-Kryqezim Lagjja Garuc)	8,327	8,265
Rikonstruksion rruga Gjomarkaj	9,248	9,230
<b>Totali“ Menaxhimi rrugëve”</b>	<b>133,443</b>	<b>123,505</b>
Blerje makine vijezi	5,000	4,998
<b>Totali“ Transporti publik”</b>	<b>5,000</b>	<b>4,998</b>
Blerje kazana, Sherbimi i pastrimit	16,950	16,692
Investime ndricim rruge dytesore +mbikqyrje+kolaudim	6,293	5,675
Shpronosim	644	-
Rruga e fshatit	1,372	-
Rrethim	1,011	-
Tabelat e lajmerimeve	180	-
Projekt per Investime ndricim rruge dytesore	257	174
<b>Totali“ Sherbimet publike vendore”</b>	<b>26,707</b>	<b>22,541</b>
Shah i madh butaforik	100	-
Rikonstuksion pallati	770	599
Bl.kompjuter printer	80	80

Tapet ringu boksi	150	107
<b>Totali“ Zhvillimi i Sportit”</b>	<b>1,100</b>	<b>786</b>
Projekt i plote Rikonstruksion i godines se Teatrit “ Migjeni”.50% e 3978526 Sipas marreveshjes me FSHZH	1,989	1,989
Blerje impiant audio dhe sistem ndricimi dhe pod per koncerte live	1,555	-
Zhvillimi dhe pasurimi i fondit te bibliotekes Blerje libra, revista, periodik	1,000	846
Pajisje teknike per zyre dhe evente kulturore	160	150
Ruajtja e Galerise se Arteve Kamera Sigurie	160	107
Permiresimi i kushteve teknike ambjenteve te ruajtjes se koleksionit GASH	541	527
Orendi zyre	80	77
Pajisje dhe risistemim i fondit te arkives	448	419
Mobilimi me orendi per mjediset e Galerise se Arteve Shkoder	80	65
Restaurim i kthines se arkeologjise si depo ruajtese	698	-
Permiresim i sistemit te ndricimit te oborrit te muzeut	250	-
Mobilim per Qendren Kulturore "Pjeter Gaci"	545	428
Pajisje zyre per Qendren Kulturore "Pjeter Gaci" (kompjuter & printer)	170	134
Blerje paisje zyre komp+fotokopje	100	95
Raft per ruajtjen e objekteve dhe dokumenteve	50	-
Rinovim i ekspozites fotografike me materiale te reja	30	30
Sistem i kamerave te sigurise	350	95
Blerje rafte per biblioteken	800	276
Nje piano per qytetin e artit	4,000	-
Mobilimi i 10 dhomave te aktoreve	360	317
Blerje paisje teknike profesionale	624	540
Mobilimi i dy dhomave per te ftuarit	154	134
<b>Totali“ Programe specifike kulturore dhe te turizmit”</b>	<b>14,144</b>	<b>6,229</b>
Kaldaja shkolla Xheladin Fishta	1,700	47
Rikonstruksion I pjesshem shkolla Tringe Smajla Fshati Grude e Re	9,400	7,408
Blerje paisje orendi	1,000	745

Blerje pajisje operacionale	1,480	1,434
<b>Totali“ Arsimi parashkollor dhe 9-vjecar”</b>	<b>13,580</b>	<b>9,634</b>
Rikonstrukcion I plote I shkolles Oso Kuka	19,300	16,630
<b>Totali“ Arsimi parauniversitar”</b>	<b>19,300</b>	<b>16,630</b>
Blerje paisje dhe orendi	390	240
Blerje paisje zyre	140	104
<b>Totali“ Sherbimet e kujdesit social”</b>	<b>530</b>	<b>344</b>
PC për qendrat komunitare	330	304
Printer për qendrat komunitare	140	96
<b>Totali“ Perkujdesi Social”</b>	<b>470</b>	<b>400</b>
<b>TOTALI</b>	<b>250,953</b>	<b>210,488</b>

**Realizimi investimeve 2016, sipas programeve buxhetore, ne % mbi totalin e burimit te financimit**



Peshën me të madhe të investimeve të realizuara me burim financimi transferten e pakushtezuar dhe të ardhurat e veta vendore, e zënë investimet në programin 4530 “ Menaxhimi I rrugëve “ me rreth 59 % , programi 1110 “ Planifikim, menaxhim ,administrim “ me 12 %, programi 6260 “ Sherbimet publike” me 11%.



## **Transferta specifike**

Risi e buxhetit te vitit 2016 ishte transferimi i disa funksioneve me burim financimi transferten specifike.

Funksionet e reja, që u transferuan në Bashki ishin:

### **Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar**

Në transfertën specifike të vitit 2016, I janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar nuk përfshihet arsimi i mesëm profesional.

Për Arsimin parashkollor (kopshtet e fëmijëve, edukatorë dhe punonjës në qendrën kulturore të fëmijëve I janë alokuar gjithsej 93,929 mijë lekë për paga dhe sigurime shoqërore për 133 punonjës të transferuar. Për punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 9-vjeçar (parashkollor dhe Qendra kulturore e fëmijëve) janë alokuar gjithsej 49,204 mijë lekë për paga dhe sigurime shoqërore për 106 punonjës të transferuar. Për punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin e mesëm, janë alokuar gjithsej 19,963 mijë lekë për paga dhe sigurime shoqërore për 43 punonjës të transferuar. Me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 17366/8 date 20.12.2016 “ Mbi zbatimin e aktit normativ nr. 2 date 16.12.2016” për arsimin parashkollor dhe 9 vjeçar u akordua fondi shtesë prej 2 802 mije leke , ndërsa për arsimin parauniversitar i mesëm i përgjithshëm u akordua fondi 716 mije leke në fund të vitit, i pamjaftueshëm për të mbuluar shpenzimet dhe me shume vonese .

Ministria e Arsimit dhe Sportit, në fillimit të vitit 2016, ka dërguar kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me: dosjet personale të punonjësve, pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor, personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Bashkia Shkodër ka realizuar procesin e transferimit të dokumentacionit të personelit, dhe pagesës së pagave dhe sigurimeve shoqërore të muajve Dhjetor 2015 e në vazhdim, në kohë dhe pa krijuar asnjë problem. Bashkia Shkodër, për të përballuar pagat dhe sigurimet shoqërore të këtij funksioni të ri, ka parashikuar që në fillim të vitit, fond nga të ardhurat e bashkisë .

### **Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)**

Në transfertën specifike të vitit 2016, janë fondet për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin. Në këto fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Shuma e alokuar është 30,678 mijë lekë, numri i punonjësve 35:

Bashkia Shkodër ka realizuar procesin e transferimit të dokumentacionit të personelit, dhe pagesës së pagave dhe sigurimeve shoqërore të muajve Dhjetor 2015 e në vazhdim, në kohë dhe pa krijuar asnjë problem.

Bashkia Shkodër është përballur me vonesën e shkaktuar në transferimin e këtij funksioni, për shkak të vendimmarrjes dhe nxjerrjes me shumë vonesë të akteve normative dhe udhëzimeve përkatëse për transferimin në pronësi të aseteve dhe inventarëve. (VKM nr. 366, datë 13.05.2016).

Në vijim të marrjes në dorëzim të funksionit të transferuar Bashkia Shkodër ka filluar procesin e regjistrimit të pronës pranë ZRRP-së, meqënëse është verifikuar që kjo pronë nuk ishte e regjistruar në sistem.

## Rrugët rurale

Në transfertën specifike të vitit 2016, janë alokuar fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Për këtë funksion për vitin 2016 I janë akorduar 17 857 mijë lekë.

Këshilli i Qarkut SHkodër gjatë vitit 2016, ka dorezuar pranë Bashkisë Shkodër mjetet dhe asetet sipas një plani të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. (VKM nr. 915, datë 11.11.2015)

## Administrimi i pyjeve

Në transfertën specifike të vitit 2016, janë planifikuar fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond perfsiheshin fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Për këtë funksion për vitin 2016 janë alokuar 3,679 mijë lekë, numri i punonjësve është 6. Ministria e Mjedisit transferoi kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me: dosjet personale të punonjësve, pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin. Deri në fund të muajit qershor, nuk ka patur asnjë akt normativ, apo ligjor për administrimin e pyjeve.

Bashkia Shkodër në strukturën organizative të saj, ka krijuar Drejtorinë e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe institucionin "Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore", brenda të cilit është sektori i pyjeve me 6 persona, i cili merret me administrimin dhe mbrojtjen e pyjeve.

## Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën specifike të vitit 2016, janë planifikuar fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond perfsiheshin fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Për këtë funksion për vitin 2016 I janë alokuar 17,388 mijë lekë, numri i punonjësve është 12.

## Konviktet e arsimit parauniversitar

Në transfertën specifike të vitit 2016, Bashkisë Shkodër i janë akorduar fonde për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë ishin të përfshira: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime. Fondi i alokuar për këtë funksion për vitin është 55 763 mijë lekë.

## Qendrat e Shërbimeve Sociale

Në transfertën specifike të vitit 2016 të Bashkisë Shkodër i janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit dhe shpenzime operative për qendrën "Shpresa" Shkodër. Shuma e alokuar për këtë qendër ishte 18 480 mijë lekë.

Realizimi i transfertes specifike në total paraqitet si më poshtë:


Transferta specifike për vitin 2016											000/lek
	Programi	Nr. Pun.	Paga dhe sigurime shoqërore		Shpenzime operative		Transferime		Totali		% realizimit
			Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	
I	Arsimi Parauniversitar	43	43,408	41,471	32,806	31,000	228	206	76,442	72,677	95%
II	Arsimi Parashkollor	239	145,723	142,701	0	0	212	212	145,935	142,913	98%
III	Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi	35	27,349	26,724	3,052	2,985	277	277	30,678	29,985	98%
IV	Mbrojtja sociale		1,013	535	423	423	17,044	16,895	18,480	17,853	97%
V	Administrimi i pyjeve	6	3,261	2,670	419	49	0	0	3,679	2,718	74%
VI	Menaxh. i Rrugëve		0	0	17,857	13,239	0	0	17,857	13,239	74%
VII	Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit	12	7,393	4,182	9,994	9,468	0	0	17,388	13,650	79%
	Shuma		228,147	218,282	64,551	57,163	17,760	17,590	310,459	293,035	94%

Ne totalin e shpenzimeve me burim financimi transferten specifike realizimi ne total eshte 94%. Jane realizuar pagat me rreth 95.7%, shpenzimet operative me rreth 88.6 % dhe transferime me rreth 99%.


000/leke

Emertimi	Plani fillestar	Plani i korigjuar	Fakti	Realizimi ne %
Paga dhe Sigurime	225,069	228,147	218,281	95.7%
Shpenz.Operative	64,551	64,551	57,163	88.6%
Transferime	17,321	17,760	17,590	99.0%
<b>Totali</b>	<b>306,941</b>	<b>310,458</b>	<b>293,034</b>	<b>94.4%</b>


Realizimi i shpenzimeve viti 2016 000/leke me burim financimi transferten specifike



Realizimi i shpenzimeve viti 2016, ne %, me burim financimi transferten specifike



**Pesha specifike e shpenzimeve 2016 ne raport me burimin e financimit  
transferte specifike**



Ne transferten specifike, peshen me te madhe prej 74.5%, e zene pagat e punonjesve te transferuar.

### **Transferta e kushtëzuar**

Transferta e kushtëzuar përbëhet nga fondet e deleguara për mbulimin e shërbimit të Gjendjes Civile, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, fondet për mbështetje me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë dhe për personat me aftësi ndryshe, qe zene edhe 86 % te totalit te transfertes se kushtezuar ne shumen 962 3450 mije leke , fondi per emergjence civile, ushqimet e nxënësve konviktorë të shkollave të mesme profesionale, ushqimi për fëmijët me aftësi ndryshe të shkollës “3 dhjetori” , transporti i arsimtarëve dhe i nxënësve në arsimin parashkollor, 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm, si dhe investime gjithsej ne shumen 106,697mije leke.

Ne vitin 2016 jane akorduar fonde nga Fondi i Zhvillimit te Rajoneve vetem per nje projekt “Rikonstruksion blloku i pallateve Xhabije” ne shumen 8,192 mije leke.

Bashkia Shkoder ka aplikuar ne te gjitha thirrjet e FZHR me projektet si me poshte:

<b>1</b>	<b>Aplikimi per Fondin e Zhvillimit te Rajoneve</b>	<b>Date 19.02.2016</b>	<b>Nr. 1948 Prot</b>
	<b>Lloji aplikimit:</b> Në zbatim të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr 2 datë 04.02.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve “Për shpalljen e thirrjes së parë për financimin e projekteve, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2016 “, Për Grantin 1: “Infrastruktura vendore dhe Rajonale”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, Shtylla 1.		
<b>Nr</b>	<b>Emertimi i Projekti</b>	<b>Vlefte e Projektit me tvsh (Lek)</b>	<b>Perfituesit ne nr.</b>
1	Rikonstruksion Godina 1-3 Kate dhe Sistemim Sheshi Funkcional	53,842,716	9,000
2	Ndërtimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujrave të Zeza në lagjen "Mar Lulaj"	122,205,501	3,000
3	Rikonstruksion Rruga "Lugoçesme"	50,843,217	1,000
4	Sistemim i Bllokut te Pallateve “ Xhabije”	76,654,597	1,500
<b>2</b>	<b>Aplikimi per Fondin e Zhvillimit te Rajoneve</b>	<b>Date 31.03.2016</b>	<b>Nr. 3591 Prot</b>

	<b>Lloji aplikimit:</b> Në zbatim të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr 14 datë 10.03.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve “Për shpalljen e thirrjes së parë për financimin e projekteve, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2016 “, Për Shtyllen 1, Grantin 2: “Arsimi”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale .		
<b>Nr</b>	<b>Emertimi i Projekti</b>	<b>Vleftha e Projektit me tvsh (Lek)</b>	<b>Perfituesit ne nr.</b>
1	Rikonstruksion Shkolla 9 vjecare “Azem Hajdari”.	63,213,467	1,548
2	Rikonstruksion Shkolla 9 vjecare “Mati Logoreci”	76,654,597	1,336
<b>3</b>	<b>Aplikimi per Fondin e Zhvillimit te Rajoneve</b>	<b>Date 01.04.2016</b>	<b>Nr. 3638 Prot</b>
	<b>Lloji aplikimit:</b> Në zbatim të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr 19 datë 10.03.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve “Për shpalljen e thirrjes për financimin e projekteve, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2016 “, Për Shtyllen 1, Grantin 3: “Shëndetësia (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor)”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale .		
<b>Nr</b>	<b>Emertimi i Projekti</b>	<b>Vleftha e Projektit me tvsh (Lek)</b>	<b>Perfituesit ne nr.</b>
1	Rikonstruksion Qendra Shëndetësore “Plazh” , Nj.A Velipoj	6,954,384	1,000 - 100,000
2	Rikonstruksion Qendra Shëndetësore “Bërdice e Madhe” , Nj.A Bërdice	10,821,951	1,700
3	Rikonstruksion Qendra Shëndetësore “Grude e Re” , Nj.A Rrethina	13,223,113	5,200
<b>4</b>	<b>Aplikimi per Fondin e Zhvillimit te Rajoneve</b>	<b>Date 27.05.2016</b>	<b>Nr. 6313 Prot</b>
	<b>Lloji aplikimit:</b> Në zbatim të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr 21 datë 18.04.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve “Për shpalljen e thirrjes së dytë për financimin e projekteve, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2016 “, për Grantin: “Infrastruktura vendore dhe Rajonale”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, Shtylla 1.		
<b>Nr</b>	<b>Emertimi i Projekti</b>	<b>Vleftha e Projektit me tvsh (Lek)</b>	<b>Perfituesit ne nr.</b>
1	Sistemim Asfaltim Rruga “Sheshi Kryesorë-Hidrovor”	242,584,932	1,000 - 100,000
2	Rikonstruksion Rruga "Lugoçesme"	50,843,217	1,000
3	Sistemim Asfaltim Rruga "Shirokë-Zogaj"	399,879,672	205,000
4	Rikonstruksion Godina 1-3 Kate dhe Sistemim Sheshi Funkcional	53,842,716	9,000
<b>5</b>	<b>Aplikimi per Fondin e Zhvillimit te Rajoneve</b>	<b>Date 06.06.2016</b>	<b>Nr. 6855 Prot</b>
	<b>Lloji aplikimit:</b> Në zbatim të Vendimit nr 27 datë 20.05.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për “SHPALLJEN E THIRRJES SË DYTE, PER VITIN 2016, PËR FINANÇIMIN E PROJEKTEVE, NGA GRAND I ARSIMIT, PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I, E FONDIT PER ZHVILLIMIN E RAJONEVE.		
<b>Nr</b>	<b>Emertimi i Projekti</b>	<b>Vleftha e Projektit me tvsh (Lek)</b>	<b>Perfituesit ne nr.</b>

1	Rikonstruksion Shkolla 9 vjecare "Azem Hajdari".	63,213,467	1,548
2	Rikonstruksion Shkolla 9 vjecare "Ismail Qemali"	76,186,933	1,258
3	Rikonstruksion Shkolla "Jordan Misja"	86,879,480	1,748
4	Rikonstruksion Shkolla 9 vjecare "Mati Logoreci"	76,654,597	1,336
6	<b>Aplikimi per Fondin e Zhvillimit te Rajoneve</b>	<b>data 22.09.2015</b>	
<b>Lloji aplikimit: Shqipëria Dixhitale</b>			
<b>Nr</b>	<b>Emertimi i Projekti</b>	<b>Vleftha e Projektit me tvsh (Lek)</b>	<b>Perfituesit ne nr.</b>
1	Implementimi i sistemit të informacionit për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore	12,250,560	Bashkitë (stafi front-line, back-office, kryetari), Qytetarët, bizneset, ojq
		<b>data 23.09.2015</b>	
2	Implementimi i disa komponenteve Softëare për përmirësimin e menaxhimit e brendshëm të punës në Bashkinë Shkodër dhe të shërbimit ndaj qytetarit dhe biznesit	103,200,000	Bashkitë (stafi front-line, back-office, kryetari), Qytetarët, bizneset, ojq
		<b>data 30.03.2016</b>	
3	Turizmi Inteligjent, një platformë inovative për rritjen e cilësisë së turizmit dhe shërbimeve të tij në Bashkinë e Shkodër	21,480,000	Qytetarët e Bashkisë Shkodër, turistët vendas dhe të huaj. Agjensitë e udhëtimeve turistike të Shkodrës.
4	Sistem informacioni dixhital multifunksional për përmirësimin e shërbimeve për qytetarin	114,808,000	Qytetarët/bizneset e Bashkisë Shkodër. Institucionet e artit, trashëgimisë kulturore, arsimin, sportit dhe turizmit të Bashkisë Shkodër. Mësuesit, nxënësit dhe prindërit e një shkolle të qytetit të Shkodrës.
		<b>data 27.06.2016</b>	
5	Implementimi i sistemit të gjeografik të informacionit për administrimin e procesit të shfrytëzimit të hapësirës publike	16,788,000	Bashkitë (stafi front-line, back-office, kryetari), Qytetarët, bizneset, ojq

Realizimi i fondeve të alokuara nga transferata e kushtezuar, paraqitet si më poshte:

000/leke


Emertimi	TOTALI	
	Plan	Fakt
QKR	1,342	1,342
Gjendja Civile	16,395	15,962
Invaliditet+Paaftesia+Nd.Ekon	962,345	962,342
Trajtim ushqimor per nxenesit konviktore	11,373	9,282
Shpenzime transporti"	1,812	1,591
Shpenzime transporti	20,531	19,445
Shpenzime trajtimi ushqimor shkolla 3 dhjetori	2,400	2,293
Emergjenca Civile	1,342	1,342
Ndert.kan.te Ujrave.bardha+zeza(shin.trenit-L.kir)	20,100	20,059
Rikonstruksion objekte banimi	3,838	3,836
Skema ujitesse Gur I Zi - Juban (faza I+II)	16,455	6,155
Skema ujitesse Berdice Shkoder	32,710	-
Blerje eskavator me zinxhir	25,402	25,402
Rikonstruksion blloku I pallateve Xhabije	8,192	5,408
<b>TOTALI</b>	<b>1,124,238</b>	<b>1,074,460</b>

Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transferten e kushtezuar ne total eshte 96% . Shpenzimet per paga jane realizuar ne masen 97% , shpenzimet operative ne masen 90 %, transfertat 100% dhe inestimet ne masen 57%.Me VKM nr 926, date 21.12.2016,“Për rishpërndarjen dhe detajimin e fondit të investimeve për funksionin e ujitjes dhe kullimit per bashkite " jane akorduar 10.300 mije per fazen e dyte “Rehabilitimi i pjesshem i skemes ujitesse Gur i Zi – Juban” dhe 32.710 mije leke per “Rehabilitimin e pjesshem te skemes ujitesse Berdice Shkoder”, ne programin 4240 “ Menaxhimi I infrastruktures se kullimit dhe ujitjes “. Keto fonde jane akorduar ne fund te vitit.


000/leke

Emertimi	Plani fillestar	Plani i korigjuar	Fakti	Realizimi ne %
Paga dhe Sigurime	15,693	15,693	15,259	97%
Shpenz.Operative	37,375	36,175	32,672	90%
Transferime	167,000	965,672	965,669	100%
Investime	15,772	106,698	60,860	57%
<b>Totali</b>	<b>235,840</b>	<b>1,124,238</b>	<b>1,074,460</b>	<b>96%</b>

**Realizimi i shpenzimeve 2016 ne 000/leke me burim financimi transferten e kushtezuar**



**Realizimi i shpenzimeve 2016, ne %, ne krahasim me planin, me burim financimi transferten e kushtezuar**





## **Detyrimet e prapambetura të njërive të vetëqeverisjes vendore**

Sipas percaktimit ne udhezimin e Ministrise se Financave, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet financiare të përcaktuara nga një ligj/kontratë /marrëveshje /vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 60 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e vetëqeverisjes vendore (kontratat e financuara nga qeveria qendrore).

Në detyrimet e prapambetura të lindura në njësitë e vetëqeverisjes vendore përfshihen vetëm detyrimet për punimet e kryera por të papaguara në kuadër të financimeve nga fondi për zhvillimin e rajoneve, si edhe transfertat për përfitimet e paaftësisë. Të gjitha detyrimet e tjera financiare të njërive të vetëqeverisjes vendore, që nuk përfshihen në sa më sipër, duhet të parashikohen në vetë buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Me vendim te Këshillit Bashkiak nr. 15 Dt. 28.04.2016 “Per miratimin e buxhetit faktitk te vitit 2015 te Bashkise Shkoder” Bashkia Shkoder, ka trashëguar nga ish-komunat detyrime per vendime gjykate te formes se prere ose ne proces, detyrime me fatura, detyrime pa fatura dhe vetem me kontrata.

Gjate vitit 2016, Bashkia Shkoder ka likuiduar detyrime per shpenzime operative ne shumen 12,595 mije leke, nga te cilat 1,830 mije leke vendime gjyqesore;investime 5,532 mije leke, fatura te kontratave te regjistruara qe nga vitet e kaluara me financim nga FZHR, ne vleren 59,020 mije leke.

Detyrimi për “Shpenzime Gjyqësore”, ka qenë 33,596 mije lekë, dhe kane mbetur pa likuiduar 31,765 mije lekë detyrime per të cilat vazhdon gjykimi dhe shpresojmë që këto procese të finalizohen në favor të Bashkisë Shkodër. Me realizimin e buxhetit te vitit 2015, u parashikuan fondet per likuidimin e vendimeve gjyqesore.

Gjate gjithë vitit 2016, Bashkia Shkoder, ka raportuar ne Agjencine e Zbatimit te Reformes Territoriale dhe Ministrine e Financave me shkresat nr.9520 Prot, datë 01.08.2016, nr.13918 prot, datë 25.10.2016, nr.16274 Prot, datë 09.12.2016” per detyrimet e trashëguara nga zbatimi i reformes territoriale.

Gjate korespondences me keto institucione, u shpresua se detyrimet e mbartura nga ish komunat do te financoheshin ne kuadrin e borxhit kombetar.

Ne muajin tetor 2016, ne takimin e organizuar me te gjithë perfaqesuesit e njësive vendore,nga Ministria e Financave dhe Ministri i Shtetit per Çështjet Vendore, ne prani edhe te shume organizatave nderkombetare, qe operojne ne Shqiperi, u be e ditur qe te gjitha detyrimet e prapambetura te trashëguara, do te perballoheshin nga buxhetet e njësive vendore.

Ne detyrimet e prapambetura, te mbartura nga ish-komunat ka edhe procedura me parregullsi financiare, te pamundura te likuidohen, te cilat do te jene objekt auditimi i njësise auditimit te brendshem dhe auditimit te jashtem ( KLSH-ja).

Në buxhetin e vitit 2017, Bashkia Shkoder ka përfshire edhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të krijuara gjate vitit 2016, nje fature 2,911 mije lekë, shumë e mbetur pa likuiduar nga mosakordimi i fondit te plotë nga Ministria e Zhvillimit Urban, për objektin “Ndërtim i Kanalizimit të ujërave të zeza, Dalja shinat e trenit-Lumi Kir” .

## Të ardhurat e veta vendore

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat dhe tarifave vendore, të ardhurat të tjera dhe donacione,. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Gjatë vitit 2016 përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve.

Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efikasitet të aseteve të veta, implementimit të procedurave online e të thjeshta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arketimeve nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të bashkisë.

Objektivat sipas programit të kryetarit të bashkisë, kryesisht të fokusuara në lehtësimin maksimal fiskal, kanë ndikuar në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, duke ruajtur dhe madje duke induktuar me efikasitet rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Gjithashtu mundësimi i shlyerjes së pagesave sa më pranë taksapaguesit, dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpërmjet zyrave me Një Ndalese dhe agjentit tatimor Ujesjelles Kanalizime të shpërndara gjeografikisht në territorin e bashkisë pranë qytetarit, si dhe shtrirja e përshtatja e afateve të pagesave me qëllim lehtësimin e taksapaguesit, kanë ndikuar në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe mardhënies me taksapaguesin.

Objektivat e përcaktuar e të realizuar, dhe që kanë ndikuar në përmirësimin e klimës së biznesit, duke ruajtur e madje duke rezultuar si politika efikase në rritjen e të ardhurave, janë ulja e taksave të banesave, nivele deri në minimumin ligjor të lejuar për taksat e ndërtesave për të gjithë bizneset, mbeshtetja e disa aktiviteteve të veçanta si bizneset e prodhimit, lehtësimi kryesisht i bizneseve të vogla, mbështetja me tarifa zero për fermerët, shtyerje e afatit të pageses deri në mes të vitit fiskal duke ju larguar kështu afateve ligjore për shlyerjen e detyrimeve tre/mujore për institucionet shtetërore, etj, me rezultat dhenie frymëmarrje financiare biznesit.

Politikat e ngjashme për gjendjen sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevojë, taksa në minimumin e lejuar ligjor për tokën bujqësore, mundësia e arkëtimit në këste dhe pranë njësive administrative ku banojnë etj, janë zbatuar dhe kanë rezultuar të sukseshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë, por edhe për vetë rritjen e të ardhurave nga viti në vit.

Keto politika të lehtësive fiskale kundrejt përmirësimit të shërbimit janë shoqeruar natyrisht me objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Rritja e vazhdueshme e të ardhurave si nga biznesi, ashtu edhe nga taksapaguesi familjar, kundrejt fokusimit për uljen e barrës fiskale nga ana tjetër, vërteton efikasitetin e këtyre politikave, kundrejt rezultatit pozitiv që bashkia ka arritur në rritjen e bazës së taksapaguesve, si familjar, ashtu edhe atij biznes.

Objektiv i rëndësishëm gjatë vitit 2016 ka qenë krijimi i regjistrave të sakte të kapaciteteve fiskale duke përfshirë gjithë territorin e bashkisë. Për këtë arsye u fuqizuan më tej strukturat e konstatimeve në vend të këtyre kapaciteteve, u ushtruan verifikime të vazhdueshme në të gjitha

njësitë administrative, duke vijuar me formalizimin etë dhënave me efekt arritjen e rezultate të mira në zërat kryesore të të ardhurave.

Kështu, të ardhurat për vitin 2016 në pjesën dërrmuese të kategorive dhe zërave janë realizuar duke përmbushur pritshmëritë referuar kapaciteteve të planifikuara.

Objektivi kryesor për sigurimin dhe rritjen e të ardhurave në krahasim me vitin e kaluar u plotësua në masën 105%, ndërsa në veçanti kategoritë që lidhen me të ardhurat nga biznesi dhe familjet, krahasuar me planin vjetor janë realizuar në masën 108%. Gjithashtu përgjatë vitit 2016 është siguruar njëtrajtshmëri në nivelet e arkëtimeve, duke garantuar kështu të ardhurat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave në disa zëra u ndikua nga shpallja ose ndryshimi i vonuar i disa ligjeve ose akteve nënligjore, si ligji për qeverisjen vendore dhe për taksat dhe tarifat vendore duke shtyrë mundësinë e miratimit në kohë të paktes fiskale, legjislacioni për turizmin që përcolli veshtirësi në planifikimin, organizimin dhe shfrytëzimin e kapaciteteve në zonat e plazhit, kalimi i vonuar i disa institucioneve me funksionet dhe asetet përkatëse efektivisht të shfrytëzueshme, morandumi për pyjet dhe shërbim pyjor që u shoqërua me pamundësinë e shfrytëzimit të tyre, tkurrja e investime në sferën e ndërtimit nga vonesa në përfundimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, ndryshimet e vazhdueshme të akteve nënligjore në procedurat e aplikimit për leje ndërtimi, etj.

Të ardhurat e veta u realizuan në proces dhe bashkëpunim me gjithë administratën e bashkisë, me Njësitë Administrative, me Institucionet si agjentë tatimorë, institucionet shtetërore etj. Vijimi i këtij procesi bashkëpunues do mundësojë më tej sigurimin e të ardhurave për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorit të bashkisë.

## **Kategorizimi i të ardhurave**

- Taksat vendore:
  - Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për ndërtesa, troje dhe toka bujqësore
  - Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
  - Taksa e fjetjes në hotel
  - Taksa e tabelës për qëllime reklamimi ose identifikimi
  - Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë, agjent tatimor ZRPP
  - Taksa vjetore e mjeteve të përdorura, agjent DRShTRr
  - Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare agjent DRT
  - Tatimi thjeshtuar mbi fitimin, biznesi vogël nga 5 milion deri në 8 milion, agjent DRT
  
- Tarifat vendore
  - Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
  - Tarifa për ndriçimin publik
  - Tarifa për gjelbrimin
  - Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Shkodër
  - Tarifa për parkimin e mjeteve e liçensuara dhe vendparkime publike
  - Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri
  - Tarifa për zënien e hapësirave publike

- Të ardhura të tjera:
  - Të ardhura nga Institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.
  - Të ardhura nga gjoba
  - Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve, zhdëmtime, shitja e mallrave dhe e shërbimeve etj

## Analiza e realizimit të të ardhurave nga burimet e veta vendore

Të ardhurat nga burimet e veta vendore për vitin 2016 u realizuan në vlerën 506.154 mijë Lekë. Ato përfshijnë të ardhurat nga taksat, të ardhurat nga tarifatat dhe të ardhurat nga burime të tjera. Pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të ardhurat nga taksat (50%).

<b>Të ardhurat nga Burimet e Veta Vendore /000 lekë</b>	<b>506.154</b>
Të ardhura nga taksat	250.258
Të ardhura nga tarifatat	219.200
Të ardhura nga burime të tjera vendore	36.696




Tabela e mëposhtme pasqyron realizimin e të ardhurave në çdo njësi administrative gjatë vitit 2016, të kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik.


Realizimi i të ardhurave viti 2016, sipas kategorive dhe njësive

- Janë realizuar, 3 procedura blerje e përqëndruar nga autotiteti kontraktor, kontretisht: Blerje karburant per nevojat e Bashkisë dhe të institucioneve të varësisë me vlerë 14.855.mijeleke, blerje kancelari për nevojat e Bashkise dhe institucioneve të varësisë në vlerën 5.732.mijeleke, dhe blerje paisje TIK për nevojat e Bashkise dhe te institucioneve të varësisë në vlerën 5.276.mijeleke.
- Janë përgatitur, të gjithë dokumentacionet që kanë të bëjnë me proceduren e prokurimit. Duke filluar që nga miratimi I kërkesës për prokurim, përgatitja e urdhërit të prokurimit, urdhërave të KVO-së dhe shpërndarja tek anëtarët e këtij komisioni, hedhja në system e të gjithë dokumentacionit teknik, ndjekja hapa pas hapit e procedurës së prokurimit, hedhja e njoftimit të fituesit në system duke respektuar afatin e parashikuar, dërgimi për kontratë i procedurës së prokurimit pranë Drejtorise Juridike dhe dërgimi për likujdim pranë Drejtorisë së Financës.



- Janë dërguar, urdhërat e prokurimit për miratim pranë degës së Thesarit Shkoder.
- Janë hartuar dokumentat standarte duke siguruar një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues përtë gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Janë përditësuar kriteret teknike në dokumentat standarte, duke vendosur kriterë më të forta të parashikuara në ligj, për arsye të marrjes së një shërbimi më cilësor nga operatorët ekonomik pjesëmarrës. Në çdo procedurë prokurimi ka pasur një pjesëmarrje masive të operatorëve ekonomik.
- Në bashkëpunim me drejtorinë, janë kontrolluar preventivat për gabime të ndryshme matematikore, vlerat e preventivit që të mos e kalojnë vlerën e parashikuar në rregjistrin e parashikimeve. Gjithashtu çmimet e zërave të punimeve janë kontrolluar me manualin e miratuar me VKM nr. 629 dt. 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike...”. Për zërat që nuk janë të parashikuar në manual janë kërkuar analizat teknike të çmimeve.
- Janë realizuar, asistencë të ndryshme nga njësi e prokurimit ndaj komisioneve të vlerësimit të ofertave, sidomos në lidhje me kriteret e veçanta që ka kërkuar njësi e prokurimit. Këtu përfshihet shpjegimi për vendosjen e kriterit për çertifikatat ISO, inxhinierët e ndryshëm të kërkuar në bazë të zërave në preventiva etj.
- Janë realizuar shtesat e rregjistrin, për drejtorinë e Bashkisë së bashku me institucionet e varësisë, për rastet kur objekti i prokurimit ka qënë i miratuar në fishen e programit përkatës por nuk kanë qënë të parashikuara në rregjistrin përfundimtar të vitit 2016.
- Gjatë kësaj periudhe janë realizuar, kthim përgjigje për të gjithë operatorët që kanë paraqitur ankesa pranë autoritetit kontraktor si për kriteret ashtu edhe për vlerësimin nga komisioni i vlerësimit të ofertave.
- Përgatitja e informacionit për komisionin e prokurimit public, në lidhje me ankesat që kanë paraqitur operatorët ekonomikë pranë këtij komisioni, në lidhje me vendimet që ka marrë autoriteti kontraktor për ankesat e këtyre operatorëve.
- Jemi në proces, të inventarizimit dhe arkivimit të të gjitha dosjeve të prokurimit për vitin 2016.

### III Fondet e financimit të programeve

Është miratuar rialokimi i fondeve brenda programit me shumë totale: 1935 mijë lekë pakësim tek shpenzimet operative dhe shtesë 1935 mijë lekë tek Investime:

- P1.F1.O2.A1 Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës pakësim 380 mijë lekë nga shpenzim operative “ Blerje kancelari”, dhe shtesë tek investimet programi P1.F1.O2.A31 “Ndërtimi i sistemit digital të konferencës dhe rregjistrimit audio në sallën e Këshillit Bashkiak”, miratuar me VKB Nr. 52 dt 02.11.2016.
- Me Vendim të Kryetares së Bashkisë nr. 609, datë 07.09.2016 dhe Nr.753 datë 24.10.2016 u bë pakësim tek P1.F1.O2.A2 : “Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për Administratën e Bashkisë së Shkodrës” perkatesisht në vlerën prej 388 mije lekësh për shtesë blerje shtypshkrime.
- Me Vendim të Kryetares së Bashkisë nr .715, datë 29.9.2016 është bërë pakësim prej 274 mije lekesh tek P1.F1.O2.A20 :” Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Shkodrës” dhe kalim tek P1.F1.O2.A28:”Zgjerimi i Sistemit të Integruar të Zyrës me Një Ndalesë (SIZ1N) në Njësi administrative” .ne vlerën 274 mije leke

- Me Vendim nr. 753 date 24.10.2016 të Kryetares së Bashkisë është bërë pakesim ne P1.F1.O2.A2 “Blerje kancelari” dhe shtese prej 1 281 mije lek per: P1.F1.O2.A17 “Rikonstruksion të rrjetit elektrik të godinës në qendër të Bashkisë së Shkodrës”
- Me VKB Nr.52 date 02.11.2016 u be pakesim tek P1.F1.O2.A23 “Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) ne vleren prej 3 568 mije lekesh për transferim tek P1.F1.O2.A31 “Ndertimi i sistemit dixhital te konferences dhe rregjistrimit audio ne sallën e Keshillit bashkiak” .
- Me VKB nr.53 dt 02.11.2016 u transferua vlera prej 2744mije lekesh nga P1.F1.O2.A27 “Mirëmbajtje e ambienteve fizike shtesë të rikonstruktura dhe dixhitalizimi i arkives” per “Rikonstruksion Njësia Administrative Guri Zi” për krijimin e kushteve në infrastrukturë prane kesaj njesie

Totali i financimit të programit planifikim menaxhim administrim, duke përfshire edhe emergjencat civile dhe mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimi, ne total është 347,567 mijë leke. Realizimi i programit për periudhën 12 mujore është 282,121 mijë lekë. Realizimi në total është 81 %.

#### Fondet për shpenzime korrente sipas planit 2016 per programin e administrates vendore janë:

- Fondi për « Paga dhe Sigurime shoqërore » u realizua në vlerën prej 178 245 mijë lekë, nga totali 219 135 mijë lekë plani i korigjuar për vitin 2016 .Realizimi 81 %
- Shpenzime Operative janë realizuar në masën 35 290 mijë lekë, nga 51 685 lekë plani i korigjuar 2016. Realizimi është 68 %.
- Transferta janë realizuar në masën 4294 mijë lekë, nga 4612 mijë lekë plani i korigjuar 2016. Realizimi është 93 %.
- Investime janë realizuar në vlerën 24 752 mijë lekë, nga 30 663 mijë lekë plani i korigjuar 2016.. Realizimi 80.7 %.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.

Aktivitete/Projekte	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi
P1.F1.O1.A1 Ndërtim i administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.	204 170	204 350	163,575
P1.F1.O1.A2 Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.	800	800	800
P1.F1.O1.A3 Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shkodrës	400	400	-
P1.F1.O2.A1 Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës	11,475	11,095	8,111

P1.F1.O2.A2 Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për Administratën e Bashkisë së Shkodrës	6,120	4,839	4,593
P1.F1.O2.A3 Shërbim higjeno-sanitar për Administratën e Bashkisë së Shkodrës	120	120	117
P1.F1.O2.A4 Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale hidraulike, elektrike, dhe paisje të tjera shtesë)	927	927	784
P1.F1.O2.A5 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës	2,880	2,880	2,879
P1.F1.O2.A6 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të mirëmbajtjes së mjeteve të transportit për administratën e Bashkisë së Shkodrës	250	250	192
P1.F1.O2.A7 Likuidim taksa qarkullimi, detyrime të trashëguara nga ish komunat ndër vite	2,243	2,243	813
P1.F1.O2.A8 Likuidim i taksave dhe detyrimeve për mjetet e transportit të administratës së Bashkisë së Shkodrës (sigurimi, kolaudimi dhe pagesa e taksës së qarkullimit për mjetet e transportit)	1,000	1,000	381
P1.F1.O2.A9 Shërbime të riparimit të mjeteve të transportit përfshirë në inventarin e Bashkisë Shkodër pas reformës territoriale	800	800	336
P1.F1.O2.A10 Udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë	150	150	115
P1.F1.O2.A11 Organizimi i pritjeve të përfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja dhe udhëtime jashtë shtetit	2,400	2,400	843
P1.F1.O2.A12 Blerje dhurata për personalitete dhe delegacione të huaja	300	300	-
P1.F1.O2.A13 Mirëmbajtje e pajisjeve të zyrave administrative të Bashkisë së Shkodrës	120	120	-
P1.F1.O2.A14 Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shkodrës	1,176	1,176	1,173
P1.F1.O2.A15 Sigurimi i ndërtesave administrative të Bashkisë së Shkodrës dhe inventarit të tyre ekonomik.	1,000	1,000	795
P1.F1.O2.A16 Shërbim i mirëmbajtjes për godinat administrative të Bashkisë së Shkodrës	800	800	529
P1.F1.O2.A17 Rikonstruksion i rrjetit elektrik të godinës në	3,500	4,781	94



qendër të Bashkisë së Shkodrës			
P1.F1.O2.A18 Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake	500	500	371
P1.F1.O2.A19 Shërbimi për regjistrimin e pronave të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër	2,500	2,500	237
P1.F1.O2.A20 Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Shkodrës	1,967	1,693	1,378
P1.F1.O2.A21 Ristrukturim fizik dhe teknik i Dhomës së Server-ave	244	244	198
P1.F1.O2.A22 Mirëmbajtje pajisje informatike	800	800	662
P1.F1.O2.A23 Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	8,000	4,432	4,417
P1.F1.O2.A24 Mirëmbajtje e faqes zyrtare <a href="http://webwww.bashkiashkoder.gov.al">webwww.bashkiashkoder.gov.al</a> dhe moduleve të integruara të saj	172	172	170
P1.F1.O2.A25 Zgjerimi i rrjetit kompjuterik (Intranet) për komunikimin elektronik të brendshëm, implementimi i Sistemit të Kontrollit të Aksesit dhe Sistemit të Vëzhgimit	6,050	6,050	6,049
P1.F1.O2.A26 Implementimi i Sistemit të Menaxhimit të Dokumentave në një Bazë të Dhënash Qendrore të Qendëruar dhe të Integruar (Integrated Active Directory System)	644	644	0
P1.F1.O2.A27 Mirembajtje e ambienteve fizike shtesë të rikonstruara dhe digjitalizimi i arkives.Ky fond me VKB u transferua për krijimin e kushteve në infrastrukturë për “Rikonstrukcion Njësia Administrative Guri Zi”	2,744	2,744	2,309
P1.F1.O2.A28 Zgjerimi i Sistemit të Integruar të Zyrës me Një Ndalesë (SIZ1N) në Njësi administrative	-	1,644	1,644
P1.F1.O2.A29 Implemtimi i sistemit të informacionit për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore	5,000	5,000	4,920
P1.F1.O2.A30 Shërbimet e deleguara të QKR dhe Gjendja Civile (paga, sigurime dhe shpenzime operative)	15,752	17,737	17,304
P1.F1.O2.A31 Ndertimi i sistemit digital te konferences dhe rregjistrimit audio ne sallën e Keshillit bashkiak miratuar me VKB 53 date 02.11.2016	-	3,948	3,948
P1.F1.O3.A1 Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshilli i Bashkisë dhe Kryepleqtë	16,336	16,336	11,625

P1.F1.O3.A2 per dhenie ndihme financiare lagjev e Hasanbeg, Cair, Smilkoviç dhe Stajkoviç te Shkupit ne Republikën e Maqedonise per solidarizim per perballimin e fatkeqesise nga permybtjet e ndodhura ne fillim te gushtit 2016.	1,220	1,220
--	-------	-------

**TOTALI** **301,340** **306,095** **242 581**

#### Fondet për shpenzime korrente sipas planit 2016 për Drejtoria e Emergjencave Civile, Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit :

Fondet e miratuara për Drejtoria e Emergjencave Civile, Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimit janë 41,472 mijë lekë. Realizimi për periudhën 12-mujore është 39,540 mijë lekë në masën 95.3 % ndaj planit vjetor të vitit 2016.

- Fondet për shpenzime personeli në zërin “Pagat dhe sigurimet shoqërore”, nga 28 891 mije lekë te parashikuara për vitin 2016, për periudhën 12-mujore realizimi është në masën 27,206 mije lekë ose 94%.
- Shpenzime operative për vitin 2016 janë planifikuar 10 442 mijë lekë, për periudhën 12-mujore realizimi është në masën 10.194 mije lekë ose në masën 98 %
- Fonde për transferime tek individë për vitin 2016 janë planifikuar 2.139 mijë lekë. Për periudhën 12-mujore realizimi është në masën 2.139 mije lekë ose 100%. Ketu jane perfshire dhenie ndihme financiare familjeve per fatkeqesite e shkaktuara nga zjarri, nga vlera 1.862 mije lek eshte realizuar ne vleren 1.862 mije leke, nga te cilat 520 mije me fondin rezerve te bashkise.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.

Aktivitete/Projekte	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi
P1.F2.F3.O1.A1. Krijimi dhe venia ne funksion e Drejtorise se Emergjencave Civile	642	642	483
P1.F2.F3.O1.A2. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	30678	31578	29985
P1.F2.F3.O3.A1. Paisja dhe kolaudimi i çdo objekti në pronësi dhe përdorim të bashkisë për mbrojtjen kundër zjarrit.	7390	7390	7210
Dhenie ndihme financiare familjeve per fatkeqesite e shkaktuara nga zjarri		1862	1862
<b>Totali</b>	<b>38 710</b>	<b>41 472</b>	<b>39540</b>

#### IV Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.

- Vështirësitë e hasura gjatë implementimit të buxhetit sipas secilit aktivitet kanë konsistuar në projektet si më poshtë :

- Aktiviteti për “Blerje dhurata për personalitete dhe delegacione të huaja” nuk është realizuar për shkak të mos realizimit të procedurave të prokurimit. Është tenderuar disa here me pjesmarrjen e disa operatorëve ekonomikë cilet janë terhequr nga konkurimi.
- Rikonstruksion i rrjetit elektrik të godinës në qendër të Bashkisë së Shkodrës
- Është përgatitur dokumentacioni tekniko ligjor, dhe menjëherë pas miratimit me Vendim nr. 753 date 24.10.2016 të Kryetares së Bashkisë ,është dërguar për realizimin e procedurës së tenderimit .Për këte aktivitet është realizuar vetëm projekti i rikonstruksionit të rrjetit elektrik në godinën e Bashkisë Qendër, kurse realizimi i zbatimit të këtij projekti nuk u arrit për arsye se procedurat e projektit janë anuluar disa herë për shkak të tërheqjes së operatorëve ekonomik ofertues.
- Shërbimi për regjistrimin e pronave të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër.
- Janë realizuar 109 (njëqind e nëntë) aplikime për regjistrimin e pronave të paluajtshme publike të Bashkisë së Shkodrës. Për 141 (njëqind e dyzet e një) aplikime për regjistrim të pronave publike, te kryera ne vite nga ana e bashkise, nuk ka nisur procesi i regjistrimit nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe me gjithe korespondancat e vazhdueshme, nuk kemi asnje pergjigje.
- Implementimi i Sistemit të Menaxhimit të Dokumentave në një Bazë të Dhënash Qendrore të Qendëruar dhe të Integruar (Integrated Active Directory System) .
- Ky aktivitet është rishikuar gjatë vitit 2016 për t’u plotësuar dhe zgjeruar më tej me platforma të licensuara të avancuara si ajo Integrated Active Directory përmes Microsoft dhe Micorsoft Office 365. Në vitin 2016 është vendosur të mos implementohet duke u transferuar për implementim në vitin 2017 si parashikim në buxhetin e vitit 2017.
- Likuidim taksa qarkullimi, detyrime të trashguara nga ish komunat ndër vite.
- Është kryer pagesa e taksave vjetore të prapambetura vetëm për disa mjete të Njërive Administrative, pasi pritej dalja e ligjit për faljen e të gjitha detyrimeve dhe gjobave në vite për automjetet.

## P.2 Planifikimi urban

Shkodra është porta hyrëse e korridorit Veri-Jug (të transportit rrugor), që lidh Shqipërinë me zonën e rrjetit të ardhshëm të korridoreve dhe lidhjeve të tyre të transportit rrugor për Europën Juglindore, ku përfshihen: Shqipëria, Mali i Zi, Kosova, etj. Territori i ri administrativ i Bashkisë së Shkodrës përmban potenciale të shumta zhvëllimore për shfrytëzimin e kësaj larmie në funksion të mirëqënies së qytetarit.

Programi i menaxhimit të territorit mbulon gjithë territorin administrativ të bashkisë me të gjitha llojet dhe karakteret e territorit si ajo urban, rural, bujqësor, natyror apo sipërfaqe ujore. Zhvillimi dhe menaxhimi territorial i Bashkisë Shkodër do të bazohet mbi parimet e bashkëpunimit ndërvendor dhe ndërkufitar për të siguruar rolin kyç që do të ketë bashkia në zhvillimin rajonal, si dhe në parimin e integritit territorial të brendshëm, për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar të të gjithë territorit të administruar nga Bashkia e Shkodrës në kontekstin e zhvillimit ekonomik, mobilitetit, burimeve natyrore, duke ju pergjigjur dinamikave zhvillimore demografike.

## I Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2016 ka fokusuar përpjekjet e saj në një funksion zhvillimi:

F1.Planifikimin, administrimin dhe kontrollin e territorit sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivat për secilin funksion janë:

F1.O1. Hartimi, mbështetja dhe monitorimi i proceseve planifikuese në Bashkinë Shkodër, me qëllim sigurimin e kornizës së përgjithshme të zhvillimit të territorit dhe promovimit të tij.

F1.O3. Realizimi dhe Monitorimi i Sistemit të Adresave si mjet për përmirsimin e shërbimeve dhe identitetit të qytetarit

F1.O3. Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale duke siguruar lidhjen e të gjitha qendrave të banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombëtar.

## II Produktet për vitin 2016

Gjatë vitit 2016 është punuar për përmbushjen e objektivave, nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër:

F1.O1.A1. Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Shkodër.

Gjatë vitit 2016 Është ndërmarrë nisma për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor. Nisma për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor është miratuar në Këshillin e Bashkisë. Ka nisur procesi i hartimit të PPV për Bashkinë e Shkodrës. Janë realizuar dëgjesa publike si dhe janë hartuar draftet e dokumentave përbërës të PPV. Specialistët dhe teknicienët në Bashkinë e Shkodrës kanë bërë verifikimet si dhe sugjerimet teknike dhe ligjore, AKPT-së dhe subjektit të kontraktuar nga MZHU për punimin e planit.

F1.O1.A2. Publikimi i Planit të Përgjithshëm Vendor Përfundimtar nëpërmjet publikimit elektronik dhe mjeteve tradicionale të informimit.

Për arsye të mos përfundimit të fazës së hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Shkodër, në përputhje me instrumentat e planifikimit, publikimit elektronik dhe mjeteve tradicionale të informimit nuk është realizuar.

F1.O2.A1. Rivlerësimi, realizimi dhe monitorimi i Sistemit të Adresave Bashkia Shkodër.

Për qytetin dhe njësitë e përmendura, është realizuar azhurnimi i objekteve të reja të ndërtuara në vitet e fundit. Bashkia Shkodër aktualisht po përditëson sistemin hartografik elektronik të informacionit bazuar mbi verifikimin në territor.

F1.O3.A1. Projektim Rikonstruksion rruga degëzimi "Isuf Sokoli"

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.8166/15 datë 17.08.2016 është realizuar projektimi i këtij objekti.

F1.O3.A2. Projektim Rikonstruksion rruga Qazim Llazani.

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.8166/16 datë 17.08.2016 është realizuar projektimi i këtij objekti.

F1.O3.A3. Projektim Rikonstruksion degëzimi rruga Draçin.

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.8166/17 datë 17.08.2016 është realizuar projektimi i këtij objekti.

F1.O3.A4. Projektim Rikonstruksion rruga e varrezave Beltojë

Me vendimin e kryetares së Bashkisë nr.726 datë 03.10.2016 fondi i parashikuar për këtë objekt është rialokuar për objektin Projektim Rikonstruksion rruga Gjomarkaj duke iu referuar listës së projekteve prioritare të miratuara nga Këshilli Bashkiak

F1.O3.A5. Projektim rikonstruksion i rrugës Stacionit pompave-Dobrac NJA Rrethina.

Projektimi i këtij objekti është në procedurë prokurimi.

F1.O3.A6. Projektim Rikualifikimi urban blloqe banimi "Qemal Draçini" (pallati me hark).

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.8166/18 datë 17.08.2016 është realizuar projektimi i këtij objekti.

F1.O3.A7. Projektim Rikualifikimi urban blloqe banimi "Bardeleve"(Pogej).

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.8166/25 datë 17.08.2016 është realizuar projektimi i këtij objekti.

F1.O3.A8. Projektim Rikualifikimi urban blloqe banimi "Tepe" (te fusha e druve).

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.8166/24 datë 17.08.2016 është realizuar projektimi i këtij objekti.

- Projektim Rikonstruksion rruga Bulevardi Skenderbeg (ish rajoni 4).

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.8166/22 datë 17.08.2016 është realizuar projektimi i këtij objekti.

- Projektim Rikonstruksion rruga Osja e Falltores (blloqe pallatesh).

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.8166/21 datë 17.08.2016 është realizuar projektimi i këtij objekti.

- Projektim Rikonstruksion rruga Edit Durham (tek shkolla Martin Camaj).

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.8166/20 datë 20.08.2016 është realizuar projektimi i këtij objekti.

- Projektim Rikonstruksion rruga Mandave.

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.8166/24 datë 17.08.2016 është realizuar projektimi i këtij objekti.

- Projektim Rikonstruksion rruga Smakej.

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.8166/23 datë 17.08.2016 është realizuar projektimi i këtij objekti.

- Projektim Rikonstruksion rruga "Memorandumi Greces"

Projektimi i këtij objekti është në procedurë prokurimi.

- Projektim Rikualifikim Urban blloqe banimi "Bulevardi Zogu i Pare"(Xhabije)

Projektimi i këtij objekti është në procedurë prokurimi.

- Projektim Rikualifikim Urban blloqe banimi "Qemal Dracini" (tek Sahati)

Projektimi i këtij objekti është në procedurë prokurimi.

- Projektim Rikonstruksion rruga Oblikë-Velinaj-Ali Metaj (segmenti Fusha e Çunit-Kryqëzim Lagja Garuc).

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.14138/6 datë 16.11.2016 është realizuar projektimi i këtij objekti.

- Projektim Rikonstruksion rruga Gjomarkaj.

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.14138/7 datë 16.11.2016 është realizuar projektimi i këtij objekti.

**Drejtorja Kontrollit Zhvillimit Territorit, Sektori i Lejeve të Ndërtimit dhe Kontrollit mbi Territorin dhe Inspektoriatit Mbrojtjes mbi Territorit** gjatë vitit 2016 ka zhvilluar aktivitetet si më poshtë;

Drejtorja Kontrollit Zhvillimit Territorit ka punuar në kushtet e ndryshimit të herë pas hershëm të lëgjislacionit të fushës së planifikimit. Duke pasur ndryshim të ligjit dhe akteve plotësuese të tij. Ndryshimi i rregullores së Planifikimit, të asaj të kontrollit të territorit, mënyrës së aplikimit, të



komunikimit me institucionet e treta dhe me qytetarin. Gjithashtu problematike ka qënë edhe bllokimi i lejeve dhe krijimi e mundësi i aplikimit përmes i hapësirave të rasteve përjashtimore.

Është punuar në kushtet e ndryshimeve të ardhura si pasojë e reformës territoriale. Marrja e arkivave dhe e dijenisë së veprimit dhe mosveprimit të ish zyrave të ish njësite vendore, territori i zmadhuar disafish duke bërë të pamundur mbulimin e territorit dhe sqarimin e të interesuarve në vënd.

Spektori i Lejeve të Ndërtimit dhe Kontrollit mbi Territorin gjatë vitit 2016 ka shqyrtuar dhe miraturar 108 (njëqind e tetë) Leje Zhvillimi e Ndërtimi (nga të cilat 9 dekalrata paraprake punimesh të dhena me sistemin e-leje), 59 (pesëdhjetë e nëntë) Deklarata Paraprake Punimesh.

Spektori i Kontrollit mbi Territorin dhe Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit ka ndërmarë 20 (njetzet) ndërhyrje në territory, sipas informacionit të mëposhtëm (forma tabelare):

Duke pasur parasysh problematikat e sipërpërmëndura, stepjen, klimën dhe krizën “ekonomike” në të cilën ndodhet në përgjithësi biznesi i ndërtimit nga njëra anë dhe presionit të krijuar nga legjislacioni favorizues dhe lehtësi i procedurave të legalizimit nga ana tjetër, që stimulojnë në çdo kohë ndërtimin pa leje, duhet thënë se është e konsiderueshme shkalla e vështirësisë së “Kontrollimit Zhvillimit Territorit”.

Drejtoria Kontrollit Zhvillimit Territorit dhe specialistët e sajë gjithashtu përveç shqyrtimit tëproblematikave të përditshme dhe sqarimit të qytetarëve ka qënë pjesë dhe ka trajtuar edhe:

- Pjesëmarrje në shqyrtimin dhe realizimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër;
- Punuar mbi rregulloren e Drejtorisë dhe të Bashkisë.
- Shqyrtimin e kërkesave për vendosje tabelash;
- Pjesëmarrje ne KVO;
- Shqyrtimin e problematikave të rrjeteve të Infrastrukturës buplike dhe private që shtrihet në territorin në pronësi dhe administrim të bashkisë Shkodër;
- Bashkëpunimin me drejtoritë dhe institucionet e varesisë së Bashkisë Shkodër në verifikimin dhe shqyrtimin e problematikave sektoriale (asetet, ujselles kanalizimin, sherbimet, infrastrukturen, prokurimet, etj).
- Detyra të tjera të caktuara nga titullari.

### III Fondet e financimit të programeve

1. Si pasojë e hyrjes në fuqi te V.K.M. nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim teritori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, duke ndryshuar mënyrat e llogaritjes së projektimit, supervizimit dhe kolaudimit, është miratur nga kryetari i Bashkisë vendimi nr.324 datë 08.06.2016 për rialokime fondesh brenda programit të infrastrukturës. Vlera totale e rialokuar është 10 957 mijë lekë. Aktivitetet e shtuara nga ky rialokim janë:

- Projektim Rikonstruksion rruga Bulevardi Skenderbeg (ish rajoni 4)
- Projektim Rikonstruksion rruga Osja e Falltores (blloqe pallatesh)
- Projektim Rikonstruksion rruga Edit Durham (tek shkolla Martin Camaj)
- Projektim Rikonstruksion rruga Mandave
- Projektim Rikonstruksion rruga Smakej

2. Bazuar në kërkesën e këshilltarit dhe administratorit të njësive administrative Ana e Malit dhe Bërdicë, është miratuar nga kryetari i Bashkisë vendimi nr.726 datë 03.10.2016 për rialokime fondesh brenda programit të infrastrukturës. Vlera totale e rialokuar është 783 mijë lekë. Aktivitetet e shtuara nga ky rialokim janë:

- Projektim Rikonstruksion rruga Oblikë-Velinaj-Ali Metaj (segmenti Fusha e Çunit-Kryqëzim Lagja Garuc)
- Projektim Rikonstruksion rruga Gjomarkaj

3. Si rezultat i diferencave të krijuara ndërmjet vlerës së parashikuar dhe vlerës fituese gjatë proceseve të prokurimit publik për zhvillimin e aktiviteteteve të parashikuara gjatë 2016, është miratuar nga kryetari i Bashkisë vendimi nr.771 datë 04.11.2016 për rialokime fondesh brenda programit të infrastrukturës. Vlera totale e rialokuar është 2 244 mijë lekë. Aktivitetet e shtuara nga ky rialokim janë:

- Projektim Rikonstruksion rruga "Memorandumi Greces
- Projektim Rikualifikim Urban blloqe banimi "Bulevardi Zogu i Pare"(Xhabije)
- Projektim Rikualifikim Urban blloqe banimi"Qemal Dracini" (tek Sahati)

#### Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2016

Fondet e miratuara për këtë program janë 10 957 mijë lekë, dhe përbëjnë 0.7 % të totalit të Buxhetit. Plani i rishikuar së bashku më të ardhurat për këtë program për vitin 2016 është 10,679 mije lekë.

Realizimi për periudhën 12-mujore është 10 088 mije lekë në masën 94 %.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.

Aktivite/Projekte	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi
P2.F1.O1.A1 Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Shkodër	-	-	-
P2.F1.O1.A2 Publikimi i Planit të përgjithshëm Vendor Përfundimtar nepermjet publikimit elektronik dhe mjeteve tradicionale të informimit	-	-	-
P2.F1.O2.A1. Rivlerësimi, realizimi dhe monitorimi i Sistemit të Adresave Bashkia Shkodër	-	-	-
P2.F1.O3.A1 Projektim rikonstruksion rruge Degëzim "Isuf Sokoli"	129	118	118
P2.F1.O3.A2 Projektim rikonstruksion rruge "Qazim Llazani"	215	199	199
P2.F1.O3.A3 Projektim rikonstruksion degezim rruge "Draçin"	759	560	560
P2.F1.O3.A4 Projektim Rikonstruksion i rruges varrezave "Beltoje"	448	-	-
P2.F1.O3.A5 Projektim rikonstruksion i rruges Stacionit pompave-Dobrac NJA Rrethina	6,250	3,011	3,011
Projektim Rikonstruksion rruga Bulevardi	-	560	560

Skenderbeg (ish rajoni 4)			
Projektim Rikonstruksion rruga Osja e Falltores (blloqe pallatesh)	-	394	394
Projektim Rikonstruksion rruga Edit Durham (tek shkolla Martin Camaj)	-	287	228
Projektim Rikonstruksion rruga Mandave	-	447	447
Projektim Rikonstruksion rruga Smakej	-	134	107
Projektim Rikonstruksion rruga "Memorandumi Greces"	-	348	348
Projektim Rikonstruksion rruga Oblikë-Velinaj-Ali Metaj (segmenti Fusha e Çunit-Kryqëzim Lagja Garuc)	-	351	120
Projektim Rikonstruksion rruga Gjomarkaj	-	432	162
P2.F1.O3.A6. Projektim rikualifikim Urban blloqe banimi "Qemal Draçini" (Pallati me hark)	698	514	514
P2.F1.O3.A7. Projektim rikualifikim Urban blloqe banimi "Bardeleve"(Pogej)	344	326	324
P2.F1.O3.A8. Projektim rikualifikim Urban blloqe banimi "Tepe-te fusha e druve"	1,725	1,102	1,102
P2.F1.O3.A9. Projektim "Sistemimi i perroit kufiri Muriqan"	390	-	-
Projektim Rikualifikim Urban blloqe banimi "Bulevardi Zogu i Pare"(Xhabije)	-	640	639
Projektim Rikualifikim Urban blloqe banimi "Qemal Dracini" (tek Sahati)	-	1,256	1,255
<b>Total</b>	<b>10,957</b>	<b>10,679</b>	<b>10,088</b>

#### **IV Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.**

Aktivitet me përqindje realizimi 0 % janë projektim Rikonstruksion i rrugës varrezave Beltojë dhe projektim Sistemimi i përroit kufiri Muriqan si pasojë e kërkesave të këshilltarit dhe administratorit të njësive administrative Ana e Malit dhe Bërdicë për ndryshim destinacioni të fondeve. Si rrjedhojë është miratuar nga kryetari i Bashkisë vendimi nr.726 datë 03.10.2016 për rialokime e fondeve të këtyre objekteve brenda së njëjtit programit.

### **P.3 Infrastruktura Rrugore**

Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses më të mirë të tyre në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare dhe ndërkombëtare është prioritet i Bashkisë së Shkodrës.

Programi i infrastrukturës rrugore, bazohet në 2 politika themelore:

- Përmirësimin e mjedisit urban me standartet e duhura në shërbim të komunitetit

- Rritjen e cilësisë dhe sigurisë së jetës së banorëve.

## I Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2016 ka fokusuar përpjekjet e saj në një funksion zhvillimi:

F1. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore;

Objektivat për secilin funksion janë:

F1.O1. Mirëmbajtja e rrugëve dhe shesheve

F1.O2. Rikonstruksion rruge dhe sheshe urbane

F1.O3. Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale duke siguruar lidhjen e të gjitha qendrave të banuara me rrjetin rrugor urban dhe kombëtar.

## II Produktet për vitin 2016

Gjatë vitit 2016 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër:

F1.O1.A1. Mirëmbajtje rruge dhe trotuare

Bazuar në kontratën 5 vjeçare 2014-2019 për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve janë kryer riparime të ndryshme me qëllim mirëmbajtjen. Buxheti i përcaktuar edhe pse ndoshta i pamjaftueshëm për nevojat e qytetit ka bërë të mundur riparimin e dëmtimeve në pjesët më të rëndësishme të rrugëve dhe trotuareve si:

- Rrugët dhe Trotuaret Urbane: Rr. "Qemal Draçini", Rr. "Fushë Çelë", Rr. "Vaso Kadia", Rr. "Kardinal Mikel Koliqi", Rr. "Bashkimi", Rr. "Tepe", Rr. "Daut Boriçi", Rr. "Hafiz Sabri Bushati", Rr. "Komiteti Kosovës", Rr. "Hamz Kazazi", "Bulevardi Mehmet Pashë Plaku", "Bulevardi Bujar Bishanaku", Rr. "Ramadan Sokoli", Rr. "Shtëpitë e bujqve", Rr. "Dasho Shkreli", Rr. "Lidhja Prizrenit", Rr. "Faik Konica", "Bulevardi Zogu I", Rr. "Lugoçesme", Rr. "Mukej",
- Sheshet Urbane: "Sheshi Rus i Madh", "Sheshi Nënë Tereza", "Sheshi Perash", "Sheshi Dervishej", "Sheshi Balshaj".

F1.O2.A1. Rikonstruksion rruga degëzimi "Isuf Sokoli"

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.12581/30 datë 12.12.2016 kanë filluar punimet për rehabilitimin e sheshit ku përfituesit e këtij investimi janë banorët e dy pallateve 8-katësh si dhe banesave të tjera private. Me këtë investim arrihet kanalizimi i ujrave të bardha, ujrave të zeza, asfaltimi dhe ndriçimi i sheshit duke krijuar kushte më të mira për banorët.

Nga ky investim:

- Shtrohen me asfalt 470 m<sup>2</sup> rruge;
- Ndërtohen 50 ml Kanalizime të ujërave të bardha;
- Ndërtohen 60 ml Kanalizime të ujërave të zeza;
- Ndriçohen 550 m<sup>2</sup> sipërfaqe;
- Përfitojnë 100 banorë.

F1.O2.A2. Rikonstruksion rruga Qazim Llazani.

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.12586/14 datë 30.11.2016, kanë filluar punimet për rikonstruksionin e rrugës. Investimi konsiston në ndërtimin e rrjeteve të KUB dhe

KUZ si dhe asfaltimin e rrugës duke bërë të mundur përmirësimin dhe urbanizimin e plotë të këtij segmenti. Rruga Qazim Llazani është një rrugë me fund që lidh banorët e saj me rrugët e qytetit duke përmirësuar kështu jetën sociale të banorëve.

Nga ky investim:

- Shtrohen me asfalt 750 m<sup>2</sup> rruge;
- Ndërtohen 260 ml Kanalizime të ujërave të bardha;
- Ndërtohen 52 ml Kanalizime të ujërave të zeza;
- Përfitojnë 80 banorë.

#### F1.O2.A3. Rikonstrukcion degëzimi rruga Draçin.

Objekti është në fazë prokurimi. Me realizimin e tij synohet të përmirësohet gjendja e degraduar aktuale e rrugës duke ndërtuar një rrugë me standarte bashkëkohore që synon përmirësimi e jetës sociale të banorëve.

Nga ky investim:

- Shtrohen me asfalt 980 m<sup>2</sup> rruge;
- Ndërtohen 280 ml Kanalizime të ujërave të bardha;
- Ndërtohen 280 ml Kanalizime të ujërave të zeza;
- Ndërtohen 460 m<sup>2</sup> trotuar;
- Ndriçohen 1500 m<sup>2</sup> sipërfaqe;
- Përfitojnë 100 banorë.

#### F1.O2.A4. Rikonstrukcion rruga e varrezave Beltojë

Bazuar në kërkesën e këshilltarit dhe administratorit të njësisë administrative Bërdicë, është miratuar nga kryetari i Bashkisë vendimi nr.726 datë 03.10.2016 për rialokime fondesh brenda programit të infrastrukturës. Fondi i parashikuar për këtë objekt është rialokuar për objektin Rikonstrukcion rruga Gjomarkaj.

#### F1.O2.A5. Rikualifikimi urban blloqe banimi "Qemal Draçini" (pallati me hark).

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.12579/15 datë 12.12.2016, kanë filluar punimet për rehabilitimin e sheshit ku përfituesit e këtij investimi janë banorët e pallateve si dhe banesave të tjera private. Me këtë investim arrihet kanalizimi i ujrave të bardha, ujrave të zeza asfaltimi, ndërtimi i ujësjellësit, asfaltimi dhe ndriçimi i sheshit duke krijuar kushte më të mira për banorët.

Nga ky investim:

- Shtrohen me asfalt 1700 m<sup>2</sup> rruge;
- Ndërtohen 335 ml Kanalizime të ujërave të bardha;
- Ndërtohen 174 ml Kanalizime të ujësjellësit;
- Ndërtohen 579 m<sup>2</sup> trotuar;
- Ndriçohen 2300 m<sup>2</sup> sipërfaqe;
- Përfitojnë 300 banorë.

#### F1.O2.A6. Rikualifikimi urban blloqe banimi "Bardelëve"(Pogej).

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.13305/16 datë 14.12.2016, kanë filluar punimet për reabilitimin e sheshit ku përfituesit e këtij investimi janë banorët e pallateve si

dhe banesave të tjera private. Me këtë investim arrihet kanalizimi i ujrave të bardha, ujrave të zeza, asfaltimi dhe ndriçimi i sheshit duke krijuar kushte më të mira jetesë për banoret.

Nga ky investim:

- Shtrohen me asfalt 966 m<sup>2</sup> rruge;
- Ndërtohen 145 ml Kanalizime të ujërave të bardha;
- Ndërtohen 135 ml Kanalizime të ujërave të zeza;
- Ndërtohen 192 m<sup>2</sup> trotuar;
- Ndriçohen 1200 m<sup>2</sup> sipërfaqe;
- Përfitojnë 260 banorë.

F1.O2.A7. Rikualifikimi urban blloqe banimi "Tepe" (te fusha e druve).

Objekti është në fazë prokurimi. Me realizimin e tij synohet të përmirësohet gjendja aktuale e këtij blloku, duke plotësuar gjithë sheshin me infrastrukturë nëntokësore dhe mbitokësore dhe asfaltim, me qëllim përmirësimin e jetesës së banorëve që jetojnë këtu.

Nga ky investim:

- Shtrohen me asfalt 2570 m<sup>2</sup> rruge;
- Ndërtohen 710 ml Kanalizime të ujërave të bardha;
- Ndërtohen 650 ml Kanalizime të ujërave të zeza;
- Ndërtohen 465 ml Kanalizime të ujësjellësit;
- Ndërtohen 2056 m<sup>2</sup> trotuar;
- Ndërtohen 2025 m<sup>2</sup> sipërfaqe e gjelbër;
- Ndriçohen 6600 m<sup>2</sup> sipërfaqe;
- Përfitojnë 800 banorë.

F1.O2.A8. Rikualifikim urban i rrugicave historike (rikonstruksion ujësjellës dhe kanalizime)

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.7263/45 datë 13.10.2016 kanë filluar punimet për ndërtimin e infrastrukturës nëntokësore në 13 rrugicat e qendrës historike. Me këtë investim arrihet kanalizimi i ujrave të zeza dhe ndërtimi i ujësjellësit për ti hapur rrugë projektit tjetër që do të plotësojë me ndërtimin e KUB dhe shtrimin me pllaka guri dekorative.

Nga ky investim:

- Ndërtohen 3263 ml Kanalizime të ujërave të zeza;
- Ndërtohen 2726 ml Kanalizime të ujësjellësit;
- Përfitojnë 650 banorë.

F1.O2.A9. Projekt zbatimi i plotë Rehabilitimi i sheshit "Gjon Pali"

Nga rehabilitimi i sheshit:

- Shtrohen me pllakë guri 1455 m<sup>2</sup> rruge;
- Ndërtohen 150 ml Kanalizime të ujërave të bardha;
- Ndriçohen 1500 m<sup>2</sup> sipërfaqe;
- Përfitojnë 800 banorë.

F1.O2.A10. Projekt zbatimi i plotë rikualifikim urban i rrugicave në qëndren historike.

Nga rehabilitimi i 13 rrugicave të qendrës historike:

- Shtrohen me pllakë guri 4490 m<sup>2</sup> rruge;

- Ndërtohen 3250 ml Kanalizime të ujërave të bardha;
- Ndriçohen 4600 m2 sipërfaqe;
- Përfitojnë 650 banorë.

#### F1.02.A11. Sistemim i sheshit të plazhit Velipojë

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes për punë publike me nr.8619/15 datë 14.09.2016, kanë përfunduar punimet për sistemimin e plazhit si rezultat i së cilit janë krijuar kushte më të mira për turistët e shumtë që frekuentojnë këtë plazh.

Nga ky investim:

- Ndërtohen 40 ml Kanalizime të ujërave të zeza;
- Ndërtohen 240 ml Kanalizime të ujësjes;
- Përfitojnë 2500 banorë.

#### F1.02.A12. Rikonstrukcion të bllokut të pallateve Xhabije.

Nga aplikimi që është bërë pranë Fondit të Zhvillimit të Rajoneve është përfituar objekti “Rikonstrukcion të bllokut të pallateve Xhabije” me financim 2-vjecar. Objekti është në proces. Me anë të mbikqyrjes dhe kolaudimit të objektit synohet që të arrihet menaxhimi dhe kontrolli i objektit për realizimin e tij në përputhje me kushtet teknike.

#### F1.03.A1 Sistemimi i përroit kufiri Muriqan

Bazuar në kërkesën e këshilltarit dhe administratorit të njësisë administrative Ana e Malit, është miratuar nga kryetari i Bashkisë vendimi nr.726 datë 03.10.2016 për rialokime fondesh brenda programit të infrastrukturës. Fondi i parashikuar për këtë objekt është rialokuar për objektin Rikonstrukcion rruga Oblikë-Velinaj-Ali Metaj (segmenti Fusha e Çunit-Kryqëzim Lagja Garuc).

#### F1.03.A2. Mirëmbajtja e rrugëve rurale.

Janë mirëmbajtur 63 km rrugë rurale në njësitë administrative:

- 1) Rruga Ura Mesit – Drisht - Muri Turkut, Nj. Administrative Postrinë, 4.2 km.
- 2) Rruga Rragam - Sheldi, Nj. Administrative Guri i Zi, 8.2 km.
- 3) Në Nj. Administrative Guri i Zi janë mirëmbajtur rrugët në fshatrat: Guri i zi, Juban, Ganjolle, 8.5 km.
- 4) Rruga “Xhorretaj”, Fshati Trush, Nj. Administrative Bërdicë, 2 km.
- 5) Në Nj. Administrative Postrinë janë mirëmbajtur rrugët në fshatrat: Kullaj, Dragoç, Boks, Myselim, Fshati i Ri, 11 km.
- 6) Në Nj. Administrative Rrethina janë mirëmbajtur rrugët në fshatrat: Grudë, Bardhaj, Shtoj i Ri, Shtoj i Vjetër, 11 km.
- 7) Në Nj. Administrative Ana e Malit janë mirëmbajtur rrugët në fshatrat: Oblike, Muriqan, Obot, Gorice, Velinaj, 10.4 km.
- 8) Në Nj. Administrative Dajç janë mirëmbajtur rrugët në fshatrat: Darragjat, Shirq, Samrish i Vjetër, 4.5 km
- 9) Në Nj. Administrative Velipojë janë mirëmbajtur rrugët në fshatrat: Sektor, Pulaj-Plazh, 3.5 km.
- 10) Janë rehabilituar Urat në Nj. Administrative Shalë: Ura Breglumi, Ura Gimaj, Ura Camaj, Ura Mushagag.

- 11) Janë në proces mirembajtja e rrugëve rurale në aksin Ura Mesit – Prekal – Kir - Breglumi – Theth, të njësive administrative Postribë, Pult, Shosh, Shalë me gjatësi prej 59 km.
- 12) Rikonstruksion rruga Gjomarkaj. Objekti është në fazë prokurimi. Me realizimin e tij synohet të përmirësohet gjendja aktuale e kësaj rruge, duke plotësuar gjithë rrugën me infrastrukturë mbitokësore dhe asfaltim, me qëllim përmirësimin e jetesës së banorëve që jetojnë këtu. Nga ky investim do të shtrohen me asfalt 2340 m<sup>2</sup> rruge me një numër përfituesish prej 200 banorësh
- 13) Rikonstruksion rruga Oblikë-Velinaj-Ali Metaj (segmenti Fusha e Çunit-Kryqëzim Lagja Garuc). Objekti është në fazë prokurimi. Me realizimin e tij synohet të përmirësohet gjendja aktuale e kësaj rruge, duke plotësuar gjithë rrugën me infrastrukturë mbitokësore dhe asfaltim, me qëllim përmirësimin e jetesës së banorëve që jetojnë këtu. Nga ky investim shtrohen me asfalt 1680 m<sup>2</sup> rruge me një numër përfituesish prej 450 banorësh.

### III Fondet e financimit të programeve

1. Si pasojë e diferencave ndërmjet vlerës së parashikuar dhe vlerës së dalë nga preventivi përfundimtar i zbatimeve për disa objekte, është miratuar nga kryetari i Bashkisë vendimi nr.704 datë 23.09.2016, për rialokime fondesh brenda programit të infrastrukturës. Vlera totale e rialokuar është 1 379.182 mijë lekë.

Aktivitetet që i janë shtuar fonde nga ky rialokim janë:

- Rikonstruksion rruga degëzimi “Isuf Sokoli”
- Rikonstruksion rruga Qazim Llazani.

2. Bazuar në kërkesën e këshilltarit dhe administratorit të njësive administrative Ana e Malit dhe Bërdicë, është miratuar nga kryetari i Bashkisë vendimi nr.726 datë 03.10.2016 për rialokime fondesh brenda programit të infrastrukturës. Vlera totale e rialokuar është 17 574 mijë lekë

Aktivitetet e shtuara nga ky rialokim janë:

- Projektim Rikonstruksion rruga Oblikë-Velinaj-Ali Metaj (segmenti Fusha e Çunit-Kryqëzim Lagja Garuc)
- Projektim Rikonstruksion rruga Gjomarkaj

Fondet e miratuara për këtë program janë 144 040 mijë lekë. Plani i rishikuar së bashku me Fondin e Zhvillimit të Rajoneve për këtë program për vitin 2016 është 172610 mijë lekë.

#### Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2016

Realizimi për periudhën 12-mujore është 155819 mijë lekë në masën 90 %

Fondet për shpenzime korrente sipas planit 2016 janë:

- Fondet e miratuara për Shpenzime Operative janë 21 554 mijë lekë. Plani i rishikuar është 21 554 mijë lekë. Realizimi për periudhën 12-mujore është 16936 mijë lekë, pra në masën 79 %
- Fondet e miratuara për Investime janë 122 486 mijë lekë. Plani i rishikuar është 151 056 mijë lekë. Realizimi për periudhën 12-mujore është 138 883 mijë lekë, pra në masën 92 %.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.



Aktivitete/Projekte	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi
P3.F1.O1.A1.Mirëmbajtje rrugë dhe trotuare në territorin e Bashkisë së Shkodrës	3,697	3,697	3,697
P3.F1.O2.A1. Rikonstruksion rruge Degëzim "Isuf Sokoli"	2,648	3,259	2,551
P3.F1.O2.A2. Rikonstruksion rruge "Qazim Llazani"	4,420	5,188	4,955
P3.F1.O2.A3. Rikonstruksion degezim rruge "Draçin"	15,649	15,649	15,622
P3.F1.O2.A4. Rikonstruksion i rruges varrezave "Beltoje"	9,249	-	-
P3.F1.O2.A4. Rikonstruksion rruga Gjomarkaj	-	9,248	9,230
P3.F1.O2.A5. Rikualifikim Urban blloqe banimi "Qemal Draçini" (Pallati me hark)	14,382	13,002	9,248
P3.F1.O2.A6. Rikualifikim Urban blloqe banimi "Bardeleve"(Pogej)	7,105	7,105	5,244
P3.F1.O2.A7. Rikualifikim Urban blloqe banimi"Tepe-te fusha e druve"	35,548	35,548	35,492
P3.F1.O2.A8. Rikualifikim urban I rrugicave ne Qendren Historike, (Rikonstruksion sistemit Ujesjelles kanalizime)	18,260	18,260	17,464
P3.F1.O2.A9. Projekt zbatimi i plote Rehabilitimi i sheshit "Gjon Pali"	667	667	667
P3.F1.O2.A10 Projekt zbatimi i plote Rikualifikim urban I rrugicave ne Qendren Historike.	1,445	1,445	1,445
P3.F1.O2.A11. Sistemim sheshe plazhi Velipoje	4,370	4,370	2,943
P3.F1.O2.A12. Rikonstruksion I bllokut te pallateve "Xhabije"	697	8,889	5,700
P3.F1.O3.A1. Sistemimi i perroit kufiri Muriqan	8,048	-	-
P3.F1.O3.A1. Rikonstruksion rruga Oblikë-Velinaj-Ali Metaj (segmenti Fusha e Çunit-Kryqëzim Lagja Garuc)	-	8,327	8,265
P3.F1.O3.A2 Mirembajtja e rrugeve rurale	17,857	17,857	13,239
<b>TOTAL</b>	<b>144,040</b>	<b>172,610</b>	<b>155,819</b>

## **IV Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.**

Aktivitet me përqindje realizimi 0 % janë Rikonstruksion i rrugës varrezave "Beltojë" dhe Sistemimi i përroit kufiri Muriqan si pasojë e kërkesave të këshilltarit dhe administratorit të njësie administrative Ana e Malit dhe Bërdicë për ndryshim destinacioni të fondeve. Si rrjedhojë është miratuar nga kryetari i Bashkisë vendimi nr.726 datë 03.10.2016 për rialokime e fondeve të këtyre objekteve brenda së njëjtit programi.

### **P.4 Shërbimet Publike**

Ofrimi i shërbimeve publike qytetarëve, bizneseve dhe të gjithë komunitetit në të gjithë territorin administrativ të Bashkisë përbën një ndër prioritet kryesore të bashkisë.

Politikat e ndjekura gjatë 2016 janë bazuar në :

1-Ofrimin e shërbimeve publike cilësore për përmirësimin e jetesës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit.

2-Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve publike, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjise si dhe zgjerimin e shërbimit.

3-Rritja e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, duke siguruar pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit, monitorimit, për ta orientuar atë sipas nevojave të tyre.

### **I Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave**

Bashkia mbështet shërbimet e saja në 8 funksione :

F1. Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane.

F2. Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbërta publike.

F3. Prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pishëm.

F4. Mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujrëve të ndotura.

F5. Mbledhjen dhe largimin e ujrave të shiut dhe mbrojtjen nga përmytjet në zonat e banuara.

F6. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e Varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit të varrimit.

F7. Shërbimi i dekorit publik.

F8. Ndriçimi i mjediseve publike.

F9.Shërbime publike vendore në Nj.Administrative.

Objektivat për secilin funksion janë:

F1.01. Rritje e performancës së shërbimit të pastrimit, zgjerimi i zonës së shërbimit dhe rritja e numrit të përfituesve të këtij shërbimi.

F2.01. Rritja e cilësisë së shërbimit për sipërfaqet e gjelbërta nëpërmjet përmirësimit dhe rikompozimit të sipërfaqeve të gjelbërta ekzistuese si dhe zgjerimit të tyre.

F3.01. Garantimi i furnizimit me ujë të pishëm të popullatës pa ndërprerje.

F4.01. Rritja e numrit të lidhjeve të shkarkimeve të ujrave të zeza të popullsisë urbane dhe rurale si dhe mirëmbajtja e rrjetit ekzistues.

F5.01.Sigurimi i funksionimit normal të rrjetit të kanalizimeve të ujrave të bardha (shiut) në qytet dhe grykëderdhjet kryesore për të evituar problematikat e ndryshme.

F6.01. Rritja e performancës së shërbimit të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së Varrezave publike dhe të dëshmorëve. Krijimi i kushteve për një shërbim funeral brenda standarteve.

- F7.O1. Realizimi i një dekori urban duke krijuar një atmosfere të gëzueshme për aktivitete dhe festa.
- F8.O1. Mbjajtja në efikasitet e rrjetit të ndriçimit publik si dhe zgjerimi i këtij shërbimi aty ku nuk ekziston .
- F9.O1. Garantimi i shpenzimeve të pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësëve të shërbimeve.

## II Produktet për vitin 2016

Gjatë vitit 2016 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër:

F1.O1.A1. Në zbatim të kontratës themelore 5-vjeçare të Tetor 2013, vazhdon realizimi i shërbimit të pastrimit me sipërmarrje private. Për rritjen e performancës është përmirësuar sistemi i monitorimit të shërbimit si dhe është arritur që problematikat e krijuara të eliminohen në një kohë më të shpejtë.

F1.O1.A2. Shërbimi i pastrimit në Velipojë sipas kontratës themelore është mbyllur me 31 Maj 2016, por për të mos e ndërprerë këtë shërbim në prag të sezonit turistik, është realizuar shtyrja e kontratës deri me 10 Shtator 2016.

Realizimi i shtesës së kontratës u bë me 14.06,2016 me nr.prot.6325/9 me vlerë 11389518 me TVSH dhe kjo u shoqërua me specifikime të reja teknike, skemë shërbimi më efikase dhe frekuenca më të shpeshta, sistemi i monitorimit më efikas, kjo e gjitha në funksion të një performancë më të mirë shërbimi gjatë sezonit turistik.

F1.O1.A4.A5. Realizimi i depozitimit të mbetjeve urbane të Nj.Administrative në Landfillin Bushat, duke eliminuar një ndër problematikat më të mëdha atë të ndotjes mjedisore.

F1.O1.A7. Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës për shërbimin e pastrimit është realizuar blerja e kazanëve të mbledhjes të mbetjeve urbane, me të cilat plotësojmë 80 % të nevojave për të gjithë Bashkinë.

F1.O1.A8 Është realizuar shërbimi i pastrimit, në njësitë administrative në të cilat kishin përfunduar kontratat me sipërmarrje. Realizimi i shërbimit është bërë i mundur me mjetet teknologjike të cilat kanë qenë në inventarin e Nj.Administrative dhe me punonjësit e shërbimeve. Me këtë shërbim kemi eliminuar në mënyrë të konsiderueshme problemin e evadimit të mbetjeve urbane, si dhe është realizuar depozitim i tyre në landfillin Bushat.

F1.O1.A9. Janë realizuar në mënyrë korrekte pagesat për punonjësit e shërbimeve si dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore të tyre.

F2.O1.A1. Në zbatim të kontratës themelore 5-vjeçare, Janar 2013 vazhdon shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta. Shërbimet janë kryer sipas kushteve teknike dhe grafikëve të përcaktuar të shërbimit.

F2.O1.A2. Në funksion të rritjes së sipërfaqeve të gjelbërta është realizuar rehabilitimi i lulishtes së plazhit Velipojë. Duke qenë një qendër e rëndësishme atraktive është zbatuar faza e parë e projektit që do vazhdojë edhe në vitin 2017. Ky projekt synon një rindërtim të plotë të sipërfaqes së gjelbërt duke e rikompozuar tërësisht atë.

### F3.O1:A1: Furnizimi me ujë i qytetit dhe njësive administrative.

Në Shkodër, qyteti furnizohet me ujë nga ujësjellësi përkatësisht 21,258 familje (87 % në Shkodër qytet) dhe 2,010 biznese; me sasi 650 litra/ sek në stinën e dimrit dhe 850 litra/sek në stinën e verës. Gjatë vitit 2016 nga drejtorja e Shërbimeve publike dhe Ndërmarrja ujësjellës e kanalizime janë realizuar këto produkte:

- 87% e banorëve në Nj.A Shkodër furnizohen me ujë të pijshëm;
- Ndërtim ujësjellësi në zonën Mark Lula;
- Rikonstuksion i ujësjellësit të fshatrave Pentar dhe Samirish i Ri;
- Rikonstruksion ujësjellësi në Oblikë;
- Ndërtimi i ujësjellësit në Fshatin Alimetaj;
- Në njësinë administrative Guri i Zi, fshati Juban, janë realizuar punimet për zëvendësimin e gjithë tubacionit të thithjes së pompës deri në pus-shpim, rehabilitimi I stacionit të pompimit, depos së ujit dhe rrugëve hyrëse në objekt. Rehabilitim I rrjetit shpërndarës duke e kthyer nga sistem furnizimi me uje me çezma publike në sistem me furnizim individual të çdo objekti.
- Në njësinë administrative Shalë janë ndërtuar 4 rezervuarë të rinj me rrjedhje të lirë.
- Në njësinë administrative Postribë, fshati Dragoç i Ri, është ndërtuar ujësjellësi i ri me vetrrjedhje. Rehabilitim i depos së ujit në Kodër Boks, pastrim dhe dezinfektim i dhomës së ujit dhe komplet objektit, pastrim dhe rrethim territori, rehabilitim i vaskave të klorinimit të ujit për plotësimin e normave sanitare të furnizimit me ujë të konsumatorit. Riparim komplet i linjës kryesore të dërgimit të ujit nga stacioni Dragoç - Depo Kodër Boks, rehabilitim i stacionit të pompave Dragoç. Ndërtim i linjës së re me tubacion çeliku për furnizimin me ujë të Fshatit të Ri nga ujësjellësi Dragoç.
- Njësia administrative Ana e Malit, fshati Oblike, është kryer riparimi i linjës së dërgimit (tub çeliku DN 100) për në depon Xhaferaj në rrugën kryesore Oblike.
- Njësia administrative Rrethina, fshati Hot i Ri janë realizuar punime për rehabilitimin e stacionit të pompimit, sistemim pastrim e rrethim të territorit dhe rrugëve hyrëse, riparime në rrjetin shpërndarës dhe shtrimin e linjës për furnizimin me ujë të shkollës dhe ambulancës. Në fshatin Bardhaj meqenëse nuk ka ujësjellës është kryer ndërtimi i linjës së re për furnizimin me ujë të shkollës dhe qëndres shëndetësore përmes pus-shpimit. Në fshatin Grudë është bërë riparimi i tubacioneve kryesore të rrjetit shpërndarës dhe furnizimi me ujë i shkollës dhe qëndres shëndetësore.
- Janë në proces ndërtimi 3,695 ml ujësjellës prej të cilëve do të përfitojnë 9,250 qytetare përkatësisht në rrugët dhe blloqet e banimit: Blloku Xhabijej, rrugicat në Qëndren Historike (rruga Fran Baron Nopca, rruga Ndoc çoba, 5 degëzime në rrugën Kol Idromeno, 2 degëzime në rrugën Gjuhadol, rruga Gurakuqve, rruga Gurazezve, rrugave Murgeshave, rruga Berdicej), blloqe banimi "Qemal Draçini"(Pallati me hark) dhe blloqe banimi "Tepe - tek Fusha e Druve“.

### F3.O1.A2 Mbështetja për mbulimin e shpenzimeve për energjinë elektrike SH.A Ujësjellës qytet.

Nga fondi i parashikuar në buxhetin 2016 janë kryer pagesat për konsumin e energjisë elektrike për 3 kontratat në Nj.A. Guri i Zi, Ana e Malit dhe Velipojë. Këto pagesa kanë mbuluar konsumin e energjisë elektrike të dy ujësjellësave që furnizojnë popullatën me ujë të pijshëm si dhe furnizimin me ujë te shatërvanit në qendër të plazhit Velipojë gjatë sezonit të plazhit.

#### F4.O1.A1. Menaxhimi I sistemit te ujërave të zeza.

Janë të lidhur në sistem 19,432 familje (66% në Shkodër qytet) dhe 2,043 biznese; 2 impiante të pastrimit të ujërat e zeza (Velipojë, Shirokë), 150 km kanalizime të ujërave të zeza në qytet.

- 15,000 banorë në Velipojë përfitojnë nga shërbimi i largimit të ujërave të zeza;
- Velipojë, vënia në funksionim e impiantit të pastrimit të ujërave të zeza;
- Shirokë, mbajtja në funksionim normal të impiantit të pastrimit të ujërave të zeza;
- Ndërtimi i sistemit të KUZ për zonën e Pulaj dhe Reç i Ri;
- Ndërtimi i një stacioni të vogël pompimi në Dobraq për pompimin e ujërave të zeza të rrjetit KUZ të zonës II të mbrojtjes sanitare të pus shpimeve, i cili i dërgon këto ujëra në kolektorin kryesor K3 të qytetit Shkodër;
- Zgjatimi i kolektorit të ujërave të zeza të rrugës Lëvizja e Postribes deri tek Policia.
- Ndërtimi I kolektorit të ujërave të zeza në rrugën e zonës Industriale deri në Fermentim, investim i BE.
- Janë në proces ndërtimi 5,420 ml rrjet KUZ ku do të përfitojnë 9,490 qytetare përkatësisht në rrugët dhe blloqet e banimit: Blloku Xhabijej, rrugicat në Qëndren Historike (rruga Fran Baron Nopca, rruga Ndoc Çoba, 5 degëzime në rrugën Kol Idromeno, 2 degëzime në rrugën Gjuhadol, rruga Gurakuqve, rruga Gurazevze, rrugave Murgeshave, rruga Berdcej), rruga "Qazim Llazani", rruga Degëzim "Isuf Sokoli", degëzim rruge "Draçin", blloqe banimi "Bardleve" (Pogej) dhe blloqe banimi "Tepe- tek Fusha e Druve".
- Në qytet rregjistrohen në muaj afërsisht: 102 raste të ndryshme zhblokimesh dhe pastrimesh të rrjetit KUZ, 317 cope puseta të pastruara, 2,812 ml rrjet KUZ i pastruar. Në rrugë të ndryshme të qytetit janë riparuar 89 puseta, janë zëvendësuar 26 kapake gize dhe 163 kapak betoni.

#### F5.O1. A1. Menaxhimi I sistemit të ujërave të shiut.

Gjatësia e përgjithshme e sistemit të kanalizimeve të KUB për qytetin është rreth 54 km nga të cilët rreth 37 km përbëhen nga tubacione të mbyllura dhe pjesa tjetër janë kanale të hapura.

- Nga Ujësjiellës Kanalizime është kryer mirëmbajtje e vazhdueshme dhe e qëndrueshme e rrjetit KUB.
- Janë mirëmbajtur dhe pastruar 3,660 ml kanale të mëdha kulluese në segmentet: Tepe-Kir, Bahçallek-Bërdicë, Bahçallek Bërdicë sekondari I I anës së rrugës, Bahçallek Bërdicë sekondari II, Telekom-Kinema Millenium, Ura Dervishbeg-Sheshi Isa Boletini, Fusha e Druve-Bonifikime.
- Janë pastruar 14,066 ml kuneta dhe kanale që përbëjnë ngarkesën tipike gjatë një muaji në rrugët: Fahri Ramadani, Rr. Ura (kanal i hapur), Tepe (kanal i hapur), Ura e Thive (kanal i hapur), Ludovik Saraçi, Kiras – Zooteknike, Rr. Bujqeve, Shk. Mekanike Bujqsore – Kiras, Daut Boriçi, Grykderdhja Kiri (kanal i hapur), Ethem Osmani, Inxh. Gjovalin Gjadri (industriale), Rr. Karavaneve (kanal i hapur-grykderdhje), Lokuçezme (kanal i hapur), Kardinal Mikel Koliqi, Mehmet Pashe Plaku, Gjuhadol, Xhabie- Kisha e Zonjes, Bujar Bishanaku, Grykderdhja Kiras-Livade, Rr. Levizja e Postribes (industriale), Qemal Draçini.
- Janë në proces ndërtimi 4,050 ml KUB ku do të përfitojnë 6,640 qytetare përkatësisht në rrugët dhe blloqet e banimit: Blloqe banimi Xhabijej, rruga "Qazim Llazani", rruga Degëzim

"Isuf Sokoli", rruga "Draçin", blloqe banimi "Qemal Draçini"(Pallati me hark), blloqe banimi "Bardeleve"(Pogej) dhe blloqe banimi "Tepe - tek Fusha e Druve"

F6.O1.A1. Vazhdon shërbimi i mirëmbajtjes së Varrezave Publike në bazë të kontratës themelore të qershor 2013. Një shërbim, brenda parametrave dhe kushteve të kontratës si dhe një gadishmëri dhe korrektësi e lartë për kryerjet e shërbimeve funerale.

F7.O1.A1. Blerje aksesor dekori për festat e fund vitit

Janë blerë aksesorë zbukurues me të cilët janë dekoruar sheshet Parrucë, Nënë Tereza, Rus i madh, rruga 13 Dhjetori, rruga 28 Nëntori, rruga Kol Idromeno si dhe godina e Bashkisë dhe sheshi i saj.

F7.O1.A2. Blerje materiale të ndryshme për dekorin

Janë blerë materialet e domosdoshme për riparimet e mundshme dhe montimin e aksesorëve të dekorit. Në zërat kryesore të shpenzimeve përfshihen:

- Kordon ndriçues dekorative (Ø 12 mm) gjithsej 1000 ml;
- Tel percjelles energjie elektrike me dimension 2x1.5 mm gjithsej 1000 ml;
- Lidhëse kabllosh plastike gjithsej 50 kuti;
- Pistolet saldimi plastik gjithsej 2 copë dhe elektroda saldimi plastike gjithsej 500 copë;

F7.O1.A3. Blerje flamuj

Janë blerë flamuj për dekorin e institucioneve administrative në të gjithë territorin si dhe në sheshe dhe rrugë kryesore.

F8.O1.A1. Mirëmbajtja e Sistemit të Ndriçimit Publik të qytetit dhe njësive administrative

1. Shpenzimet për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik të ndriçimit publik janë realizuar në bazë të preventivave të hartuar për ndërhyrje rehabilituese dhe riparimin e defekteve në të gjitha rrugët, sheshet, blloqet e banimit dhe lulishtet.

1.1 Materiale për ndërhyrje rehabilituese. Është bërë zëvendësimi i kallbove të vjedhuara në rrugët: Unaza Perëndimore 2000 ml, Rruga e Kalasë 400ml, Rruga Besnik Ceka 400ml, Rruga Marin Beçikemi 400ml dhe Rruga Tepe 200ml me dimension 4x10 mm. Zëvendësimi i kuadrove të komandimit të dëmtuara (5 copë). Zëvendësimi ndriçuesish të dalë jashtë përdorimi dhe të thyer në rrugët: Bahçallek-Sheshi Balshaj 10 copë, Sheshi Balshaj-Shkolla Pyjore 11 copë, Rruga Europa 3 copë, Rruga Bujar Bishanaku 6 copë, Bulevardi Skenderbeg 5 copë dhe Unaza Perëndimore 15 copë dhe 30 copë krah ndriçuesish

1.2 Materiale për mirëmbajtje e rrjetit të ndriçimit publik gjatë vitit

Këtu janë blerë materiale e domosdoshme për riparimin e difekteve të mundshme të ndriçuesve. Në këto materiale përfshihen:

- Automat të madhësive të ndryshme 10 A deri 63 A gjithsej 520 copë. Këto automate do i përdorim për riparim e difekteve gjatë viti si dhe për dekorimin e qytetit me rastin e festave të fund vitit , ku çdo ndriçues kërkon një automat të veçantë,
- Drosel ndriçuesi 250 Ë, 150 Ë dhe neon 36 Ë gjithsej 1040 copë

- Kabëll elektrik të madhësive 2x2.5, 2x4, 2x6, 3x6,4x4,4x6, 2x6 koksial mm2 gjithsej 4300 m për eliminimin e difekteve nga dëmtimet gjatë viti
- Lëshues të kapacitetit 25 A deri 40A gjithsej 350 copë.
- Lampa SAP 150 Ë gjithsej 900 copë dhe 250 Ë gjithsej 130 copë
- Lampa 70 Ë gjithsej 130 copë
- Lampa fuoriesçente 22 Ë gjithsej 400 copë
- Rele krepuskolare modulare 16/30 gjithsej 100 copë
- Rele krepuskolare për shtyllë 12/25 gjithsej 100 copë
- Portollampa për lampa SAP 150 Ë gjithsej 100 copë
- Portollampa porcelani për lampa elektronike 22 Ë gjithsej 250 copë
- Kasete metalike 40x50 gjithsej 13 copë

#### F8.O1.A2. Pagesa e konsumit të ndriçimit

Janë realizuar pagesat për konsumin e energjisë elektrike për ndriçimin publik në qytet dhe në njësitë administrative. Ka pasur tejkalim plani si rezultat i kontratave shtesë nga investimet e reja në ndriçimin rrugor. Pagesa e muajit dhjetor është bërë nga shumat e trashëguara ndër vite të ndriçimit rrugor.

#### F8.O1.A3. Blerje komplet veglash dhe komplete të sigurimit teknik

Janë realizuar blerja e veglave të punës si më poshtë: set pincash, set kaçavidash, trakide, dandic, etj, si dhe kompletet e sigurimit teknik që përmbajnë (galoshe dieletrike, doreza elektrike për tension të ulët, tregues tensioni deri 1000 V, tokëzues portativ, vegla pune me doreza të izoluara, rrip siguri për montatorët, kambaleca për ngjitje në shtyllë. etj)

#### F8.O1.A4. Pjesë këmbimi F8.O1.A5. Mirëmbajtje

Në funksion të mirëmbajtjes së ndriçimit dhe dekorit janë 2 autovinçat tip

##### 1.1 IVECO

##### 1.2 NISSAN

për të cilët në bazë të preventiva përkatës janë realizuar këto shpenzime. Në zërat kryesor mund të përmendim: mirëmbajtje të zakoshme si ndërrim filtra vaj, ajri, naftë, ndërrim vaj motorri, ndërrim goma, riparim hidraulik i vinçit, riparim pompe naftë, saldimit i koshit.

#### F8.O1.A6. Shpenzime për karburant

Në bazë të normativave të llogarituara është realizuar blerja e karburantit për secilin mjet.

#### F8.O1.A7. Pagesa për dokumentacionin

Për secilin mjet është realizuar pagesa e siguracionit, taksave dhe kolaudimit

#### F8.O1.A8. Investime

Në zbatim të buxhetit të 2016 është realizuar ndriçimi i 17 rrugëve dytësore: Rruga Cakej (blloku i pallateve), rruga Lidhja Prizrenit (degëzim tek zyra e Punës), rruga Velaj, rruga e Dibranëve (mbas teatrit), rruga Karinëve, rruga e Tepes (tek xhamia), rruga At Donat Kurti, rruga Danja, rruga Roza Lejn, rruga Qendër-Hidrovor (pas pallateve Fishat, Nj.A Velipojë), rruga Qendër Renc (Nj.A Gur i Zi), rruga Gjomarkaj (Nj.A Bërdicë), rruga Xhaferraj (Nj.A Ana e Malit), rruga fshati Boks (Nj.A Postribë),



rruga fshati Dragoç(Nj.A Postribë), rruga fshati Kullaj (Nj.A Postribë) dhe rruga fshati Bardhaj (Nj.A Rrethina).

### III Fondet e financimit te programeve

Si rezultat i diferencave të krijuara ndërmjet vlerës së parashikuar dhe vlerës fituese gjatë proceseve te prokurimit publik për zhvillimin e aktiviteteteve të parashikuara gjatë 2016, ëshë miratuar rialokimi i fondeve sipas vendimit nr 774 datë 04.11.2016 me shumë totale: 1,110 mije lekë për dy zërat buxhetore: Furnizim me materiale të përgjithshme për njësinë e ofrimit të shërbime dhe blerje bredha.

Fondet e miratuara për këtë program janë 314 mije lekë.

Realizimi për periudhën 12 mujore është 287 mije lek në masën 92% ndaj planit vjetor.

#### Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2016, paraqitet si me poshte:

- a) Shpenzime Operative janë realizuar në masën 240,337 mijë lekë nga 253,496 mijë lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 95 %.
- b) Subvencione janë realizuar në masën 5,000 mijë lekë nga 5,000 mijë lekë që ka qënë e parashikuar. Realizimi 100 %.
- c) Transferta jane realizuar ne mase 62 mije lek nga 382 mije leke qe ka qene e parashikuar. Realizimi ne mase 16%
- d) Investime janë realizuar në masën 22,541 mijë lekë nga 26,707 mijë lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 84.4 %.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.

Aktivitete/Projekte	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi
P4.F1.O1.A1. Sherbimi I pastrimit dhe depozitimit te mbetjeve urbane per NjA qytet Shkoder.	112,086	112,086	110,696
P4.F1.O1.A2.Sherbimi i pastrimit dhe depozitimit te mbetjeve urbane per NjA Velipoje (Kontrate ne vijim deri me 31 maj 2016)	7,500	7,500	7,500
P4.F1.O1.A3.Sherbimi i pastrimit dhe depozitimit te mbetjeve urbane per NjA Velipoje dhe Dajç	18,204	17,094	11,301
P4.F1.O1.A4.Sherbimi i pastrimit dhe depozitimit te mbetjeve urbane per NjA Rrethina, Postribë dhe Shale.	9,479	9,479	-
P4.F1.O1.A5.Sherbimi i pastrimit dhe depozitimit te mbetjeve urbane per NjA Guri I Zi, Berdice dhe Ana e Malit.	1,838	1,838	1,544
P4.F1.O1.A6 Sherbimi i largimit dhe depozitimit te mbetjeve ndertimore.	600	600	599



P4.F1.O1.A7 Blerje kontiniere per sherbimin e pastrimit	16,950	16,950	16,692
P4.F2.O1.a1: Shërbimi i Mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta	35,000	35,000	34,993
P4.F3.O1:A1: Furnizimi me ujë i qytetit dhe njësie administrative	1,040	1,040	-
P4.F3.O1:A2 Mbështetja për mbulimin e shpenzimeve për energjinë elektrike SH.A Ujësjellës qytet.	5,000	5,000	4,988
P4. F4. O1. A1 . Menaxhimi i sistemit te ujërave të zeza	-	-	-
P4.F5.O1. A1. Menaxhimi I sistemit te ujërave të shiut	-	-	-
P4.F6.O1.A1: Mirëmbajtje e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve.	11,297	11,297	7,205
P4.F7.O1.A1 Dekorimi i mjediseve publike	1,121	1,271	1,175
P4.F8.O1.A1: Mirëmbajtja e Sistemit te Ndriçimit Publik të qytetit dhe njësie administrative	65,088	66,048	71,172
P4.F9.O1.A1:Shpenzime per pagat dhe sigurime shoqerore per punonjesit e Sherbimeve Publike	28,598	28,598	19,394
<b>TOTALI</b>	<b>313,801</b>	<b>313,801</b>	<b>287,259</b>

#### **IV Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave te buxhetit te programit.**

F1.O1.A3. Shërbimi i pastrimit në Nj.A Velipojë dhe Dajç. Proçedura e prokurimi është realizuar dy herë. Në të dyja rastet operatorët pjesëmarrës kanë patur mangësi në dokumentat e paraqitura.

F1.O1.A6. Shërbimi i pastrimit në Nj.A Rrethina, Postribë dhe Shalë. Proçedura e prokurimi është realizuar dy herë. Në të dyja rastet operatorët pjesëmarrës kanë patur mangësi në dokumentat e paraqitura.

F1.O1.A7. Transporti i mbeturinave Ndërtimore. Proçedure prokurimi është realizuar por nuk është zbatuar për mungesë të një venddepozitim për mbetjet inerte. Kontrata e shtyrë deri në miratimin e venddepozitimit nga dikasteret përgjegjëse.

F6.O1.A2. Mirëmbajtje varrezash në Nj.A Dajç dhe Ana Malit. Shërbime të planifikuara, por të kryera nga kontributet e vetë komunitetit.

F6.O1.A3. Ky aktivitet nuk është realizuar pasi ka qenë i lidhur me prçedurën e shpronësimit, e cila nuk ka përfunduar.

## **P.5 Transporti publik dhe lëvizshmëria**

Mobiliteti ose lëvizshmëria ka të bëjë me përdorimin më të mirë të infrastrukturës rrugore, duke i dhënë përparësi mënyrave aktive dhe të qëndrueshme të lëvizjes (ecje, pedalim, transport publik, etj.). Duke pasur parasysh traditën e pedalimit me biçikletë të qytetit të Shkodrës, por edhe gjithë fushës së Nënshkodrës dhe Mbishkodrës, ruajtja dhe promovimi i mëtejshëm merr një kuptim më të plotë në rastin e Bashkisë së Shkodrës. Me rëndësi rrënjësore është konsolidimi i linjave të transportit publik që lidhin zonat bujqësore, malore dhe bregdetare me qendrën urbane.

### **I Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave.**

Bashkia mbështet shërbimet e saja në funksione:

F1. Përmirësimi i lëvizshmërisë urbane për një cilësi jetese më të mirë dhe ofrimi i një shërbimi transporti publik cilësor për qytetarët e Bashkisë Shkodër.

Objektivat për secilin funksion janë:

F1.O1.Zgjerimi i mbulimit të zonës urbane me shërbimin publik urban, rritjen e sigurisë në rrugë dhe hartimi i një plani të qëndrueshëm mobiliteti.

### **II Produktet për vitin 2016**

Gjatë vitit 2016 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër:

#### **F1.O1.A.1.1. Promovim**

Promovimet e parashikuara në këtë artikull janë realizuar në bashkëpunim me organizatat partnere (GO2 dhe EUIC) si dhe me drejtorinë e Turizmit

#### **F1.O1.A.1.2. Blerje materiale për sinjalistikë horizontale + vertikale**

Për vitin 2016 janë parashikuar shpenzimet për sinjalistikën horizontale e vertikale në bazë të preventivave përkatës. Parashikimi për bazë materiale për mirëmbajtjen e sinjalistikës horizontale e vertikale është bërë duke u bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara. Në zërat kryesore të shpenzimeve përfshihen: Blerje materiale për sinjalistikë horizontale + vertikale.

- Bojë rrugore e bardhë gjithsej 2800 kg
- Bojë rrugore e verdhe gjithsej 600 kg
- Fosfor gjithsej 500 kg
- Shkrirës boje (diluent) gjithsej 1000 kg
- Tabela rrugore të ndryshme gjithsej 60 copë

#### **F1.O1.A.1.3. Pjesë këmbimi për makinën e vijëzimit**

Në funksion të mirëmbajtjes së sinjalistikës horizontale është një makinë vijëzimi, për të cilën janë realizuar këto shpenzime për pjesë këmbimi. Në zërat kryesor mund të përmendim: zëvendësimi gomash, kompresor, pistole boje.

#### **F1.O1.A.1.4. Mirëmbajtje për makinën e vijëzimit**

Janë realizuar këto shpenzime për mirëmbajtje: shërbim motori, pastrim injektorësh

#### **F1.O1.A.1.5. Shpenzime për karburant për makinën e vijëzimit**

Në bazë të normativave të llogarituara është realizuar blerja e karburantit për makinën e vijëzimit

F1.O1.A.1.6 Blerje makinë vijëzimi

Makina e vijëzimit është akoma në procedura prokurimi

### III Fondet e financimit te programeve

F1.O1.A.1.6 Blerje makinë vijëzimi

Blerja e makinës vijëzimi është parashikur në shumën 3,500 mijë lekë. Nga testimi i tregut këto fonde ishin të pamjaftueshme për blerjen e makinës sipas parametrave të kërkuara. Me vendimit nr 774 datë 04.11.2016 është bërë pakësimi në zërin Subvencionepër abonetë e transportit urban në shumën 1,500 mijë lekë. Ky objekt me vlerë 5,000 mijë lekë është në mënyrë të përsëritur në procedurë prokurimi.

#### Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2016

Fondet e miratuara për këtë program janë 14,376 lekë. Realizimi për periudhën 12 mujore është 7,685 në masën 53,4 % ndaj planit vjetor.

a) Shpenzime Operative janë realizuar në masën 2,687 mijë lekë nga 3,876 mijë lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 69 %.

b) Investime janë realizuar në masën 4,998 mijë lekë nga 5,000 mijë lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 99.9 %.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.

Aktivitete/Projekte	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi
P5.F1.O1.A1: Mobiliteti dhe sherbimi I transportit urban	14,376	14,376	7,685
<b>TOTALI</b>	<b>14,376</b>	<b>14,376</b>	<b>7,685</b>

### IV Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave te buxhetit te programit.

F1.O1.A.2. Subvencione për abonetë e transportit urban

Për këtë sherbim nuk është realizuar akt-marrëveshje me operatorin që kryen shërbimin e transportit urban.

## P.6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit

Bashkia Shkodër, në krahasim me organizimin e mëparshëm është rritur në hapësirë, ky ndryshim ka sjellë një rol të ri për zhvillimin dhe menaxhimin territorial. Në këtë situatë të re bëhet e domosdoshme përpjekja për të përcaktuar drejtimit që duhen ndjekur në të ardhmen duke u fokusuar dhe përdorur mirë burimet ekzistuese. Ndaj çështja kryesore është përkthimi i

shumëllojshmërisë së avantazheve konkurruese në mundësi për investimet e huaja të cilat do të sjellin zhvillim social-ekonomik, duke bërë të mundur që çdo territor të kontribuojë në mirëqënien e Bashkisë.

Duke qënë se rritja ekonomike dhe hapja e vendeve të reja të punës në ekonomitë në zhvillim, varen nga dy faktorë kryesorë: tërheqja e investitorëve të huaj dhe zhvillimi i NVM-ve, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit gjatë vitit 2016 ndërmoi disa nisma për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkesve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës, promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

Turizmi, si aktivitet ndërsektoral, është i lidhur me shumë aktivitete ekonomike me ndikim të jashtëzakonshëm në sektorë të ndryshëm, duke ofruar shërbime të lidhura me kohën e lirë dhe me udhëtimet e biznesit. Ai luan një rol të madh në zhvillim, pasi kontribuon në zhvillimin lokal, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e zonave në rënie industriale apo rurale, si dhe në rigjenerimin urban. Drejtoria e Turizmit, gjatë vitit 2016 me një qasje të re në hartimin e politikave të zhvillimit të turizmit, ka trajtuar çështje kritike territoriale në mënyrë të koordinuar duke ruajtur një vazhdimësi me programet sektorale të zhvillimit. Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara për përmirësimin e shërbimit ndaj vizitorit, përmirësimi i infrastrukturës turistike, organizimi i panairove të atraksioneve dhe bizneseve turistike të rajonit, prodhimi i materialeve promocionale për territorin e ri të Bashkisë Shkodër, organizimi i një sërë aktiviteteve me qëllim ripërtëritjen e trashëgimisë kulturore dhe artistike, bashkëpunimi me sektorin privat në marketingun e vlerave dhe potencialeve të territorit , ka ndikuar në forcimin e identitetit të rajonit duke kontribuar në rritjen e shpenzimeve të turistëve dhe për rrjedhojë në rritjen e të ardhurave për territorin.

## **I      Pershkrimi i funksioneve dhe objektivave**

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2016 ka fokusuar përpjekjet e saj në 6 funksione zhvillimi:

- F1. Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal
- F2. Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë
- F3. Mbështetje për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairove e reklama në vende publike
- F4. Publikimi i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik.
- F5. Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.
- F6. Zhvillimi i Turizmit

Objektivat për secilin funksion janë:

F1.01. Mbështetja për përmirësimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucione të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planeve ekonomike zhvillimore lokale.

F2.01. Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës.

F3.01. Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar

F4.O1. Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promocionale për nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja

F5.O1. Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendor, nëpërmjet incentivave financiar, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre

F6.O1.Promovim i territorit të Bashkisë nëpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve. promocionale-informative.

F6.O2. Organizim dhe pjesëmarrje në panairë lokale, kombëtare dhe ndërkombetare.

F6.O3. Organizimi i aktiviteteve për promovimin e ofertave dhe produkteve turistike të Bashkisë Shkodër.

F6.O4. Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara për përmirësimin e shërbimit ndaj vizitorit.

F6.O5. Zhvillim i produkteve të reja dhe përmirësimi i infrastrukturës së produkteve turistike ekzistuese.

## **II Produktet për vitin 2016**

Gjatë vitit 2016 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër:

P6.F1.O1.A1. Ngritja e Bordit të Zhvillimit Ekonomik.

Në mbështetje të Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin e territorit", VKM nr 671 dt 29.07.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", Bashkia Shkodër në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor me vendim të Këshillit Bashkiak ka ngritur forumin këshillimor vendor me përfaqësues të institucioneve, OJF dhe sektorit privat në të gjitha fushat e zhvillimit.

P6.F1.O1.A2. Studimi për klasterat e biznesit që operojnë në Bashkinë Shkodër.

Në territorin e Bashkisë Shkodër operojnë një numër i konsiderueshëm biznesesh të fushave dhe aktiviteteve të ndryshme. Shembull i mirë i organizimit të bizneseve në një shoqatë është ai i bizneseve të rrugës "13 Dhjetori"- "28 Nëntori" të cilët në mënyrë të organizuar mbrojnë interesat e tyre. Me qëllim rritjen e konkurrencës së bizneseve është realizuar studimi për klasterat e biznesit. Ky studim vë në dukje nevojën për mbështetjen e klasterave ekzistuese të biznesit dhe mbështetjen për krijimin e klasterave të reja si një instrument që nxit konkurrencën e bizneseve që operojnë në territorin e Bashkisë Shkodër.

P6.F1.O1.A3. Hartimi i dokumentave strategjike.

Bazuar në VKM nr. 671, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", neni 52 "Hartimi i Strategjisë Territoriale të njësisë vendore", Bashkia Shkodër ka hartuar Planin e Përgjithshëm Vendor, si një instrument shumë i rëndësishëm i cili përfshin identifikimin dhe shfrytëzimin kryesisht të burimeve vendore, ideve dhe aftësive për të stimuluar rritjen dhe zhvillimin ekonomik.

P6.F2.O1.A1. Studim fizibiliteti për ngritjen e tregjeve.



Sistemet e qëndrueshme bujqësore janë një bazë e domosdoshme për zhvillimin rural. Qëndrueshmëria kërkon që këto sisteme të jenë: të shëndoshë nga ana mjedisore, të mundshëm financiarisht e ekonomikisht, si dhe të pranueshëm nga ana sociale. Në këtë kuadër, me ndryshimet territoriale që ndodhën lindi si domosdoshmëri hartimi i studimit të fizibilitetit për ngritjen e tregjeve industriale të shitjes me shumicë dhe pakicë.

Meqënëse rritja e agrobizneseve private varet kryesisht nga iniciativa private, Bashkia Shkodër ka luajtur një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave lehtësuese mjedisore dhe në promovimin e zhvillimit të një tregu të lirë e të ndershëm. Në vitin 2016 u realizua një studim fisibiliteti për ngritjen e tregjeve. Qëllimi i studimit është ofrimi i një modeli ekonomik të arsyeshëm për funksionimin e tregjeve si dhe të përcaktojë standarte të përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit tregtar në këto tregje.

#### P6.F3.O1.A1. Organizimi i një panairi pune.

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me institucionet e tjera publike ka kryer rolin koordinues dhe mbështetës, si pikë takimi i sektorëve të arsimit profesional, biznesit dhe institucioneve financiare për të promovuar dhe orientuar ofertën dhe kërkesën për fuqi punëtore të specializuar, jo vetëm nga sistemi i arsimit profesional por edhe kërkesës së bizneseve për vende pune.

#### P6.F3.O1.A2. Organizimi i panairit të bizneseve prodhuese.

Gjatë vitit 2016 është organizuar një panairi i bizneseve prodhuese me qëllim:

Promovimin, orientimin e ofertës dhe kërkesën për forcë punëtore të specializuar nga sistemi i arsimit profesional dhe kërkesës së bizneseve për vende pune;

Shkëmbimin e ideve dhe krijimin e një rrjeti bashkëpunimi ndërmjet sektorëve pjesëmarrës për një rritje ekonomike të qëndrueshme në Bashkinë Shkodër.

#### P6.F4.O1.A1. Botimi i profilit ekonomik të Bashkisë.

Bashkia Shkodër e përbërë tashmë nga 11 njësi administrative ka realizuar procesin e hartimit të profilit të ri të Bashkisë, një dokument informativ në të cilin në mënyrë të përmbledhur jepen të dhëna statistikore dhe informacion përshkrimor në lidhje me zonën dhe komunitetin e saj, duke përfshirë të dhëna gjeografike, historike, demografike dhe social ekonomike. Ky material prezanton në mënyrë të përmbledhur të gjithë territorin dhe tendencat e zhvillimit të saj.

#### P6.F4.O1.A2. Përditësimi i informacionit dixhital për faqen Web të Bashkisë Shkodër.

Bashkia Shkodër nëpërmjet faqes së saj të internetit ofron informacione të ndryshme për shërbime ndaj qytetarëve, bizneseve si dhe informacione të ndryshme informative statistikore dhe social kulturore. Kjo faqe web është pasuruar dhe më tej në lidhje me rikonceptimin e strukturës së informacionit dhe shërbimeve që ofron ndaj të bërit biznes në Shkodër.

P6.F4.O1.A3. Botimi i broshurës informative për tërheqjen e investimeve vendase dhe të huaja në Bashkinë Shkodër.

Duke qënë se rritja ekonomike dhe hapja e vendeve të reja të punës në ekonomitë në zhvillim, varen nga dy faktorë kryesorë: tërheqja e investitorëve të huaj dhe zhvillimi i SME-ve, Bashkia

Shkodër këtë vit realizoi përgatitjen e broshurës informative "Të investosh në Shkodër". Ky dokument është një udhërrëfyes i vyer për tërheqjen kryesisht të investitorëve të huaj. Broshura informative është përgatitur në tre gjuhë (shqip, anglisht, italisht).

P6.P6.F5.O1.A1. Bashkëpunimi me zonën e përmirësimit të biznesit BID Shkodër.

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është mbështetja e biznesit të vogël për t'u konsoliduar, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të zonës së përmirësimit të biznesit, për ta kthyer atë në një vend terheqës për vizitorin. Nga ky bashkëpunim përfituan rreth 120 biznese.

P6.F6.O1.A1. Krijimi i faqes web për turizmin e rajonit të Shkodrës.

Një ndër instrumentat më të fuqishëm dhe më aktual të promocionit është promovimi online. Sitet e ndryshme web të destinacioneve turistike janë të natyrave dhe funksioneve të ndryshme. Promocioni online ofron avantazhe të shumta, është lehtësisht i arritshëm nga çdo pikë e globit, mund të përditësohet shpejt, është i lirë etj. Aktualisht Bashkia Shkodër ka një website zyrtar në të cilin jepen edhe informacionet bazë për territorin. Ky website nuk ofron informacion të mjaftueshëm dhe në shkallën e duhur të zhvillimit aktual të turizmit në Shkodër. Gjatë vitit 2016 është përcaktuar modeli i website\_t të turizmit dhe janë hartuar termat e referencës për ndërtimin e tij. Është mbledhur informacioni që është parashikuar të përmbajë website\_it.

P6.F6.O1.A2. Përgatitja dhe publikimi i guidës turistike të Bashkisë Shkodër.

Një numër gjithnjë në rritje turistësh, vizitojnë territorin e Bashkisë Shkodër në mënyrë të organizuar por edhe individualisht. Megjithëse ka pasur disa botime të ndryshme guidash turistike, ato duhet të përmirësohen dhe përditësohen edhe për shkak të reformës territoriale të Bashkisë. Fondi limit për botimin e guidës turistike është rritur me anë të rialokimit të fondeve me qëllim përmirësimin e cilësisë së botimit të saj. Stafi i Drejtorisë së Turizmit, ka konceptuar modelin, përmbajtjen, hartuar termat e referencës dhe mbledhur informacionin e nevojshëm.

P6.F6.O1.A3. Publikimi i hartës turistike së territorit të Bashkisë. Është realizuar përzgjedhja e modelit dhe përmbajtjes së informacionit që do të ketë harta turistike e Bashkisë Shkodër.

P6.F6.O1.A4. Publikimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore të Bashkisë.

Në territorin aktual të Bashkisë Shkodër zhvillohen një seri ngjarjesh dhe aktiviteteve social-kulturore, sportive etj. Pjesa më e madhe e tyre e organizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose e mbështetur në mënyra të ndryshme nga Bashkia. Një pjesë e tyre janë aktivitete me pjesëmarrje të gjërë dhe me potencial të konsiderueshëm për të tërhequr vizitorë edhe nga trevat e tjera të Shqipërisë e më gjërë. Stafi i Drejtorisë së Turizmit, ka konceptuar modelin, përmbajtjen, hartuar termat e referencës dhe mbledhur informacionin e nevojshëm si dhe ka bërë përkthimin në anglisht të tekstit të kalendarit. Botimi i saj është hedhur disa herë për prokurim por për shkak të interesit të pamjaftueshëm të operatorëve ekonomik deri më sot nuk ka qenë e mundur të kryhet prokurimi.

P6.F6.O2.A1. Panairi i atraksioneve dhe bizneseve turistike I integruar me produktet artizanale, bujqësore dhe ushqimore.

Rajoni jonë ofron një gamë të gjërë të produkteve bujqësore dhe gastronomike me shije krejt të veçanta që përbëjnë një element shumë të rëndësishëm të ofertës turistike të rajonit. Një sinergji më e konsoliduar mes bizneve turistike dhe atyre të produkteve bujqësore dhe gastronomike krijon



mundësinë për produkte të reja turistike duke rritur ndjeshëm numrin e tyre por edhe duke i përmirësuar cilësisht ato. Gjatë vitit janë realizuar disa panairë të tilla në ditë dhe në raste të ndryshme gjatë vitit 2016. Mund të përmendim panairin e realizuar me rastin e hapjes së sezonit turistik në Theth, panairin e bizneseve turistike dhe produkteve artizanale, bujqësore dhe ushqimore, në ditën ndërkombëtare të turizmit.

#### P6.F6.O3.A1. Festa e Liqenit

Bashkia Shkodër tashmë për të disatin vit rradhazi, ka zhvilluar edhe këtë vit Festën e Liqenit. Janë zhvilluar aktivitete promovuese social kulturore, sportive me qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë së pasur natyrore të qytetit si dhe promovimin e produkteve rajonale dhe bizneseve lokale të Shkodrës.

Janë organizuar gara të ndryshme noti (të rritur, të rinj & fëmijë), gara me kanoe, ski board, ndeshje vaterpoli me pjesëmarrjen e ekipeve të notit dhe fshatrave Zogaj dhe Shirokë.

#### P6.F6.O3.A2. Dita e turizmit.

Me qëllim ndërgjegjësimin dhe rritjen e vëmendjes së komunitetit të biznesit për të rritur përpjekjet dhe bashkëpunimin në këtë drejtim, ishte planifikuar dhe u realizua menduar të organizohet festa kushtuar turizmit, pikërisht në ditën botërore të turizmit me datë 27 Shtator dhe synohet që të shndërrohet në një festë tradicionale dhe të festohet çdo vit me aktivitete të ndryshme. Ky aktivitet u realizua me dy aktivitete të ndryshme. Më përpara u organizua panairi i bizneseve të turizmit dhe prodhuesve të produkteve artizanale dhe atyre të agrobiznesit. Në pjesën e dytë, në bashkëpunim me Universitetin “Luigj Gurakuqi” u organizua një ëorkshop me bizneset pjesëmarrëse në panair ku u theksua nevoja për bashkëpunim e të gjithë aktorëve të interesuar në zhvillimin e turizmit.

#### P6.F6.O3.A3. Hapja e sezonit turistik Velipojë.

Velipoja është një ndër destinacionet e më të njohura të bregdetit Shqiptar me vlera të padiskutueshme dhe potenciale të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit të diellit e rërës. Aktualisht frekuentohet nga një numër i madh pushuesish gjatë sezonit të verës të përqëndruar kryesisht vetëm në muajt korrik e gusht, por Velipoja zotëron potenciale të tilla që ky sezon të jetë më masiv dhe më i shtrirë në kohë. Dita e hapjes së sezonit turistik është zhvilluar çdo vit këto vitet e fundit me pjesëmarrjen e banorëve të zonës dhe qytetarë nga Shkodra. Këtë vit, ky aktivitet u realizua me anë të organizimit të një koncerti festiv të mbajtur në qendër të plazhit të Velipojës në të cilin performuan live një rockband i përbërë nga artistë të qytetit të Shkodrës si edhe një grup valltarësh.

#### P6.F6.O3.A4. Feste e Thethit

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me AdZM dhe GIZ në kuadër të hapjes së sezonit turistik në Theth dhe 50 vjetorit të shpalljes së Parkut Kombëtar, ka organizuar aktivitetin “Dalja n’bjeshkë”. Gjatë këtij aktiviteti u prezantuan politikat lokale të Bashkisë Shkodër për zhvillimin e turizmit në këtë zonë, nismat e ndërmarra nga Agjencia Kombëtare për zonat e mbrojtura, projektet bashkëpunuese për ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të biodiversitetit- Programi CABRA i GIZ. Ky aktivitet kishte si qëllim promovimin e vlerave natyrore dhe kulturore të zonës, produkteve autoktone vendore të zonës mbi të gjitha prezantimin e ofertës turistike me qëllim rritjen e numrit



të turistëve me ndikim në ekonominë rurale të zonës. Ky aktivitet konsistoi në koncert me këngë dhe valle tradicionale, lojra popullore, panair i produkteve vendore të zonës, i ushqimit dhe gatimit tradicional, shëtitje e udhëhequr e atraksioneve të Thethit.

#### P6.F6.O3.A5. Dita e biçikletave.

Shkodra renditet në 10 qytetet që përdorin më shumë biçikletën në shkallë europiane. Me organizimin e ditës së biçikletave dhe shndërrimin e saj në një festë të përvitshme synohet ripërtëritja e traditës si edhe promovimi i mënyrës së shëndetshme të jetesës por synohet edhe gjallërimi i jetës kulturore të qytetit duke rritur atraktivitetin e tij. Dita e biçikletave u festua këtë vit me një sërë aktivitetesh ku mund të përmendim, shëtitje e organizuar me bicikleta, shpërndarje cmimesh për përdorues të njohur të biçikletës në qytet, punime të fëmijëve me temë biçikletën dhe pasdite, në bashkëpunim me organizatën GO2, u zhvillua ekspozita fotografike me titull “Shkodra, familja ime, biçikleta ime, historia ime” dhe me këtë rast u shpërndanë edhe cmime për fotot më të mira.

#### P6.F6.O3:A6. Triathlon

Bashkia Shkodër, në kuadër të zhvillimit të sportit dhe turizmit në liqenin e Shkodrës, organizoi aktivitetin e përvitshëm “Triathlon” – një kompeticion tre garësh: not, çiklizëm dhe vrapim. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte promovimi dhe nxitja e zhvillimit të sportit si një mënyrë e shëndetshme e të jetuarit. Aktiviteti u karakterizua nga pjesmarrja e gjerë e sportistëve dhe amatorëve të sportit nga disa qytete të Shqipërisë dhe Malit të Zi. Aktivitete të tilla shërbejnë në promovimin e turizmit natyror në liqenin e Shkodrës, si një aset i pazëvendësueshëm i territorit dhe kontribuon në promovimin e burimeve dhe potencialeve që zotëron Liqeni i Shkodrës për zhvillimin e sporteve ujore dhe turizmit në tërësi.

#### P6.F6.O4:A1. Krijimi i drejtorisë së turizmit

Deri në vitin 2016, ka pasur një sektor të promovimit të territorit dhe zhvillimit ekonomik. Me krijimin e Bashkisë së re dhe përparësinë që po i jepet zhvillimit të turizmit, është realizuar ngritja e një drejtorie të dedikuar turizmit me dy sektorë që janë Sektori i Zhvillimit të Turizmit dhe Produktit Turistik dhe Sektori i Marketingut dhe i Shërbimit për vizitorin. Ka përfunduar rekrutimi i personelit si edhe paisja e drejtorisë me logjistikën e nevojshme për kryerjen e funksioneve të saj.

P6.F6.O4.A2. Ngritja dhe paisja e Zyrës së Informacionit Turistik në teritorin administrativ të qytetit Shkodër.

Projekti për spostimin dhe konstruksionin e zyrës ekzistuese turistike të qytetit të Shkodrës, është në proces përfundimi. Është realizuar procesi i tenderimit; është përcaktuar vendodhja e re e objektit dhe po punohet për konstruksionin e saj dhe vënien në funksion të saj.

P6.F6.O4:A3. Ngritja dhe paisja e Zyrës së Informacionit Turistik në njësinë administrative Velipojë.

Bashkia Shkodër ka ngritur zyrën e informacionit turistik në njësinë administrative Velipojë me qëllim përmirësimin e shërbimit ndaj vizitorit dhe marketingun e destinacionit. Ka përfunduar pajisja e zyrës me të gjitha lehtësirat teknike, është realizuar sigurimi i stafit të trajnuar, është siguruar

bashkëpunimi me bizneset lokale të turizmit dhe ka përfunduar inventarizimi i shërbimeve turistike (njësive akomoduese), burimeve dhe ofertës turistike.

P6.F6.O4:A4. Ngritja dhe paisja e Zyrës së Informacionit Turistik në Theth.

Në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional, Bashkia Shkodër ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me AdZM (Agjencinë Rajonale të Zonave të Mbrojtura) për ngritjen dhe funksionimin e zyrës së Informacionit Turistik në Theth. Kjo marrëveshje konsiston në ndërtimin e kësaj zyre nga ADZM me një fond limit 14,000,000 lekë. Bashkia Shkodër ka marrë përsipër pajisjen e zyrës me infrastrukturën e nevojshme teknike dhe ka përfunduar rekrutimin e personelit.

P6.F6.O5.A1. Vendosja e tabelave informative turistike për objekte të interesit për vizitorët.

Me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare së Turizmit dhe financimin e GiZ, Bashkia Shkodër ka realizuar vendosjen e 5 tabelave informative turistike në pikat kryesore të qytetit. Gjithashtu për realizimin e këtyre tabelave, stafi i drejtorisë ka bërë konceptimin e materialit, përkthimin në anglisht si dhe ka përzgjedhur fotot ilustruese të atraksioneve kryesore të qytetit.

P6.F6.O5.A2. Gjatë vitit 2016, në kuadër të promovimit të turizmit të interesit të veçantë dhe diversifikimit të ofertës turistike në Liqenin e Shkodrës, Drejtorja e Turizmit ka punuar për identifikimin e shtigjeve të reja për ecje në malin e Taraboshit.

P6.F6.O5.A4 Krijimi i 7 shtigjeve të reja për bicikleta në lumin Buna, Velipojë, Baks dhe Rrjoll.

Në kuadër të nxitjes së zhvillimit të turizmit rural dhe promovimit të vlerave ekologjike, kulturore dhe etnografike, Bashkia Shkodër në bashkëpunim me IUCN dhe Ride Albania Mountain Biking, ka realizuar krijimin e 7 shtigjeve të reja përgjatë lumit Buna dhe Velipojë – Baks Rrjoll.

P6.F6.O5.A5. Është konceptuar përmbajtja për realizimin e broshurave dhe materialeve promocionale që konsistojnë në hartimin e 5 paketave të ndryshme të integruara turistike me itinerare të sugjeruara dhe informacione në lidhje me atraksionet turistike.

P6.F6.O5.A6 Integrimi i marketingut të produkteve bujqësore në ofertën e turizmit rural në Theth.

Në kuadër të projektit CABRA të GiZ, në bashkëpunim Bashkinë Shkodër për zonën e Thethit, me qëllim nxitjen për shtimin e produkteve tipike agro- ushqimore si pjesë themelore e vlerësimit të identitetit dhe kulturës lokale dhe një atraksion i fuqishëm për turistët e huaj duke promovuar prodhuesit/ fermerët e zones, është realizuar:

Identifikimi i produkteve të zonës dhe hartëzimi i tyre; Mbledhja e informacionit të nevojshëm dhe përshkrimi për secilin produkt kultivues me qëllim krijimin e kalendarit vjetor të produkteve; aktivitete promocionale (fushata marketingu me botimin e materialeve promovuese, panaire të fermerëve, fushata edukimi për komunitetin, tregje lokale), ofrimi i asistencës teknike/ trajnime të fermerëve për zhvillimin dhe promovimin e produkteve lokale dhe integrimin, nxitje në shkëmbimin e produkteve lokale dhe fermerëve me restorantet/ guest house të zonës dhe integrimin të produkteve lokale në ofertën turistike të Thethit. Kjo nismë ka si qëllim vlerësimin dhe menaxhimin novator të produkteve tipike lokale për t'i japë shtysë zhvillimit të turizmit rural, duke ndihmuar në diversifikimin e ofertës turistike.

P6.F6.O5.A7 Krijimi i ofertës për turizmin e konferencave.

Në qytetin e Shkodrës zhvillohen një numër i konsiderueshëm konferencash të tipologjive të ndryshme dhe përbëjnë një treg të rëndësishëm potencial për zhvillimin e turizmit. Një pjesë e mirë e tyre janë konferenca shkencore ndërkombëtare të organizuara edhe nga organizata të huaja me aktivitet në Shkodër. Në këto konferenca marrin pjesë vizitorë të huaj por edhe nga qytetet e tjera të Shqipërisë. Integrimi i elementëve të nevojshëm në disa produkte të përshtatshme do të krjonte lehtësi të madhe në organizimin e tyre. Përveç kësaj organizimi i kujdesshëm i tyre përbën një mundësi të mirë për promovimin e qytetit tek pjesëmarrësit në këto konferenca. Bashkia Shkodër, në kuadër të diversifikimit të ofertës turistike, ka realizuar mbledhjen dhe sistemimin e informacionit për potencialet që ka Shkodra për organizimin e konferencave, organizimin e këtij informacioni në paketa turistike dhe marketingun e ofertës së turizmit të konferencave në bashkëpunim me sektorin privat.

### III Fondet e financimit të programeve

Si rezultat i diferencave të krijuara ndërmjet vlerës së parashikuar dhe vlerës fituese gjatë proceseve të prokurimit publik për zhvillimin e aktiviteteteve të parashikuara gjatë 2016, me vendim të kryetares së Bashkisë, nr 768, dt 03.11.2016, është miratuar riallokimi i fondeve me shumë totale: 547 mije lekë për katër zërat buxhetore:

1. Ngritja dhe pajisja e Zyrës së informacionit turistik në territorin administrativ të qytetit Shkodër me materiale promociionale dhe funksionale.
2. Përgatitja dhe publikimi i guidës turistike të Bashkisë Shkodër.
3. Shpenzime për shërbimin fotografik për tabelat informative turistike.
4. Publikimi i hartës turistike të territorit të Bashkisë.

#### Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2016

Fondet e miratuara për këtë program janë 7,120 mije lekë. Realizimi për periudhën 12 mujore është 4 174 mije në masën 59 % ndaj planit vjetor.

1. Shpenzime Operative janë realizuar në masën 2 574 mije lekë nga 5 520 mije lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 46.6 %.
2. Transferta janë realizuar në masën 1 600 mije lekë nga 1 600 mije lekë që ka qënë e parashikuar. Realizimi 100 %.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.

Aktivite/Projekte	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi
P6.F1.O1.A1. Hartimi i Planit të Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë Shkodër (krijimi i një bordi lokal të zhvillimit ekonomik me përfaqësues të sektoreve baze dhe hartimi i një plani vjetor )	-	-	-
P6.F1.O1.A2. Studim për klusterat e biznesit që operojnë në Bashkinë Shkodër	-	-	-

P6.F1.O1.A3. Hartimi i studimit per marketingun dhe brandimin per bizneset dhe sektoret qe mund te eksportojne jashte Shkodres	150	150	-
P6.F2.O1.A1. Studimi ngritjes se tregjeve te shitjes me shumice dhe pakice te produkteve industriale.	-	-	-
P6.F3.O1.A1. Organizimi i nje panaire pune ne bashkepunim me universitetin dhe shkollat profesionale	100	100	63
P6.F3.O1.A2. Panairi i produkteve te bizneseve prodhuese ne Bashkine Shkoder	100	100	79
P6.F4.O1.A1. Hartimi dhe botimi i profilit te Bashkise	200	200	192
P6.F4.O1.A2. Ristrukturimi dhe pasurimi I faqes Web te Bashkise per sektorin e zhvillimit ekonomik	-	-	-
P6.F4.O1.A3. Botim i broshures informative per terheqjen e investimeve vendase dhe te huaja ne Bashkine Shkoder	200	200	-
P6.F5.O1.A1. Zgjerimi i zones se permiresimit te biznesit ne rrugen 13 Dhjetori dhe 28 Nentori	1,600	1,600	1,600
P6.F6.O1.A1. Krijimi i faqes web për turizmin e rajonit të Shkodrës	150	150	-
P6.F6.O1.A2. Pergatitja dhe publikimi I guidës turistike të Bashkisë Shkodër.	500	600	579.7
P6.F6.O1.A3. Publikimi i hartës turistike së territorit të Bashkisë	300	350	
P6.F6.O1.A4. Publikimi I kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore të Bashkisë	150	150	
P6.F6.O2.A1. Panairi I atraksioneve dhe bizneseve turistike I integruar me produktet artizanale, bujqesore dhe ushqimore.	250	250	
P6.F6.O2.A2. Pjesëmarrje në panaire kombetare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës	250	250	
P6.F6.O3.A1. Festa e Liqenit	300	235	235
P6.F6.O3.A2. Dita e turizmit	250	148	148
P6.F6.O3.A3. Hapja e sezonit turistik Velipoje	350	200	200
P6.F6.O3.A4. Feste e Thethit	350	257	257
P6.F6.O3.A5. Dita e biçikletave	150	116	116

P6:F6:O3:A6. Triathlon	150	117	117
P6.F6.O4:A1. Krijimi i drejtorisë së turizmit	-	-	-
P6.F6.O4.A2. Ngritja dhe paisja e Zyrës së Informacionit Turistik në teritorin administrativ të qytetit Shkodër	250	617	408
P6.F6.O4:A3. Ngritja dhe paisja e Zyrës së Informacionit Turistik në njësinë administrative Velipojë	250	180	180
P6.F6.O4:A4. Ngritja dhe paisja e Zyrës së Informacionit Turistik në Theth.	250	250	
P6.F6.O5.A1. Vendosja e tabelave informative turistike për objekte të interesit për vizitorët	150	180	
P6.F6.O5.A2. Identifikimi dhe paisja me sinjalistikën e përshtatshme të shtigjeve për ecje në malin e Taraboshit.	200	200	
P6.F6.O5.A3. Identifikimi dhe paisja me sinjalistikën e përshtatshme të shtigjeve për ecje në Theth.	400	400	
P6.F6.O5.A4 Krijimi i 7 shtigjeve të reja për bicikleta në lumin Buna, Velipojë, Baks dhe Rrjoll	-	-	
P6.F6.O5.A5. Hartimi i paketave të integruara me produkte të ndryshme turistike	120	120	
P6.F6.O5.A6. Integrimi i marketingut të produkteve bujqesore në oferten e turizmit rural në Theth	-	-	
P6.F6.O5.A7. Organizim i ofertës për turizmin e konferencave në bashkëpunim me bizneset dhe universitetin.	-	-	
<b>Total</b>	<b>7,120</b>	<b>7,120</b>	<b>4,174</b>

#### **IV Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.**

Vështirësitë e hasura gjatë implementimit të buxhetit sipas secilit aktivitet kanë konsistuar në:

- Hartimi i studimit për marketingun dhe brandimin për bizneset dhe sektoret që mund të eksportojnë jashtë Shkodrës, ka pasur një gabim në klasifikimin ekonomik kontabël të aktivitetit në hartimin e buxhetit.

Botim i broshurës informative për tërheqjen e investimeve vendase dhe të huaja në Bashkinë Shkodër. Nuk është realizuar vetëm printimi i broshurës për shkak të tërheqjes së operatorëve nga procedura e prokurimit. Kanë konkuruar 10 operatorë ekonomikë, nga të cilët janë kualifikuar 5 të cilët janë tërhequr në momentin e dërgimit të njoftimit të fituesit.

- Krijimi i faqes web për turizmin e rajonit të Shkodrës, hostim, mirembajtje, perditesim dhe sherbime shtese per web sitin e turizmit. Në fakt është konceptuar website në totalin e tij, hartuar termat e referencës, mbledhur dhe sistemuar informacioni, pregatitur dokumentacioni tekniko ligjor për prokurimin publik në muajin dhjetor, por nuk u arrit të kryhej prokurimi publik për shkak të pamundësisë për të respektuar afatet ligjore për realizimin e procedurës.
- Publikimi i hartës turistike të territorit të Bashkisë nuk u arrit të kryhej prokurimi publik për shkak të pamundësisë për të respektuar afatet ligjore për realizimin e procedurës.
- Publikimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore të Bashkisë. Është konceptuar materiali, hartuar termat e referencës dhe pregatitur dokumentacioni tekniko ligjor për prokurimin publik, janë realizuar dy proceduara prokurimi për këtë aktivitet. Në procedurën e parë kanë pjesë 14 operatorë ekonomik dhe në të dytën 10 operatorë ekonomikë. Të dyja procedurat janë anuluar për shkak të tërheqjes së operatorëve ekonomik ofertues.
- Panairi i atraksioneve dhe bizneseve turistike i integruar me produktet artizanale, bujqesore dhe ushqimore. Si aktivitet është zhvilluar në dy raste të ndryshme, në ditën Ndërkombëtare të turizmit dhe në festën e Thethit. Ky aktivitet është realizuar me mbështetjen financiare të GiZ. Kjo është arsyeja e mospërdorimit të fondit të parashikuar në buxhetin e Bashkisë për këtë aktivitet.
- Pjesëmarrje në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës. Arsyeja e mosrealizimit të këtij aktiviteti ishte aprovimi i buxhetit në muajin Maj dhe tejkalimi i afateve për pjesëmarrje në panairët ndërkombëtare të planifikuara.
- Identifikimi dhe paisja me sinjalistikën e përshtatshme të shtigjeve për ecje në malin e Taraboshit. Ka pasur një gabim në klasifikimin ekonomik kontabël të aktivitetit në hartimin e buxhetit.
- Identifikimi dhe paisja me sinjalistikën e përshtatshme të shtigjeve për ecje në Theth. Ka pasur një gabim në klasifikimin ekonomik kontabël të aktivitetit në hartimin e buxhetit.
- Pergatitja dhe publikimi I guidës turistike të Bashkisë Shkodër. Është konceptuar materiali, hartuar termat e referencës dhe pregatitur dokumentacioni tekniko ligjor për prokurimin publik, janë realizuar dy proceduara prokurimi për këtë aktivitet. Në procedurën e parë kanë pjesë 14 operatë ekonomik dhe në të dytën 9 operatorë ekonomikë. Të dyja procedurat janë anuluar për shkak të tërheqjes së operatorëve ekonomik ofertues.
- Hartimi i paketave të integruara me produkte të ndryshme turistike. Ky aktivitet ishte parashikuar të kryhej nga stafi i drejtorisë, për shkak të rekrutimit të stafit të ri në muajin gusht, për arsye kohore, nuk qe e mundur të realizohet.
- Vendosja e tabelave informative turistike për objekte të interesit për vizitorët. Me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare së Turizmit dhe financimin e GiZ, Bashkia Shkodër ka realizuar vendosjen e 5 tabelave informative turistike në pikat kryesore të qytetit. Kjo është arsyeja e mospërdorimit të fondit të parashikuar në buxhetin e Bashkisë për këtë aktivitet.

## **P.7 Bujqësia dhe zhvillimi rural**

Zhvillimi i Zonave Rurale bazohet në politikën që sjellë popullsinë dhe ekonominë në një barazpeshë. Synimi afatgjatë kryesor është racionalizimi i modelit të fshatrave përsa i përket përdorimit të tokës, infrastrukturës rrugore e nëntokësore dhe shërbimeve komunale në lidhje me burimet ekonomike të shfrytëzueshme.

Rreth 43% e popullsisë së Bashkisë Shkodër jeton në zonat rurale. Numri i fermave bujqësore është rreth 11,200 me drejtim kryesisht blegtoral, perime dhe fruti kulturë (për tregun lokal), me një madhësi mesatare prej 1.1 ha/fermë e ndarë në 2-3 parcela. Sipërfaqja e tokës bujqësore është 16,054 ha ose 22.4% e territorit të Bashkisë, tokë subargjilore e mesme (SAM) dhe me bonitet mesatar III-IV. Me delegimin e funksioneve të reja Bashkia Shkodër ka trashëguar 213 km kanale ujitëse, nga këta 37 km janë funksionale dhe 176 km janë jo funksionale, ndërsa kanale kulluese janë gjithsej 622.7 km prej të cilave 142.7 km janë kanale të dyta dhe 480 km janë kanale të treta kulluese.

Sot problemi kryesor mbetet fragmentarizimi i tokës, gjë e cila krijon probleme në adoptimin e skemave të subvencioneve dhe futjes së teknikave të reja (modernizimit për të qenë me konkurent në tregjet e brëndshme), prandaj është domosdoshmëri përfundimi i procesit të rregjistrimit të tokës dhe krijimin e tregut të saj.

### **I Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave**

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2016 ka fokusuar përpjekjet e saj në 3 funksione zhvillimi:

- F1. Administrimi i infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit të tokave si dhe menaxhimi i institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- F2. Administrimi i sistemit të informacionit dhe kadastrës së tokave bujqësore.
- F3. Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit.

Objektivat për secilin funksion janë:

- F1.01. Ngritja e strukturës menaxhuese për çështjet e zhvillimit rural, administrimin dhe përdorimin e tokës bujqësore.
- F1.02. Përmirësimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit.
- F2.F3.O1. Krijimi i sektorit për administrimin, përdorimin dhe mbrojtjen e tokës.
- F2.F3.O2. Përfundimi i plotësimit me AMTP e gjithë familjeve përfituese të tokës bujqësore.

### **II Produktet për vitin 2016**

Gjatë vitit 2016 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër:

F1.01.A1. Krijimi i Drejtorisë së Bujqësisë në Bashkinë Shkodër

Për realizimin e këtyre funksioneve është krijuar Drejtoria e Bujqësisë e cila përbëhet nga dy sektorë, sektori i Zhvillimit Rural dhe sektori i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës. Kjo strukturë ka në përbërjen e saj: Drejtor drejtorie; Përgjegjës sektori (2 në secilin sektor); 2 specialistë në sektorin e zhvillimit rural dhe 8 specialistë në sektorin e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës. Krijimi i Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore (institucion varësie) me 12 punonjës, pagesa e të cilëve kryhet nga transferta specifike dhe të ardhurat e Bashkisë Shkodër.

#### F1.O1.A2. Krijimi i Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore (institucion varësie)

Me vendim të Këshillit të Ministrave, Nr.1108, datë 30.12.2015, u bë kalimi i Bordit të Kullimit në administrim të Bashkisë Shkodër. Për realizimin e këtij shërbimi u ngrit dhe funksionon struktura e Ujitjes dhe Kullimit nën institucionin Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore.

Në transfertën specifike të vitit 2016, janë transferuar fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Bashkia Shkodër, në zbatim të VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 dhe Udhëzuesit të AZRT nr. 540/1, datë 31.12.2015, ka ngritur grupin e punës për marrjen në dorëzim të funksionit të ujitjes dhe kullimit me Urdhërin e Brëndshëm të Kryetar-es së Bashkisë nr. 3, datë 12.01.2016.

Vazhdimisht është komunikuar me Ministrinë e Bujqësisë, AZRT dhe Prefektin e Qarkut me Shkresën nr. 2048, datë 22.02.2016 për ecurinë e punës dhe veshtirësitë për marrjen në dorëzim të aseteve si dhe Shkresën nr. 3354, datë 29.02.2016 drejtuar Bordit Rajonal të Kullimit Lezhë, Ministrisë së Bujqësisë, AZRT-se dhe Prefektit Qarkut Shkodër.

Proçesi i marrjës në dorëzim i aseteve është përfunduar me datën 31.05.2016.

Bashkia Shkodër me Urdhërin nr. 14, datë 19.01.2016 ka krijuar institucionin “Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore” i cili do të merret me shërbimin e mirëmbajtjes së kanaleve vaditese dhe kulluese.

Me email të ardhur nga AZRT të datës 19.02.2016, për pezullimin e transferimit të personelit, janë anuluar pagesat e muajit janar 2016 duke shkaktuar probleme në transferimin e këtij funksioni. Me Shkresën nr. 2571, datë 03.03.2016 “Informacion mbi pezullimin e proçesit të transferimit të punonjësve të Bordit të Kullimit tek Bashkia” kemi venë në dijeni Bordin Rajonal të Kullimit Lezhë, dhe Prefektin e Qarkut Shkodër për proçedurën e ndjekur.

Me VKM nr. 90 dt. 04.02.2016 për detajimin e fondit të investimeve për funksionin e ujitjes dhe kullimit sipas bashkive, bashkisë Shkodër i është akorduar një fond prej 25 402 mije lekë për blerjen e dy eskavatorëve (1 tip mesatar, 1 tip i vogël). Prokurimi është kryer i përqëndruar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave në vlerën 25 402 mije lekë me datë 01/11/2016. Mjetet janë vënë akoma në dispozicion të Bashkisë Shkodër në muajin Shkurt 2017.

#### F1.O2.A1. Pastrim kanalesh ujitese dhe kulluese për NjA

Kalimi i funksionit të ujitjes dhe kullimit në Bashki (VKM nr.1108, date 30.12.2015, Ligji nr 147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, Neni 15), ka sjellë studimin e situatës dhe caktimin e ndërhyrjeve prioritare për të gjitha NjA. Këto ndërhyrje kanë konsistuar në pastrime dhe riparime sipas nevojave të territorit. Ndërhyrja siguron mbajtjen në nivele optimale të ujrave duke eliminuar si dëmtimin e bimeve të mbjellura nga fermerët ashtu edhe të strukturës së tokës në vetvete. Me VKM nr. 90 dt. 04.02.2016 u akordua fondi prej 6 000 mije lekë, për pastrim kanalesh ujitese dhe kulluese për NjA, Në këtë kuadër është kryer tenderi me objekt “Pastrimi i kanaleve ujitese dhe kulluese, Bashkia Shkodër”. Realizimi i kësaj kontrate në vlerën 3 447 mije lekë ka përfunduar në muajin Shtator 2016. Me fondet e mbetura është realizuar proçedura e prokurimit me objekt



“Marrje mjetesh me qera për pastrim kanale kulluese” për Drejtorinë e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore, mbeshtetur në Vendimin e Kryetares së Bashkisë Shkodër me nr 692, date 20.09.2016 “Për një ndryshim emertimi të nenartikujve të zerit të shpenzimeve operative për vitin 2016”. Kontrata ndodhet në fazën e zbatimit.

#### F1.O2.A2. Rehabilitimi i pjesshëm i skemës ujitëse Gur i Zi – Juban

Me VKM nr.90, datë 04.02.2016 është akorduar fondi prej 10,000 mijë leke transfertë e kushtëzuar për “Rehabilitimi i pjesshëm i skemës ujitëse Gur i Zi – Juban” faza e parë. Është lidhur kontrata në vlerë 6 155 mijë lekë (me TVSH).

Në njësinë administrative Guri i Zi ku është zbatuar projekti, ka në total 45 km kanale të dyta ujitëse dhe kulluese, nga të cilat 23 km janë kanale të dyta ujitëse dhe 22 kulluese. Kanalet e para ujitëse janë me dy burime marrjeje: njëri nga liqeni i Vaut të Dejës dhe tjetri nga lumi Drin në Spathar. Këto furnizojnë me ujë kanalet e dyta dhe si rezultat mbulojnë me ujitje një sipërfaqe rreth 700 ha nga toka bujqësore (nga total 2112 ha që ka NJA e Gurit të Zi).

Punimet për realizimin e kontratës kanë përfunduar .

Me VKM nr 926, date 21.12.2016, “Për rishpërndarjen dhe detajimin e fondit të investimeve për funksionin e ujitjes dhe kullimit për bashkitë ” janë akorduar 10.300 mijë për fazën e dytë “Rehabilitimi i pjesshëm i skemës ujitëse Gur i Zi – Juban” dhe 32.710 mijë leke për “Rehabilitimin e pjesshëm të skemës ujitëse Berdice Shkodër”.

#### F1.O2.A3. Hartimi i projekteve teknike prioritare për sistemin e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga erozioni

Degradimi i tokës së punueshme për shkak të përmytjeve të herë pas herëshme (kryesisht në NJA Guri i Zi, Ana e Malit, Dajç dhe Velipojë), rënia e vegjetacionit, mospërdorimi i tokës për qëllime bujqësore, metodat e papërshtatshme të ujitjes janë disa nga faktorët, të cilat kanë përshpejtuar fenomenin e erozionit në shumë zona. Kjo ka sjellë nevojën për hartimin e projekteve teknike në sistemin e ujitjes dhe kullimit dhe studimeve specifike për mbrojtjen e tokës bujqësore nga erozioni. Me qëllim futjen e këtij sektori në rrugën bashkëkohore të zhvillimit të bujqësisë është në proces hartimi i detyrave të projektimit për këto objekte.

#### F2/F3.O1.A1 Krijimi i kadastrës rurale

Regjistrimi i tokës bujqësore rezulton të ketë ecur me ritme të ngadalta për shkak të shumë vështirësive me të cilat janë ballafaquar NJA të Bashkisë Shkodër. Vetëm një pjesë e vogël e tyre kanë një sistem të kompjuterizuar për inventarizimin e pasurive dhe të sistemit të informacionit GIS. Të dhënat në regjistrin e pronave bujqësore rezultojnë të jenë me mangësi dhe informacione të pjeshme në lidhje me të dhënat kadastrale.

Në këtë kuadër është krijuar sektori i Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës. Është siguruar rreth 80% e listës së familjeve përfituese të tokës në pronësi (Formulari 06) të Njësive Administrative të Bashkisë Shkodër, gjithashtu është siguruar lista e pronarëve të trojeve dhe shtëpive ( Formulari 01), Harta kadastrale 1: 5000 të Njësive Administrative malore etj.

Është krijuar dhe vazhdon procesi i përditësimit të regjistrit elektronik të listave të familjeve përfituese të tokës në pronësi sipas ligjit nr. 7501 dhe VKM nr. 452, datë 17.10.1992, si dhe ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995 për Njësitë Administrative të Bashkisë Shkodër. Listë kjo e realizuar nëpërmjet krahasimit dhe verifikimit të Formularit nr. 06 me listen e banorëve kryefamiljar të vitit

1991, nxjerrë nga Zyra e Gjendjes Civile me qëllim saktësimin dhe konfirmimin e çdo përfituesi të tokës bujqësore.

F3.O2.A1 Krijimi i grupeve të punës në NJA për zbatimin e procedurave për plotësimin e AMTP

Ligji parashikon përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore në pronësi të përfitueseve, sipas kategorive të përcaktuara. Ndonëse ky proces ka një afat të caktuar, rezultojnë mungesa në plotësimin e dokumentacionit të përdorimit apo pronësisë së tokës bujqësore në disa NJA dhe AMTP. Në këtë situatë problematike lindi nevoja e krijimit të grupeve të punës për organizimin, ndjekjen dhe plotësimin e dokumentacionit ligjor.

Gjatë vitit 2016 është evidentuar gjëndja e plotësimit të AMTP në çdo NJA. Rezultojnë të pa plotësuara me AMTP: NJA Shalë 5 fshatra; NJA Shosh 4 fshatra; NJA Pult 4 fshatra; NJA Dajç 2 fshatra; NJA Velipojë janë plotësuar me probleme 2 fshatra.

Në funksion të realizimit të kësaj detyre (brënda afatit të shtyre deri me 31 Dhjetor 2017) është në proces procedura ligjore për verifikimin e kërkesave dhe plotësimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi (AMTP), mbështetur në ligjin nr. 253 datë 06/03/2013 dhe ligjit nr. 171/2014. Janë siguruar hartat 1:5000 për zonat malore të pa rilevuara, kopjet e formulareve nr. 6 për familjet përfituese, janë pajisur të gjitha NJA me dokumentacionin tip, janë bërë afishimet si dhe lajmërimet për çdo fshat. Duhet të theksohet se për vazhdimin e mëtejshëm të kësaj procedure është e domosdoshme paisja me materiale dhe dokumentacione kadastrale nga ana e institucioneve përkatëse. Me gjithë angazhimin tonë dhe kërkesave të vazhdueshme pranë Z.V.R.P.P. Shkodër, materialet nuk janë vënë në dispozicion, në kundërshtim me detyrimet ligjore dhe administrative.

Ka vazhduar procedura për trajtimin e kërkesave të qytetarëve për paisjen me certifikatë pronësie të tokës bujqësore, dërgimi i aplikimeve të verifikuara për regjistrim të titujve të pronësisë së tokës bujqësore pranë Z.V.R.P.P, arkivimi i kopjes së praktikës (fotokopje e dosjes së praktikës për çdo aplikues), regjistrimi në sistem i praktikës A.M.T.P. së përpunuar për çdo subjekt kërkues që ka kryer aplikimin nëpërmjet Zyrës me Një Ndalesë (Z1N).

Për vitin 2016 numri i praktikave për regjistrim të titujve të pronësisë së tokës bujqësore të përpunuara nga Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP është aplikime të përpunuara 1398 copë nga të cilat:

- Përcjellë pranë Z.V.R.P.P. Shkodër për rregjistrim - 961 copë.
- Kthyer përgjigje për plotësim të mëtejshëm dokumentacioni - 437 copë.

### **III Fondet e financimit të programeve**

Fondet e miratuara për këtë program janë 37 030 mijë lekë, 22% paga dhe sigurime, 38% shpenzime operative dhe 40% investime, pergjate vitit buxhetor plani është rishikuar në masën 101 597 mijë lek. Realizimi për periudhën 12 mujore është 47 816 mijë lekë në masën 47 % ndaj planit vjetor.

#### **Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2016**

Fondet totale të programit janë realizuar 47,816 mijë leke ose në masën 47%, tre ndara si më poshtë:

1. Paga e sigurime janë realizuar në masën 4 182 mijë lekë nga 8 035 mijë lekë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 52 %.
2. Shpenzime Operative janë realizuar në masën 12077mijëlekë nga 13 994 mijë lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 86 %.

3. Investimet janë realizuar në masën 31 557 mijë lekë nga 79 567 mijë lekë që ka qenë e parashikuar në planin e korigjuar, realizimi në masën 40% .

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare

Aktivitete/Projekte	Plani Fillestar	Plani Korigjuar	Realizimi
P7.F1.O1.A1 Krijimi i Drejtorisë së Bujqësisë në Bashkinë Shkodër	-	-	-
P7.F1.O1.A2 Krijimi i Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore (institucion varesie)	16,030	41,432	37,109
P7.F1.O2.A1 Pastrim kanalesh ujitëse dhe kulluese për NJA (Tenderim)	6,000	6,000	4,552
P7.F1.O2.A2 Rehabilitimi i pjesëshëm i skemës ujitëse Gur i Zi – Juban	10,000	16,455	6,155
P7.F1.O2.A2 Rehabilitimi i pjesëshëm i skemës ujitëse Berdice Shkoder		32,710	
P7.F1.O2.A3 Hartimi i projekteve teknike prioritare për sistemin e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga erozioni.	5,000	5,000	-
P7.F2.F3.O1.A1 Krijimi i kadastrës rurale	-	-	-
P7.F2.F3.O2.A1 Krijimi i grupeve të punës në NJA për zbatimin e procedurave për plotësimin e AMTP	-	-	-
<b>TOTALI</b>	<b>37,030</b>	<b>101,597</b>	<b>47,816</b>

#### IV Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.

Vështirësitë e hasura gjatë implementimit të buxhetit sipas secilit aktivitet kanë konsistuar në:

- Ka pasur vështirësi në paisjen me materiale dhe dokumentacione kadastrale nga ana e institucioneve përkatëse. Me gjithë angazhimin tonë dhe kërkesave të vazhdueshme pranë Z.V.R.P.P. Shkodër, materialet nuk janë vënë në dispozicion, në kundërshtim me detyrimet ligjore dhe administrative.
- Marrja në dorezim të aseteve të Bordit të Kullimit dhe transferimit të punonjësve. Problem ka edhe pronësia në atë institucion. Sipas VKM janë për transferim 10200 m<sup>2</sup> truall, i cili aktualisht rezulton i zënë, i rrethuar. Kemi kërkuar me shkresën nr. 1968, datë 19.02.2016 drejtuar Zyrës Vendore të Regj. Pasurive të Paluajtshme për shprehje juridike të statusit të pronës për këtë institucion dhe me përgjigjen e tyre nr. 912/1, datë 08.3.2016 rezulton që i gjithë territori i ndërmarrjes ka kaluar në pronësi private, i regjistruar në muajin qershor 2015. Njëkohësisht

edhe ndërtesa oficinë është brënda territorit të rrethuar dhe zyrat + magazinë janë të regjistruara ne ZRPP me të drejtë parablerjeje.

- Prokurimi për siguracion, takse kolaudimi, taksë qarkullimi, lubrifikante, pjesë këmbimi për mjete nuk është prokuruar për arsye se Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore nuk dispononte mjete në inventarin e saj.
- .Realizimi 45 % i fondit Paga e Sigurime për Drejtorinë e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore ka ardhur si arsye se plotesimi i strukturës me punonjës të kësaj drejtorie ka përfunduar vetëm në 6-mujorin e dytë të 2016.
- Hartimi i projekteve teknike prioritare për sistemin e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga erozioni nuk është realizuar gjatë vitit për shkak se gjatë procesit të punës është konstatuar se ekzistojnë projekte të gatshme pjesore të rrjetit ujites dhe kullues të hartuara nga institucione të tjera të cilat janë kërkuar të na vihen në dispozicion.

## **P8. Mjedi dhe mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave**

Programi i mbrojtjes së mjedisit mbulon sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë dhe reduktimit të ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe ndotjes akustike. Ky program ka për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve pyjore dhe kullosore, që të sigurojnë ekuilibrin biologjik të ekosistemeve, ruajtjen e sipërfaqeve pyjore, rritjen e prodhimit dhe afësisë ripërtitëse të tyre, parandalimin e degradimit të mëtejshëm të tokës.

Për hartimin dhe zbatimin e planeve nëpërmjet forcimit të zbatimit të kushteve të lejes mjedisore që synon parandalimin e krijimit të hotspoteve të reja, ndërmarrjes së veprimeve për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit gjithpërfshirës. Në fushën e mbrojtjes së natyrës bashkëpunim me të gjitha institucionet rajonale për të bashkëpunuar për ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimi i statusit të ruajtjes për llojet dhe habitatet që janë pjesë e mbrojtur me ligje dhe konventa të veçanta.

Politikat e këtij programi kanë për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve pyjore dhe kullosore, që të sigurojnë ekuilibrin biologjik të ekosistemeve pyjore, ruajtjen e sipërfaqeve pyjore, rritjen e prodhimit dhe aftësisë ripërtitëse të pyjeve, parandalimin e degradimit të mëtejshëm të tokës. Një politikë shumë e rëndësishme e programit është shfrytëzimi racional i burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre sipas qëllimeve të përdorimit, si edhe mbrojtjen e tyre nga ndotja.

### **I Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave**

Duke analizuar në formë analitike programin buxhetor për "Mjedisin dhe Mbrojtjen e Pyjeve dhe Kullotave", realizimi i këtij programi referuar objektivave specifike dhe aktiviteteve/projekteve për periudhën Janar - Dhjetor 2016, të paraqitura edhe në Matricën e Buxhetit të Vitit 2016 miratuar me VKB, paraqitet si vijon:

F1. Zbatimin e dispozitave ligjore nëpërmjet strategjive, programeve dhe projekteve të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshme të mjedisit dhe të përbërësve të tij.

F2. Ndërgjegjësimi i banorëve nëpërmjet promovimit të politikave edukuese për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

F3. Mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, lumenjve dhe liqenit, ujrave nëntokësore etj, nëpërmjet shfrytëzimit racional të burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre sipas qellimeve të përdorimit si edhe mbrojtjen e tyre nga ndotja.

F4. Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivat për secilin funksion janë:

F1.O1. Hartimi dhe zbatimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Zbatimi i Planeve të Menaxhimit në bashkëpunim me zyrat rajonale dhe institucionet qendrore.

F2.O1. Forcimi i pjesëmarrjes publike në takimet për Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis dhe aktivitetet në mbrojtje te tij.

F3.O1. Bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe institucionet e tjera për të pasur pranë Bashkisë kadastrën eletronike të burimeve ujore.

F3.O2. Pjesëmarrje në hartimin e planit të menaxhimit të burimeve ujore për basenin Drin-Bunë.

F4.O1. Realizimi i planeve dhe shërbimeve të mbarështimit për të gjithë sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullosor. Azhurnimi i Regjistrit të Pyjeve dhe Kullotave, Përgatitja e hartave tematike në GIS.

F4.O2. Regjistrimin e fondit pyjor dhe kullosor në ZRPP. Rehabilitimi, pyllëzimi dhe ripyllëzim të sipërfaqeve, të degraduara, djegura dhe rehabilitimin e kullotave nëpërmjet praktikave silvo-pastorale.Parandalimit të gërryerjes së mëtejshme të tokës pyjore dhe kullosore.

## II Produktet për vitin 2016

Gjatë periudhës që raportohet nga ana e Drejtorisë së Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave është punuar me përkushtim për realizimin e objektivave specifike në funksion të realizimit të Funksioneve kryesore.

F1.O1.A1. Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit të Përgjithshëm Vendor

Bashkia Shkodër nuk ka një Plan të Përgjithshëm Vendor për të gjithë territorin, rrjedhimisht nuk ka edhe një Vlerësim Strategjik Mjedisor. Mungesa e një dokumenti të tillë ndikon në arritjen e objektivave për një zhvillim të qëndrueshëm të territorit, promovimin e përgjegjësisë dhe besueshmërisë ndaj publikut. Në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, është punuar dhe bashkëpunuar me institucione qendrore dhe vendore si edhe agjensitë, në bashkëpunim me konsulentin e përcaktuar për hartimin e PPV të Bashkisë Shkodër, u punua në përgatitjen e Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

Ky Raport i Vlerësimit Strategjik Mjedisor i Plani të Shkodrës është përgatitur në përputhje me legjislacionin shqipëtar, në veçanti bazuar në ligjin nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisorë" si dhe në legjislacionin e Bashkimit Europian që kërkohet për këtë lloj vlerësimi.

U komunikua që në fillim dhe në vijimësi me Ministrinë e Mjedisit si institucioni qendror i cili kishte detyrimin e koordinimit dhe dhënies së orjentimeve për realizimin e këtij raporti të rëndësishëm.

F2.O1.A1. Organizimi i takimeve sensibilizuese me komunitetin

Për realizimin me sukses të këtij raporti si edhe në funksion të zbatimit të dispozitave ligjore të ligjit "Për mbrojtjen e mjedisit" nenit 10 të Ligjit nr. 91/2013, datë 28.02.2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" si edhe mbi konsultimin publik, u realizuan Dëgjesat Publike të cilat ishin parashikuar si një objektiv i vecantë në funksion të realizimit të objektivave kryesore. Kështu për një gjithpërfshirje të komunitetit, grupeve të ndryshme të interesit, specialistëve të fushës së mjedisit dhe jo vetëm, morën pjesë në këtë proces transparent shumë të rëndësishëm.

Për të gjitha këto takime (gjithësej 4 të tilla), nga Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave u hartuan raporte përmbledhëse të cilat u bënë publike në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al). Referuar dispozitave ligjore këto raporte u publikuan edhe në Regjistrin Elektronik të Territorit.

Në Raportin përfundimtar të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të gjitha këto takime si edhe raportet përmbledhëse janë të pasqyruara. Pjesë e tyre janë listat e pjesëmarrësve si dhe foto të takimeve konsultative. Kështu në përfundim të këtij procesi u realizua objektivi për realizimin e Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, si instrumenti kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin strategjik dhe vendimmarrjen.

Mbas realizimit të Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisorë, u dorëzua pranë Ministrisë së Mjedisit i gjithë dokumentacioni i nevojshëm me qëllim leshimin e Deklaratës Mjedisore. Kështu ky raport shoqërohet me Deklaratën Mjedisore të lëshuar nga Ministri i Mjedisit, nr. 4967/1 prot datë 26.08.2016. Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Deklarata Mjedisore u publikuan në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al).

Në këtë mënyrë Drejtoria e MPAU realizoi dy objektivat e parë së bashku me aktivitetet që shoqëronin këto objektiva.

#### F3.O1.A1. Mbledhja e informacionit për hartimin e kadastrës ujore

Në zbatim të funksioneve të Bashkisë në fushën e mjedisit : *“marrjen e masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja,”* pranë Drejtorisë së Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave u ngrit Sektori i Mjedisit dhe Administrimit të Ujrave. Pavarësisht se ‘ujrat’ janë një e mirë publike e cila administrohet nga institucionet qendrore ( Ministri dhe Agjensi), për vetë rëndësinë që kanë burimet ujorë në Bashkinë e Shkodrës , u krijua dhe ky sektor.

Kjo kadastrë e cila u formua në këtë vit do të pasurohet me të dhënat që do të vinë nga hartimi i Planit të Menaxhimit Drin-Bunë. Drejtoria e MPAU ka qënë pjesë e diskutimeve për hartimin e këtij plani. Aktualisht ky material është në formën e draft/planit dhe Bashkia do të jetë pjesë e diskutimeve përfundimtare. Qëllimi i hartimit të kësaj kadastrë do të jetë që të arrihet një shfrytëzim sa racional i burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre sipas qëllimeve të përdorimit, si edhe mbrojtjen e tyre nga ndotja.

#### F3.O2.A1. Mbledhja e informacionit për përdorimin e ujrave në Bashkinë Shkodër

Shkodra është e rrethuar me liqen, lumenj dhe det dhe ndikimi i tyre në jetën urbane është shumë i madh, si me ndikim pozitiv ashtu edhe me ndikim negativ, përmendim këtu rastet e përmytjeve.

Nisur nga këto realizimi i Kadastrës Ujore është një objektivi i rëndësishëm. U bashkëpunua me Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Bujqësisë dhe Administrimit të Ujrave, Agjensinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe u realizua grumbullimi i informacionit elektronik dhe hard copy, e cila u përkthye në formatin GIS. Sot kemi një informacion fillestar i cili na jep të dhëna të rëndësishme siç është pellgu ujëmbledhës Drin-Bunë, vija bregdetare që administron Bashkia Shkodër, vija lumore apo edhe sipërfaqja liqenore.

#### F4.O1.A1. Administrimi i shërbimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Shkodër

Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Bashkisë Shkodër, është një funksion i deleguar i bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 22 pika 4 dhe neni 27 pika 5. Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjisllacionit në fuqi.

Në përmbushje të detyrimit ligjor Bashkia Shkodër krijoi Strukturën për Administrimin e fondit pyjor/kullosor të përbërë nga Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, me një drejtor dhe një sektor të Administrimit të Pyjeve të përbërë nga përgjegjësi (ing. pyjesh) dhe dy specialistë (ing. pyjesh dhe ing. mjedisi). Njëkohësisht është krijuar institucioni i varësisë Drejtoria e Shërbimeve

Bujqësore e Pyjore, instiucion, në vartësi të Bashkisë, ku një sektor “Sektori i pyjeve” ka 4 inspektorë pyjorë(technikë pyjesh) dhe një inxhinier pyjesh.

Në VKM nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike”, sipas listës së inventareve dhe aktualisht në administrim të MM e të ish komunave/bashkive”, bëri që nga ana e Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me MM të realizojë procesin e marrjes në dorëzim të materialeve shkresore dhe hartografike të inventarit pyjor, referuar pikës 48 të këtij vendimi.

#### F4.O1.A2.Mbrojtja e sipërfaqeve pyjore /kullosore

Mbrojtja dhe Administrimi i Pyjeve/Kullotave kaloi si veprimtari e Njësisë së Qeverisjes Vendore- Bashkia Shkodër nëpërmjet Ligjit nr. 139/2015 “Për veteqeverisjen vendore” dhe Ligjit nr. 9385/2005 (i ndryshuar) “ Për Pyjet dhe Sherbimin pyjor”. Rritja natyrore e pyjeve shoqerohet me rritjen dhe zhvillimin e kurorës së drurëve e cila në 80-90% të saj është e pa krasitur. Kjo shoqerohet me rritjen dhe zhvillimin e shkurreve të cilat së bashku me kurorat e pa krasitura krijojnë një shtresë drunore gjysëm të njome dhe gjysëm të thatë e cila përbën rrezik potencial për djegien nga zjarret e mundeshme. Nisur nga këto faktorë dhe ndryshimet klimatike, mbrojtja e sipërfaqes pyjore/kullosore është një domosdoshmëri, në këto kushte në Buxhetin e vitit 2016 u parashikua fondi nga të ardhurat e veta për 15 vrojtues për një periudhë kohore prej 5 muaj, si “punëtorë të përkohshëm për vrojtimin e zonave pyjore” si edhe një fond të veçantë për paga për punonjës për shuarje zjarresh. Megjithatë nuk ka pasur zjarre si rrjedhim nuk janë marrë punonjës provizorë për shuarjen e zjarreve. Në përmbushje të detyrimeve ligjore për Administrimin/menaxhimin e fondit pyjor kullosor në Buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2016 ishte parashikuar një fond prej 760.000 lekë për “Shërbime mbrojtëse e sanitare në pyjet e gështenjës në zonën e Pultit” Shërbime këto të domosdoshme për përtëritje dhe shëndoshje të pyjeve të gështenjës. I gjithë materiali drusor dhe i shkurreve i përfituar nga ky shërbim i shfrytëzimit të pyjeve në zonën e Pultit, gjithësej 22 m<sup>3</sup> u furnizua shkolla e zonës.

#### F4.O2.A1. Hartimi i rievimeve topografike /harta per regjistrim ne ZVRPP per NjA Velipoje dhe NjA Rrethina

Aktualisht në territorin e Bashkisë së Shkodrës ka një sipërfaqe totale në Pyje, Kullota dhe Toka Inproduktive prej 23 741 ha prej të cilave 22 782 ha janë sipërfaqe që i bashkëngjiten nga Njësitë Administrative dhe qyteti i Shkodrës me një sipërfaqe prej 958 ha. Regjistrimi i të gjithë pyjeve/kullotave përveçse një detyrim ligjor është edhe një sfidë. Kjo kërkon hartimin/përgatitjen e dokumentacionit për rievimet topografike për të realizuar regjistrimin e këtyre pronave. Nëpërmjet këtij projekti synohet regjistrimi pranë ZVRPP Shkodër i të gjitha pyjeve/kullotave të cilat janë pronë e bashkisë Shkodër sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave për inventarin e pyjeve/kullotave që kalojnë në pronësi të bashkisë.

#### F4.O2.A2. Zbatimi i Projektit " Pyllëzimi i Malit të Taraboshit"

Projekti “Objekt pyllëzimi në “Tarabosh” konsiston në realizimin e ndërhyrjeve përmes mbjelljes së pishave të egra 1 deri 2 vjecare , rreth 100.000 të tilla në një sipërfaqe rreth 40 ha. Në kushtet e rritjes së popullsisë së qytetit si edhe rritjes të mjeteve otorike, mungesa e një kurore të gjelbër sjell pasojat të dëmshme për jetën e njerëzve, ndërkohë influencion në rritjen e fenomenit të erozionit. Kjo ndërhyrje ka impakt në drejtim të mbrotjes dhe përmirësimit të mjedisit natyror në këtë zonë si dhe duke e konsideruar objekt atraksioni turistik. Kështu u realizuar projekti për “Pyllëzimi në Tarabosh “ me një fond total prej 25.944.000 lekë, projekt me të cilin është aplikuar në Shtyllën 1 të Grantit 6 “ Rehabilitim mjedisor , gjelbërim, pyllëzim” pranë Fondit të Zhvillimit të Rajoneve dhe Bashkia Shkodër nuk përfitoi asnjë investim. Gjithëashtu u realizua projekti tjetër për “Pyllëzimi në

Tarabosh“ me një fond total prej 8.030.000 lekë projekt me të cilin është aplikuar në Shtyllën 1 të Grantit 6 “ Rehabilitim mjedisor , gjelbërim, pyllëzim” pranë Fondit të Zhvillimit të Rajoneve.

#### F4.O2.A3.Përmirësim, pyllëzimi Mali i Taraboshit

Projekti “Përmirësimi, pyllëzimi në Tarabosh” përmban: Ndërhyrje me rrallime në 10-15 % të numrit të drurëve, duke hequr drurë të bigëzuar, të thatë etj. Krasitje të degëve të poshtme të pishave deri në 1/3 e kurorës. Kurora ka zhvillime të ndryshme dhe në një pjesë të konsiderushme grumbulli pyjor (druret përbërës) nuk janë vetë krasitë, apo degët e poshtme janë tharë por nuk janë shkëputur nga trungu i drurit. Gjithashtu si pasojë e djegieve ndër vite druret e djegur për mungesë fondesh nuk janë hequr. Në përmbushje të detyrimit për Administrimin e fondit pyjor e kullosoz mbështetur në dispozitat ligjore Drejtoria e MPAU në bashkëpunim me Sektorin e pyjeve të Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore e Pyjore, janë hartuar projekte për ndërhyrje në fondin pyjor me Pyllëzime si edhe Përmirësim pyllëzimi në zonën e kurorës së gjelbër të qytetit të Shkodrës , Zona e Taraboshit.

#### F4.O2.A4. Zbatimi i projektit për ndërtimin e lerës së ujit Kullota -Zogaj

Ndërtimi i lerës së re për grumbullim dhe mbajtje uji të pijshëm për blegtorinë me kapacitet 205m<sup>3</sup>, për të cilat sigurohet uji për një numër prej rreth 163 krerë të imta dhe 15 krerë të trasha. Për të llogaritur ujin e dobishëm janë marrë në konsideratë humbjet e ujit nga avullimi ditor si pasojë e temperaturave të verës lidhur kjo me koeficientin e avullimit për sipërfaqen e lerës që kërkohet. U realizua ndërtim i lerës së re për grumbullim dhe mbajtje uji të pijshëm për blegtorinë me kapacitet 205 m<sup>3</sup>, për të cilat sigurohet uji për një numër prej rreth 163 krerë të imta dhe 15 krerë të trasha. Mqs këto kullota janë me kapacitet mesatar deri të larta, por shfrytëzimi i tyre nuk ka qënë në lartësinë e duhur për mungesë të ujit për këtë arsye ndërtimi i lerës bën që të shfrytëzohet nga bagëtitë për pirje uji rreth 300 ditë në vit.

### III Fondet e financimit të programeve

Për përmbushjen e plotë të detyrimit ligjor për Administrimin e fondit pyjor kullosoz, referuar edhe pamjaftueshmërisë financiare të dhënë me transfertën specifike, Bashkia Shkodër akordoi në Buxhetin e vitit 2016 një fond shtesë në funksion të këtij shërbimi, me shumë totale 3.600.000 lekë Fondet e miratuara për këtë programjanë 8 294 mije lekë.

#### Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2016

Realizimi për periudhën 12 mujore është 4 304 lek në masën 52% ndaj planit vjetor.

1. Shpenzime per paga jane realizuar 3076 mije leke nga 5691 mije leke qe ka qene e parashikuar ne fillim te vitit. Realizimi 54 %
2. Shpenzime Operative janë realizuar në masën 558 mije lekë nga 1.589 mije lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi 35 %.
3. Shpenzime per investimet jane realizuar ne masen 670 mije nga 1015 mije leke qe ka qene e parashikuar ne fillim te vitit. Realizimi 66%.

Fondet e akorduara nga buxheti i shtetit në kuadër të transfertës specifike për këtë funksion të ri, ishin të pamjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore për administrimin/mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave, referuar legjislacionit në fuqi.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.



Aktivitete/Projekte	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi
P8.F1.O1.A1. Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit të Përgjithshëm Vendor	-	-	-
P8.F2.O1.A1. Organizimi i takimeve sensibilizuese me komunitetin	-	-	-
P8.F3.O1.A1. Mbledhja e informacionit për hartimin e kadastrës ujore	-	-	-
P8.F3.O2.A1. Mbledhja e informacionit për përdorimin e ujrave në Bashkinë e Shkodrës	-	-	-
P8.F4.O1.A1. Administrimi i shërbimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Shkodër	3,679	3,679	2,718
P8.F4.O1.A2.Mbrojtja e sipërfaqeve pyjore /kullosore	3,600	3,600	916
P8.F4.O2.A1. Hartimi i rilevimeve topografike /harta për regjistrim në ZVRPP për NjA Velipojë dhe NjA Rrethina.	-	-	-
P8.F4.O2.A2. Zbatimi i Projektit " Pyllezimi i Malit të Taraboshit"	-	-	-
P8.F4.O2.A3.Përmirësimi, pyllëzimi Mali i Taraboshit	-	-	-
P8.F4.O2.A4. Zbatimi i projektit për ndërtimin e lerës së ujit Kullota – Zogaj	1,015	1,015	670
<b>Totali</b>	<b>8,294</b>	<b>8,294</b>	<b>4,304</b>

#### IV Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.

- Ndryshimet ligjore dhe aktet nënligjore në zbatim të tij sollën që Zonat e Mbrojtura pavarësisht që ndodhen brenda territorit administrativ të Bashkisë Shkodër nuk administrohen nga Bashkia (pika 3 neni 2 i ligjit nr 48/2016). Kështu ekonomitë pyjore/kullosore të NJA Velipojë nuk administrohen nga Bashkia Shkodër por nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Për këtë arsye aktiviteti i parashikuar për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor për këtë zonë nuk u realizua. VKM nr 433/2016 , bëri kalimin në pronësi të Bashkisë Shkodër,pyjet e kullotat , ku u përcaktuan qartë se cilat ishin ekonomitë pyjore/kullosore të cilat kaluan në pronësi të Bashkisë tonë. Kështu u punua për ekonominë pyjore Rosek-Drisht. Në zbatim të pikës 66 të VKM nr 433/2016 Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe dërguar dokumentacionin për Regjistrim pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Palujtëshme Shkodër, të pasurive Pyjore/Kullosore të 367 parcela ( Ekonomia pyjore Rosek-Drisht) , por nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Palujtëshme Shkodër nuk është bërë asnjë regjistrim.
- Diferenca e vërejtur në mosrealizim në zërin Shpenzime operative prej 310 000 lekë vjen për zërin “Blerja e Uniformave dalluese”, nuk është kryer sepse Ministria e Mjedisit nuk ka miratuar akoma llojin e uniformes e cila bazuar në nenin 9 të Ligjit nr 48/2016, përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.

- Materialet informuese për pyje do të realizohet mbas marrjes në dorëzim të inventarit të pyjeve/kullotave bazuar në VKM nr 433/2016 “ Për transferimin e pyjeve/kullotave publike, sipas listave të inventarit..” , pasi në këtë mënyrë kemi të përcaktuar zonën pyjore që administrohet nga Bashkia Shkodër.
- Fikëset e zjarrit nuk është realizuar sepse sasia e kërkuar nuk përputhej me cmimin dhe llojin e materialit i cili kërkohëj në specifikimet teknike. Lloji i kërkuar i këtyre fikseve zjarri shpine kanë specifikime të vecanta si rrjedhim edhe cmimi nuk përputhej me atë të parashikuar.
- Vlera prej 262 mijelekeështë kursim i ardhur nga procedura e tenderimit. Ndryshimet e Ligjit 9385/2005 “ Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar Ligji nr 48/2016 të miratuara në maj 2016 u shoqëruan edhe me akte nënligjore. Kalimi i kompetencave për Administrimin e fondit pyjor /kullosor nëpërmjet Ligjit 139/2015, nuk u shoqërua me bazë ligjore. Kështu ndryshimet ligjore që bënin kalimin e kompetencave Bashkive, u realizuan në Maj 2016 dhe aktet e tjera nënligjore në funksion të këtyre ndryshimeve u plotësuan në muajin korrik 2016. Pra rreth 7 muaj kanë qënë në vakuim ligjor.
- Referuar pronave ( pyje/kullota) të kaluara në pronësi të Bashkisë Shkodër, theksojmë së nuk ka një inventar fizik te pyjeve/kullotave, por ky inventar i referohet vitit 1985 dhe në disa raste edhe më herët 1982. Nisur nga kjo problematikat kanë qënë shumë komplekse.
- Megjithëse ka një vendim për kalim në pronësi të fondit pyjor/kullosot (433/2016), përsëri problematikat janë të mëdha. Kjo është shprehur edhe në një shkresë të Ministrit të Mjedisit nr 8057 prot dt 09.12.2016 i cili kërkon azhornimin e kadastrës pyjore /kullosore duke theksuar që të përcaktohen qartë kufijtë ndërmjet bashkive. Aktualisht Drejtoria e MPAU ka filluar nga puna për azhornimin e kadastrës pyjore dhe plotësimin e detyrimeve ligjore.
- Kështu u realizuar projekti për “Pyllëzimi në Tarabosh “ me një fond total prej 25.944.mije lekë, projekt me të cilin është aplikuar në Shtyllën 1 të Grantit 6 “ Rehabilitim mjedisor , gjelbërim, pyllëzim” pranë Fondit të Zhvillimit të Rajoneve dhe Bashkia Shkodër nuk përfitoi asnjë investim.U realizuar projekti tjetër për “Pyllëzimi në Tarabosh“ me një fond total prej 8.030.mije lekë, projekt me të cilin është aplikuar në Shtyllën 1 të Grantit 6 “ Rehabilitim mjedisor, gjelbërim, pyllëzim” pranë Fondit të Zhvillimit të Rajoneve dhe Bashkia Shkodër nuk përfitoi asnjë investim.

## **P.9 Arsimi Parauniversitar dhe Parashkollor**

Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë.

Shkolla duhet t'i mundësojë çdo fëmijë që të ketë rezultate të kënaqshme në mësim, të jetë i sigurtë, i shëndetshëm dhe aktiv në jetën komunitare.

Me ndarjen e re territoriale, Bashkia Shkodër duhet të sigurojë mirëmbajtjen e një numri të madh institucionesh arsimore për 11 njësitë administrative. (64 shkolla, 55 kopshte, 3 konvikte), që kërkojnë një vëmendje të veçantë.

Synimi ynë është menaxhimi me efikasitet i fondeve për arsimin dhe krijimi i mundësive për një zhvillim e shfrytëzim cilësor të infrastrukturës së institucioneve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies dhe duke siguruar kushte për pjesëmarrje në arsimin bazë dhe të mesëm për të gjithë fëmijët në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar.

Arsimim cilësor dhe gjithëpërfshirës me synim plotësimin e standardeve Europiane, tërheqja e fëmijëve romë/egjiptian.

### **I Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave**

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2016 ka fokusuar përpjekjet e saj në 2 funksione zhvillimi:

F1.Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.

F2.Sistemin arsimor parashkollor në kopshte.

Objektivat për secilin funksion janë:

F1.F2.O1 Ofrimi i shërbimeve cilësore për zhvillimin e procesit mesimor edukativ në kushtë të përshatshme në gjithë territorin administrativ të Bashkisë Shkodër.

F1.F2.O2 Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mesimor në sistemin parauniversitar dhe parashkollor.

F1.F2.O3 Krijimi i ambjenteve dhe mjediseve të sistemit arsimor, të sigurtë konform standardeve ligjore.

F1.F2.O4 Nxitja dhe promovimi i aktiviteteve kulturore, sportive dhe argëtuese për fëmijë.

### **II Produktet për vitin 2016**

Gjatë vitit 2016 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër:

F1.F2.O1.A1 Pagat dhe sigurime shoqërore për punonjësit e arsimit

Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr. 11166, datë 24.12.2015, në lidhje me procedurat e transferimit të punonjësve si dhe fondet për mbulimin e shpenzimeve për personelin për pagat e punonjësve që transferohen nga Ministria Arsimit dhe Sportit të Njësitë e Qeverisjes Vendore (bashkitë e reja) për vitin 2016, si dhe në transfertë specifike parashikuar në Ligjin për Buxhetin e Shtetit të vitit 2016, parashikohet në buxhetin e bashkisë për t'u shpenzuar për këtë funksion, numri i personelit gjatë vitit 2016. Gjatë këtij viti në kuadër të reformës administrative Bashkia Shkodër ka mbuluar shërbimet mbështetëse në arsimin 9 vjeçar dhe në arsimin e mesëm me numër punonjësish

186 (njëqindtë dhjetëgjashhtë). Me transfertë specifike, numri i punonjësve të transferuar është 165 (njëqindgjashhtëdhjetëpesë), nga këto:

- Punonjës mbështetës të arsimit para shkollore dhe 9 – vjecare 76 (shtatëdhjetëgjashhtë);
- Punonjës mbështetës të arsimit të mesëm 43 (ketërdhjetëtre);
- Punonjësve në organikë për punonjësit e Konviktëve 46 (pesëdhjetë).

Numri i punonjësve të administratës është 21 (njetëdhjetë) punonjës, prej të cilave:

- Punonjës në organike për zyrën e Arsimit 15 (tëmbëdhjetë);
- Punonjës kujdestarë pranë zyrës së arsimit 6 (gjashtë).

F1.F2.O1.A2 Arsimi Parashkollor (Paga të personelit të kopështeve dhe blerje ushqime për kopështet me drekë)

Në kuadër të reformës territoriale dhe ligjit të ri për vetqeverisjen vendore Bashkisë Shkodër i kanë kaluar funksione të reja. Konkretisht një nga funksionet e reja të cilat transferohen tek Bashkitë janë; "Personeli edukativ dhe mbështetës në arsimin parashkollor". Planifikimi i fondeve është bërë duke marrë në konsideratë parashikimet për kontratën e re e cila është prokuruar për furnizimin me ushqime.

F1.F2.O1.A3 Blerje materiale (batanije, çarçafë, peshqirë dhe mbulesa tryezash) në shërbim të konvikteve.

Blerje materiale (batanije, çarçafë, peshqirë dhe mbulesa tryezash) në shërbim të arsimit të mesëm profesional dhe arsimit parashkollor. Tre konviktë shkolla Speciale 3 Dhjetori, 5 kopshtë me drekë në qytet. Shkolla duhet ti mundësojë të gjithë fëmijëve që të kenë rezultatë në mësim, të jenë të sigurtë, të shëndetshëm dhe aktivë në jetën komunitare. Në 3 konviktë (ai i shkollës Artistike, i vajzave "Shejnaze Juka" dhe i shkollës Industriale) janë 210 nxënës të akomoduar.

Në shkollën speciale "3 Dhjetori" janë 95 fëmijë.

Në 5 kopështet me drekë ("Bëp Tusha", "Tom Alimhilli", "I.S. Bruçaj", "Guerilie", "1 Qershori") frekuentohen nga mesatarisht 310 fëmijë.

F1.F2.O1.A4 Blerje materiale kuzhine

Tre konvikte, shkolla Speciale "3 Dhjetori", 5 kopështe me drekë në qytet. Për krijimin e kushtëve optimale për rritjen e cilësisë së shërbimeve. Në 3 konviktë (konvikti i shkollës Artistike, konvikti "Shejnaze Juka" dhe konvikti i shkollës Industriale) janë 210 nxënës të akomoduar.

F1.F2.O1.A5 Blerje ushqime për konviktet e shkollave të mesme dhe kopshteve me drekë

Me fonde të akorduara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit si dhe Ministria e Mireqënies Sociale është bërë e mundur sigurimi i produktëve bazë për disa institucione sipas ligjit. Këto mallra janë pjesë e furnizimit për 2 konviktë dhe në institucione të tjera në shkolla.

Konvikti Shkollës Artistike, 50 nxënës.

Konvikti i shkollës Industriale 93 nxënës.

Shkolla Speciale 3 Dhjetori 94 nxënës nga keto 35 vajza dhe 59 djem.

Në konviktet e qytetit Shkodër në vitin 2016 kemi patur 15 nxënës me pagesë.

#### F1.F2.O1.A6. Blerje materiale kancelarie për sistemin arsimorparauniversitar

Në vitin 2016 furnizimi me këto matëriale është realizuar në të gjitha shkollat e qytetit edhe të atyre në njësitë administrative duke ruajtur si kriter kapacitetet e shkollave me qëllim krijimin e kushteve optimale për rritjen e cilësisë së mësimdhënies.

#### F1.F2.O1.A7Blerje materiale të ndryshme për shërbimetmbështetëse për sistemin arsimor parauniversitardhe parashkollor

Për të krijuar kushtë sa me komode për vitin 2016, bazuar në kërkesat e paraqitura nga institucionet arsimore si në qytet dhe në njësitë administrative janë realizuar blerjet, brava dyer druri copë 237, reflektor gazi copë 65 copë, dryj 60 copë, tuba dhe kthesa shporeti me dru 150 copë, mjete pune të ndryshme (dalta, trapone, punta, vidaplasmas, gomina xhami, doreza për dyer, rregullator gazi, tub gome gazi etj).

#### F1.F2.O1 .A8Blerje pjesë këmbimi për mirëmbajtjen esistemeve hidraulike të sistemit arsimor parauniversitar dhe edukimit parashkollor.

Për të krijuar kushte normale në institucionet arsimore për vitin 2016 janë vleresuar kërkesat e paraqitura nga shkollat në njësitë administrative dhe atyre në qytete. Një vemëndje e veçantë është për konviktët dhe për kopështët me drekë.

Nisur nga problemet e paraqitura për këtë lloj shpenzimi janë realizuar blerje për këto matëriale:

Pompa uji copë 2, rubinetë copë 108, tuba të ndryshëm fleksibël copë 71, sifon lavamani copë 60, kaseta shkarkimi copë 60, matëriale të ndryshme (koka dushi, valvula etj).

#### F1.F2.O1.A9Blerje materiale pastrimi ambientesh

Për vitin 2016 është bërë blerja dhe shpërndarja në bazë të një grafiku të matërialeve të pastrimit për shkollat në qytetit dhe në të gjitha shkollat në Njësitë Administrative. Janë plotësuar kërkesat e domosdoshme për të krijuar një situatë sa më normale të kushtëve higjienike. Në përpilimin e shpenzimeve për këtë zë është marrë parasysh numri i fëmijëve dhe i klasave për çdo shkollë në mënyrë proporcionale.

#### F1.F2.O1.A10 Blerje dru zjarri për ngrohje për sistemin e arsimit parauniversitar dhe parashkollor

Ngrohja me dru zjarri është realizuar sipas kërkesave të institucioneve të njësive administrative Pult, Shalë, Shosh, Ana e Mali, Dajç, Bërdicë, Postrinë dhe institucioneve të qytetit Shkodër. Është e nevojshme të mundësohet ngrohje me dru zjarri, për 332 ambjentë mësimore për një periudhë 4 mujore, sipas parashikimit më poshtë:

- Në qytet 65 ambjente;
- Në njësitë administrative 267 ambjente (Ana e Malit 6 ambjente, Bërdica 48 ambjente, Dajç 38 ambjente, Guri i Zi 18 ambjente, Postrina 72 ambjente, Pulti 16 ambjente, Rrethina 50, Shalë 13, Shosh 6 ambjente.

Sasia e parashikuar është bërë mbi bazën e një kuote mujore që shkon mesatarisht 1.3 ms në muaj për një ambient mësimor duke diferencuar, sipas standartëve zonat me nivele të ndryshme të temperaturave dhe është llogaritur për katër muaj në vit furnizimi.

F1.F2.O1.A11 Blerje gaz të lëngshëm për ngrohje për sistemin arsimor parauniversitar dhe parashkollor

Me ngrohje me gaz të lëngshëm, janë furnizuar sipas kërkesave të institucioneve shkollat e njësive administrative Ana e Malit, Guri i Zi, Rrethina, Velipoje, Bërdicë dhe shumica e institucioneve të qytetit Shkodër.

Për të siguruar kushte optimale në ambientët shkollorë për vitin 2016 janë marrë kërkesat e shkollave dhe të njësive administrative për burimin e ngrohjes në institucionet e tyre.

Sasia e llogaritur është bazuar në një konsum mujor për çdo ambient mesimor, me 15 kg (një bombul gazi) për 4 muaj në vit.

Sasia e gazit e planifikuar është për 752 ambiente mësimore të ndara:

- Shkollat në qytet 527 ambiente mësimore (klasa, zyrat e drejtuesve, kabinetë);
- Në njësitë administrative Ana e Malit 45 ambiente, Bërdica 25 ambiente, Guri i Zi 71 ambiente, Rrethinat 39 ambiente, Velipoja 45 ambiente;
- Shkolla Speciale "3 Dhejtori".

Gjthashtu në përlllogaritje është përfshirë edhe gazi për gatim për 5 kopështët me drekë dhe 2 konvikte për një periudhë 9 mujore.

F1.F2.O1.A12 Blerje lëndë djegëse karburante për ngrohje dhe për mjete transporti (naftë dhe benzinë)

Ngrohje me naftë është kryer në këto institucione: Shkolla Ali Lacaj, shkolla Artistike, Konvikti i shkollës Artistike, kopështi Bëp Tusha

Nafta është konsumuar edhe nga dy automjetët, njeri që siguron transportin e nxënësve të shkollës Speciale 3 Dhjetori dhe automjeti që bën shpërndarjen e ushqimeve në kopshtët me drekë.

Për dy automjetët është bërë grafiku i udhëtimit ditorë dhe mbi bazën e gjatësisë së rrugës së përshkruar është bërë një përlllogaritje e konsumit për km.

Për institucionet e cituara me sipër është marrë në konsideratë konsumi orar mesatar i kaldajave dhe gjithashtu kohën e domosdoshme për ngrohje të institucioneve, për periudhën 4 mujore.

Parashikimi është si më poshtë:

- Për shkollat 9 vjeçare është parashikuar një shumë vjetore 1600 litra për secilën;
- Për shkollën Artistike e cila punon në orare me të zgjatura 1600;
- Për konviktin e shkollës Artistike 1680 litra meqënëse ka në përdorim shumë ambiente akomodimi dhe me orar të zgjatur;
- Për kopështin B.Tusha 1680 litra duke qënë kopesht me drekë ka një aktivitet të gjatë.

F1.F2.O1.A13 Riparim paisje orendi

Për vitin 2016 është realizuar shërbim (riparim paisje orendi, karrige e tryeza nxënësish) nisur nga gjëndja e amortizuar e tyre. Kjo ndërhyrje është e nvojshme edhe për të ulur shpenzimet për

blerje të paisjeve (orendi) për insitucionet ku janë paraqitur kërkesa të konsiderueshme. Konkretisht riparime: karrige nxënësish (copë 242) dhe tryeza nxënësish (copë 110).

F1.F2.O1.A14 Mirëmbajtje e mjeteve të transportit për shërbimet mbështetëse të sistemit arsimor parauniversitar dhe parashkollor

Dy mjetet e transportit që kemi në përdorim realizojnë dy shërbime, një për lëvizjen e nxënësve të shkollës Speciale “3 Dhjetori” në mëngjez dhe në drekë dhe një mjet për shpërndarjen e ushqimeve për kopështe dhe çerdhe. Gjatë vitit 2016 është realizuar shpenzimi për mirëmbajtje dhe blerje pjesë këmbimi goma dhe batëri.

F1.F2.O1.A15 Furnizim me energji elektrike, ujë, postë

Gjatë vitit 2016 janë furnizuar me energji elektrike 45 objekte shkollore në qytet dhe 47 objekte shkollore në njësitë Administrative Shalë, Shosh, Pult. Gjatë vitit 2016 janë furnizuar me ujë 38 ambjentë shkollore në qytet por problem mbëten shkollat në njësitë administrative, si pasojë e procesit të transferimit të Ujesjellsit Fshat. Kemi konstatuar mos faturim të ujit në disa objekte shkollore në njësitë administrative.

Shërbimi postar vlen për të mbajtur korespondencën shkollë – nxënës, shkollë – prind, kryesisht për shkollat me konvikt.

Për vitin 2016 situata e shpenzimeve për energjinë elektrike ka qënë:

- Shkodër qytet për 45 objekte shkollore;
  - Njësia Administrative Shalë për 6 objekte;
  - Njësia Administrative Shosh për 3 objekte shkollore;
  - Njësia Administrative Pult për 8 objekte shkollore;
  - Njësia Administrative Postribë për 6 objekte shkollore;
  - Njësia Administrative Ana Malit për 4 objekte shkollore;
  - Njësia Administrative Dajç për 4 objekte shkollore;
  - Njësia Administrative Velipojë për 5 objekte shkollore;
  - Njësia Administrative Bërdicë 8 objekte shkollore;
  - Njësia Administrative Guri i Zi për 9 objekte shkollore;
  - Njësia Administrative Rrethina për 10 objekte shkollore.
- Po kështu edhe për furnizimin me ujë, për Njësitë Administrative në disa objekte shkollore gjëndja është:
- Shkodër janë 38 objekte shkollore;
  - Postribë në 6 objekte shkollore;
  - Ana e Malit në 4 objekte shkollore;
  - Dajc për 4 objekte shkollore;
  - Velipoje për 5 objekte shkollore;
  - Bërdicë për 5 objekte.

F1.F2.O1.A16 Transporti i nxënësve dhe mësuesve

Në zbatim të ligjit nr.69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të ligjit nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të ligjit nr. 147/2015 “ Për buxhetin e vitit 2016 si

dhe të Vendimit nr.682, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit” i ndryshuar, me Vendimin nr. 1102, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.682, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, është përcaktuar fondi për Bashkinë Shkodër. Mbas shkëmbimit të informacionit me DAR Shkodër mbi numrin e mesuesve dhe nxënësve është bërë edhe përcaktimit i nevojave sipas linjave (që paracakton ligji) dhe numrit të mësuesve dhe nxënësve përfitues. Numri përfitues nga ky shërbim është 947 nxënës dhe 476 mësues.

Fondet për shpenzime” Transport i nxënësve dhe mësuesve” arrijnë në 22 342 mijë lekë në vitin 2016. Për periudhën 12-mujore realizimi është në masën 21 037 mijëlekë ose në masën 94%.

#### F1.F2.O2.A1 “Blerje xhami për mirëmbajtjen e dritareve për të gjitha objektet e arsimit parauniversitar dhe parashkollor”

Për vitin 2016 është bërë furnizimi me xham të zakonshëm kryesisht për shkollat e qytetit dhe për njësitë administrative sipas kërkesave të konsiderueshme të paraqitura prej tyre. Sasia e parashikuar ka të përfshirë jo vetëm kërkesat e paraqitura por edhe një sasi rezerve me qëllim përmbushjen e nevojave të lindura gjatë vitit. Sasia totale e xhamit të blere është 500 m<sup>2</sup>.

#### F1.F2.O2.A2 Blerje bojrash të ndryshme për lyerjen e mjediseve të godinave të sistemit arsimor parauniversitar dhe parashkollor

Për vitin 2016 kërkesat e paraqitura për krijimin e ambjenteve sa më komode nga shkollat e njësive administrative dhe ato të qytetit janë në rritje. Sasia e parashikuar, bojë hidromat 870 kg, pigmentë copë 60, boje vaji 115, tretës boje copë 26.

#### F1.F2.O2.A3 Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjeteve elektrike për godinat e sistemit arsimor parauniversitar dhe parashkollor

Për vitin 2016 bërë furnizimi me materiale elektrike për shkollat e qytetit kryesisht me llampa ekonomike, llampa të zakonshme, priza, çelësa, portollampa e të tjera të kësaj natyre. Për të krijuar kushtë sa më optimale për vitin 2016 nisur nga kërkesat e paraqitura nga shkollat si në qytet dhe nga ato të njësive administrative si dhe krijimi i një sasisë të vogël rezervë është parashikuar të blihen materiale elektrike si më poshtë:

- Llampa të zakonshme elektrike copë 4600;
- Çelësa elektrik 250 copë;
- Portollampa të zakonshme 120 copë;
- Priza të zakonshme 300 copë dhe zgjatuesa 30 copë (për laboratorët kompjuterike të shkollave).

#### F1.F2.O2.A4 “Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore”

Në fillim të vitit 2016 në 5 objekte arsimore u krye rikonstruksioni i terracave të tyre, shkollave:

- Azem Hajdari me 510 nxënës;
- Dëshmoret e Prishtinës me 418 nxënës;
- Kole Idromeno me 550 nxënës;
- Ndre Mjeda me 1016 nxënës;
- Oso Kuka me 637 nxënës.



Gjatë viti 2016 u kryen punime mirëmbatje në objekte të tjera si:

- Sistemit të ndriçimit të shkollës "Pashko Vasa me 300 nxënës;
- Rregullimi i ambientit të dusheve të konviktit të shkollës industriale;
- Bojatisja e ambientëve të brëndshme të shkollës Ndoc Mazi, shkollë me 286 nxënës;
- Rrethimi i fushës sportive të shkollës Skëndërbëg, në të cilën zhvillojnë mësimin 644 nxënës;
- Shkollën Shejnaze Juka (423 nxënës), u kryen punime hidroizolimi dhe riparimi shtresash;
- Kopshti Salo Hali ku për shkak të një zjarri ishin dëmtuar dy ambientë të këtij kopshti, të cilët u kthyen në gjëndjen e mëparshme;
- Kopshti Ruzhdi Daca, u bë zëvendësimi i hidroizolimit të dëmtuar dhe lyerja e tij e brëndshme dhe e jashtme.

#### **Në Njësinë Administrative POSTRIBË**

- Rikonstrukcion i pjesshëm i shkollës së fshatit Prekal, ku u riparuan tualetët, terraca, shtresat e suvatimeve në ambientët e brëndshme. Në këtë shkollë aktualisht zhvillojnë mësim 63 nxënës;
- Në shkollën e fshatit Domen (65 nxënës), ku u bënë riparime të dyerve dhe pjesëve të dëmtuara të terracës, si dhe u bë lyerja e ambientëve të brëndshme të shkollës. U krijua dhe një ambientët i veçantë për kopshtin e shkollës, ambient i cili më parë mungonte;
- Në shkollën e fshatit Drisht ( 117 nxënës) u bë kthimi në gjendje funksionale i tualetëve, lyerja e pjesës së jashtme të godinës, dhe në kopshtin e kësaj shkolle u bë zëvendësimi i plotë i hidroizolimit, shtrimi me pllaka dhe lyerja e ketij ambjenti.

#### **Në njësinë Administrative DAJC**

- Në shkollën Samrisht i ri, aneksi i shkollës Pjetër Gaci, objekti ku zhvillojnë mesim 41 nxënës, u bë zëvendësimi i gjitha dyerve të dëmtuara nga lagështira për shkak të përmbytjeve të ndodhura në këtë zonë. U bë riparimi i tualetëve të brëndshme të godinës, dhe zëvendësimi i xhamave të thyer;
- Në shkollën Luce Agraja (107 nxënës), u bë riparimi dhe zëvendësimi i dyerve të dëmtura dhe i hidrosanitareve në tualetët e shkollës;
- Në shkollën Gjergj Laca (35 nxënës) u bë lyerja e plotë e ambientëve të jashtme.

#### **Në Njësinë Administrative RRETHINA**

- Në shkollën e fshatit Bardhaj (501 nxënës) u bë riparimi i ulluqeve të cilat mungonin tërësisht, zëvendësimi i hidrosanitareve të prishura, si dhe riparimi i çatisë së shkollës;
- Në shkollën e fshatit Mes-Myselim (88 nxënës) u kryen riparime në ambientët e brëndshme të suvatimeve, kryesisht në tualete, tek të cilat u bë zëvendësimi edhe i dyerve dhe hidrosanitareve të dëmtuara;
- Në shkollën Isa Jakupi (238 nxënës), u bë një rikonstrukcion i plotë i tualetëve, përfshi hidrosanitaret, dyert etj, si dhe riparime të pjeshme të shtresave të dëmtuara në ambjente të ndryshme të shkollës.

**Në Njësinë Administrative GURI ZI** është kryer lyerja e plotë, e brëndshme dhe e jashtme e shkollës dhe kopshtit të fshatit Kuc (66 nxënës).

**Në Njësinë Administrative ANA MALIT** është kryer lysterja e plotë e ambientit të jashtëm të godinës së gjimnazit të fshatit Oblike ( 131 nxënës).

**Në njësinë Administrative BËRDICE** është kryer lysterja e plotë e ambientit të jashtëm të godinës së shkollës Dom Mikel Gjergji ( 43 nxënës).

F1.F2.O2.A5 “Blerje paisje orendi për mobilimin e klasave për sistemin arsimor parauniversitar”.

Në vitin 2016 është realizuar blerje për paisje orendi për shkollat. Karrige nxënësi 220 copë, tryeza nxënësi 60 copë. Për vitin 2016 kërkesat për paisje shkollore si karrige nxënësi dhe tryeza nxënësi, janë shumë të mëdha veçanërisht nga shkollat e njësive administrative.

Me perfundimin e procesit te inventarizimit eshte duke u ripare mundesia e rishperndarjes se pajisjeve mes shkollave.

F1.F2.O2.A6 “Blerje paisje ngrohese, frigoriferike dhe larëse për sistemin arsimor parauniversitar dhe parashkollor”

Për vitin 2016 janë paraqitur nevojat e njësive administrative Rrethina, Guri i Zi, Dajc, Shosh, Bërdicë, Ana e Malit për blerje të paisjeve ngrohëse. Gjithashtu kërkesa si nga shkollat ashtu edhe nga konviktet dhe kopështet për blerje paisje frigoriferike dhe larëse.

Në përmbushje të kërkesave të domosdoshme që janë paraqitur blerjet për paisje janë parashikuar:

Stufa për grohje me dru zjarri copë 70, stufa për ngrohje me gaz copë 30 për të plotësuar kërkesat me të domosdoshme të institucioneve arsimore në qytet që ngrohen me gaz (gjithsej 31), lavatrice copë 2, frigoriferë copë 1.

F1.F2.O3.A2 “Sigurimi i objekteve për raste të ngjarjeve të jashtëzakonëshme si zjarr dhe termete”

Gjatë vitit 2016 është bërë sigurimi i 20 objekteve, ku janë përfshirë konviktët, kopështët me drekë dhe shkollat që janë me numër më të madh nxënësish. Sigurimi i objekteve është bërë për raste të ngjarjeve të jashtëzakonëshme si zjarr dhe tërmete,.

Konviktë, Industriale, Artistike, Pedagogjike.

Shkolla, “3 Dhjetori”, “Ndërtimi”, “Teknologjike”, “28 Nëntori”. “Jordan Misja”, “Oso Kuka”, “Ismail Qemali”, “Ndre Mjeda”, “Shkolla Branko Kadia”, “Shkolla Azem Hajdari”, “Shkolla Skenderbëj”, “Shkolla Ali Lacej”, “Shkolla Xheladin Fishta”, “Qendra Kulturore e fëmijëve”

Kopështë, “ I.S.Brucaj”, “Bëp Tusha”, “Ton Alimhilli”

F1.F2.O3.A3 “Dizinfektimi i mjediseve të objekteve të shërbimeve mbështetëse”

Gjatë vitit 2016 është kryer shërbimi i dizinfektimit në 3200 m2, për ambientë kuzhina. mensa dhe magazina për kopështët me drekë dhe konviktët, nisur kjo nga kërkesa e vazhdueshme të bëra si pasojë e kontrolleve të ushtruara nga institucionet e kontrollit shëndetësor.

Kanë përfituar nga ky proces:

- Kopështe me drekë (ambjentet e kuzhinave, magazinat ushqimore, dhomat e ndenjës dhe fjetjes së fëmijëve si dhe anekset sanitare). Kjo për 5 kopështët me drekë. (Bep Tusha, Ton Alimhilli. I.S.Bruçaj. Guerilie, 1 Qershori);
- Konviktet (Artistike, i vajzave “Shejnaze Juka” dhe i shkollës “Industriale”) kuzhina, mensa, magazine ushqimore, dhomat e fjetjes në përdorim, sallat që përdoren për aktivite të nxënësve konviktor dhe anekset sanitare;
- Shkolla special “ 3 Dhjetori “ kuzhina, mensa, magazine ushqimore dhe anekset sanitare.

#### F1.F2.O4.A1 Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë

Identifikimi i talentëve të reja në fushën e interpretimit të këngës nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve kulturore artistike. Rritja e cilësisë së jetës kulturore në qytetin e Shkodrës nëpërmjet inkurajimit dhe mbështetjes së brezit të ri. Bilbilave të vegjël i shtohën çdo vit dhjetëra zëra të rinj, prandaj nevojë të veçantë ka për përkushtimin, pasjonin dhe investimin e përditshëm deri në detajet e vogla. Edicioni i 21-të këtë vit u zhvillua në katër faza ku marrën pjesë rreth 2500 fëmijë nga të gjitha shkollat që Bashkia Shkodër administron. Shkollat paraqitë fëmijët me talent pa kufizim në numër, të cilët ju nënshtruan punës përgatitore dhe fazave seleksionuese nën udhëheqjen e specialistëve. Matëriali muzikor për të gjithë konkurentët u përcaktua nga organizatorët, në përshtatje me moshën dhe karakteristikat vokale.

Në fazën finale konkurojnë më të talentuarit e përzgjedhur nga fazat seleksionuese dhe, nga këta, shpallen këngëtarët fitues. E kënduara direkt (Live) përmirësohet vazhdimisht përmes një punë të kualifikuar dhe sigurimit të një zërimi sa më cilësor.

#### F1.F2.O4.A2 Festivali i 54-t mbarëkombëtar për fëmijë

Skena e këtij festivali shërbeu për promovimin e mëtejshëm të fëmijëve në fushën e veprimtarive për kompozitorë, skenaristë, autorë tekstësh, regjisorë, koreografë, skenografë, dirigjentë, instrumentues, orkestrues, mjeshtra vokali, etj.

Festivali Mbarëkombëtar i këngës për fëmijë i 54-ti, u realizua në fillim të muajit qershor 2016, në ambient të hapur, në sheshin para Bashkisë së qytetit. Festivali mbahet si festë e këngës shqiptare dhe mundëson ndjekjen nga një shumicë artdashësish të qytetit të Shkodrës, trevave të tjera shqiptare dhe të shqipfolësve nëpërmjet transmetimit satelitor dhe faqeve të Web-sitit. Edicioni i 54-te, promovoi 26 këngë të reja, interpretimet më të mira të krijimeve më të zgjedhura të kompozitorëve, poetëve, aranzhuesve dhe këngëtarëve të këtij viti në realitetin shqiptar të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Diasporës.

Realizimi i këtij Festivali, i vetmi i këtij lloji në realitetin shqipfolës, synon të ruajë dhe të çojë përpara traditën e gjatë dhe të suksesshme të këtij zhanri; Stimulimin e talenteve të fëmijëve nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së zërit në të kënduarën direkt (Live).

F1.F2.O4.A3 “Veprimtari masive” (sportive, artistike e shkencore) të Qendres Kulturore të Fëmijëve”

Qendra Kulturore e Fëmijëve organizon sipas kalendarit të përcaktuar veprimtari masive sportive, artistike e shkencore, mbi bazën e platformave që ndërton dhe ua shpërndan shkollave 9

vjeçare. Këto veprimtari gjallërojnë dukshëm sheshet, fushat sportive, palestrat dhe sallat që qyteti ynë disponon. Përmendim këtu:

Në gjashtë mujorin e parë Janar - Qershor:

- Kampionati i shahut në mes shkollave 9 vjeçare (rreth 30 shkolla)
- Morën pjesë nga çdo shkollë 2 vajza dhe 2 djem (CU)
  - o 2 vajza dhe 2 djem nga kl 5-6
  - o 2 vajza dhe 2 djem nga klasa 7-8-9
- Kampionati i pimpongut në mes shkollave 9 vjeçare (rreth 30 shkolla)
- Garë me biçikleta ndërmjet kopshtëve të qytetit.  
Morën pjesë nga çdo kopsht 2 vajza dhe 2 djem.
- Gara zhvillohet e ndarë, në pedonalen tek ura e Bunës. Ky aktivitet hyn tek aktivitetet e traditës (rreth 30 vjet që zhvillohet) dhe rezulton shumë i dashur jo vetëm nga fëmijët por edhe nga prindërit. Kjo ditë kthehet në një festë për këtë brez fëmijësh.

Në këto aktivitete përveç fëmijëve të talentuar në fushat respektive, angazhohen edhe mësuesit edukimit fizik, të letërsisë, trainere, gjygtarë, regjizorë, aktorë, moderatorë dhe shkrimtarë nga më të njohurit që qyteti ynë ka.

Të gjitha këto veprimtari kanë fituesit e tyre të cilët stimulohen.

Morën pjesë nga çdo shkollë 2 vajza dhe 2 djem nga 5-6 si dhe 2 vajza dhe 2 nga klasa 7-8-9.

Kampionatet pranverore në Basketboll, Volejball dhe Minifutboll të femrave dhe meshkujve nërmjet shkollave 9 vjeçare (rreth 20 shkolla). Kjo veprimtari u realizua në tri faza, mbi bazën e shortit të hedhur në fillim duke vazhduar më pas me sistemin e eliminimit.

Ky aktivitet u zhvillua në disa terrene dhe palestra të qytetit tonë dhe zgjati rreth një muaj e gjysëm. Në fund u shpall ekipi fitues për secilin sport.

### **Zbavitimi me gjuhët e huaja**

Marrin pjesë anëtarë të rretheve të gjuhëve të huaja të QKF (150 fëmijë) si dhe nxënës të dalluar në këtë fushë nga shkollat 9 vjeçare. Kjo veprimtari u organizua në sallën e QKF-së ku nxënësit shpalosën arritjet e tyre përmes këngës, recitimit, inskenimit dhe humorit në gjuhë të huaja.

Në gjashtë mujorin e dytë Shtator-Dhjetor:

- Kampionati i vrapimit në natyrë në mes shkolla 9 vjeçare(rreth 30 shkolla)  
Marrin pjesë nga çdo shkollë 2 vajza dhe 2 djem nga CU-3 vajza dhe 3 djem nga CU.
- Konkursi i fjalës artistike në mes shkolla 9 vjeçare(rreth 27 shkolla)
- Konkursi zhvillohet në tre faza sipas kalendarit të përcaktuar.  
Faza e parë, në shkolla, pa kufizim numrin i konkurentëve, ndiqet nga specialistët e QKF-së.

Faza e dytë në sallën e QKF në 10 ditë dhe në të marrin pjesë nga çdo shkollë: 3 recitues nga CU- 2

recitues nga CL dhe Një nxënës ose një grup në fushën e humorit.

Nga kjo fazë Juria përzgjedh finalistët të cilët konkurojnë në Finale për të shpallur 8 fituesit: Vendi i parë, dytë, tretë dhe inkurajues për CU dhe për CL.

- Garë me biçikleta në mes kopshtëve të qytetit  
Marrin pjesë nga çdo kopësht 2 vajza dhe 2 djem.
- Gara zhvillohet e ndarë, në pedonalen tek ura e Bunës. Ky aktivitet hyn tek aktivitetet e traditës (rreth 30 vjet që zhvillohet) dhe rezulton shumë i dashur jo vetëm nga fëmijët por edhe nga prindërit. Kjo ditë kthehet në një festë për këtë brez fëmijësh.

Në këto aktivitete përveç fëmijëve të talentuar në fushat respektive, angazhohen edhe mësuesit edukimit fizik, të letërsisë, trainere, gjygtarë, regjizorë, aktorë, moderatorë dhe shkrimtarë nga më të njohurit që qyteti ynë ka.

Të gjitha këto veprimtari kanë fituesit e tyre të cilët stimulohen.

Këto veprimtari ndiqen me shumë interes nga drejtuesit dhe tekniket e klubit shumësportësh "Vllaznia" si mënyrë për të afruar në ekipet e këtij klubi më të talentuarit.

#### F1.F2.O4.A4 Veprimtari me rrethet artistike, sportive e shkencore për vitin 2016

Qendra Kulturore e Fëmijëve, gjatë vitit mësimor ushtron veprimtari me rrethet artistike, sportive e tekniko-shkencore mbi bazën e programeve të miratuara nga MASH. Për çdo vit marrin pjesë rreth 500 fëmijë si dhe një grup specialistësh nga fusha e artit, sportit dhe shkencës nga më të mirët e qytetit tonë.

Nga kjo veprimtari e suksesshme ndër vitë kanë dalë figura të spikatura të artit dhe sportit, duke shkëlqyer në skenat dhe fushat sportive kombëtare e më gjërë. Gjithashtu nga kjo veprimtari argëtohen, aftësohen dhe stërvitën çdo vit një grup i madh fëmijësh të talentuar në fushat respektive. Pranë QKF-së për këtë vit kalendarik funksionuan disa kurse për përgatitjen e talentëve të reja në art, sport dhe shkencë, traditë kjo 70 vjeçare.

#### F1.F2.O4.A5 "Mbrëmja Tradicionale e Vitit të Ri për nxënësit e shkollave 9 vjeçare"

Mbrëmja tradicionale e vitit të ri ka një traditë më shumë se 60 vjeçare, realizuar pa ndërprerje çdo vit nga QKF (ish Shtëpia e Pionierit) në fund të muajit dhjetor, me mbështetjen e Bashkisë Shkodër. Ky aktivitet stimulon nxënësit e talentuar pa dallime, që zgjidhen nga shkollat, DAR-i dhe stafi i QKF. Kjo mbrëmje shërbën si premierë e talentëve të humorit, këngës, baletit dhe aerobisë së QKF dhe si stimulim i nxënësve më të mirë të qytetit, (stimulohen rreth 70 nxënës të dalluar të ciklit të ulët të shkollave 9 vjeçare dhe 130 artistë dhe sportistë të vegjël). Materiali artistik i kësaj veprimtarie është rreth 75% krejt i ri. Gjithashtu kjo mbrëmje stimulon bashkëpunimin me artistë të afirmuar, të cilët ftohen si mysafirë nderi. Kjo gjë rrit interesin dhe pëlqyeshërinë duke e bërë këtë aktivitet shumë argëtues. Nëpërmjet këtij aktiviteti gjallërohet jeta kulturore dhe artistike e brezit të fëmijëve.

**Nga Drejtoria gjithashtu është realizuar:**



- **Shpërndarja e bursave për nxënës dhe student.** Me Vendim të Këshillit të Ministrave, numër 911.datë 11.11.2015 “Për bursat për nxënës dhe student” me fondet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Mirëqënies Sociale. Për vitin 2016 përfituan bursë me vendim të Këshillit Bashkiak nr.56 dhe 40 datë 29.12.2015, 277 nxënës.
- **Projekti “Shkollat si qendra komunitare”.** Bashkia Shkodër, në bazë të standardeve dhe udhëzimit të miratuar nga MAS për realizimin e projekteve në shkolla, me mbështetjen e donatorëve dhe financimin nga vetë Bashkia ka hartuar politikat për shkollat të cilat janë dhe do të jenë qendra komunitare. Nëpërmjet këtij projekti promovohet dhe nxitet hapja e strukturave të edukimit jashtë orarit të mesimit, për gjithë fëmijët e komunitetit.
- **Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara.** Bashkia Shkodër, mbështet këtë kategori nxënësish duke ju ofruar shërbimet mbështetëse në shkollën Speciale “3 Dhjetori”. Gjithashtu Bashkia mbështet dhe aktivitet kulturore dhe sociale të nxënësve të kësaj shkolle.
- Detajimi, ndjekja e zbatimi i buxhetit, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 17 datë 28.04.2016”;
- Detajimi i Buxhetit për të gjitha zerat e shpenzimeve;
- Detajimi i shpenzimeve mujore për të gjitha zërat;
- Ndjekja dhe monitorimi i zbatimit të buxhetit për vitin 2016;
- Përgatitja e raportit vjetor të monitorimi të Drejtorise Ekonomike të Arsimit për vitin 2015;
- Përgatitja e raportit vjetor të konsoliduar të Pasqyrave Financiare për vitin 2015;
- Hartimi i projektbuxhetit për vitin 2017, si dhe periudhën afatmesme 2017-2019;
- Planifikimi dhe ndjekja e procedurave për pagesat e e shpenzimeve sipas programeve për çdo muaj;
- Raportimi për evidencën e shpenzimeve dhe tabëlat për realizimin e ketyre shpenzimeve pranë Drejtorisë Analizes dhe Programimit Buxhetor për çdo muaj;
- Analiza të pagave të punonjësve si dhe shpenzimet për personelin mbështetës në Arsim, transportin e nxënësve dhe mësuesve, bursat dhe kuotat ushqimore, investimet kapitale etj;
- Pjesëmarrje në grupe pune për hartimin e specifikimeve teknike si dhe fondit limit për procedura prokurimi të parashikuara për vitin 2016;
- Hartimi i projekt vendimeve.

### III Fondet e financimit të programeve

Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr. 11166, datë 24.12.2015, në lidhje me procedurat e transferimit të punonjësve si dhe fondet për mbulimin e shpenzimeve për personelin për pagat e punonjësve që transferohen nga Ministria Arsimit e Sportit tek Njësitë e Qeverisjes Vendore (bashkitë e reja) për vitin 2016, si dhe në transfertë specifike parashikuara në Ligjin për Buxhetin e Shtetit të vitit 2016. Urdher i Brendshëm nr. 757 date 14.11.2016” Per tranferim fondi”, Kerkese per ndryshim fondi me nr.124 date 1.07.2016, Vendim i Kryetares Bashkise nr.748 date 21.10.2016”Per rishperndarje te fondeve”, Shkrese nr.17 366/8 date 20.12.2016”Mbi zbatimin e aktit normativ nr.2 date 16.12.2016,”Per shtese fondi page”.

## Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2016

Fondet e miratuara për këtë program (P9), janë 348.191 mijë. Plani i korigjuar është 350 509 mijë. Realizimi për periudhën 12-mujore është 322 018 mijë lekë në këtë program në masën 91% ndaj planit vjetor.

Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzime korente 93 %. Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale 88 %. Gjithësej 91 %.

a) Fondet për shpenzime përsonele në zërin “Pagat dhe sigurimet shoqërore”, arrijnë në 210 988 mijë lekë në vitin 2016, për periudhën 12-mujore realizimi është në masën 197 199mijelekë ose në masën 93%. Keto fonde kanë mbuluar pagat si dhe sigurimet shoqërore për 357 punonjës, nga të cilët:

- Aparati i Drejtorisë Ekonomike të Arsimit 21 punonjës;
- Punonjës mbështetës të arsimit 9- vjecar 76 punonjës;
- Punonjës mbështetës arsimit mesëm 43 punonjës;
- Punonjës konvikti 46 punonjës;
- Punonjës arsimit parashkollor 163 punonjës;
- Punonjës mbështetës arsimit parashkollor 8 punonjës.

b) Fondet për shpenzime Operative për vitin 2016 sipas planit të rishikuar arrijnë në masën 104 202 mijë lekë me realizim 96 143 mijë leke, në masën 92 % me synim kryesor krijimi i kushtëve optimale për zhvillimin e procesit mësimor në standartet e kërkuara.

c) Fondet nga transfertat për vitin 2016 nga plani i korigjuar 2440 mijë leke është realizuar 2415 mijë leke në masën 99 %

d) Fondet për investime për vitin 2016 sipas planit të rishikuar arrijnë në masën 32 880 mijë leke dhe është realizuar në masën 26264 mijë leke me përqindje realizimi 80 %

**Tabëla e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.**

Aktivite/Projekte	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi
P9.F1.F2.O1.A1 Pagat dhe sigurime shoqërore për punonjësit e arsimit.	101,420	107,810	98,909
P9.F1.F2.O1.A2 Arsimit Parashkollor (Paga të personelit të kopështëve dhe blerje ushqime për kopshtet me drekë).	112,964	109,880	104,859
P9.F1.F2.O1.A3 Blerje materiale (batanije, çarçafë, peshqirë dhe mbulesa tryezash) në shërbim të konvikteve.	100	100	82
P9.F1.F2.O1.A4 Blerje materiale shërbime mbështetëse kuzhine.	156	156	-
P9.F1.F2.O1.A5 Blerje ushqime për konviktet e shkollave të mesme.	17,998	17,998	15,322
P9.F1.F2.O1.A6 Blerje materiale kancelarie për sistemin arsimor parauniversitar.	1,131	1,131	684
P9.F1.F2.O1.A7 Blerje materiale të ndryshme për shërbimet mbështetëse për sistemin arsimor	680	680	620



parauniversitar dhe parashkollor.						
P9.F1.F2.O1.A8	Blerje pjesë kembimi për mirëmbajtjen e sistemeve hidraulike të sistemit arsimor parauniversitar dhe edukimit parashkollor.	300	300	194		
P9.F1.F2.O1.A9	Blerje materiale pastrimi ambientesh.	2,079	2,079	2,034		
P9.F1.F2.O1.A10	Blerje dru zjarri për ngrohje për sistemin e arsimit parauniversitar.	8,900	8,900	8,888		
P9.F1.F2.O1.A11	Blerje gaz të lengshem për ngrohje për sistemin arsimor parashkollor dhe sistemin arsimor parauniversitar.	6,420	6,420	6,210		
P9.F1.F2.O1.A12	Blerje lënde djegëse karburantë për ngrohje dhe për mjete transporti (naftë dhe bënzinë).	2,934	2,934	2,923		
P9.F1.F2.O1.A13	Riparim paisje orendi.	258	258	81		
P9.F1.F2.O1.A14	Mirëmbajtje e mjeteve të transportit për shërbimet mbështetëse të sistemit arsimor parauniversitar dhe sistemit arsimor parashkollor.	403	403	291		
P9.F1.F2.O1.A15	Furnizim me energji elektrike, ujë dhe telefon për të gjitha shkollat në territorin e Bashkisë.	20,552	20,552	22,058		
P9.F1.F2.O1.A16	Transport i arsimtarëve dhe nxënësve i sistemit arsimor parashkollor dhe i mesëm.	22,342	22,342	21,037		
P9.F1.F2.O2.A1	Blerje xhami për mirëmbajtjen e dritareve për të gjitha objektet e arsimit parauniversitar dhe parashkollor.	320	320	299		
P9.F1.F2.O2.A2	Blerje bojërash të ndryshme për lyerjen e mjediseve të godinave të sistemit arsimor parauniversitar dhe parashkollor.	320	320	209		
P9.F1.F2.O2.A3	Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjeteve elektrike për godinat e sistemit arsimor parauniversitar.	500	500	197		
P9.F1.F2.O2.A4	Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore.	7,831	7,831	6,435		
P9.F1.F2.O2.A5	Blerje paisje orendi për mobilimin e klasave për sistemin arsimor parauniversitar.	1,000	1,000	745		
P9.F1.F2.O2.A6	Blerje paisje ngrohëse, frigoriferike dhe larëse për sistemin arsimor parauniversitar dhe parashkollor.	1,480	1,480	1,433		
P9.F1.F2.O2.A7	Pajisja dhe instalimi i kaldajës në shkollën "Xheladin Fishta"	1,700	1,700	47		



P9.F1.F2.O2.A8 Rikonstruksion i plote i objektit arsimor "Oso Kuka".	19,300	19,300	16,630
P9.F1.F2.O2.A9 Rikonstruksion i pjesshëm shkolla "Tringe Smajla" Fshati Grudë e Re, Njësia Administrative Rrethina.	9,400	9,400	7,409
P9.F1.F2.O3.A1 Rimbushje fikëse zjarri.	240	240	-
P9.F1.F2.O3.A2 Sigurimi i objekteve për raste të ngjarjeve të jashtëzakonshme si zjarre dhe tërmete.	800	800	665
P9.F1.F2.O3.A3 Dizinfektimi i mjediseve të objekteve të shërbimeve mbështetëse.	283	283	144
P9.F1.F2.O4.A1 Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë	410	410	409
P9.F1.F2.O4.A2 Festivali i 54-t mbarëkombëtar për fëmijë	4,500	4,500	4,325
P9.F1.F2.O4.A3 "Veprimtari masive" (sportive, artistike e shkencore) të Qendrës Kulturore të Fëmijëve.	280	280	280
P9.F1.F2.O4.A4 Veprimtari me rrethet artistike, sportive e shkencore per vitin 2016.	744	744	744
P9.F1.F2.O4.A5 Mbrëmja Tradicionale e Vitit të Ri për nxënësit e shkollave 9 vjeçare.	446	446	446
<b>TOTALI</b>	<b>348,191</b>	<b>350,509</b>	<b>322,018</b>

#### IV Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.

Vështirësitë e hasura gjatë implementimit të buxhetit sipas secilit aktivitet kanë konsistuar në:

- Blerje materiale shërbime mbështetëse kuzhine, meqense gjateë vitit 2016, nuk ka patur kërkesa nga Konviktet , Shkolla Speciale dhe Kopshtet për enë kuzhine, nuk e kemi realizuar si shpenzim.
- Pajisja dhe instalimi i kaldajës në shkollën "Xheladin Fishta". Meqense gjate muajit dhjetor kemi realizuar projektin Hidro-termik te kaldajes, ne baze te ligjit per procedurat e prokurimit publik, per perfundimin e nje procedure zgjate 45 dite, nuk u arrit te realizohet brenda vitit 2016
- Rikonstruksion i plotë i objektit arsimor "Oso Kuka". Në këtë objekt është parashikuar rikonstruksioni i plotë i rrjetit elektrik të brendshëm dhe të jashtëm, paisja e shkollës me rrjet LAN, sistem kamerash të brëndshme dhe rrjeti i ngrohjes i cili mungonte terësisht më parë. Si rrjedhojë e proceduarve të projektimit të projektit elektirk, është zgjatur dhe procesi I prokurimit të zbatimit të objektit. Objekti është prokuruar në vitin 2016 dhe do zbatohet në fillim të vitit 2017.
- Rikonstruksion i pjesshëm shkolla "Tringe Smajla" Fshati Grudë e Re, Njësia Administrative Rrethina. Objekt në të cilin kanë filluar punimet. Këto punime përfshijnë rikonstruksionin e

plotë të terracës, zëvendësimi i shtresave të pllakave të dyshemeve, riparimi i tualetëve, si dhe paisja e shkollës me një rrjet elektrik, sistemi i brendshëm i kamerave dhe rrjeti LAN sipas kushtëve të MAS. Objekti përfundon në vitin 2017.

- Rimbushje fikese zjarri. Ky shërbim është realizuar nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Mbrotjes Kundër Zjarrit, i cili ka mbuluar gjithë nevojat e objekteve shkollore.

## P.10 Strehimi dhe Shërbimet Sociale

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik është drejtori e krijuar për herë të parë në Bashkinë e Shkodrës në fillim të vitit 2016.

***Vizioni i kësaj drejtorie është “Shërbime Sociale multisektoriale, të qëndrueshme dhe të standartizuara pranë komunitetit, në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë”.***

Struktura e kësaj drejtorie përbëhet nga 2 sektorë si më poshtë:

1. Sektori i Përfshirjes Sociale, Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Strehimit.
2. Sektori i Planifikimit Strategjik, Standarteve e Monitorimit për Shërbimet sociale, dhe Shëndetin Publik.

Shërbimet me bazë komunitare të krijuara gjatë vitit 2016 janë të parat struktura operative në territorin e Bashkisë së Shkodrës. 7 qendra komunitare “Për Familjen” u krijuan dhe u vune në funksion, nga një në të çdo lagje të Shkodrës dhe 2 në njësinë administrative të Gurit të Zi dhe të Dajçit. Në këto qendra ofrohet informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizimi ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komunitetit, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, etj.

### I Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

Në ushtrim të detyrave funksionale në zbatim të ligjit 139 “Për vërtetëqeverisjen vendore”, ligjit 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” dhe aktet nënligjore përkatëse, veprimtaria e Drejtorisë është bazuar në katër funksione kryesore të ndara sipas objektivave specifike:

- F1. Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehim social sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
  - F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, për personant me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, të moshuarit.
  - F3. Ndërtimi dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.
  - F4. Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- Objektivat për secilin funksion janë:
- F1.O1. Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë.
  - F2.O1. Mbulimi sa më i plotë i territorit të Bashkisë me shërbime sociale duke u harmonizuar me nevojat e komunitetit.
  - F2.O2. Bashkërendimi dhe harmonizimi I aktiviteteve lokale me Strategjitë dhe Politikat kombëtare, me institucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare.
  - F2.O3. Partneritetet i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jofitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.
  - F2.O4. Gjithëpërfshirja, pjesëmarrja, krijimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, moshës, origjinës, minoritetit.
  - F3.O1. Fuqizimi i institucioneve që ofrojnë shërbime sociale me orientim promovimin dhe zhvillimin e shërbimeve alternative

F4.O1. Krijimi i fondit të dedikuar për mbështetjen e personave me AN në bashkërendim me shoqërinë civile.

## II Produktet për vitin 2016

Gjatë vitit 2016 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër.

F1.O1.A1. Përmirësimi i kushteve të banimit dhe kushteve sociale për komunitetin rom dhe egjiptian Pas një studimi dhe vlerësimi i situatës të kushteve të jetës të komunitetit R&E është aplikuar pranë MZHU dhe është realizuar rikonstruksioni i 9 banesave romë dhe egjiptiane ku jetojnë 51 banorë, duke përmirësuar kushtet e banimit për këtë komunitet në zonën përtej ures së Bunës.

F1.O1.A2. Rikonstruksion dhe përshtatje e ish konviktit të shkollës pyjore, në banesa për personat e dalë nga institucionet e përkujdesjes sociale.

Pas aplikimit të Bashkisë së Shkodrës pranë MZHU është mundësuar realizimi rikonstruksionit dhe përshtatja e ish-konviktit të shkollës pyjore në banesa sociale për jetimët që aktualisht jetojnë në konvikte, për jetimët që dalin nga institucionet rezidenciale dhe për familjet me një prind që jetojnë në kushte të vështira.

Jetimët që dalin nga institucionet mbeten pa asnjë mbështetje, prandaj janë shumë vulnerabël ndaj fenomeneve sociale si keqtrajtimi, trafikimi apo abuzimi, ndaj është vlerësuar e nevojshme që të sistemohen pranë kësaj strukture, në 26 apartamente.

F2.O2.A1. Përgatitja, përditësimi dhe botimi i Planit Social të Zonës dhe Guidës së shërbimeve.

Gjatë vitit 2016 është punuar për përgatitjen e Planit Social të Zonës, si instrument bazë i vlerësimit të nevojave, planifikimit, realizimit e monitorimit të vazhdueshëm të shërbimeve sociale, duke përfshirë të gjithë territorin e Bashkisë së re Shkodër. Për këtë Bashkia e Shkodrës ka vlerësuar shumë të rëndësishme bashkëpunimin e ngushtë me organizatat jo-fitimprurese në përgatitjen e PSZ, në konsultimet teknike, në mbulimin sa më të mirë të territorit me shërbime dhe në promovimin e modeleve alternative të shërbimeve sociale. Botimi i PSZ për arsye teknike do të realizohet në fillim të vitit 2017.

F2.O2.A2 Trajtimi i qenjve të rrugës

Gjatë vitit 2016 është lidhur kontrata për trajtimin e 230 qenjve të rrugës që përfshin kapjen e qenjve, sterilizimin, matrikulimin dhe vaksinimin e tyre. Kjo ndërhyrje do të ul rrezikshmërinë e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse tek qytetarët si dhe zvogëlon mundësinë e riprodhimit të tyre. Kontrata është lidhur në fund të vitit 2016 dhe afati i zbatimit është shtyre deri me datë 31.05.2017.

F2.O1.A3 Hartimi dhe zbatimi i Planit Lokal të Veprimit për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge.

Bashkia e Shkodrës në zbatim të detyrimeve të saja ligjore e në kuadër të nënshkrimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit mes MMSR, MAS dhe MPB “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge dhe Planit Kombëtar të veprimit, ka hartuar dhe miratuar Planin Lokal i Veprimit për fëmijët në situatë rruge. Bashkia ka përgjegjësinë kryesore për mbrojtjen e fëmijëve dhe koordinimin e punës ndërmjet institucioneve përgjegjëse.

Për realizimin e kësaj janë krijuar skuadrat që realizojnë punën në terren për identifikimin dhe referimin e rasteve të fëmijëve. Njëkohësisht është punuar për menaxhimin e rasteve dhe fuqizimin

e familjeve sipas nevojave bazuar në Protokollin e punës për fëmijët. Gjithashtu janë realizuar fushata ndërgjegjësuese në bashkëpunim me organizatat dhe institucionet lokale. Gjatë vitit 2016 janë identifikuar rreth 100 fëmijë në situatë rruge.

#### F2.O2.A4 Ndhurma ekonomike dhe pagesa e paftesise

Në skemen e ndihmes ekonomike rezultojnë nga 4487 familje në muajin Janar 2016 ndërsa në fund vitit muaji Dhjetor rezultojnë 4095 familje. Kjo zbritje prej 392 familje ka ardhur si rezultat i verifikimeve në mënyre periodike të listave të punesimit, të sigurimeve shoqerore, të konstatimeve të kapitalit të dyte, etj.

Në skemën e paftesise: nga 4475 persona me P.A.K në muajin Janar në muajin Dhjetor rezultojnë 4197 persona, zbritja prej 278 personash vjen nga verifikimi i komisioneve të kempit.

Në pagesat e shtesave të kempit të invalideve të punës: nga 3230 inv.punë në muajin Janar - në Dhjetor rezultojnë 3305 inv.punë.

Nga ana financiare :

Fondet e dhëna nga Ministria e Mireqënies Sociale dhe Rinisë janë përdorur plotësisht duke mbetur edhe detyrime për tu shlyer, për një grup personash për mungese fondesh, gjate vitit 2017 si me poshtë:

Fonde të akorduara për vitin 2016 962.345.mije leke

Fonde të përdorura për vitin 2016 962.342.mije leke

#### F2.O2.A5 Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare

Në zbatim të detyrimeve ligjore gjatë vitit 2016 ka filluar puna për riorganizimin dhe funksionimin e sistemit të referimit për rastet e dhunës në familje. Kështu është përgatitur draft marëveshja për zbatimin e sistemit të referimit të dhunës në marrëdhëniet familjare. Funksionimi i sistemit do të përmirësojë ndërhyrjen e koordinuar në identifikimin, referimin e rasteve të dhunës në familje si dhe ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e viktimave të dhunës për denoncimin si dhe për parandalimin e këtij fenomeni.

#### F2.O2.A6 16 ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë ligjore

Bashkia e Shkodrës, në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore, në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet publike ka zhvilluar një sërë aktiviteteve ndërgjegjësuese, të cilat kanë filluar më 25 nëntor 2016, në ditën ndërkombëtare kundër dhunës me bazë gjinore dhe kanë vazhduar përgjatë 16 ditëve të aktivizimit.

Organizimi i këtyre aktiviteteve ka për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit ndaj rasteve të dhunës në familje si dhe parandalimin e këtij fenomeni.

#### F.2.O2.A7 Dita ndërkombëtare për familjen

Bashkia e Shkodrës, në kuadër të ditës ndërkombëtare për familjen, ka marrë pjesë në panairin kombëtar të organizuar nga MMSR, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile. Qëllimi i këtij aktiviteti ka qenë prezantimi dhe promovimi i shërbimeve që ofrohen nga Drejtoria e Shërbimit Social, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

#### F2.O2.A8 Partneriteti me departamentin e psikologjisë, punës sociale dhe infermierisë

Në kuadër të partneritetit me Departamentin e psikologjisë, punës sociale dhe infermierisë është realizuar praktika mësimore për rreth 9 studentë. Gjatë periudhës së realizimit të praktikës

mësimore, studentët kanë marrë pjesë aktive në aktivitetet e drejtorisë për identifikimin, informimin, dhe referimin e shërbimeve.

#### F2.O3.A1 Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në qytetin e Shkodrës

Gjatë vitit 2016, janë realizuar një sërë takimesh me organizatat partnere që veprojnë në Bashkinë e Shkodrës. Qëllimi i takimeve ka qenë koordinimi dhe bashkërendimi i shërbimeve dhe aktiviteteve që ofrohen në mbështetje të shtresave në vështirësi social ekonomike.

#### F2.O3.A2 Aktivitet sensibilizues në kuadër të ditës ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve

Në kuadër të ditës ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve janë organizuar aktivitete sensibilizuese dhe informuese me fëmijë dhe të rinj të institucioneve rezidenciale, të familjeve në vështirësi social, ekonomike, etj.

#### F2.O3.A3 Shkodra n`Fest

Bashkia Shkodër në kuadër të festave të fundvitit, për të dytin vit radhazi, në bashkëpunim me organizatat partnere të shoqërisë civile organizoi aktivitetin “Shkodra n`Fest” .

Ky aktivitet u zhvillua nga data 8 Dhjetor deri me datë 31 Dhjetor 2016. Ashtu si vitin e kaluar, sërish në vitin 2016 Shkodra-n` Fest është vendosur në qendër të qytetit, në mënyrë që të përfshijë sa më shumë të rinj, fëmijë, dhe qytetarë në organizimet festive.

#### F2.O3.A4 Dita ndërkombëtare e të moshuarve

Në kuadër të ditës ndërkombëtare të të moshuarve, është organizuar aktivitet sensibilizues për shërbimet e nevojshme për moshën e tretë. Aktiviteti është zhvilluar në shtëpinë e të moshuarve, Shkodër.

#### F2.O3.A5 Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të 1 Dhjetorit, ditës botërore kundër Hiv Aids

Në kuadër të ditës botërore kundër Hiv Aids, u zhvilluan një sërë aktiviteteve si:

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetit Publik, Drejtorinë Arsimore, UNAids, YËCA dhe organizatat rinore vendore, në sheshin para Bashkisë së Shkodrës, është organizuar aktiviteti për informimin e të rinjve dhe jo vetëm për parandalimin dhe mbrojtjen nga HIV AIDS.

Në ambjentet e shkollës publike 9 vjeçare “Edit Durham” të rinjtë dhe studentët janë informuar nga mjekët specialistë për mënyrat e transmetimit dhe parandalimit të këtij virusi. Në fund të kësaj dite është organizuar aktiviteti përmbyllës me të rinj, pranë qendrës rinore “Arka” .

F2.O3.A6 Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për personat me aftësi ndryshe, 3 Dhjetori.

Në kuadër të ditës ndërkombëtare për PAN është organizuar një aktivitet social kulturor me synim ndërgjegjësimin e mbarë komunitetit, institucioneve publike, shoqërisë civile, por edhe përfituesve për t` u bërë pjesë dhe për të përfituar në procesin e integritit të personave me aftësi ndryshe. Në këtë aktivitet u zhvillua një panair me punimet e personave me AN dhe janë performuar këngë dhe recitime për pjesëmarrësit.

#### F2.O3. A8 Dita ndërkombëtare e gruas, 8 Marsi.

Në kuadër të ditës ndërkombëtare të gruas, Bashkia e Shkodrës, ka përgatitur spotin sensibilizues për të drejtat e grave, si të drejta themelore të njeriut. Ky spot është transmetuar në mediat lokale dhe në aktivitetin e organizuar për këtë ditë, nën kujdesin e Bashkisë së Shkodrës. Gjithashtu është kompozuar, orkestruar dhe kënduar një këngë, nga këngëtarët dhe muzikantët e Shkodrës.

#### F2.O3.A9 Bashkëpunim me Save the Children.

Me qëllim institucionalizimin e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile ndërkombëtare, kombëtare dhe vendore, Bashkia e Shkodrës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Këto marrëveshje janë miratuar në këshillin bashkiak.

Qëllimi i marrëveshjes me Save the Children është promovimi dhe ofrimi i shërbimeve alternative për fëmijët në rrezik institucionalizimi ose deinstitutionalizimi i fëmijëve nga institucionet e përkujdesit rezidencial.

#### F2.O3.A10 Bashkëpunimi me Fondacionin Shpresë për Botën, Shtëpinë e foshnjës dhe Shtëpinë fëmijës shkollore.

Për ofrimin sa më të mirë të shërbimeve ndaj fëmijëve që jetojnë në institucionet e përkujdesit rezidencial (shtëpia e foshnjës 0-3 vjeç dhe shtëpia e fëmijës shkollor 6-18 vjeç) dhe krijimin e një atmosfere sa më të këndshme dhe sa më të përshtatshme për çdo grup-moshë që jeton në këto institucione, është krijuar partneriteti me fondacionin “Shpresë për botën” .

Me mbështetjen e kësaj organizate janë përmirësuar kushtet e jetesës për fëmijët dhe janë organizuar festimet e festave zyrtare, festimet e ditëlindjeve të secilit fëmijë, janë organizuar aktivitete të ndryshme kulturore dhe argëtuese dhe gjithashtu janë plotësuar nevojat specifike emergjente të fëmijëve. Njëkohësisht, nëpërmjet këtij bashkëpunimi janë nxitur dhe mbështetur takimet e fëmijëve me familjen biologjike.

#### F2.O4.A1 Lojra popullore Fest.

Në zbatim të politikave vendore sociale, në kuadër të gjithëpërfshirjes është planifikuar dhe realizuar aktiviteti “Lojna popullore fest 2016” . Ky aktivitet është organizuar në bashkëpunim me organizatën The Door. Trupat pjesëmarrëse edhe këtë vit ishin të shumta dhe sollën larmi kostumesh këngësh e vallesh folklorike. Synimi i këtij aktiviteti ka qenë pasurimi i jetës social-kulturore të rinjve dhe njohja e ruajtja e traditave kombëtare nëpërmjet performancave të valleve, këngëve dhe lojrave popullore.

#### F2.O4.A2 Qendër multidisiplinare socio – mjekësore

Në vitin 2016, është synuar ndërtimi i një qendre multidisiplinare socio-mjekësore në shërbim të komunitetit rom dhe egjiptian. Për ngritjen e kësaj qendre, Bashkia e Shkodrës arriti në një marrëveshje bashkëpunimi me organizatën Malteser. Realizimi i kësaj qendre, nuk u bë i mundur si pasojë e mos marrjes së votave të mjaftueshme në Këshillin Bashkiak, Shkodër.

#### F2.O4.A3 Fuqizimi socio-ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian

Bashkia e Shkodrës, në muajin prill 2016 ka lançuar fillimin e projektit "Fuqizimi Ekonomik dhe Social për Romët dhe Egjiptianët-një shtysë për përfshirjen sociale". Projekt i cili po zbatohet në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), me mbështetjen e Bashkimit Europian.



Gjatë vitit të parë të zbatimit të këtij projekti është punuar për fuqizimin e komunitetit, formimin profesional dhe nxitjen e punësimit. Gjithashtu është bërë vlerësimi i nevojave për ndërhyrje në infrastrukturë dhe përmirësim të kushteve të banimit dhe jetesës.

#### F3.O1.A1 Ngritja dhe vendosja në funksion e 5 qendrave sociale komunitare “Për familjen”

Shërbimet me bazë komunitare të krijuara gjatë vitit 2016 janë të parat struktura operative në territorin e Bashkisë së Shkodrës. 7 qendra komunitare “Për Familjen” u krijuan dhe u vendosën në funksion, nga një në çdo lagje të Shkodrës dhe 2 në njësinë administrative të Gurit të Zi dhe Dajçit. Në këto qendra ofrohet informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizimi ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komunitetit, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, etj.

#### F3.O1.A2 Çerdhet

Bashkia Shkodër, aktualisht ka tre çerdhe dhe konkretisht çerdhja Manush Alimani ka të rregjistruar 43 fëmijë si dhe personeli përbëhet nga 8 kujdestarë dhe 1 infermierë, të cilët punojnë me dy turne. Çerdhja Perash ka të rregjistruar 55 fëmijë dhe personeli përbëhet nga 22 kujdestarë dhe 1 infermierë të cilët punojnë me dy turne.

Çerdhja 1 Qershori ka të rregjistruar 55 fëmijë dhe personeli përbëhet nga 12 kujdestarë e 1 infermiere të cilat gjithashtu punojnë me turne .

Raporti i Shpenzimeve faktike të Programit sipas Artikujve për periudhën 12-Mujore.

#### Shpenzime Personeli.

Fondi i planifikuar për mbulimin e shpenzimeve në paga është 19.349 mijë lekë dhe realizimi paraqitet në masën 18.497 mijë lekë dhe fondi i planifikuar për sigurime shoqërore është 3.150 mijë lekë dhe realizimi paraqitet në masën 3.104 mijë lekë.

#### Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të tjera.

Fondi i planifikuar për këtë zë është 9.199 mijë lekë dhe realizimi i këtij artikulli paraqitet me vlerën 8.341 mijë lekë. Në zërin “Materiale zyre dhe të përgjithshme” realizimi është 886 mijë lekë, kjo vlerë përfaqëson shpenzimet që janë bërë për blerje kancelari dhe materiale pastrimi dhe dizinfektimi për çerdhet.

Në zërin "Materiale dhe shërbime speciale" realizimi është 4.273 mijë lekë nga 4.400 mijë lekë që ishte planifikuar ose 97% e planit. Kjo vlerë përbëhet prej 3.917 mijë lekë që përfaqëson shpenzimet për ushqime ndërsa vlera tjetër prej 356 mijë lekë përfaqëson shpenzimet që janë bërë për blerje të materialeve të ndryshme si dyshekë, karriga, tavolina për fëmijë etj.

Në zërin "Shërbime nga të tretë" realizimi është 1.956 mijë lekë. Kjo vlerë pasqyrohet në faturat e energjisë elektrike në shumën prej 659 mijë lekë dhe faturat e konsumit të ujit me vlerë prej 944 mijë lekë.

Blerja e lëndëve djegëse “dru zjarri,, e planifikuar me një vlerë prej 400 mijë lekë është realizuar në masën 86% ose me vlerën 346 mijë lekë.

Në zërin “Shërbime nga të tretë” përfshihen edhe shpenzimet telefonike të cilat përfaqësohen me vlerën prej 7 mijë lekë të cilat janë faturat e internetit.

Në zërin “Mirëmbajtje e zakonshme” fondi i planifikuar prej 1.290 mijë lekë është realizuar në masën 74% ose me vlerën 956 mijë lekë dhe konkretisht: 907 mijë lekë janë shpenzuar për lyerjen me bojë e çerdheve, mirëmbajtja e çerdhes “Perash” riparimi i çatisë së saj dhe mirëmbajtja e 2 çerdheve të tjera si “Manush Alimani “ dhe “1 Qershori”



Shpenzimet për mirëmbajtjen e pajisjeve teknike përfshijnë vlerën 49 mijë lekë. Në zërin "Qera objekti" vlera prej 360 mijë lekë e planifikuar është realizuar në vlerën 270 mijë lekë. Likujdimi i qerasë së çerdhes "10 Korriku" është bërë vetëm për 9 muaj pasi kjo çerdhe është mbyllur me dt. 30.09.2016 sepse ka rënë frekuentimi i fëmijëve për arsye të kushteve jo të mira. Kontigjenti i fëmijëve dhe personeli i kësaj çerdhe janë shpërndarë në tri çerdhet e tjera.

Në zërin "Investime" fondi planifikuar prej 530 mijë lekë është realizuar në vlerën 344 mijë lekë. Tek kjo vlerë përfshihet shuma prej 240 mijë lekë që është përdorur për të blerë pajisje (lavatriçe, pompë uji, boliera dhe soba për gatim) ndërsa vlera prej 104 mijë lekë është përdorur për të blerë pajisje zyre (kompjuter, karrige dhe vendosja e internetit).

#### F3.O1.A3 Shërbimi i kujdestarisë

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë së Shkodrës dhe organizatës "Save the Children", gjatë vitit 2016 është punuar për zbatimin e shërbimit të kujdestarisë si një mundësi më e mirë për fëmijët në situatë rreziku të institucionalizimit. Gjithashtu është punuar për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi mundësinë e ofrimit të shërbimit të kujdestarisë si një nga mënyrat më efektive për mirërritjen e fëmijëve të braktisur.

#### F4.O1.A1 Projekti "Shpresa" për personat e braktisur dhe me aftësi ndryshe

Bashkia Shkodër, gjatë vitit 2016, ka mbështetur projektin Shpresa, si një organizatë që ofron shërbim të përkujdesit social rezidencial të tipit shtëpi-familje. Aktualisht janë 7 shtëpi familje ku jetojnë 57 vajza dhe djem me aftësi ndryshe, të cilët përfitojnë shërbime të specializuara për riaftësimin dhe riintegrimin e tyre.

Për vitin 2016, është mundësuar pagesa për stafin kujdestar (24 punonjës), administratorin, psikologun klinik dhe infermierin, kuotën ushqimore dhe pagesën e energjisë elektrike.

#### F4.O1.A1 Asnjë fëmijë jashtë

Aktiviteti "Asnjë fëmijë jashtë" është një aktivitet social kulturor që organizohet nga Bashkia e Shkodrës në bashkëpunim me organizatën The Door. Protagonistë të këtij aktiviteti janë fëmijët e familjeve në vështirësi ekonomike dhe sociale dhe fëmijët me aftësi ndryshe, duke performuar në fusha të ndryshme si muzikë, recitim, kërcim, etj.

#### F4.O1.A3 Mbështetja e trupës muzikore të personave me aftësi të kufizuar

Me synim integrimin dhe përfshirjen aktive të personave me aftësi ndryshe, Bashkia e Shkodrës, në bashkëpunim me organizatën The Door, kanë mbështetur vazhdimin e aktiviteteve të Bandës Muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe ".

Gjatë vitit 2016, janë zhvilluar një sërë eventesh kulturore dhe artistike me pjesëmarrjen e kësaj bande.

### III Fondet e financimit të programeve

Buxheti i akorduar për këtë program ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të Programit të hartuar gjatë procesit të miratimit të Buxhetit të vitit 2016. Ky program konsiston në mbulimin sa më të plotë të territorit me shërbime sociale duke harmonizuar me nevojat dhe interesat e komunitetit.

Buxheti i akorduar në këtë program është në funksion të realizimit të politikës së programit. Politika buxhetore e këtij programi, ka si qëllim ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.

### Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2016

1.Fondet e miratuara për këtë program për aktivitetet e planifikuara nga Drejtoria e Shërbimeve sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik janë 1 026 153 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 1 019 181 mijë lekë që përbëjnë 99 % .

Nga këto fondet përshpenzime korrente sipas planit 2016 janë:

a. Paga dhe sigurime janë realizuar në masën 23 121 mijë lekë nga 27 180 mijë lekë që ka qenë e parashikuar dhe që përbën 85 %.

b.Shpenzime operative janë realizuar në masën 11 809 mijë lekë nga 14 283 mijë lekë që ka qenë e parashikuar dhe që përbën 83 %.

c. Transferta janë realizuar në masën 979 671 mijë lekë nga 979 852 mijë lekë që ka qenë e parashikuar dhe përbën 99 %.

d.Investime janë realizuar në masën 4 580 mijë lekë nga 4 838 mijë lekë që ka qenë e parashikuar dhe që përbën 95 %.

e. Fondi rezervë i parashikuar për shpërblimin e jetimeve në festat e fundvitit është në vlerën 352 mijë lekë dhe është realizuar 352 mijë lekë dhe përbën 100%.

### Fondet e rishikuara për këtë program:

Meqënëse fondi i parashikuar për Mirëmbajtjen e qendrave komunitare u vlerësua si i pamjaftueshëm në raport me nevojat e konstatuara për ndërhyrje, me Vendim nr. 752, datë 21.10.2016, të Kryetares së Bashkisë është miratuar rishpërndarja ndërmjet zërave të shpenzimeve dhe investimeve në P10F301A1 “Ngritja dhe vendosja në funksion e 5 qendrave komunitare“ me pakësim të investimeve në vlerën 175 000 lekë dhe shtesë në shpenzime në vlerën 175.000 lekë. Për projektin “Përmirësimi i kushteve të banimit të komunitetit rom dhe egjiptian” është planifikuar në vlerën 5,772 lekë dhe është realizuar në vlerën 3,836 lekë.

Me vendim nr. 51 datë 2.11.2016 është planifikuar Fondi rezervë “Për miratim fondi si ndihmë për jetimët për festat e fund vitit” në vlerën 352 lekë .

Për Çerdhet është miratuar me VKB nr.50 datë 2.11.2016shtim të fondit në vlerën 1,534 lekë në zërin e pagave dhe sigurimeve shoqëre.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.

Aktivitet/Projekte	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi
P10.F1.O1.A1 Përmirësimi i kushteve të banimit dhe kushteve sociale për komunitetin rom dhe egjiptian	5,772	3,838	3,836
P10.F1.O1.A2 Rikonstrukcion dhe përshtatje e ish	-	-	0.00

konviktit të shkollës pyjore, në banesa për personat e dalë nga institucionet e përkujdesit rezidencial

P10.F2.O2.A1. Përgatitja, përditësimi dhe botimi i Planit Social të Zonës dhe guidës së shërbimeve sociale	600	600	-
P10.F2.O2.A2.Trajtimi i qenve të rrugës	1,000	1,000	842
P10.F2.O1.A3 Hartimi dhe zbatimi i Planit lokal të Veprimit për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rrugë	336	336	297
P10.F2.O2.A4. Ndihma ekonomike dhe PAK	167,000	962,345	962,342
P10.F2.O2.A5. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare;	-	-	-
P10.F2.O2.A2. 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore; 25 nëntor – 10 dhjetor;	300	300	197
P10.F2.O2.A3. Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj	30	30	-
P10.F2.O2.A4. Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë	-	-	-
P10.F2.O3. A1. Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës;	-	-	-
P10.F2.O3. A2. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.	50	50	42
P10.F2.O3. A3. “Shkodra n’fest”	300	300	300
P10.F2.O3. A4. Dita ndërkombëtare e të moshuarve	-	-	-
P10.F2.O3. A5. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të “1 Dhjetorit”, ditës Botërore kundër Hiv Aids	-	-	-
P10.F2.O3. A6. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe, më 3 Dhjetor.	100	100	96
P10.F2.O3. A7. Dita ndërkombëtare kundër homofobisë	-	-	-
P10.F2.O3. A8. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi	153	153	-
P10.F2.O3. A9 Bashkëpunimi me Save the Children	-	-	-
P10.F2.O3. A10 Bashkëpunimi me Fondacionin “Shpresë për botën”, Shtëpinë e foshnjës dhe Shtëpinë e Fëmijës Shkollor”.	-	-	-
P10.F2.O4.A1. Lojra Popullore Fest, edicioni 9-të	209	209	132

P10.F2.O4.A2 Qendër multidisiplinare socio - mjekësore	-	-	-
P10.F2.O4.A3 Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian	-	-	-
P10.F2.O4.A4. Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit	-	352	352
P10.F3.O1.A1. Ngritja dhe vendosja në funksion e 5 Qendrave Sociale Komunitare “Për Familjen”	6448	6,448	2,811
P10.F3.O1. A2 Çerdhet	30,806	32,340	30,369
P10.F3.O1. A3. Shërbimi i Kujdestarisë Familjare	100	100	100
P10.F4.O1. A1. Projekti “Shpresa” për personat e braktisur dhe me aftësi ndryshe;	17,044	17,044	16,895
P10.F4.O1. A2. “Asnjë Fëmijë Jashtë”	266	266	235
P10.F4.O1. A3.Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe”	342	342	336
<b>Total</b>	<b>230,857</b>	<b>1,026,153</b>	<b>1,019,181</b>

#### **IV Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.**

Pavarësisht vështirësive të vitit të parë të krijimit dhe fillimit të aktiviteteve si Drejtori e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik realizimi i buxhetit është realizuar në përputhje me pritshmëritë.

Përgatitja e Planit Social të Zonës dhe e guidës së shërbimeve sociale pavarësisht punës së madhe disa mujore që u zhvillua deri në përgatitjen e draftit nuk u arrit në botimin e tij. Procesi i përgatitjes ishte i gjatë dhe u realizua me pjesëmarrjen e shumë aktorëve, si OJF, institucione publike dhe private të fushës sociale, të shëndetsisë, të arsimit, grupeve komunitare, individë, etj,, të cilët jo gjithmonë ishin aktiv dhe të motivuar në kohën e mënyrën e duhur.

Mos realizimi i buxhetit të parashikuar për Ditën ndërkombëtare të Gruas dhe Ditën ndërkombëtare për Familjen 15 maj, nuk u realizua pasi Buxheti i vitit 2016 është aprovuar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak në fund të prillit 2016.

Ndërsa mos realizimi i plotë i projektit “Ngritja dhe vendosja në funksion e 5 qendrave komunitare” ka qenë për arsye të mos plotësimit në kohë të stafit që punojnë në këto qendra, për pasojë nuk është realizuar zëri paga dhe sigurime.

Mos realizimi i zërit të shpenzimeve “Transport” të parashikuar tek aktiviteti “Hartimi dhe zbatimi i Planit Lokal për fëmijët në situatë rruge ka qenë për arsye se shpenzimi i parashikuar për këtë zë është realizuar nga fondi i përgjithshëm i Bashkisë.

## **P11 Kultura dhe shërbimet rekreacionale**

Shkodra, me konfigurimin e ri administrativ, shndërrohet në territorin më të volitshëm për zhvillimin e kulturës, duke u kthyer në një pikë reference të tërheqjes së vizitorëve vendas dhe të huaj. Pjesë e strategjisë zhvillimore do të bëhen të gjithë ato vlera të trashëgimisë kulturore e natyrore që përbëjnë potencialin kryesor për zhvillimin e turizmit kulturor. Kjo trashëgimi kulturore e vendosur në një pozitë të favorshme gjeografike, me shtrirje nga Alpet deri në bregdet, do të bëhet faktor kyç për rritjen e mirëqenies ekonomike të qytetarëve.

Njëqind e dyzet e dy monumente kulture janë sot të përfshira në hartën e re administrative territoriale të Bashkisë së Shkodrës. Programi ynë synon fuqizimin e strukturës administrative dhe mirë organizimin e institucioneve aktuale të kulturës së Bashkisë. Një nga kolonat kryesore të programit ka qene rivitalizimi i institucioneve aktuale të kulturës. Shkodra ka afirmuar vlera të patjetërsueshme në art dhe kulturë, me të cilat ajo merr kuptim. Këto vlera kanë një vend të rëndësishëm në jetën e secilit prej nesh. Pjesë e programit ka qene mbështetësja dhe nxitësja e zhvillimit të jetës kulturore dhe artistike, nëpërmjet institucioneve dhe enteve lokale.

Pikënisja e programit tonë është mirë menaxhimi dhe administrimi i institucioneve kulturore-artistike, asetëve të trashëgimisë kulturore, duke risjellë në vëmendjen e vizitorëve vlerat dhe pasuritë që disponohen, ndër më të pasurat në vendin tonë si në sektorin arkeologjik, etnografik, historik, të fotografisë, muzikës, teatrit etj. Si dhe ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të zonave të ndryshme të territorit të Bashkisë së Shkodrës.

Muzika folklorike dhe qytetare shkodrane, promovimi dhe organizimi i festivaleve të përvitshme dhe aktivitetet kulturore kanë pasuruar traditën muzikore të qytetit me kompozime dhe shfaqje të reja duke gjallëruar jetën artistike në Shkodër. Kemi synuar promovimin e formave alternative të administrimit dhe marketingut të arteve pamore dhe institucioneve të tjera kulturore në Shkodër pjesë e rrjetit muzeve dhe institucioneve kulturore për t'u vizituar. Zbulimin dhe zhvillimin e talenteve në fushën e artit, sportit, si dhe edukimi dhe përcimi i vlerave kulturore dhe sportive ka qene një nga politikat e programit.

Bashkia e Shkodrës, Drejtoria e Kulturës bashkë me Bibliotekën Marin Barleti, ka mbështetur në fuqizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve mbështetëse dhe promovuese për librin dhe lexuesit e tij me synimin e ndërthurjes së politikave vendore dhe strategjive ndërkombëtare për bibliotekat publike.

### **I Përshkrimi i funksioneve dhe i objektivave**

Drejtoria jonë me qëllim kryesorë atë të zhvillimit të sektorit të kulturës, në zbatim të kuadrit ligjor, synon në mbulimin e këtyre funksioneve kryesore:

F1. Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

F2. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar dhe lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

F3. Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i bibliotekave dhe ambienteve për lexim me qëllimin e edukimit të përgjithshëm të qytetarëve.

Objektivat për secilin funksion janë:



- F1.O1. Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimise kulturore dhe mirë administrimi e fuqizimi i institucioneve menaxhuese.
- F2.O1.Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë së Shkodrës.
- F2.O2. Pasurimi dhe gjallërimi i jetës kulturore nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve artistike dhe kulturore përgjatë gjithë vitit.
- F3.O1. Promovimi dhe nxitja e leximit si instrument edukimi duke rritur aksesin dhe cilësinë e shërbimit pranë Bibliotekës “Marin Barleti”.
- F3.O2. Ruajtja, mirë administrimi dhe pasurimi i fondit të Bibliotekës “Marin Barleti”.

## **II Produktet për vitin 2016**

Gjatë vitit 2016, për realizimin e funksioneve dhe objektivave përkatës të mësipërm, drejtoria e jonë ka realizuar produktet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme, të parashikuara në Buxhetin 2016 të Bashkisë Shkodër për programin e Kulturës.

### **F1.O1. A1. Ekspozitë "Shkodra gjatë luftës së parë botërore"**

Realizimi i kësaj ekspozite, e cila u hap me datën 25 nëntor 2016 në ambjentet e Muzeut Historik dhe qëndroi e hapur deri në datën 2 dhjetor 2016, pati një impakt shumë pozitiv tek pjesëmarrësit. Ekspozita përbëhej nga materiale të ndryshme të kohës si dokumente, vepra arti, relike, fotografi etj. të cilat janë pjesë e fondit të arkivit të këtij Muzeu.

Njohja me fakte të reja, të papublikuara më parë në lidhje me zhvillimet e Luftës së Parë Botërore në qytetin e Shkodrës, nxitu interesin e vizitorëve për të njohur një anë tjetër të historisë. Ekspozita me nëntitull “Shkodra ndërtohej, kur bota shkatërrohej” solli një panoramë krejt të panjohur të zhvillimeve të brendshme në Shkodër, ku evidentohej etja e qytetarëve për një shtet modern dhe shoqëri europiane.

### **F1.O1. A2. Prodhim dhe shtypje biletash**

Prodhimi dhe shtypja e biletave për rrjetin e Muzeve të Bashkisë Shkodër, e cila u realizua tek “Shtypshkronja e Letrave me vlerë”, është një proces i përvitshëm, i cili shërben së pari për shërbimin korrekt dhe transparent të këtyre institucioneve ndaj qytetarit dhe së dyti përmbush detyrimin ligjor, të parashikuar në nenin 14 të ligjit nr.9386, datë 04.05.2005 “Për Muzetë” dhe të miratuar nga Këshilli Bashkiak, Shkodër në Paketën Fiskale të Bashkisë Shkodër në programin II.4.7 “Tarifa shërbimi nga institucione arsimit, kulture, sporti, shërbimi social etj.”

### **F1.O1. A3. Përmirësimi i dukshmërisë së sallave ekspozuese të Muzeut të Kështjellës**

Në bazë të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 25 “Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese”, Bashkia Shkodër këtë vit ka kryer disa investime në përmirësimin dhe ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore. Problematika e krijuar tek Muzeu i Kështjellës, si pasojë e lagështirës, bëri të domosdoshëm ndërhyrjen nga ana jonë edhe këtë vit. Lyerja e mureve të këtij Muzeu me gëlqere është nevojë e përvitshme, në mënyrë që të minimizohen pasojat që sjell lagështira. Gjithashtu, lyerja me vaj lini e dyshemesë, të përbërë prej dërrasash, është domosdoshmëri për jetëgjatësinë e tyre. Këtë vit u realizuan edhe riparime të vogla të suvasë në muret e brendshme të këtij Muzeu.

### **F1.O1. A5. Administrimi ruajtja e mirëmbajtja e arkivit të Muzeut**

Arkivi i Muzeut Historik (Banesa “Oso Kuka”), është ndër arkivët muzeal më të pasur në rang kombëtar, përse i përket dokumentave, relikeve e materialeve të ndryshme. Situata e konservimit të këtyre materialeve prej vitesh kishte degraduar dhe për pasojë, ishte i domosdoshëm investimi. Në

bazë të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", këtë vit Banesa "Oso Kuka", u pajis me 14 dollapë metalik arkivorë, të madhësive të ndryshme, sipas standartit muzeal.

#### F1.O1.A7. Hostim dhe mirëmbajtje e faqes web të Muzeut Historik

Promovimi dhe krijimi i kushteve bashkëkohore për aksesimin nga një numër sa më i madh njerëzish, brenda dhe jashtë vendit, të fondeve dhe ekspozitave të ndryshme të Muzeut Historik, është i domosdoshëm. Faqja zyrtare e Muzeut Historik që prej krijimit të saj në vitin 2015, ka ndikuar pozitivisht në rritjen e numrit të vizitorëve pranë këtij Muzeu, gjithashtu ka dhënë një kontribut të mirë në promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore që ka qyteti ynë. Ndaj çdo vit, është e rëndësishme që kjo faqe të përmirësohet dhe të pasurohet me materiale të reja.

#### F1.O1.A9. Konkurs për Logon e Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës

"Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës", i hapur në shtator të vitit 2014, nuk kishte ende një logo zyrtare, me të cilën të përfaqësohej në aktivitete të ndryshme. Krijimi i një logoje zyrtare për këtë institucion, ishte domosdoshmëri për promovimin e këtij muzeu, unik në llojin e vet. Mbas konkursit të shpallur, nga një grup ekspertë të fushës, u zgjodh dizenoja më e mirë dhe tashmë "Vendi i Dëshmirë dhe Kujtesës" paraqitet në mënyrë dinjitoze në aktivitetet e ndryshme.

#### F1.O1.A10. Përmirësimi i sistemit të ruajtjes kundra zjarrit

Në bazë të ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", neni 25 "Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese"; ligjit nr.9386, datë 04.05.2005 "Për Muzetë", neni 13 "Detyrimi për sigurimin e muzeut", këtë vit "Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës" u pajis për herë të parë me bombula fikëse zjarri.

#### F1.O1.A11. Blerje të vogla

Në kuadër të përmirësimit të punës të administratës së "Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës", këtë vit u blenë kasaforta, e cila shërben për grumbullimin e të ardhurave që vijnë nga vizitorët si dhe materiale të tjera të vogla që rritin cilësinë e shërbimit pranë këtij Muzeu.

#### F1.O1.A12. Blerje pajisje zyre

Në kuadër të përmirësimit të punës të administratës së "Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës", këtë vit u blenë kompiuter dhe fotokopje-printer-skaner, pajisje të domosdoshme për mirëfunksionimin e punës së përditshme në këtë muze.

#### F1.O1. A13. Ndriçimi i galerisë me dritë artificiale

Në bazë të ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", neni 25 "Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese", Bashkia Shkodër këtë vit ka kryer disa investime në përmirësimin dhe ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore. Kështu, në "Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës" për herë të parë u investua në pjesën e quajtur "Galeria" që lidh pjesën hyrëse të ndërtesës me zonën e qelive, e cila deri më tani ndriçohej vetëm me dritë natyrale, duke kufizuar aksesin për vizitorët në orët e pasdites. Investimi i kryer në pajisjen me ndriçim artificial në zonën e quajtur "Galeria", i ka dhënë mundësi "Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës" të ketë shërbim më të mirë ndaj vizitorit, edhe në orët e vona.

#### F1.O1. A14. Rafta për ruajtjen e objekteve dhe dokumentave

Në bazë të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, "Për Arkivat", këtë vit u investua nga Bashkia Shkodër në "Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës". Arkivi i "Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës" çdo vit sa vjen e pasurohet, ndaj është i domosdoshëm konservimi i këtyre materialeve në bazë të standarteve ligjore.

Këtë vit “Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës”, u pajis me dollapë metalik arkivorë, sipas standartit muzeal.

#### F1.O1. A15. Rinovimi i ekspozitës fotografike me materiale të reja

Në “Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës” në njërin nga hapësirat e ekspozimit, në momentin e ndërtimit të kësaj hapësire, nuk janë respektuar kriteret muzeologjike për ndërtimin e ekspozitave. Këtë vit u realizua riorganizimi i kësaj hapësire ekspozuese, me materiale të reja fotografike-historike, duke respektuar standartet muzeologjike.

#### F1.O1. A16. Shërbim i ruajtjes së objektit

Në bazë të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 25 “Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese”; ligjit nr.9386, datë 04.05.2005 “Për Muzetë”, neni 13 “Detyrimi për sigurimin e muzeut”, këtë vit u realizua shërbimi “Ruajtje objekti me sinjal alarmi” për “Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës”.

#### F1.O1.A17. Instalim i sistemit të kamerave të sigurisë në hapësirat e brendshme të muzeut të Dëshmisë dhe Kujtesës

Në bazë të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 25 “Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese”; ligjit nr.9386, datë 04.05.2005 “Për Muzetë”, neni 13 “Detyrimi për sigurimin e muzeut”, këtë vit për herë të parë u instaluan kamerat e sigurisë në çdo ambient të “Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës”.

#### F1.O1.A18. Blerje pajisjesh teknike për zyrë dhe aktivitete artistike

Në kuadër të përmirësimit të punës të administratës së Galerisë së Arteve, këtë vit u blenë kompiuter - laptop dhe projektor, pajisje të domosdoshme për mirëfunksionimin e punës së përditshme dhe cilësinë e aktiviteteve të ndryshme artistike që zhvillohen në Galeri.

#### F1.O1.A19. Shërbimi i ruajtjes së objektit Galerisë së Arteve me Shoqëri Private të Ruajtjes dhe Sigurisë fizike

Në bazë të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 25 “Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese”; ligjit nr.9386, datë 04.05.2005 “Për Muzetë”, neni 13 “Detyrimi për sigurimin e muzeut”, këtë vit u realizuan shërbimet “Vendosje sistem kamerash” dhe “Ruajtje objekti me shoqëri private e ruajtjes fizike të objekteve”.

#### F1.O1.A20. Përmirësimi i kushteve teknike të ambienteve të ruajtjes të koleksionit të Galerisë së Arteve Shkodër

Në bazë të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 25 “Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese”; këtë vit u investua në përmirësimin e kushteve teknike të ruajtjes së koleksioneve të Galerisë së Arteve, duke përbushur kështu detyrimet ligjore të konservimit të vlerave të trashëgimisë kulturore. Këtë vit në Galerinë e Arteve u përmirësua dukshëm sistemi i Aspirim-Kondicionimit si dhe në bazë të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”, Galeria e Arteve u pajis me 6 rafta metalik për ruajtjen e koleksioneve, sipas standarteve muzeale.

#### F1.O1.A21. Shërbimi i ndriçimit të Galerisë së Arteve

Në kuadër të sigurimit të kushteve normale të punës në ambientet e Galerisë së Arteve për administratën si dhe rritjen e parametrave për ndriçimin në sallat e ekspozimit gjatë zhvillimit të aktiviteteve, këtë vit u realizua shërbimi i ndriçimit në ambientet e brendshme të Galerisë së Arteve.



#### F1.O1.A22. Shpenzime për hostim dhe mirëmbajtje të faqes web

Promovimi në kushte bashkëkohore i Galerisë së Arteve, përmes faqes zyrtare të saj, është një mjet i domosdoshëm për afrimin e publikut dhe njohjen e saj edhe jashtë territorit të Shqipërisë. Faqja zyrtare e Galerisë së Arteve që prej krijimit të saj, ka ndikuar pozitivisht jo vetëm në rritjen e numrit të vizitorëve, por edhe në lidhjen dhe bashkëpunimin e ndërsjellë me artistë ndërkombëtarë. Ndaj çdo vit, është e rëndësishme që kjo faqe të përmirësohet dhe të pasurohet me materiale të reja.

#### F1.O1.A23. Mobilimi me orendi për mjediset e Galerisë së Arteve Shkodër

Në kuadër të përmirësimit të punës të administratës së “Galerisë së Arteve”, këtë vit u investua në orendi zyre (rafte), të cilat shërbejnë për depozitimin e dosjeve të punës, dokumentacionit, letërkëmbimeve etj.

#### F1.O1.A24. Zhvillimi i disa projekteve edukative me gjimnazet e qytetit

Në kuadër të përcjelljes së historisë, ashtu siç ajo ka ndodhur, tek brezat e rinj, “Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës” organizoi disa aktivitete me nxënës të shkollave të mesme të Bashkisë Shkodër, me tematikë “diktaturën komuniste”. Ky aktivitet u trajtua në një formë të veçantë, duke i vënë nxënësit në kushte pune kërkimore dhe qëllimi final ishte dhënia e mundësisë brezave të rinj të rivlerësojnë drejtë disa aspekte të historisë së diktaturës. Këto aktivitete u zhvilluan me nxënësit e katër shkollave të qytetit: “28 nëntori”, “Pjetër Meshkalla”, “Jordan Misja” dhe “Maria Ndihmëtare”.

#### F1.O1.A25. Ekspozitë fotografike “Shkodra në diktaturën komuniste: personazhe dhe fakte”

Kjo ekspozitë u hap në kuadër të “Javës së Pavarësisë”, organizuar nga Bashkia Shkodër, me datë 24 nëntor dhe qëndroi e hapur për dy javë rresht në ambjentet e “Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës”. Aty u evidentuan ngjarje dhe personazhe të lidhura me persekutimin komunist në qytetin e Shkodrës. Qëllimi i ndërgjegjësimit të brezave të rinj me të kaluarën, u realizua në një masë të kënaqshme, duke patur parasysh numrin e të rinjve që vizituan këtë ekspozitë gjatë të gjitha ditëve. Numri i vizitorëve ishte përafërsisht 320 persona.

#### F1.O1.A26. Ekspozitë fotografike “Shkodra në Vitet ‘90”

Në qershor në “Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës” u hap ekspozita fotografike me temë “Shkodra në vitet ‘90”, e cila qëndroi e hapur gjatë gjithë muajit. Në këtë ekspozitë u shfaqën foto historike të rralla, të cilat dëshmojnë ndryshimet radikale që pësoi Shkodra dhe Shqipëria në ato vite, të fokusuara nga fotografë profesionistë dhe amator. Ekspozita shfaqti interes tek publiku.

#### F1.O1.A27. Dita Ndërkombëtare e Muzeumeve

18 maji është shpalluar si “Dita ndërkombëtare e muzeumeve”. Në këtë kuadër edhe Shkodra i është bashkuar festimeve të kësaj dite, në të gjithë rrjetin muzeor të Bashkisë Shkodër. Banesa “Oso Kuka”, Muzeu i Kështjellës dhe “Vendi i dëshmisë dhe Kujtesës”, këtë ditë hapën dyert falas për vizitorët.

Në Banesën “Oso Kuka” u zhvillua edhe aktiviteti pedagogjiko-edukativ, i cili konsistoi në përfshirjen e të rinjve (nxënës dhe student) në sensibilizimin për ruatjen e vlerave të trashëgimisë kulturore. Të rinjtë pjesëmarrës në këtë aktivitet, gjatë gjithë ditës morën leksione mbi historinë dhe mënyrën e ruajtjes dhe mirëmbajtjes të objekteve, të cilat ndodhen nën ndikimin e faktorëve atmosferik. Në mënyrë aktive, të drejtuar nga profesionistë të fushës, të rinjtë morën pjesë në pastrimin dhe teknikat e mirëmbajtjes përmes mjeteve profesionale të objekteve të trashëgimisë kulturore që janë pjesë e Banesës “Oso Kuka”.

#### F1.O1.A28. Ekspozita "Salloni i vjeshtës"

Ekspozita e arteve pamore, e cila zhvillohet çdo vit në Galerinë e Arteve, "Salloni i vjeshtës", u hap me datën 26 nëntor 2016 dhe qëndroi e hapur për një muaj. Ky është një konkurs mes artistëve që aplikojnë artet pamore dhe këtë vit u shpall fitues piktori shkodran Andi Hila. Këtë vit "Salloni i vjeshtës" shënoi edicionin e 10-të të tij. Pjesëmarrja e vizitorëve ishte e lartë, 900-1000 vetë gjatë një muaji.

#### F1.O1.A29. Ekspozita personale e fituesit të "Çmimit Idromeno 2015", Lek Gjeloshi

Ekspozita e titulluar "Off-cells", e artistit Lek Gjeloshi, u hap me datën 9 shtator dhe qëndroi e hapur deri në datën 29 shtator në Galerinë e Arteve. Natyra e kësaj ekspozite ishte e karakterit modern. Pjesëmarrja e vizitorëve ishte afërsisht 500 vetë.

#### F1.O1. A30. "Personazh i ftuar"- Ekspozitë personale e një personaliteti të spikatur të artit pamor shqiptar të ftuar nga Galeria e Arteve e Shkodrës

Si çdo vit, Galeria e Arteve, Shkodër, zgjedh një personalitet të artit pamor, si të ftuar të veçantë. Këtë vit u zgjodh piktori i njohur Edi Hila, i cili erdhi me ekspozitën e tij personale të titulluar "Prani e munguar" në datat 1 nëntor deri më 15 nëntor 2016. Ekspozita pati interes tek publiku dhe numëroi afërsisht 500 vizitorë.

#### F1.O1. A31. Takimet publike -bisedat publike mbi artin dhe ëorkshop me artistë të rinj

Takimet publike, bisedat e hapura për publikun për temat e artit dhe ëorkshopet me artistë të rinj zënë një vend të rëndësishëm në axhendën e Galerisë së Arteve. Ato u zhvilluan të ndara në tre të premtë, konkretisht në datat 20 dhe 27 maj dhe 3 qershor 2016 në ambjentet e Galerisë së Arteve. I ftuari i parë në "Programi i bisedave për artin" ishte Zef Paci, i cili mbajti një leksion të hapur me temë "Fotografia shqiptare në periudhën 1970-2000". Në këtë takim ishin të pranishëm rreth 50 persona.

I ftuari i dytë, i datës 27 maj ishte Alket Frashëri, i cili mbajti leksionin mbi "Trashëgiminë e Revolucionit të përhershëm dhe epokës së riprodhimit teknik në metamorfozën e veprës së artit dhe artistit".

Takimi i tretë i "Programit të bisedave për artin" u mbajt në datën 3 qershor dhe e ftuar ishte Suzana V. Kuka, e cila mbajti leksionin e hapur me temë "Arti është gjurma e kalimit tonë mbi këtë tokë".

#### F1.O1.A32. Aktivitete në partneritet me subjekte kulturore të tretë

Aktivitetet në bashkëpunim me të tretët, këtë vit, ishin një risi për Galerinë e Arteve Shkodër. Në këtë kuadër Bashkia Shkodër, përmes Galerisë së Arteve, mbështeti financiarisht realizimin e tre takimeve të "Art House Shkodër" me artistët dhe studiueset ndërkombëtare të artit. Në datën 8 shtator erdhi në Shkodër artistja norvegjeze Cecilie Hjelvik Andersen, e cila mbajti një leksion mbi artin në ambjentet e "Art House" në orën 19:00.

Takimi i dytë u zhvillua në datën 18 shtator, ku e ftuar ishte Mary Spirito, e cila është drejtoreshë e "Alt", një hapësirë e re ekspozimi në Stamboll. Ajo është gjithashtu drejtoreshë themeluese dhe kuratore e organizatës artistike "Protocinema", e cila përgatit ekspozita në qytete të ndryshme të botës.

Takimi i tretë u mbajt në datën 7 tetor, në orën 19:00, ku ishte e ftuar për të mbajtur njëbisedë mbi "performancën si gjuhë që bashkon teatrin me artet vizive" Caterina Iaquina, e cila është profesoreshë në NABA (Nuova Accademia di Belle Arti) dhe në Universitetin "Cattolica" në Milano.

#### F2.O1.A3. Orkestra Frymore Honorare vjetore

Formacioni i Orkestrës Frymore është një nga vlerat e veçanta artistike unike që ka qyteti ynë, me fillimet e hershme që nga viti 1876. Bashkia Shkodër e mbështet çdo vit me honorare këtë formacion, i cili gjatë gjithë vitit është prezent në pothuajse të gjitha aktivitetet artisko-kulturore si dhe në datat e rëndësishme historike zyrtare kombëtare dhe lokale. Formacioni i Orkestrës Frymore të Bashkisë Shkodër, përbëhet prej 40 muzikantëve.

#### F2.O1.A4. Mobilim për Qendrën Kulturore “Pjetër Gaci”

Në kuadër të përmirësimit të punës të administratës dhe ambjenteve të punës në Qendrën Kulturore “Pjetër Gaci”, këtë vit u realizua projekti i mobilimit, i cili konsiston në raftet për garderobën, e cila përbëhet nga veshje të rralla të etnografisë tonë kombëtare, të cilat përdoren nga grupet artistike të atashuara pranë kësaj qendre; raftet për arkivë, të cilat shërbejnë për sistemimin e dokumentave dhe veprave muzikore; orendi zyre, të cilat shërbejnë për depozitimin e dosjeve të punës, dokumentacionit, letërkëmbimeve etj. si dhe u investua në sistemimin e sallës së provave të grupeve të ndryshme artistike.

#### F2.O1.A5. Pajisje Teknike Zyre për Qendrën Kulturore “Pjetër Gaci” (kompjuter dhe printer)

Në kuadër të përmirësimit të punës të administratës së Qendrës Kulturore “Pjetër Gaci”, këtë vit u blenë kompiuter dhe printer A3 A4, pajisje të domosdoshme për mirëfunksionimin e punës së përditshme në këtë qendër.

#### F2.O1.A6. Krijimi dhe Mirëmbajtja e Faqes web

Për herë të parë Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” krijoi faqen e saj zyrtare web, e cila i shërben asaj në përmirësimin e performancës së punës si dhe prezantimin dinjitoz të aktiviteteve që ajo realizon në një rreth më të gjërë njerëzish.

#### F2.O1.A7. Përmirësim i kushteve të punës për aktorët, për pritjet e të ftuarve dhe blerje paisje teknike

Këtë vit, pas shumë vitesh mungese të investimeve serioze në Teatrin “Migjeni”, nga Bashkia Shkodër u realizuan një sërë investimesh, të cilat ndikojnë vetëm në përmirësimin e kushteve të punës për administratën dhe aktorët e Teatrit “Migjeni”, por edhe prezantimin dinjitoz të ambjenteve të këtij teatri për publikun. Kjo fishe konsiston në realizimin e mobilimit të 10 dhomave të aktorëve; mobilimi i dy dhomave për të ftuarit; Blerje e pajisjeve teknike profesionale, të cilat shërbejnë për realizimin me efekte speciale të shfaqjeve që zhvillohen në Teatër.

#### F2.O1.A9. Administrimi dhe Menaxhimi i Teatrit “Migjeni”

Institucioni i Teatrit “Migjeni” është një institucion varësie i Bashkisë Shkodër. Struktura e tij përbëhet prej 38 personash. Kjo fishe ka të bëjë me pagat dhe sigurimet shoqërore për të gjithë personelin e punësuar pranë Teatrit “Migjeni”.

#### F2.O1.A10. Shërbime nga të tretë për furnizimin me energji, ujë, etj.

Shërbimet nga të tretë si energji, ujë etj. janë shërbime që financohen nga Bashkia Shkodër çdo vit, të cilat janë të domosdoshme për mirëfunksionimin e Teatrit “Migjeni”.

#### F2.O1.A11. Shërbime administrative për Teatrin “Migjeni”

Kjo fishe e realizuar konsiston në administrimin e aktivitetit të përditshëm të Teatrit “Migjeni”, siç janë pritje-përcjelljet, të nevojshme për aktivitete të ndryshme; siguracioni i ndërtesës së Teatrit “Migjeni”, i cili është detyrim ligjor; pjesëmarrje në konferenca të ndryshme.

#### F2.O1.A12. Shërbime mbështetëse transporti për aktivitete artistike

Trupat artistike të atashuara pranë Teatrit “Migjeni” shpesh herë ftohen të marrin pjesë në aktivitete apo konkurse të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. Në shumicën e rasteve, këto trupa kthehen me çmime të fituara me meritë nga këto aktivitete. Bashkia Shkodër e nxit dhe e mbështet çdo vit Teatrin “Migjeni” për të qenë pjesë e këtyre aktiviteteve.

#### F2.O2.A1. Dita e Luleve 6 Maj

Këtë vit aktiviteti “Dita e luleve” kishte 10 vjetorin e tij dhe në këtë përvjetor u vendos të zhvillohej në 2 ditë me radhë. Ai u zhvillua në datat 6 dhe 7 maj 2016. Në të morën pjesë shumë trupa artistike, duke filluar nga kopshtet, shkollat 9 vjeçare dhe të mesme të territorit të Bashkisë Shkodër, të cilat u organizuan në parada të ndryshme me tematikë “lulet”. Dita e luleve u realizua në tre ambjente të ndryshme të qytetit a) Sheshi para Bashkisë Shkodër, b) sheshi para ish-kafes së madhe dhe c) sheshi “Nënë Tereza”. Në dy ditë u organizuan shfaqje të ndryshme artistike, koncerte për fëmijë, aktivitete të vogla artistike me kërcime si dhe në mbyllje Koncerti i madh festiv. Ky aktivitet ka marrë përmasa të gjëra dhe është kthyer në traditë në qytetin e Shkodrës.

#### F2.O2.A2. Ndërmendje

Koncerti i fundvitit i quajtur “Ndërmendje”, është kthyer në traditë tashmë në qytetin e Shkodrës. Këtë vit “Ndërmendje 2016” u mbajt në datën 30 dhjetor në Teatrin “Migjeni”, në orën 18:00. “Ndërmendje” është njëkoncert i madh festiv, me karakter klasik. Këtë vit ai u realizua nga Shoqata kulturore-artistike “Prenkë Jakova”, i cili u shpall si projekti më i mirë nga Këshilli Artistik Kulturor i Bashkisë Shkodër. Formacionet orkestrale të zgjedhur për të realizuar “Ndërmendje 2016” ishin të përbërë nga tre asamble me rreth 120 artistë, të cilët ndaheshin në: a) Formacioni i harqeve të Universitetit të Arteve, Tiranë, në bashkëpunim me instrumentistët më të mirë të qytetit tonë, b) Orkestra Frymore e Bashkisë Shkodër dhe c) Kori polifonik “Prenkë Jakova”. Programi i zgjedhur për këtë vit mbështetej në literaturën e muzikës klasike botërore dhe shqiptare dhe të ftuar special ishin Mariana Leka (soprano e Teatrit të Operas dhe Baletit), Dorina Garuci dhe Lorenc Radovani.

#### F2.O2.A4. Festivali i muzikës moderne

“Festivali i muzikës moderne”, shënoi këtë vit edicionin e tij të 5-të. I mbajtur nëdatat 11 dhe 12 qershor 2016, ai u zhvillua në sheshin “Nënë Tereza” në datën 11 dhe në Teatrin “Migjeni” në datën 12. Ky festival është i orientuar drejt muzikës moderne dhe këtë vit ishin të ftuar grupe të ndryshme nga Shqipëria dhe jashtë saj si dhe në mbyllje ishte e ftuar “Big-band” frymorë i qytetit, i drejtuar nga Gjon Shllaku.

#### F2.O2.A6. Aktivitete me rastin e 2 Prillit

“2 prilli” është një aktivitet përkujtimor, i cili organizohet çdo vit nga Bashkia Shkodër, në përkujtim të 4 Dëshmorëve të Demokracisë, Arben Broci, Bujar Bishanaku, Besnik Ceka dhe Nazmi Kryeziu. Aktiviteti këtë vit filloi në orën 10:00 në sheshin para Memorialit “2 prilli” me vendosjen e kurorave nga të pranishmit pranë këtij memoriali, për të vazhduar më pas me aktivitetin përkujtimor artistik të zhvilluar në sallën e Teatrit “Migjeni” nga aktorët e këtij teatri.

#### F2.O2.A7. “Shkodra Jazz Festival”

“Shkodra Jazz Festival” u rikthye këtë vit, pas 6 vitesh mungesë, në edicionin e tij të 7-të. Projekti i paraqitur nga “Acli-Ipsia”, nën titullin “Markelian Kapidani” dhe i drejtuar nga Florian Jakaj, u shpall fitues nga Këshilli Artistik i Bashkisë Shkodër. “Shkodra Jazz Festival” u mbajt në datat 8-9-10 dhjetor 2016. Ky edicion, i dedikuar pianistit shkodran Markelian Kapidani, solli në Shkodër jo vetëm pianistin, por edhe artistë të tjerë ndërkombëtarë, të cilët shoqëruan Kapidanin në performancat e tij. Aktivitetet u zhvilluan të ndarë nëdisa takime.

Në datën 8 dhjetor, në orën 18:00, u zhvillua komunikimi me mediat dhe qytetarët në ambientet e Kinema “Millenium”, ku organizatorët prezantuan projektin e këtij edicioni të “Shkodra Jazz Festival”

Në datën 9 dhjetor, në orën 10:30 u mbajt njëkoncert/masterclass i hapur mbi temat “shpjegimi mbi dinamikat dhe si ndërtohen pjesët e shkruara nga Kapidani; lidhja me muzikën jazz dhe format e interpretimit të tij sipas ritmeve të ndryshme” për nxënësit e shkollës artistike “Prenkë Jakova”, i cili u zhvillua në sallën e koncerteve “Gjon Kapidani” të kësaj shkolle. Ndërsa mbasditen e të njëjtës ditë, në hollin e Teatrit “Migjeni”, pianisti Markelian Kapidani mbajti koncert recital.

Në datën 10 dhjetor, në orën 18:00 u zhvillua koncerti i Markelian Kapidanit dhe miqve të ftuar,

Përveç anës artistike, edicioni i shtatë i “Shkodra Jazz Festival”, kishte përfshirë si pjesë të saj edhe projektin e artistit ndërkombëtar, Davi Lamastra, i cili po punon mbi veprën e artit në progres të titulluar “Requiem 4 Mariposas<sup>3</sup>”, kushtuar sensibilizimit kundër dhunës ndaj grave. Shkodra Jazz Festival është një aktivitet i cili garanton sukses, duke parë emrat e mëdhenj të muzikës jazz që kanë performuar në Shkodër gjatë të gjithë edicioneve. Edhe këtë vit ky aktivitet pati sukses tek publiku.

#### F2.O2.A8. Karnavalet

Karnavalet në qytetin e Shkodrës janë rikthyer tashmë në një traditë të përvitshme, të mbështetura nga Bashkia Shkodër. Në ndryshim nga vitet e tjera, këtë vit, Karnavalet ju rikthyen traditës të festimit të tyre sipas tipologjisë tipike shkodrane. Kështu, u rikthye tradita e karvanit, i cili shëtit nëpër të gjithë qytetin, duke u ndalur herë pas herë për të dhënë shfaqje, të cilat mbartin sarkazmën e njohur të humorit shkodran, i cili thimbon fenomenet negative të shoqërisë. Karnavale 2016 u mbajtën në datat 4 shkurt deri më 8 shkurt 2016 dhe përfshinë një numër shumë të madh të trupave artistike, duke filluar nga organizimi i shkollave 9 vjeçare dhe të mesme, për të vazhduar më tej me grupet artistike të organizatave të ndryshme të ftuara për të qenë pjesë e këtyre festimeve.

#### F2.O2.A9. Koncertet e verës

Projekti i paraqitur nga “Code Partners”, i cili u shpall fitue nga Këshilli Artistiko-kulturor i Bashkisë Shkodër, realizoi projektin “Koncertet e verës”. Koncertet u mbajtën në ndarë në tre të hëna, në datat 1/8/15 gusht 2016.

Koncerti i parë, i datës 1 gusht, ishte konceptuar si koncert me muzikë rock dhe të ftuar ishin këngëtarë të ndryshëm, si Rezarta Smaja, Ylber Tahiri, Laorjan Ejlli etj. Koncerti u mbajt në sheshin “Nënë Tereza” në orën 19:00 dhe pati një pjesëmarrje të gjërë të publikut.

Koncerti i dytë, i datës 8 gusht, u zhvillua në oborrin e Muzeut Historik Shkodër, ku të ftuar ishin kuarteti i harqeve “StrinGirls”. Koncerti ishte i karakterit klasik dhe zgjati rreth dy orë. Edhe këtu pjesëmarrja e publikut ishte e madhe.

Koncerti i tretë u zhvillua në pedonalen “Gjuhador”, në datën 15 gusht dhe kishte karakter të ritmeve latine, ku të ftuar ishin grupi “B4and” dhe këngëtari Laorjan Ejlli. Këto koncerte i dhanë prioritet promovimit të të rinjve dhe arritën të kenë sukses tek publiku.

#### F2.O2.A10. Aktivitetet e fundvitit

Aktivitetet e fundvitit konsistojnë në ngritjen e një tregu festiv në qendër të qytetit, në të cilin organizohen aktivitete artistike çdo vit. Ky ishte edicioni i tretë. Projekti i paraqitur nga “Code Partners” u shpall fitues nga Këshilli artistiko-kulturor i Bashkisë Shkodër. Aktivitetet e fundvitit, të titulluara nga subjekti “Shkodra n’fest”, filluan në datën 8 dhjetor 2016 dhe zgjatën për gjatë gjithë muajit dhjetor. Këtë vit aktivitetet e fundvitit u instaluan në sheshin “Nënë Tereza”.

Aktivitetet artistike të zhvilluara janë si më poshtë:

Data 8/12/2016 – Të ftuar për të hapur këtë aktivitet ishte grupi “NA”, i cili përbëhet nga një bandë muzikore prej 4 vetash. Koncerti filloi në orën 19:30. Të vendosur në një skenë të madhe, me

ndriçim artistik profesional dhe me një foni të mirë, koncerti zgjati rreth dy orë dhe pjesëmarrja e publikut ishte e madhe.

Data 15/12/2016 – Koncert i madh festiv me të ftuar këngëtarin e mirënjohur Valon Shehu dhe grupi i tij. Koncerti filloi në orën 18:00, i vendosur në një skenë dinjitoze, me ndriçim artistik dhe foni cilësor, zgjati më shumë se dy orë. Pjesëmarrja e publikut në këtë koncert ishte e madhe.

Data 23/12/2016 – Koncert me muzikë moderne. I ftuar D.J Hektor. Ky koncert, i cili filloi në orën 18:00, u zhvillua në mes të shtëpizave prej druri dhe pati shumë interes tek të rinjtë e pranishëm, të cilët u përfshinë në mënyrë aktive në këtë festë.

Data 25/12/2016 – Koncert festiv me skenë, foni dhe ndriçim cilësor. Të ftuar në këtë mbrëmje ishin grupi shkodran “The B4ND”, të cilët janë të njohur në qytet për performancat e tyre në muzikën me ritme latine. Koncerti filloi në orën 18:00 dhe zgjati më shumë se dy orë. Pjesëmarrja e publikut në këtë koncert ishte e mirë.

Data 29/12/2016 – Koncert me muzikë jazz, ku të ftuar ishin këngëtarja e njohur shkodrane Jozefina Simoni dhe instrumentisti Aldo Simoni. Koncerti u zhvillua në mes të shtëpijave prej druri dhe pjesëmarrja dhe interesi i të rinjve ishte e lartë. Koncerti filloi në orën 18:00.

#### F2.O2.A10. Dita e Artizanatit dhe Zejeve

Aktiviteti u zhvillua në ditën kombëtare të artizanatit 9 qershor 2016 dhe zgjati për dy ditë. Ky aktivitet u organizua nga shoqata e artizanve shkodranë dhe ishte i ndarë në dy drejtime: 1) Në zhvillimin e një konference mbi punimet e artizanatit dhe të zejeve, i cili u zhvillua në sallën e Këshillit Bashkiak Shkodër, ku të ftuar për të referuar ishin njohës dhe kontribues të këtij sektori dhe 2) Në hapjen e panairit të Artizanatit dhe Zejeve në pedonalen pranë sheshit “Nënë Tereza”. Aktivitete të tilla, të cilat mbështeten nga Bashkia Shkodër çdo vit, ngjallin interes të lartë tek qytetarët shkodranë dhe tek turistët që vizitojnë vendin tonë.

#### F2.O2.A13. Aktivitete të ndryshme gjatë vitit

Kjo fishe konsiston në propozime të ndryshme që vijnë në Bashkinë Shkodër nga subjekte të ndryshme kulturore, apo nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Këtë vit kjo fishe buxheti, u realizua përmes një koncerti festiv në njesinë administrative Velipojë, në kuadër të nxitjes së turizmit dhe argëtimit të pushuesve, të cilët janë të shumtë në numër në plazhin e Velipojës. Projekti i paraqitur në Këshillin artistiko-kulturor të Bashkisë Shkodër, i titulluar “Maratona e Këngës”, nga subjekti “QZHK-Sot për të ardhmen” u shpall fitues dhe realizoi koncertin festiv me pjesëmarrjen e rreth 30 këngëtarëve në qendër të shëtitores së Velipojës. Aktiviteti u zhvillua në datën 20 korrik 2016 dhe pati pjesëmarrje shumë të madhe të spektatorëve.

#### F2.O2.A14. Honorare anëtarët e këshillit kulturor artistik

Bazuar në VKM nr.540, datë 21.12.1992 “Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, i ndryshuar me VKM nr. 121, datë 25.02.2005, Udhëzimit të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nr. 1, datë 24.05.2005 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko – kulturor”: VKB nr. 17, datë 28.04.2016 “Për buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2016”: VKB nr.27, datë 01.06.2016 “Për ngritjen e këshillit artistiko-kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në Bashkinë Shkodër” ; këtë vit Bashkia Shkodër ngriti Këshillin Artistiko Kulturor, i cili përbëhet prej 7 anëtarësh dhe i cili merr në shqyrtim në bazë të një procedure të parashikuar në ligj, të gjithë projektet kulturore, artistike, rinore dhe sportive të Bashkisë Shkodër. Ky këshill paguhet në bazë të ligjit me honorare për 6 mbledhje në vit.

#### F2.O2.A15. Lëvizja e Postribës

Data 9 shtator kujtohet çdo vit si “Lëvizja e Postribës”, e njohur si lëvizja e parë antikomuniste në Shqipëri. Aktivitetet organizohen çdo vit nga Bashkia Shkodër, në Njesinë Administrative Postribë, si një homazh për të rënët e kësaj lëvizjeje. Këtë vit aktivitetet filluan në orën 10:00 me vendosjen e kurorave pranë monumentit të ngritur në nder të Lëvizjes së Postribës. Ky moment u shoqërua nga Orkestra Frymore e Bashkisë Shkodër. Më pas u mbajt një koncert përkujtimor në qendër të Postribës nga grupe të ndryshme artistike.

#### F2.O2.A17. Çmimi “Pjetër Gaci”, Edicioni 15-të

Çmimi “Pjetër Gaci”, i cili financohet nga Bashkia Shkodër prej 15 vitesh dhe organizohet nga Qendra kulturore “Pjetër Gaci”, është konkurs i interpretuesve të muzikës klasike. Këtë vit ai u zhvillua në datat 13-14-15 nëntor 2016 në Teatrin “Migjeni” dhe në sallën e koncerteve “Gjon Kapidani” pranë shkollës artistike “Prenkë Jakova”. Edicioni i 15-të i Çmimit “Pjetër Gaci” pati 115 regjistrime nga nxënës dhe studentë nga pothuajse të gjitha shkollat artistike dhe Universitetet e arteve të Shqipërisë, si dhe nga shkollat artistike dhe Universitetet e arteve të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi. Konkursi edhe këtë vit u nda në 3 disiplina të ndryshme: Piano/ Harqe dhe Kanto dhe në disa kategori, sipas moshës.

Ky konkurs ndau çmime për fituesit e disiplinave dhe kategorive dhe një çmim të madh të titulluar “Pjetër Gaci”. Anëtarët e jurisë të këtij edicioni ishin të një niveli të lartë artistik, duke nisur nga kryetari i saj Tenori me famë ndërkombëtare Josif Gjipali; sopranoja e Teatrit të Operas dhe Baletit Mariana Leka; dirigjenti Maurizio Postai nga Trento, Itali; Vladimir Milosevic, pedagog i pianos në Universitetin e arteve të Beogradit; Lejla Pula, pedagoge e pianos në Universitetin e arteve Prishtinë; Kristina Laço, pedagoge e pianos në Univesitetin e arteve Tiranë; Sihana Badivuku, pedagoge e violinës në Universitetin e arteve Prishtinë; Marko Josifoski, pedagog nga Universiteti i arteve Beograd dhe Bujar Sykja, pedagog i violinës në Universitetin e arteve, Tiranë.

Çmimi “Pjetër Gaci” është i vetmi konkurs i intepretuesve të muzikës klasike, në rang rajonal, i cili financohet plotësisht nga një institucion publik.

#### F2.O2.A18. “Ahengu Shkodran”

29 shtatori është shpallur nga Ministria e Kulturës, si Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore dhe “Ahengu shkodran” i shpallur si një ndër shtatë kryeveprat e trashëgimisë shpirtërore shqiptare, është një aktivitet që mbështetet çdo vit nga Bashkia Shkodër dhe organizohet nga Qendra kulturore “Pjetër Gaci”.

“Ahengu shkodran” edhe këtë vit u zhvillua me 29 shtator, në oborrin e Banesës “Oso Kuka”. Risia e këtij viti ishte intepretimi i të gjithë materialeve muzikore të zgjedhura për këtë edicion, nga të rinj dhe të reja. “Ahengu shkodran” i këtij viti pati një pjesëmarrje të gjërë të spektatorëve.

#### F2.O2.A19. “Riaktivizimi i Grupit të Valleve”

Këtë vit, me mbështetjen financiare të Bashkisë Shkodër, pranë Qendrës kulturore “Pjetër Gaci” u ngrit Grupi i Valleve. Ky grup mori pjesë në shumicën e aktiviteteve që organizojnë institucionet e kulturës të Bashkisë Shkodër. Ky grup përbëhet prej 12 personash, të cilët trajtohen me honorare për 10 muaj.

#### F2.O2.A20. Festivali i Këngës Qytetare, me krijimtari të re

Pas 27 vitesh mungesë, Bashkia Shkodër dhe Qendra Kulturore “Pjetër Gaci”, në bashkëpunim me Teatrin “Migjeni”, në kuadër të rikthimit të traditës të krijimit të këngës qytetare, me motive shkodrane, organizoi Festivalin e këngës qytetare të titulluar “Luleborë”.

Festivali “Luleborë u zhvillua në datat 26-27-28 dhjetor 2016 në Teatrin “Migjeni” me pjesëmarrjen e 21 këngëve të reja dhe pati një gjithëpërfshirje të krijuesve në muzikë, tekste, orkestrues dhe interpretues, të afirmuar dhe të rinj.

Në këtë festival u ndanë 5 çmime:

Çmimi i parë shkoi për këngën “Nana” të kompozitorit Zef Çoba

Çmimi i dytë – “Për herë t’parë n’Shkodër kush vjen” – krijuar nga Bepin Vjerdha

Çmimi i tretë – “Mori Hylleshë” e kompozitorit Bardhyl Hysa

Teksti më i mirë shkoi për poetin Agim Doçi, për krijimin e tekstit të këngës “Për ty Shkodër më rreth zemra”, të kompozuar nga Edmond Zhulali.

Çmimi për këngëtarin më të mirë ju dha Eduard Jubanit, për intepretimimin e këngës “Edhe Rozafa ta ka lakmi” të kompozuar nga Namik Jahja.

Festivali i këngës qytetare “Luleborë” pati sukses të madh, ku spektatorët mbushën sallën e Teatrit “Migjeni” në të trija netët e zhvillimit të tij dhe pati jehonë edhe në mediat kombëtare dhe ato të shkruara.

#### F2.O2.A22. “Koncert – Premierë i Orkestrës Frymore”

Orkestra Frymore e Bashkisë Shkodër, në funksionimin e saj, përveç angazhimit në aktivitete të ndryshme artistike që zhvillohen në qytet në data të caktuara historike, ka edhe organizimin e koncerteve premierë.

Këtë vit Koncerti premierë u zhvillua në datën 15 nëntor 2016 në Teatrin “Migjeni”. Me një program tërësisht të ri dhe me përfshirjen edhe të solistëve të veçantë, të cilët u shoqëruan nga orchestra frymore, koncerti pati sukses të madh dhe u mirprit nga publiku, I cili mbushi sallën e Teatrit “Migjeni”.

#### F2.O2.A23. “Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Qytetare”

Ky Festival organizohet çdo vit nga Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike, në Elbasan. Qendra Kulturore “Pjetër Gaci”, me formacionet e veta artistike, merr pjesë çdo vit, i mbështetur financiarisht nga Bashkia Shkodër. Edhe këtë vit, grupi i Shkodrës fitoi çmimin e parë “Isuf Myzyri” në këtë festival, duke u prezantuar denjësisht me këngët qytetare shkodrane.

#### F2.O2.A25. 10 Urdhnimet – nga Roberto Benigni

“10 urdhnimet, sipas Benignit” u vunë në skenë 17 - 18 dhjetor në Teatrin “Migjeni”. Monodrama e interpretuar nga aktorja Rita Gjeka, pati impakt pozitiv tek publiku në të dyja netët që kjo shfaqje u vu në skenë. E konceptuar me një skenografi shumë të veçantë dhe me përshtatjen e tekstit letrar sipas realitetit shqiptar, shfaqja pati jehonë edhe në ditët pas mbarimit të saj.

#### F2.O2.A26. “In memoriam”- Pjerin Ashiku

Në kuadër të përkujtimit dhe respektit për artistët e shquar që kanë dhënë kontribut të shquar në vendin tonë, estrada e Teatrit “Migjeni” në datën 5 maj 2016 vuri në skenë shfaqjen dedikuar aktorit shkodran Pjerin Ashiku “In memoriam”. Shfaqja homazh pati sukses tek publiku, i cili kishte mbushur sallën e Teatrit “Migjeni”.

#### F2.O2.A26. “Kopraci - sipas Molierit” Stefan Çapaliku

Komedia e cila u vu në skenë në datat 13-14-15 maj 2016 nga regjizori Stefan Çapaliku dhe trupa e Teatrit “Migjeni” u mirprit nga publiku, i cili mbushi sallën e tetatrit në të treja natën e kësaj shfaqje.

#### F2.O2.A28. “Kur Nënë Tereza ishte Gonxhe” – nga Bashkim Kozeli



Shfaqja “Kur Nënë Tereza ishte Gonxhe” u vu në skenën e Teatrit “Migjeni në datat 30 shtator, 1-2-3-4-5-6 tetor 2016. Figura e Nënë Terezës, e sjellë nga autori në një këndvështrim tërësisht të ri, kur ajo ende nuk njihet, bëri që kjo shfaqje të ndiqej shumë nga spektatorët në të gjitha ditët që u vu në skenë. Gjithashtu kjo shfaqje u vu në skenë 3 herë për nxënësit e shkollave të mesme, duke patur sukses për numrin e lartë të pjesëmarrësve, rreth 1500 nxënës.

#### F2.O2.A29. Shoë 2016

“Shoë 2016” është shfaqje e estradës së Teatrit “Migjeni”. Këtë vit regjizor i kësaj shfaqje ishte Zehrudin Dokle dhe titulli i zgjedhur për këtë shoë ishte “Je shkodran nëqoftë se...”Premiera u shfaq në Teatrin “Migjeni” në datën 19 nëntor deri në datën 27 nëntor 2016.

Humori i spikatur shkodran dhe muzika e zgjedhur për këtë shfaqje, bënë që Teatri “Migjeni” të ishte i mbushur plot në të gjitha ditët e shfaqjes.

#### F3.O1.A2. Periodiku gegnisht

Për herë të parë, Bashkia Shkodër dhe Biblioteka “Marin Barleti” botoi revistën artistiko-kulturorë, të titulluar “Gegnia”, numri i parë i të cilës u promovua në datën 27 nëntor 2016 në ambjentet e Bibliotekës “Marin Barleti. Kjo revistë ka karakter kulturor dhe përfshin një gamë të gjërë artikujsh që kanë lidhje me gjuhën, letërsinë, artin, albanologjinë, historinë etj. Promovimi i kësaj reviste pati jehonë pozitive dhe interesi për të ishte i lartë. Revista “Gegnia” është organ zyrtar i Bashkisë Shkodër, i regjistruar me ISSN përkatëse, me orientim kulturor dhe është e hapur për të gjithë shkrimtarët e rinj dhe profesionistë.

#### F3.O1.A3. Festivali letrar i Shkodrës

Përveç punës kërkimore shkencore që Biblioteka “Marin Barleti” ka në punën e saj të përditshme, ajo gjatë gjithë vitit organizon edhe veprimtari kulturore që kanë ndikim tek publiku. “Festivali letrar i Shkodrës” zhvilloi edicionin e nëntë të tij këtë vit. Ky festival, i konceptuar si një forum letrar, i dedikohet kryesisht shkrimtarëve shkodranë që jetojnë në Shkodër dhe jashtë saj, por gjithashtu synimi i këtij festivali është edhe të jetë një urë lidhëse me shkrimtarë të hapësirave shqiptare.

Këtë vit festivali u zhvillua i ndarë në katër takime si më poshtë:

- 1) Takimi i parë – datë 07/10/2016 i ftuar shkrimtari Xhahid Bushati, me temë “Letërsia për fëmijë. Përse më pëlqen? Përse më pëlqen ta shkruaj...”
- 2) Takimi i dytë – datë 14/10/2016 , i ftuar z.Haxhi Hasani, me temë “Integrimet e letërsisë shqiptare brenda vetes”
- 3) Takimi i tretë – datë 22/10/2016, i ftuar shkrimtari Kolec Traboini, me temë “Poetika e fëminisë”
- 4) Takimi i katërt – datë 28/10/2016, i ftuar Adrian Paci, me temë “Mbi vështirësitë e leximit dhe një kolazh mendimesh”.

#### F3.O2.A1. Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës

Detyra kryesore e çdo biblioteke është zhvillimi dhe pasurimi i koleksioneve, përmes zgjedhjes së materialeve të shtypura dhe jo të shtypura që shërbejnë për plotësimin e nevojave për edukim dhe çlodhje të komunitetit.

Bashkia Shkodër çdo vit mbështet Bibliotekën “Marin Barleti” në pasurimin e fondeve të saj. Edhe këtë vit Biblioteka “Marin Barleti” shtoi numrin e fondeve të saj, në letërsi të huaj, në fondin për fëmijë, fondin e autorëve shqiptar, albanologji dhe fondin e gjuhëve të huaja.

F3.O2.A2. Mbrojtja e aparaturave nga mungesa dhe oshilacionet e energjisë

Në kuadër të sigurimit të kushteve normale të punës në ambjentet e Bibliotekës “Marin Barleti” për administratën dhe vizitorët, këtë vit u realizua pajisja me mjetet e nevojshme për mbrojtjen e pajisjeve elektronike të Bibliotekës “Marin Barleti”.

F3.O2.A3. Rimbushje dhe blerje fikse zjarri

Në bazë të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 25 “Funksonet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese”; ligjit nr.9386, datë 04.05.2005 “Për Muzetë”, neni 13 “Detyrimi për sigurimin e muzeut”, këtë vit “Biblioteka Marin Barleti” u pajis me bombula fikse zjarri.

F3.O2.A4. Hostim, mirëmbajtje e faqes web të Bibliotekës “Marin Barleti”.

Promovimi në kushte bashkëkohore i Bibliotekës “Marin Barleti”, përmes faqes zyrtare të saj, është një mjet i domosdoshëm për afrimin e publikut me librin dhe njohjen e saj edhe jashtë territorit të Shqipërisë. Faqja zyrtare e Bibliotekës “Marin Barleti” që prej krijimit të saj në vitin 2009, ka ndikuar pozitivisht në rritjen e numrit të dashamirësëve të librit që vizitojnë bibliotekën. Në këtë faqe me kalimin e viteve janë dixhitalizuar edhe një pjesë e madhe e fondeve të bibliotekës. Ndaj çdo vit, është e rëndësishme që kjo faqe të përmirësohet dhe të pasurohet me materiale të reja.

F3.O2.A5. Shërbime kancelarie dhe materiale pastrimi

Dega ekonomike e kulturës ka një strukturë prej 6 ndërtesash, të cilat krijojnë mirëmbajtje. Në kuadër të sigurimit të kushteve normale të punës në këto ambjente, nga Bashkia Shkodër, u realizua pajisja me mjetet e nevojshme të kancelarisë dhe materiale pastrimi.

F3.O2.A6. Administrimi, ruajtja dhe mirëmbajtja e fondeve muzeale te Bibliotekes Marin Barleti

Administrimi, ruajtja dhe mirëmbajtja e kujdesshme e fondit të librave, është një detyrëligjore e Bashkisë Shkodër, në bazë të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 25 “Funksonet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese”. Këtëvit në Biblioteka “Marin Barleti” u pajis me 20 rafte për ruajtjen e fondeve të saj, në bazë të standarteve.

### **III Fondet e financimit te programeve**

#### **Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2016.**

Fondet e miratuara për këtë program janë 86 534 mije lekë dhe realizimi për periudhën 12 mujore është 68 507 mije lekë, në masën 79% .

- Paga e sigurime janë realizuar në masën 36 173 mije Lekë nga 40 500 mije Lekë që ka qene e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi në masën 89%.
- Shpenzime operative janë realizuar në masën 21942 mije Lekë nga 26 189 mije Lekë që ka qene e parashikuar në fillim te vitit. Realizimi në masën 84%.
- Transferta janë realizuar në masën 4 163 Lekë nga 5 700 mije Lekë parashikuar pas vendimit të marrë për ndryshimin e artikullit për fondin 3 850 000 lekë nga 604 në 602. Realizmi në masën 73%.
- Investimet janë realizuar në masën 6 229 mije Lekë nga 14 144 mije Lekë të parashikuara në fillim të vitit. Realizimi në masën 44%.

Sipas kërkesës të Teatrit Migjeni, të miratuar nga Kryetarja e Bashkisë me nr prot 426, datë 01.07.2016 kemi patur një ndryshim artikulli të fondit per tu perdorur nga Teatri Migjeni prej 3 850 mije lekë nga 604 në 602.

Tabela e produkteve dhe realizimit të tyre nga pikëpamja financiare

Aktivite/Projekte	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi
P11.F1.O1 .a1 Ekspozitë "Shkodra gjate luftes se pare boterore"	90	90	72
P11.F1.O1 .a2 Prodhim dhe Shtypje Biletash	70	70	70
P11.F1.O1 .a3 Përmirësimi i dukshmërisë së sallave ekspozuese të Muzeut të Kështjellës	125	125	119
P11.F1.O1 .a4 Përmirësimi i sistemit ndricues të sallave dhe ambienteve ekspozuese te Muzeut	30	30	30
P11.F1.O1 .a5 Administrimi , ruajtja dhe mirëmbajtja e arkivit të Muzeut	448	448	419
P11.F1.O1 .a6 Përmirësimi dhe rritja e kapaciteteve magazinuese te Muzeumit Historik	698	698	-
P11.F1.O1 .7 Hostim dhe mirëmbajtje të faqes web te Muzeumit Historik	15	15	15
P11.F1.O1 .a8 Përmirësim i sistemit të ndriçimit të oborrit të Muzeut "Oso Kuka"	250	250	-
P11.F1.O1 .a9 Konkurs për Logon e Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës	30	30	30
P11.F1.O1 .a10 Përmirësimi i sistemit te ruajtjes kundra zjarrit	39	39	35
P11.F1.O1 .a11 Blerje të vogla	12	12	12
P11.F1.O1 .a12 Blerje pajisje zyre	100	100	95
P11.F1.O1 .a13 Ndriçimi i galerisë me dritë artificiale	48	48	48
P11.F1.O1 .a14 Rafta për ruajtjen e objekteve dhe dokumentave	50	50	-
P11.F1.O1 .a15 Rinovimi i ekspozitës fotografike me materiale të reja	30	30	30
P11.F1.O1 .a16 Shërbim i ruajtjes së objektit/security	204	204	66
P11.F1.O1 .a17 Sistemi kamera sigurie- instalim në hapësirat e brendshme	350	350	95
P11.F1.O1 .a18 Blerje pajisjesh teknike për zyrë dhe aktivite artistike	160	160	150

P11.F1.O1 .a19 Ruajtja e Galerisë së Arteve me Shoqëri Private të Ruajtjes dhe Sigurisë fizike.	280	280	145
P11.F1.O1 .a20 Përmirësimi i kushteve teknike të ambienteve të ruajtjes të koleksionit	541	541	527
P11.F1.O1 .a21 Shpenzime zyre (Ndriçim)	30	30	30
P11.F1.O1 .a22 Shpenzime për hostim dhe mirëmbajtje të faqes web	15	15	15
P11.F1.O1 .a23 Orendi zyre	80	80	77
P11.F1.O1 .a24 Zhvillimi i disa projekteve edukative me gjimnazet e qytetit.	20	20	20
P11.F1.O1 .a25 Ekspozitë fotografike “Shkodra në diktaturën komuniste: personazhe dhe fakte”	62	62	-
P11.F1.O1 .a26 Ekspozitë fotografike “Shkodra në Vitet ‘90”	47	47	47
P11.F1.O1 .a27 Dita Ndërkombëtare e Muzeumeve	50	50	40
P11.F1.O1 .a28 Ekspozita “Salloni i vjeshtës ”	465	465	385
P11.F1.O1 .a29 Ekspozita personale e fituesit të “Çmimit Idromeno 2015”, Lek Gjeloshi.	315	315	308
P11.F1.O1 .a30 “Personazh i ftuar”- Ekspozitë personale e një personaliteti të spikatur të artit pamor shqiptar të ftuar nga Galeria e Arteve e Shkodrës.	136	136	132
P11.F1.O1 .a31 Takimet publike -bisedat publike mbi artin dhe ëorkshop me artistë të rinj	190	190	80
P11.F1.O1 .a32 Aktivitete në partneritet me subjekte kulturore të tretë	109	109	109
P11.F2.O1.A1 Një Piano për Qytetin e Artit	4,000	4,000	-
P11.F2.O1.A2 Blerje impiant Audio, Sistem ndriçimi dhe pod për koncerte live	1,555	1,555	-
P11.F2.O1.A3 Orkestra Frymore Honorare vjetore	3,674	3,674	3,623
P11.F2.O1.A4 Mobilim për Qendrën Kulturore “Pjetër Gaci”	545	545	428

P11.F2.O1.A5 Pajisje Teknike Zyre për Qendrën Kulturore “Pjetër Gaci” (kompjuter dhe printer)	170	170	134
P11.F2.O1.A6 Krijimi dhe Mirëmbajtja e Faqes Web	50	50	-
P11.F2.O1.A7 Përmirësim i kushteve të punës për aktorët, për pritjet e të ftuarve dhe blerje paisje teknike	1,577	1,577	1,361
P11.F2.O1.A8 Projekt zbatimi i plote Rikonstruksion i godines se Teatrit “ Migjeni”.	1,989	1,989	1,989
P11.F2.O1.A9 Administrimi dhe Menaxhimi i Teatrit “Migjeni”	21,952	21,682	18,527
P11.F2.O1.A10 Shërbime nga të tretë për furnizimin me energji, ujë, etj.	1,361	1,361	1,324
P11.F2.O1.A11 Shërbime administrative për Teatrin “Migjeni”	603	873	841
P11.F2.O1.A12 Shërbime mbështetëse transporti për aktivitete artistike.	1,000	1,000	960
P11.F2.O2.A1 Dita e Luleve 6 Maj	1,200	1,200	1,030
P11.F2.O2.A2 Ndërmendje	1,500	1,500	1,500
P11.F2.O2.A3 Lumturimi i Nënë Terezës	505	505	-
P11.F2.O2.A4 Festivali i muzikës moderne	900	900	546
P11.F2.O2.A5 Aktiviteti me të përsekutuarit politik	800	800	-
P11.F2.O2.A6 Aktivitete me rastin e 2 Prillit	300	300	49
P11.F2.O2.A7 Shkodra Jazz Festival	1,000	1,000	1,000
P11.F2.O2.A8 Karnavalet	960	960	911
P11.F2.O2.A9 Koncertet e verës	300	300	300
P11.F2.O2.A10 Aktivitetet e fundvitit	200	200	200
P11.F2.O2.A11 Dita Botërore e Muzikës	200	200	49
P11.F2.O2.A12 Dita e Artizanatit dhe Zejeve	200	200	86
P11.F2.O2.A13 Aktivitete të ndryshme gjatë vitit	1,000	1,000	1,000
P11. F2.O2.A14 Honorare anëtarët e këshillit kulturor artistik	1,000	1,000	166
P11.F2.O2.A15 Lëvizja e Postribës	70	70	8
P11.F2.O2.A16 “Koncert – Premiere i Orkestrës Frymore” në Tiranë	284	284	23
P11.F2.O2.A17 Çmimi “Pjetër Gaci” Edicioni 15-të	1,309	1,309	1,166
P11.F2.O2.A18 “Ahengu Shkodran”	479	479	478
P11.F2.O2.A19 “Riaktivizimi i Grupit të Valleve”	720	720	576
P11.F2.O2.A20 “Festivali i Këngës Qytetare”	1,285	1,285	1,280

P11.F2.O2.A21 "Formacioni i Harqeve - Riorganizimi dhe aktivitetet "	523	523	385
P11.F2.O2.A22 "Koncert – Premierë i Orkestrës Frymore"	234	234	203
P11.F2.O2.A23 "Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Qytetare"	340	340	296
P11.F2.O2.A24 "Fesitivali i Rapsodëve dhe Instrumentistëve Popullorë"	70	70	-
P11.F2.O2.A25 10 Urdhnimet – nga Roberto Benigni	1,130	1,130	1,087
P11.F2.O2.A26 "In memoriam"- Pjerin Ashiku	400	400	358
P11.F2.O2.A27 "Kopraci – sipas Molierit" Stefan Capaliku	1,150	1,150	1,125
P11.F2.O2.A28 "Kur Nënë Tereza ishte Gonxhe" – nga Bashkim Kozeli	500	500	497
P11.F2.O2.A29 Shoë 2016	600	600	596
P11.F3.O1.A1 Aktiviteti letrar: "Dita e poezisë për fëmijë".	90	90	-
P11.F3.O1.A2 Periodiku gegnisht	220	220	158
P11.F3.O1.A3 Festivali letrar i Shkodrës	70	70	50
P11.F3.O2.A1 Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës	1,000	1,000	846
P11.F3.O2.A2 Mbrojtja e aparaturave nga mungesa dhe oshilacionet e energjisë.	10	10	10
P11.F3.O2.A3 Rimbushje dhe blerje fikse zjarri	235	235	217
P11.F3.O2.A4 Hostim, mirëmbajtje e faqes web të Bibliotekës "Marin Barleti"	50	50	40
P11.F3.O2.A5 Shërbime kancelarie dhe sanitare për Degën ekonomike të kulturës	658	658	561
P11.F3.O2.A6 Administrimi, ruajtja dhe mirëmbajtja e fondeve muzeale te Bibliotekes Marin Barleti.	800	800	276
P11.F3.O2.A7 Shërbime nga të tretë për furnizimin me energji, ujë, etj. (Energji Elektike, Ujë ,Shpenzime Telefoni dhe Interneti ,Shpenzime Postare )	1,580	1,580	1,207
P11.F3.O2.A8 Shërbime mirëmbajtje të mjediseve të Bibliotekës "Marin Barleti"	50	50	50
P11.F3.O2.A9 Shërbimi i ruajtjes së ndërtesës së Bibliotekës "Marin Barleti"	35	35	29
P11.F3.O2.A10 Administrimi dhe menaxhimi i Degës ekonomike të kulturës	19,013	19,013	17,760

#### **IV Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.**

- Disa projekte të Muzeut Oso Kuka vendosëm ti zbatonim në një plan më të gjerë veprimatë të riparimit të përgjithshëm të tij. Kështu projektet për riparimin e arkivës dhe atë të ndriçimit të jashtëm do të përfshihen në projektin e përgjithshëm të riparimit të tij në 2017.
- Për arsye të mos planifikimit si duhet të shpenzimeve të nevojshme në fishet e projekteve për për blerjen e një pianoje koncertore si dhe të një sistemi audio e ndriçimi për aktivitetet e koncerte live, u pengua realizimi i tyre duke i shtyre këto projekte për tu realizuar për vitin 2017.
- Riparimi e rikonstruksioni i godinës së Teatrit “Migjeni” është kryer me fondet e Ministrisë së Kulturës duke bërë të mundur realizimin e rikonstruksionit. Ky ishte nje projekt qe kishte filluar qe ne vitin 2015.
- Mosfunksionimi i Këshillit Artistik Kulturor që në fillim të vitit solli që disa aktivitete të planifikuara të realizoheshin me transfertë, nëpërmjet vendimeve të këtij këshilli, të mos zhvilloheshin.

## **P12 Rinia dhe Sportet**

Programi për rininë ofron shërbime specifike në lidhje me a) Informimin dhe këshillimin për rininë për shërbimet lokale, edukim, për formim profesional, etj. b) Vlerësimin e nevojës për mbështetje të rinjve; c) Bashkëfinancim të aktiviteteve rinore; d) Bashkërendim me sektorin e shërbimeve sociale, shëndetësore e të sportit për nxitjen e aktiviteteve më të rinj.

Pjesë e programit për rininë dhe sportet janë organizimi i përvitshëm i aktiviteteve sportive dhe zhvillimi i sportit në komunitet. Këto aktivitete zhvillojnë traditën ku të rinjtë dhe të rejtat e Shkodrës, shoqatat e klubet sportive nga vendi ose nga rajoni të garojnë në mes tyre. Nëpërmjet programit për rininë dhe sportin mbështeten administrimi dhe funksionimi i Klubit shumësportësh "Vllaznia" dhe Klubi i futbollit "Vllaznia".

Në përbërje të Klubit shumësportësh "Vllaznia" mbështeten ekipet në disiplina të ndryshme sportive. Pjesë përbërëse e programit në mbështetje të sportit të futbollit është mbështetja dhe financimi i ekipeve zinxhirë të grupmohave të ndryshme pjesë e Akademisë së Futbollit "Vllaznia".

### **I Përshkrimi i funksioneve dhe i objektivave**

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2016, për synimet e saj në zhvillimin e sportit është përqendruar në këto funksione zhvillimi:

F1. Programet dhe projektet rinore.

F2. Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreacionale, zhvillimi dhe administrimi i institucioneve dhe objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Objektivat për secilin funksion janë si më poshtë:

F1.O1. Të promovojmë dhe të nxisim pjesëmarrjen aktive të rinjve në aktivitete sportive dhe sociale, si aktorë thelbësorë në zhvillimin e territorit.

F2.O1. Menaxhimi dhe mirë administrimi i strukturave sportive dhe krijimi i infrastrukturës së përshtatshme dhe cilësore për të gjithë sportet.

F2.O2. Garantimi i pjesëmarrjes së të gjithë ekipeve të Klubit "Vllaznia" në Kampionatet kombëtare me synim arritjen e rezultateve cilësore.

### **II Produktet për vitin 2016**

Drejtoria e Kulturës, Arsimit Rinisë dhe Sportit, gjatë vitit 2016 ka punuar për përmbushjen e funksioneve dhe objektivave të caktuara sa më sipër nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

F1.O1.A1. Dita e vullnetarizmit

Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit gjatë vitit 2016 ishte iniciatore për organizimin e disa ditëve të veçanta të vullnetarizmit. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Çështjeve Sociale, me shkollat e qytetit me OJF të ndryshme që operojnë në qytet si edhe në bashkëpunim me shkollat e qytetit arriti të organizojë disa ditë ku të rinjtë së bashku u angazhuan të ofrojnë punë vullnetare në shërbim të qytetit. Vlen për tu theksuar angazhimi në muajin Prill 2016 për pastrimin e Plazhit të Velipojës, ku në bashkëpunim me Njësinë Administrative Velipojë u realizua pastrimi i disa qindra metër katror, duke dhënë kështu një shembull sensibilizimi edhe për qytetarët për një ambient të



përbashkët më të pastër. Në vazhdim të bashkëpunimit me shkollat e qytetit në Tetor 2016 u organizua një aktivitet social edukativ ku synimi ishte organizimi i pastrimit të ambjenteve në lagjen Tophane, lagje e banuar kryesisht nga komuniteti rom. Aktiviteti u krye në bashkëpunim me PNUD në kuadër të projektit ESERE.

#### F1.O1.A4. Maratona e pavarësisë Ulqin - Shkodër 2016

Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit pranë Bashkisë me datën 28 Nëntor 2016, në kuadrin e festimeve të Javës së Pavarësisë, ka organizuar Maratonën e Pavarësisë, me nisje nga Ulqini për në Shkodër, 42 km e gjatë, me pjesëmarrjen e 65 sportistëve maratonistë, nga të cilët 61 meshkuj dhe 4 femra. Në këtë maratonë, në kategorinë meshkuj dolën fitues 3 sportistë përkatësisht në vend të parë Haris Ajdarevic – Novi Pazar Serbi, në vend të dytë Ilir Kellezi, Korçë Shqipëri, vendi i tretë Sergej Mironov, Rusi. Për herë të parë në këtë eveniment pati fitues edhe në kategorinë e femrave ku vendi i parë ishte Teodora Simovic, Novi Pazar Serbi.

Ky aktivitet u organizua në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, Komunën Ulqin dhe Këshillin Kombëtar i Shqiptarëve në Ulqin. Aktiviteti u ndoq nga mbi 1000 qytetarë të mbledhur para sheshit të Bashkisë që ndiqnin dhe programin kulturor me rastin e Festës së Pavarësisë organizuar me këtë rast si dhe sportdashës të ndryshëm që kishin ardhur posaçërisht për të shprehur mbështetjen e tyre për sportistët pjesëmarrës.

#### F1.O1.A5. Promovimi i lojës së shahut në Shkodër

Loja e shahut ka një traditë pozitive dhe të hershme në qytetin e Shkodrës. Tradicionalisht pranë klubit Vllaznia ka funksionuar ekipi i shahut për meshkuj dhe femra, të cilët kanë arritur rezultate sportive shumë të mira në vite, duke u shpallur, disa prej tyre edhe Kampion Kombëtar. Sporti i shahut është një nga sportet që ndihmon në zhvillimin pozitiv të aftësive njohëse të fëmijëve dhe nxënësve. Njëkohësisht ndikon në krijimin e besimit në vetvete, rritjen e kujtesës e të menduarit, rritjen e përqendrimit dhe të përmirësimit të rezultateve në mësimet tek fëmijët dhe të rinjtë. Gjatë vitit 2016 Bashkia Shkodër u angazhua për blerjen e tabelave dhe librave të shahut për shkollat 9 vjeçare për të realizuar më pas një aktivitet të madh, gjithëpërfshirës.

#### F1.O1.A6. Aktivitete sportive në plazhin e Velipojë

Sektori i Arsimit Rinisë dhe sportit pranë Bashkisë gjatë muajit Gusht 2016 ka mbështetur aktivitete sportive (beach vollej) në plazhin e Velipojës, aktivitete që kanë kulmuar në datën 20 Gusht, nga ora 8.00- 20.30, kur është organizuar dhe zhvilluar kampionati i këtij sporti me pjesëmarrjen e 38 sportistëve nga të cilët 14 vajza dhe 24 djem. Nga këto ndeshje rezultuan fitues 8 sportistë nga të cilët 4 sportistë (2 vajza e 2 djem) çmim të parë dhe 4 sportistë çmim të dytë (2 vajza e 2 djem).

Ky aktivitet u mbështet dhe nga katërshja e arbitrave të cilët dhanë një mbështetje me vlerë në mbarëvajtjen e kampionatit që konsistuan në mbajtjen e ndeshjes, zgjidhjen e kontestimeve të dala herë pas here nga sportistët, mbajtjen e rregullt të pikëve, përcaktimin e skuadrave fituese si në fazën pre eliminatorë, eliminatorë dhe në atë finale. Aktiviteti u ndoq nga 850 pushues që u përfshinë në mbështetje të sportistëve dhe skuadrave të ndryshme.

#### F1.O1.A7. Turneu i tenisit për salla të mbyllura për fëmijë dhe të rinj 2016.

Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit pranë Bashkisë në datat 22-27 Dhjetor 2016, ka organizuar turneun e tenisit për salla të mbyllura për fëmijë dhe të rinj, me pjesëmarrjen e 62 pjesëmarrësve nga të cilët 32 kategoria të rinj dhe 30 sportistë kategoria fëmijë. Kategoria e të rinjve ishin të gjithë meshkuj, ndërsa kategoria fëmijë ishin 16 meshkuj dhe 14 femra. Këto sportiste ishin nga Shqipëria (Durrës, Tiranë, Shkodër) si dhe nga Mali i Zi dhe Kosova. Ky aktivitet u arbitrua nga 6 arbitra nga Shqipëria, Mali i Zi dhe Kosova. Në datat 22,23,24 u zhvilluan netët kualifikuese dhe u

ndoqën nga 150 sportdashës në çdo natë. Në datat 25,26,27 u zhvilluan finalet për grupmoshat dhe u ndoqën nga 300 vetë sportdashës.

#### F2.O1.A1. Menaxhimi i Sport Klub Vllaznia

Është realizuar menaxhimi i sport klubit Vllaznia duke krijuar kushtet për mirë administrimin e tij në shërbim të përmirësimit të cilësisë sportive të ekipeve të tij.

#### F2.O1.A2. Trajtime ushqimore shtesë për sportistët më të mirë të vitit

Janë realizuar trajtimet ushqimore shtesë për sportistët më të mirë të vitit në mënyrë që të mbështeten në përpjekjet e tyre në arritjen e rezultateve cilësore.

#### F2.O1.A4. Administrimi i Klubit të futbollit Vllaznia

Është realizuar administrimi i Klubit të futbollit Vllaznia në shërbim të sigurimit të standarteve për drejtim sipas standarteve të tij.

#### F2.O2.A1. Mbështetje të Ekipit basketbollit meshkuj të rritur

Ekipi i Basketbollit i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion 9 herë në vitet 1967, 1969, 1990, 1993, 1994, 1995, 2000, 2014, 2015, 2016. Fitues i kupës së Republikës 8 herë në vitin 1957, 1959, 1965, 1989, 2001, 2008, 2013, 2014.

#### F2.O2.A2. Mbështetje e ekipit të basketbollit meshkuj të rinj

Ekipi i basketbollit të të rinjve i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 5 herë në vitet 2005, 2006, 2008, 2010, 2013.

#### F2.O2.A3. Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të rritura

Ekipi i të rriturve për femra i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka arritur në vazhdimësi rezultate të larta në të gjitha aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare. Fitues i kupës së Republikës 2 herë në vitet 1962,1988.

#### F2.O2.A4. Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të reja

Ekipi i basketbollit të të rinjve për femra SK "Vllaznia" përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner. Gjatë historisë së tij ky ekip ka zënë gjithnjë vende të kënaqshme në renditje në aktivitetet e zhvilluara. Kampion kombëtar në vitin 2016.

#### F2.O2.A5. Mbështetje e ekipit të volejbollit meshkuj të rritur

Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë. Fitues i kupës së Republikës 3 herë në vitet 1969, 1970, 1973.

#### F2.O2.A6. Mbështetje e ekipit të volejbollit femra të rritura

Ekipi i volejbollit të të rriturve për femra përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 3 herë në vitet 1947, 1957, 1960. Fitues i Kupës së Republikës 3 herë, në vitet 1962, 1963, 1964.

#### F2.O2.A7. Mbështetje e ekipit të Volejboll meshkuj të rinj

Ekipi i të rinjve i volejbollit të meshkujve Vllaznia përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka fituar tre kampionate kombëtare në vitet 1997, 2001, 2012.

#### F2.O2.A8. Mbështetje e ekipit të Volejbollit femra të reja

Ekipi i të rejave i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka zënë vende të treta dhe të katërta në kampionatet kombëtare. Në vitin 2016 ekipi shpallet kampion kombëtar.

#### F2.O2.A9. Mbështetje e ekipit të boksit meshkuj të rritur

Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 20 sportistë dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion 20 herë, në vitet 1951, 1991 deri 1995 dhe 1997 deri 2013 dhe 2015. Fitues i kupës së Republikës 20 herë në vitet 1991 deri 1995 dhe 1997 deri 2013.

F2.O2.A10. Aktivitet sportiv ndërkombëtar, "Memorial Vllaznia 2016" në boks

Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë të ekipit kombëtar dhe 3 trajnerë. Ekipi i boksit të të rriturve ka marrë pjesë në këtë eveniment për 13 vite rresht duke dalë kampion në këtë aktivitet dhe duke marrë medalje ari, argjendi dhe bronzi, gjithësej 42 medalje.

F2.O2.A11. Mbështetje e ekipit të atletikës meshkuj të rritur

Ky ekip ka dalë kampion 16 herë në vitet 1993, 1994, 1997, 1998, 1999, 2003, deri në 2005, 2009 deri në 2015 kampion absolut. Fitues i Kupës së Republikës në 26 vitet e fundit në vitet 2005, 2007, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016.

F2.O2.A12. Mbështetje e ekipit të Çiklizëm meshkuj të rritur

Ekipi i çiklizmit të të rriturve të Vllaznisë përbëhet nga 8 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka zënë vende të para në kampionatet kombëtare (Rrethi ciklistik i Shqipërisë) 7 herë në vitet 1982, 1984, 1985, 1998, 1989, 1995, 1997.

F2.O2.A13. Mbështetje e ekipit të Futbollit femra të rritura

Ekipi i futbollit të femrave për të rritur i Vllaznisë përbëhet nga 25 sportiste dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 2 herë në vitet 2013, 2014.

F2.O2.A14. Mbështetje e ekipit të Gjimnastikës femra të rritura

Ekipi përbëhet nga 10 sportistë dhe 1 trajner. Ekipi i gjimnastikës i të rriturve për meshkuj ka zënë vendin e parë në vitet 1976-1977, ndërsa ekipi i gjimnastikës i të rriturve për femra ka zënë 6 herë vendin e parë në kampionatet në vitet 2005, 2006, 2008, 2013, 2014, 2015.

F2.O2.A15. Mbështetje e ekipit të Hendbollit meshkuj të rritur

Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 1 herë në vitin 1994. Ky ekip mbas vitit 1994 deri në vitin 1998 nuk merr pjesë në asnjë aktivitet për arsye financiare dhe fillon aktivitet në vitin 1999 e në vazhdim.

Ekipi i të rriturve në vitin 2014, 2015, renditet në vendin e dytë dhe të tretë duke patur rezultate shumë të mira në aktivitetet kombëtare dhe merr pjesë disa here në aktivitetet miqësore ndërkombëtare.

F2.O2.A16. Mbështetje e ekipit të Mundjes meshkuj të rritur

Ekipi i të rriturve të Vllaznisë përbëhet nga 10 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka dalë N/kampion 2 herë në vitet 2009, 2010, nga vitit 2010 dhe deri 2015 renditet në e vendin e tretë.

F2.O2.A17. Mbështetje e ekipit të Notit të rritur dhe të rritura

Ekipi i notit për të rritur i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 1 trajner. Në gara individuale ka pasur shumë rezultate të larta, gjithsej 30 medalje ari, argjendi dhe bronzi.

F2.O2.A18. Mbështetje e ekipit të peshngritjes meshkuj të rritur

Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 10 sportistë dhe 3 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion 8 herë në vitet 1972, 1973, 1976, 1978, 1991, 2004, 2008, 2009.

F2.O2.A19. Mbështetje e ekipit të Ping - Pong të rritur

Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 6 herë në vitet 1966, 1968, 1970, 1975, 1982, 1983. Ky ekip, që në vitin 1990 merr pjesë rregullisht në kampionatin kombëtar dhe kupat e Republikës duke zënë

vënde të dyta dhe të treta.



F2.O2.A20. Mbështetje e ekipit të Shahut të rritur

Ekipi i të rriturve i Vllaznisë përbëhet nga 8 sportistë dhe 1 trajner. Ky ekip ka dalë kampion kombëtar 1 herë në vitin 2008.

F2.O2.A21 Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rinj / të reja/ të rritur/të rritura

Ekipi përbëhet nga 40 kadet (grupmoshat), 30 të rinj dhe të rritur dhe 5 trajnerë. Gjithsej ekipi Vllaznia është shpallur 9 herë kampioni Kupës së Republikës.

### III Fonde të financimit të programit

#### Fonde të rishpërndara në program:

Për shkak të mosdorëzimit të Stadiumit “Loro Boriçi” nga FSHF dhe mospërdorimit të fondeve të planifikuara për menaxhimin e tij, si dhe me kërkesë të Klubit Futbollit Vllaznia u miratua nga Këshilli Bashkiak me nr. Prot. 55.02.11. 2016 rishpërndarja e fondeve, paksimi i tyre nga administrimi dhe mirëmbajtje e Stadiumit “Loro Boriçi”, shtesë tek Administrimi i Klubit të futbollit Vllaznia në shumën 12 000 mije lekë.

**Fondet e miratuara për këtë program** janë 102 983 mije lekë. Realizimi për periudhën 12 mujore është 100 532 mije lekë, në masën 97% ndaj planifikimit vjetor .

- Paga e sigurime shoqërore janë realizuar në masën 9 204 mije lekë nga 9 464 mije lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi është në masën 97%.
- Shpenzime operative janë realizuar në masën 27716 mije lekë nga 29 557 mije lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi është në masën 93%.
- Transferta është realizuar në masën 62 826 mije lekë nga 62 862 mije lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi është në masën 99%.
- Investime janë realizuar në masën 786 mije lekë nga 1 100 mije lekë që ka qënë e parashikuar në fillim të vitit. Realizimi është në masën 71 %.

Tabela e produkteve dhe realizimit të tyre nga pikëpamja financiare

Aktivitete/Projekte	Plani Fillestar	Plani Korrigjuar	Realizimi
P12.F1.O1.A1 Dita e vullnetarizmit	576	576	102
P12.F1.O1.A2 Portali për rininë	90	90	-
P12.F1.O1.A3 Kampionati i lojrave me dorë mes shkollave të mesme të Bashkisë së Shkodrës.	150	150	-
P12.F1.O1.A4 Maratona e pavarësisë Ulqin – Shkodër 2016	270	270	197
P12.F1.O1.A5 Promovimi i lojës së shahut në Shkodër	450	450	187
P12.F1.O1.A6 Aktivitete sportive në plazhin e Velipojës	300	300	223
P12.F1.O1.A7 Turneu i tenisit për salla të mbyllura për fëmijë dhe të rinj, 2016, Shkodër	140	140	80
P12.F2.O1.A1 Menaxhimi i Sport Klub	12,800	12,833	12,166

Vllaznia			
P12.F2.O1.A2 Trajtime ushqimore shtesë për sportistët më të mirë të vitit.	50	50	50
Shperblim per sportistet me te mire te vitit		780	780
P12.F2.O1.A3 Administrimi dhe Mirëmbajtje e Stadiumit “Loro Borici “	12,800	800	396
P12.F2.O1.A4 Administrimi i Klubit të futbollit Vllaznia	50,000	62,000	62,000
P12.F2.O2.A1 Ekipi i basketbollit meshkuj të rritur	3,333	3,333	3,311
P12.F2.O2.A2 Mbështetje e ekipit të basketbollit meshkuj të rinj	516	516	514
P12.F2.O2.A3 Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të rritura	1,949	1,949	1,949
P12.F2.O2.A4 Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të reja	428	428	428
P12.F2.O2.A5 Mbështetje e ekipit të volejbollit meshkuj të rritur.	3,107	3,107	3,082
P12.F2.O2.A6 Mbështetje e ekipit të volejbollit femra të rritura	1,228	1,228	1,228
P12.F2.O2.A7 Mbështetje e ekipit të Volejboll meshkuj të rinj	373	373	373
P12.F2.O2.A8 Mbështetje e ekipit të Volejbollit femra të reja	417	417	373
P12.F2.O2.A9 Mbështetje e ekipit të boksit meshkuj të rritur	2,964	2,964	2,964
P12.F2.O2.A10 Aktivitet sportiv ndërkombëtar, "Memorial Vllaznia 2016" në boks.	900	867	791
P12.F2.O2.A11 Mbështetje e ekipit të atletikës meshkuj të rritur	2,938	2,938	2,926
P12.F2.O2.A12 Mbështetje e ekipit të Çiklizëm meshkuj të rritur	1,002	1,002	1,002
P12.F2.O2.A13 Mbështetje e ekipit të Futbollit femra të rritura	250	250	250
P12.F2.O2.A14 Mbështetje e ekipit të Gjimnastikës femra të rritura	936	936	924
P12.F2.O2.A15 Mbështetje e ekipit të Hendbollit meshkuj të rritur	186	186	186
P12.F2.O2.A16 Mbështetje e ekipit i Mundjes meshkuj të rritur	795	795	795
P12.F2.O2.A17 Mbështetje e ekipit të Notit të rritur dhe të rritura	197	197	197
P12.F2.O2.A18 Mbështetje e ekipit të peshngritjes meshkuj të rritur	1,930	1,930	1,930



P12.F2.O2.A19 Mbështetje e ekipit të Ping - Pong te rritur	163	163	163
P12.F2.O2.A20 Mbështetje e ekipit të Shahut te rritur	284	284	284
P12.F2.O2.A21 Mbështetje e ekipit të xhudos për moshat të rinj / të reja/ të rritur/të rritura	681	681	681
<b>TOTAL</b>	<b>102,203</b>	<b>102,983</b>	<b>100,532</b>

#### **IV Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa zërave të buxhetit të programit.**

Vështirësite e ndeshura përgjatë realizimit të Buxhetit 2016 në programin Rinia e Sportet janë si më poshtë:

- Procedurat e tenderimit të shërbimeve dhe blerjes së mallrave të ndryshëm sportive shpesh kanë hasur në vonesa për shkak të aplikimeve të operatorëve të vetëm ekonomike, të tërheqjes së tyre nga konkurimi, apo dhe mos paraqitjes të operatorëve për kryerjen e shërbimit apo dorezimit të materialeve. Kështu procedurat janë përsëritur, duke shkaktuar mosrealizimin e plotë të projekteve të planifikuara.
- Dorezimi i munguar i stadiumit “Loro Boriçi” solli mospërdorimin e fondeve të planifikuara për këtë qëllim.

## Rishperndarja e fondeve te trasheguara

Gjate zbatimit te buxhetit, ne te gjitha programet ka teprica fondesh, qe jane rrjedhoje e procesit te rekrutimit te kryer gjate vitit 2016, sipas procedurave dhe afateve ligjore: diferenca gjate procesit te prokurimit si rrjedhoje e uljes se vleres ne oferta nga operatoret ekonomike, riperseritje te procedurave nga mosparaqitja e operatorëve ekonomike, duke shkaktuar mosrealizimin te plotë të projekteve të planifikuara, etj arsye qe u permenden gjate relacionit te secilit program.

1. Fondet e perealizuara ne transfertin specifike do te perdoren me te njejtin destinacion te vitit 2016, sipas ligjit 147/2015“ Per buxhetin e vitit 2016 “ dhe aktet normative perkatese, sipas fishave bashkelidhe.

1.1. Ne programin “Infrastruktura rrugore”, Transporti rrugor/ Mirembajtje rruge rurale, kursimi ne shpenzimet operative prej 4,617 mije leke, do te perdoret si projekti Nr 1.

1.2. Ne programin “Bujqesia dhe zhvillimi rural”, Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes, kursimi ne shpenzimet operative prej 527 mije leke, do te perdoret si projekti Nr 2.

1.3. Ne programin “Mjedisi dhe mbrojtja e pyjeve e kullotave”, Administrimi i Pyjeve, kursimi ne shpenzimet operative prej 370 mije leke, do te perdoret si projekti Nr 3.

2. Fondet me burim financimi nga transferti e pakushtezuar dhe te ardhurat e veta vendore.

2.1. Fondet e perealizuara ne zerin “paga dhe sigurime shoqerore” te trashegohen dhe te mbulojne rritjen e pagave gjate vitit 2017. Duke ditur realizimin e pritshem te vitit 2016 ne zerin “paga dhe sigurime shoqerore”, kemi parashikuar, qe te gjitha tepricat ne keto zera te trashegohen dhe te mbulojne rritjen e pagave gjate vitit 2017, sipas projekteve te paraqitura ne miratimin e buxhetit te vitit 2017.

2.2 Fondet qe rezultojne si diferenca gjate procesit te prokurimit, ose mosrealizime te aktiviteve te parashikuara edhe pas riperseritjes se procedurave te prokurimit pa sukses, te pakesohen sipas tabelës bashkelidhe p/vendimit .

3. Fondet me burim financimi nga Transferti e pakushtezuar dhe te ardhurat e veta vendore, te pakesuara sipas tabelës 4, te rishperndahen ne keto programe:

3.1. Programit P4 “ Sherbimet publike”, i shtohet fondi prej 1,214 mije leke ne zerin “paga dhe sigurime shoqerore”, per te perballuar shtesen e pagave per punonjesit administrative te ketij programi ne perputhje me aktivitetin e parashikuar ne buxhetin e vitit 2017 P4.F9.O1.A1:Shpenzime për pagat dhe sigurime shoqërore për punonjësit e Shërbimeve Publike.

3.2. Programit P8 “Mjedisi dhe mbrojtja e pyjeve e kullotave”, i shtohet fondi 17,317 mije leke Gjelberim i aksit rrugor ne Zonen Industriale rr “ inxh. Gjovalin Gjadri” ( pjesa e pare) dhe gjelbrim i akseve rrugore ne qytet dhe Pyllezim i siperfaqeve pyjore me drurin e frutave pyjore Geshtenje ne NJA Posttribe –Ekonomia Pyjore Rosek Drisht, si projektet Nr 4 dhe 5.

3.3. Programit P10 “Strehimi dhe Shërbimet sociale”, i shtohet fondi 1,000 leke me destinacion pershtatjen e ambienteve tek shkolla “Edith Durham” per femijet autike, si projekti Nr 6.

Nr.1	<b>Projekti</b> : <b>P3.F1.04.A1Mirëmbajtje e rrugëve Rurale</b> <b>Fondi tepricë nga prokurimet e vitit 2016 të transfertës specifike</b>	<b>Llojet e programit P3: Infrastruktura rrugore</b>  <b>Funksioni P3F1: Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore;</b>
------	--	---

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situa ( Shpjego në menyre të detajuar problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)**

Bashkia e Shkodrës është përgjegjëse në territorin e juridiksionit të saj në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bazuar në ligjin Nr. 139/2015 dt. 17. 12. 2015, **“PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”**, Neni 23, **Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike**, pika 4: Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.

Vendimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 915, datë 11.11.2015, **“Për transferimin në pronësi, nga Këshillat e Qarqeve të Bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve”**, neni-1, ka kaluar në administrim të Bashkisë së Shkodrës fondin e rrugëve rurale sipas tabelës:

Nr	Emërtimi i rrugës	km
1	Fermentim – Ura e Mesit – Muri i Turkut	19
2	Ura e Mesit – Prekal – Kir – Breguilumit – Theth	76
3	Guri i Mathes – Komuna Pog	4
4	DegëzimNdreaj – KomunaShosh	2,5
5	DegëzimasfaltVelipojë – KomunaDajç	7,5
6	QafëThore – Theth	16
<b>TOTALI</b>		<b>125</b>

Përveç rrjetit të rrugëve rurale të mësipërm, Bashkia Shkodër, bazuar në ligjin Nr. 139/2015 dt. 17. 12. 2015, **“PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”**, Neni 23 ka në administrim edhe rrjetin rrugor të rrugëve lokale të njësive administrative si më poshtë:

Nr.	Njësia Administrative	Gjatësia km	Numri i Rrugëve
1	Njësia Administrative Bërdicë	31	57
2	Njësia Administrative Velipojë	40.5	38
3	Njësia Administrative Daç	61.1	61
4	Njësia Administrative Rrethina	108	218
5	Njësia Administrative Postribë	78	51
6	Njësia Administrative Ana e Malit	71.2	100
7	Njësia Administrative Guri i Zi	60	94
<b>Totali</b>		<b>449.8</b>	<b>619</b>

Gjendja e infrastrukturës rrugore është përmirësuar ndjeshëm si rezultat i ndërhyrjeve nga bashkia për riparimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve Brenda territorit të saj.

Me fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2016 transfertat specifike janë realizuar kontratat e mirëmbajtjes së rrugëve rurale dhe riparimi i urave, si më poshtë vijon:

1. Ura e Mesit – Prekal – Kir Breglumi - Theth; Guri i Mathës – Komuna Pog; Degëzimi Ndreaj – Komuna Shosh, Loti 1 me vlerë punimesh 7,495,500 lek me TVSH
2. Fermentim Ura e Mesit – Muri i Turkut, Loti 2 me vlerë punimesh 933,118 lek me TVSH.
3. Rruga e Sheldise, Loti 3 me vlerë punimesh 1,611,091 lek me TVSH
4. Riparim Ura Breglumi me vlerë punimesh 458,580 lek me TVSH .
5. Riparim Ura Gimaj mbi lumin Shale me vlerë punimesh 458,589 lek me TVSH.
6. Blerje baze materiale për riparimin e akseve të ndryshme me mjetet e bashkisë Shkodër me vlere 1,797,000 lek me TVSH.

Kryesisht punimet në kontratat e mirëmbajtjes së rrugëve rurale konsistojnë në këto zëra: gërmim dhe mbushje në trup të rrugës dhe kanale, cilindrim kasonete, riparim gropash dhe mbushje me çakull dhe stabilizant, riparime të shtresave asfaltike (asfalt & binder), vepra arti si tombino dhe ura të vogla, pastrim dhe formim të kanaleve anësore për largimin e ujërave sipërfaqësore, mure mbajtëse etj. Është kryer riparimi i rrugëve të fshatrave me zhavorr dhe çakull duke shfrytëzuar mjetet e bashkisë.

Janë kthyer në shërbim të komunitetit urat: Ura Breglumi, tip beli (L=33m, b=3.9m) dhe tip pasarel (L=45m, b=1.5m); Ura Gimaj, tip beli (L=31m, b=3.9m) dhe Ura Mushagag, Gimaj tip pasarel (L=45m, b=1).

Për vitin 2016, në realizimin e projektit: P3.F1.04.A1. Mirëmbajtja e rrugëve Rurale me fondet e transfertës specifike, gjatë prokurimeve janë krijuar mbetje të katër fondeve me vlerë 4'617'265 lekë të cilat transferohen për vitin 2017.

**Problematika që paraqiten.**

Bashkia e Shkodrës ka trashëguar një infrastrukturë të dobët rrugore kjo si pasojë e mungesës së investimeve tërësore, standarteve të ulëta dhe veçanarisht si pasojë e mos gjetjes së një praktike të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit rrugor e cila të ishte afatgjate dhe e



qëndrueshme.

Rrjeti rrugor rural përbëhet kryesisht nga rrugë të paasfaltuar dhe në gjendje të keqe që kërkojnë mirëmbajtje të vazhdueshme. Në këto rrugë nuk është kryer mirëmbajtje për një periudhë të gjatë kohore ose ajo ka qënë e pa mjaftueshme kryesisht si pasojë e mungesës së fondeve.

Në këto segmente rrugorë mungojnë kanalet anësorë të grumbullimit të ujrave sipërfaqësorë, veprat e artit si tombino dhe ura te vogla, mure mbajtese etj. Gjendja paraqitet më e rënduar sidomos në zonat malore ku prurjet e shumta kanë geryer dhe prishur trupin e rrugës duke vështirsuar qarkullimin e mjeteve dhe rrezikuar kalimin në këto rrugë.

Rrjeti rrugor I asfaltuar ka problem që vijnë kryesisht nga cilësia e dobët e punimeve. Në segmente të ndryshme shtresat asfaltike janë të dëmtuara dhe me shtresezime. Prania e ujit për njëkohë të gjatë në segmentet e dëmtuar ka sjelle dëmtime edhe të shtresave të tjera të rruges si të bazës dhe nën-bazës. Një problem tjetër është mbushja e kanaleve me inerte dhe material të ndryshme nga banorët për aksesin në pronat e tyre duke bërë që ujrën të dalin në sipërfaqe dhe sjellë dëmtime të trupit të rrugës.

Periudha e dimrit shpesh ka krijuar vështirësi qarkullimi në rrugë nga bora dhe ngricat për mjetet dhe këmbësorët e cila mund të bëhet shkak edhe për aksidente të përdoruesve të rrugës.

**ii. Synimi I projektit (me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problem kryesor, përfitimi I grupit të synuar)**

**Për vitin 2017.**

- Të ridetajoje ne fondete parashikuara për vitin 2017 duke përfshirë fondin me vlerë 4'617'265 lekë të vitit 2016 nga tepricat e prokurimeve të transfertës specifike.
- Të sigurojë administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrugëve, në pronësi të bashkisë.
- Të përmirësojë infrastrukturen rrugore si dhe të rrisë aksesin ndaj shërbimeve bazë në zonat rurale.
- Të rrisë sigurinë e lëvizjes në rrugë të automjeteve.
- Të reduktojë kostot për realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes nëpërmjet rritjes së kapaciteteve teknologjike dhe burimeve njerëzore të njësive administrative.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerri për të prodhuar rezultate)**

**Për vitin 2017**

- Blerjen e rreth 80 ton kripë të zezë për pastrimin e rrugëve në periudhën e dimrit nga bora dhe akulli.
- Riparimin e rreth 1'500 m2, shtresa asfaltike në rrugët më të dëmtuara dhe që kanë qarkullim më të madh për përdoruesit dhe bizneset në njësitë administrative; Postribë, Gur i Zi, Bërdicë, Velipojë, Dajç, Ana e Malit, Rrethina.
- Mirëmbajtjen e akseve rrugore QafëThore – Thethe dhe Prekal – Kir – Breglumi – Thethe.
- Hartimi i kalendarit të ndërhyrjeve;
- Përcaktimi i volumeve të punës;
- Alokimi i fondeve, monitorimi i realizimit të shërbimeve sipas kalendarit të ndërhyrjeve dhe volumeve të punës të parashikuara.
- Administrim dhe mirembajtje te infrastrukturës rrugore.

**b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)**

**Për vitin 2017.**

- Sigurimi i qëndrueshmerise dhe funksionalitetit afatgjate te rrjetit rrugor nepermjet shërbimeve te mirembajtjes.
- Rritjen e sigurise rrugore.
- Permirësimin e infrastrukturës dhe lidhja e rrugëve rurale me rrugët nacionale, qendrat e fshatrave me rrugët nacionale dhe qendrat e fshatrave brenda njësive administrative.
- Zvogëlimin e kostove të mirëmbajtjes së rrugëve rurale me punonjesit e njësive administrative dhe pergjigja ne kohe per nderhyrje emergjente.

**c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)**

- Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës.
- Spektori i planifikimit të Mirëmbajtjes së Infrastrukturës.
- Njësitë administrative: Pult, Shosh, Shalë, Postribë, Gur i Zi, Bërdicë, Velipojë, Dajç, Ana E Malit, Rrethina.

**d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)**

Bashkia e Shkodrës

**e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

Shpenzimet për çdo aktivitet 2017		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
Fondi tepricë nga prokurimet e vitit 2016 të transfertës specifike			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Sherbime riparimi të akseve të rrugëve	3,177			3,177		
A.2	Blerje baze materiale	1,440			1,440		
	<b>Shuma Totale</b>	<b>4,617</b>			<b>4,617</b>		

**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**  
Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës, Spektori i planifikimit të Mirëmbajtjes së Infrastrukturës.

Periudha e zbatimit (kurfillon, kurpërfundon)  
Janar- Dhjetor 2017

Nr.2	<b>Projekti : P7.F1.O1.A1.</b> Blerje materiale kancelarie dhe paisje zyre	<b>Llojet e programit : P7</b> Administrimi i infrastruktures vendore te kullimit dhe ujitjes <b>Funksioni P7.</b> Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes				
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit :</b> Blerje materiale kancelarie dhe paisje zyre						
<b>i. Situata</b>						
Duke qene se Drejtoria e Sherbimeve Bujqesore dhe Pyjore eshte drejtori e krijuar rishtazi ka nevojje per plotësimin e infrastruktures nevojshme per menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punes.						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
Krijimi i kushteve te nevojshme per ecurine normale te procesit te punes						
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>						
Hartimi i nevojave per materiale zyre dhe materiale kancelarie si dhe blerja e tyre						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i kushteve te nevojshme per mbarëvajtjen e punes</li> <li>• Lehtësi per administraten e DSHBP</li> <li>• Plotesimin e nevojave per materiale zyre</li> </ul>						
<b>c) Aktoret e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Bashkia Shkoder Administrata e DSHBP				Bashkia Shkodër		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2017</b>		Totali ( mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Materiale Zyre	400			400	
A.2	Kancelari	127			127	
	<b>Shuma</b>	<b>527</b>			<b>527</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)</b> Janar 2017 – Dhjetor 2017			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Sherbimeve Bujqesore dhe Pyjore</b>			

Nr.3	<b>Projekti P8.F4.O3.A6:</b> <b>Sherbimi i luftimit te semundjeve /demtuesve ne pyjet e Pishes</b> <b>Luftim proçesionar ne Gur i Zi - Postribë</b>		<b>Llojet e programit :</b> P8 Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.  <b>Funksioni P8.F4. :</b> Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve ne sherbim te ketij funksioni sipas menyres se percaktuar me ligj			
<b>a) Pershkrimi i shkurtër i projektit:</b> Sherbimi i luftimit te semundjeve /demtuesve ne pyjet e Pishes Luftim proçesionar ne Gur i Zi - Postribë						
<b>i. Situata</b>						
Realizimi i sherbimit te Administrimit te Pyjeve /Kullotave bazohet ne Ligin nr. 9385/2005 ( i ndryshuar ) “ Per Pyjet dhe Sherbimin pyjor “. <b>Ne kuader te mbrojtjes dhe ripërteritjes se pyjeve dhe sherbimit ndaj tyre Bashkia Shkoder planifikon te kryeje punime te luftimit te semundjeve dhe demtuesve kryesisht ne pyje.</b> <b>Pyjet sic do lloj qenie biologjike preken nga demtuesit dhe dhe semundjet , duke u shkaktuar deme tek llojet drusore ne ulje te fuqise vegjetative , frenim te rritjes dhe zhvillim normal te tyre. Mosluftimi i tyre con deri ne tharrjen e druveve.</b> <b>Ne zonat pyjore sipas llojit te drurit jane verifikuar semundje dhe demtues te ndryshem ,</b>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<b>Nderhyrja ne kohe per luftimin e semundjes, do te sjelle permiresimin e situates duke rritur fuqine vegjetative te drurit</b> <b>Po keshtu nderhyrja ne pyjet e Pishes duke luftuar hirin apo gjetheperdreresen do te ndikojë ne permiresimin e fuqise vegjetative, mbrojtjen nga tharrja e tyre.</b>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore te projektit ( Veprimet qe do te ndermerrni per te prodhuar rezultate)</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi i projektit</li> <li>- Zbatimi i projektit sipas fazave te parashikuara.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet që prisni</b>						
- Qëllimi i përgjithshëm është mbrojtja e mjedisit natyror, Për më tepër, synon zhvillimin e një kapitali mjedisor, social e kulturor që do të garantojë kushtet për zhvillim të qëndrueshëm. - Me ane te permiresimit (luftimi nga semundjet /demtuesit) arrihet ruajtja e pyjeve, fuqia vegjetative e tyre e cila ndikon drejtperdrejt ne permiresimin e mjedisit pyjor dhe atij social.						
<b>c) Aktoret e mundshëm</b>				<b>d) Kontributet e mundshme ne projekt</b>		
Bashkia Shkoder Komuniteti i zonave Shoqatat e pyjeve Shoqatat mjedisore				Bashkia Shkoder Shoqatat e pyjeve Shoqatat Mjedisore Vullnetare		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2017</b>		Totali ( mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Sherbimi i luftimit te semundjeve /demtuesve ne pyjet e Pishes Luftim proçesionar ne Gur i Zi - Postribë	369			369	0
	<b>Shuma</b>	<b>369</b>			<b>369</b>	<b>0</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> prill 2017 – dhjetor 2017		<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave/Drejtoria e Sherbimeve bujqesore e pyjore.				

Nr.4	Projekti P8F403A4/1: Gjelberim i aksit rrugor ne Zonen Industriale rr " inxh. Gjovalin Gjadri" ( pjesa e pare) dhe gjelbrim i akseve rrugore ne qytet.	<p><b>Llojet e programit :</b> P8 Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.</p> <p><b>Funksioni P8.F4. :</b> Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve ne sherbim të ketij funksioni sipas menyres se percaktuar me ligj</p>				
<b>a) Pershkrimi i shkurter i projektit : Gjelberimi i aksit rrugor ne Zonen Industriale rr " Inxh Gjovalin Gjadri" ( pjesa e pare).</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Ruajtja dhe permiresimi I mjedisit dhe cilesise se ajrit eshte nje nga objektivat kryesore te politikese se Bashkise Shkoder . Permiresimi I mjedisit ne pergjithesi dhe cilesise se ajrit vjen kryesisht dhe jo vetem edhe nepermjet nderhyrjeve qe kryhen ne gjelberimin e akseve rrugore duke bere mbjellje me peme.</p> <p>Rruga "inxh Gjovalin Gjadri" eshte nje nga akset kryesore te Zones Industriale te qytetit te Shkodres. Ne kete zone jane te vendosura edhe shume aktivite/biznese te medha si , fasoneri, prodhim kepuce, prodhim duralumin, apo edhe punime druri etj. Ne kete rruge jane kryer pothuaj te gjitha punimet e infrastructures mbi e nentokesore si edhe ndricimi.</p> <p>Nderhyrja qe parashikohet me mbjelljen e pemeve do te jete nje investim I shtuar per kete zone. Kjo duke permiresuar cilesine e ajrit dhe njekohesisht duke e bere sa me terheqese.</p> <p>Aktualisht ne kete rruge ka te mbjell peme Mimoza , te cilat e kane kryer ciklin e tyre dhe aktualisht jane te demtuara dhe duhen zevendesuar.</p> <p>Ky project propozon mbjelljen e pemes se Manjoles, nje peme fletore e cila krijon nje kurore te bukur dhe qendron gjithnje ne ngjyre te gjelber.</p> <p>Pervec kesaj rruge, ne funksion te gjelbrimit ne akse te ndryshme rrugore, ka nevojte per nderhyrje lokale me gjelbrim, per zevendesim ose plotesim te gjelbrimit te munguar .</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<p>Projekti synon permiresimin e cilesise se ajrit dhe arredimit urban ne rrugen " Inxh Gjovalin Gjadri". Projekti parashikon mbjelljen e e pemes se Manjoles, nje peme fletore e cila krijon nje kurore te bukur dhe qendron gjithnje ne ngjyre te gjelber.</p> <p>Rruga e cila propozohet te nderhyet ka nje gjatesi 1150 ml. Gjate gjithte gjatesise se rruges ne ted y krahet e saj pra ne nje gjatesi te pergjitheshme prej 2300 ml dho te mbillen gjithesej rreth 230 peme manjole , ne nje largesi rreth 10 ml nga njera tjetra.</p> <p>Gjelbrimi ne qytet do te shtohet edhe me rreth 200 peme te tjera ne akse te ndryshme rrugore.</p>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore te projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi i projektit</li> <li>- Zbatimi i projektit sipas fazave të parashikuara.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet qe prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjelberimi i rruges " Inxh Gjovalin Gjadri"</li> <li>- Plotesim/gjelbrim i akseve rrugore</li> <li>- Permiresimi i cilesise se mjedisit</li> <li>- Permiresimi i arredimit urban te zones.</li> </ul>						
<b>c) Aktoret e mundshem</b>				<b>d) Kontributet e mundshme ne projekt</b>		
Bashkia Shkoder Bizneset e zones Shoqatat mjedisore				Bashkia Shkoder Bizneset e zones Shoqatat mjedisore Vullnetare		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura ( per cdo aktivitet të mesiperme (pika iii))</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2017</b>					Totali ( mije lekë)	
					Nga kjo:	
					Paga	Sigurime
					Operative	Transferime
					Kapitale	
A.1	<b>Gjelberimi i aksit rrugor ne Zonen Industriale rr " Inxh Gjovalin Gjadri" ( pjesa e pare) dhe gjelbrim i akseve rrugore ne qytet</b>				5700	
	<b>Shuma</b>				<b>5700</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> mars 2017 – dhjetor 2017					<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave/Drejtoria e Sherbimeve bujqesore e pyjore.	

Nr. 5	<b>Projekti P8F4O3A4/2: Pyllezim i siperfaqeve pyjore me drurin e frutave pyjore Geshtenje ne NJA Postribre – Ekonomia Pyjore Rosek Drisht.</b>	<b>Llojet e programit : P8 Mjedisit dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.</b>  <b>Funksioni P8.F4. :</b> Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve ne sherbim të ketij funksioni sipas menyres se percaktuar me ligj				
<b>b) Pershkrimi i shkurter i projektit : Pyllezim i siperfaqeve pyjore me drurin e frutave pyjore Geshtenje ne NJA Postribre – Ekonomia Pyjore Rosek Drisht..</b>						
<b>i. Situata</b>						
<p>Mbrojtja dhe Administrimi i Pyjeve /Kullotave ka kaluar si veprimtari e Njesise se Qeverisjes Vendore- Bashkia Shkoder nepermjet Ligjit nr 139/2015 “ Per veteqeverisjen vendore”. Realizimi i sherbimit të Administrimit të Pyjeve /kullotave bazohet ne Ligin nr 9385/2005 “ Per Pyjet dhe Sherbimin pyjor “. ( i ndryshuar)</p> <p>Ne kuader të mbrojtjes dhe riprteritjes se pyjeve dhe sherbimit ndaj tyre Bashkia Shkoder planifikon të kryeje punime të pyllezimit me drurin e frutit pyjor Geshtenje, kjo ne zonen e Rosek Drishtit ku aktualisht ka nje siperfaqe pyjore me Geshtenje dhe shtimi ne vijimesi I kesaj kryesisht ne zona të demtuara dhe shume të demtuara. Komuniteti I ketyre zonave e ka te lidhur mirqenien e tyre me shfrytezimin e sistemit agro-pyjor te kesaj peme. Aktualisht kjo peme mund te prodhoje deri ne 0.6 ton/ha . Nisur nga kjo edhe rendesia ekonomike per kultivimin e saj merr nje rendesi te vecante..</p> <p>Gjithashtu nepermjet politikave per aplikimin e teknikave dhe teknologjive te reja per perpunimin, marketingun e frutave te geshtenjave dhe prodhimeve te tjera te pyjeve do te kemi nje rritje ekonomike te perdoruesve te ketyre siperfaqeve me pyje geshtenje.</p>						
<b>ii. Synimi i projektit</b>						
<p>Zhvillimin e një kapitali mjedisor, social e kulturor që do të garantojë kushtet për zhvillim të qëndrueshëm. Sensibilizimin e komunitetit që banon rreth zonës në fjalë për rëndësinë që ka geshtenja si nje sistem agro-pyjor . Agro per vete frutat qe kjo peme prodhon dhe pyjor per sherbimin qe i kryhet duke e konsideruar si nje pyll. Nepermjet ketyre nderhyrjeve per pyllezim me Geshtenje do te rritet siperfaqja me kete peme e cila prodhon geshtenje ku prodhimi dhe miradministrimi i mbledhjes se tyre do te , rrite ndikimet positive ne mjedis ne ruajtjen e tokes,ujrave dhe të ajrit dhe se fundi ndikimi i pyllit te geshtenjes mbi kushtet social ekonomike të komunitetit dhe agroturizem.</p> <p>Masivi pyjore qe do të krijohet,do të permiresoj ndjeshem kushtet eko-mjedisore të zones duke permiresuar ndjeshem edhe anen shendetsore të popullsesise të zones per rreth.</p> <p>Bazuar ne normativat e pyllezimit nevojiten rreth 625 peme geshtenje per 1 ha. Realizimi i projektit do të kryhet me etapa sepse edhe menaxhimi është me i mire. Projekti synon pyllezimin me geshtenje te rreth 19 ha siperfaqe pyjore.</p>						
<b>iii. Aktivitetet kryesore te projektit</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi i projektit</li> <li>- Zbatimi i projektit sipas fazave të parashikuara.</li> </ul>						
<b>b) Rezultatet qe prisni</b>						
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pyllezimi i siperfaqeve të demtuara dhe shume të demtuara me drurin e geshtenjes</li> <li>- Permiresimi i kushteve social/ekonomike te banoreve te zones.</li> <li>-Permiresimi i cilesise se mjedisit</li> </ul>						
<b>c) Aktoret e mundshem</b>				<b>d) Kontributet e mundshme ne projekt</b>		
Bashkia Shkoder Komuniteti i zonave Shoqatat e pyjeve Shoqatat mjedisore				Bashkia Shkoder Shoqatat e pyjeve Shoqatat Mjedisore Vullnetare		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura ( per cdo aktivitet të mesiperme (pika iii)</b>						
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2017</b>		Totali ( mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime Kapitale
A.1	Pyllezim ne siperfaqet pyjore ne NJA Postribre Ekonomia Pyjore Rosek Drisht ( Vilze)	11617				11617
<b>Shuma</b>		<b>11617</b>				<b>11617</b>
<b>f) Periudha e zbatimit</b> mars 2017 – dhjetor 2017			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave/Drejtoria e Sherbimeve bujqesore e pyjore.			



Nr. 6	<b>P10.F2.O3.A12</b> Përshatja e ambienteve për krijimin e Qendres së Autizmit	<b>Llojet e programit: P10.Strehimi dhe Shërbimet sociale</b> <b>Funksioni:P10.F2.Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.</b>					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
<b>i. Situata ( Shpjego ne menyre te detajuar problemin, aspektet negative, të dhëna për zonën)</b>							
<p>Autizimi është një sëmundje e cila po përhapet në mënyrë të shpejtë duke u shndërruar në një sfidë për shëndëtitn publik në mbarë botën për shkak të kostove shoqërore dhe ekonomike. Njohuritë për autizimin në shërbimin shëndetësor tonin e më tepër në popullatën shqiptare janë shumë të pakta dhe nuk është e qartë se rritja e rasteve është rezultat i shtimit real të rasteve apo diagnoikimit më të mirë.</p> <p>Autizimi është një sëmundje e cila karakterizohet nga, çrregullime të marrëdhënieve sociale, të komunikimit dhe sjellje e levizje stereotipike.</p> <p>Në SHBA mendohet që 1 në 150 fëmije vuajnë nga çrregullime të autizmit dhe numri i rasteve që diagnostikohen rritet dita ditës. Ndërsa në Shqipëri shifrat janë në rritje, por nuk ka të dhëna të sakta. Specialistët e shëndetësisë apelojnë për sensibilizimin e opinionit publik për diagnostikimin e hershëm, përkrahjen ndaj fëmijëve autikë dhe integrimin e tyre në shoqëri.</p> <p>Aktualisht në Shkodër nuk kemi një qender të specializuar për diagnostikimin dhe trajtimin e autizimit e cila do të mundësonte mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve integruese në moshë sa më hereshme. Për këtë arsye janë vlerësuar ambiente e mundshme për ngritjen e Qendre për Fëmijët me Autizem e cila do të ofrojë shërbimeve informuese, diagnostikuese, rrahilituese, integruese për përsoant autik.</p> <p>Shkolla Edit Durham aktualisht ka një numër të kufizuar nxënësish e si rezultat në përdorim vetëm katin e parë të godinës 3 katesh dhe nuk parashikohet që të ketë rritje të numrit të nxënësve në vitet e ardhshme, për këtë arsye dhe mbas verifikimeve teknike është vlerësuar që kati i tretë i kësaj shkolle është ambjen i vlefshëm për ngritjen e Qendres për Fëmijët me Autizen. Për realizimin e kësaj qendre kërkohet bashkëpunim dhe mbështetjen e organizatave me eksperience në këtë fushë dhe të donatoreve të ndryshëm.</p>							
<b>ii. Synimi i projektit ( me një fjali çfarë do të zgjidhni për atë që është problemi kryesor, përfitimi i grupit të synuar)</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Projekti synon mbështetjen e krijimit të një Qender të Specializuar për diagnostimin e hershem ë fëmijëve me autizem.</li> <li>• Ofrimi i shqërbimeve rehabilitues dhe integruese për fëmijët me autizem.</li> <li>• Informimin dhe sensibilizimin e shoqërisë për autizimin dhe orjentimi i tyre për ndihmë.</li> <li>• Informimin dhe trajnimin e personelit të çerdheve, kopshteve dhe shëndetësor për diagnostimin e hershëm të fëmijëve autik.</li> <li>• Bashkënrëndimin me organizata të specializuara dhe donatorë për financimin e krijimit dhe administrimit të kësaj qendre.</li> </ul>							
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit (Veprimet që do të ndërmerrni për të prodhuar rezultate)</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shërbime mirëmbajtjeje për çatinë e godinës dhe përshtatjet e nevojshme të katit të 3 të shkollës Edit Durham në ambiente të përshtatshme për Qendren e trajtimit të Fëmijëve me Autizëm</li> <li>▪ Trajnimi i stafit të Qendres për të ofruar shërbime cilësore dhe të nevojshme për fëmijët autik e prindërit e tyre.</li> <li>▪ Trajnimi dhe informimi i stafit të qendrave shëndetësore për njohjen dhe diagnostikimin e hershëm të fëmijëve autik.</li> </ul>							
<b>b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)</b>							
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Infrastruktura e Qendres për Fëmijët Autik e gatshme për shërbim.</li> <li>○ Staf i trajnuar dhe i përgatitur për të ofruar shërbimet e duhura për fëmijët autik.</li> <li>○ Staf i qendrave shëndetësore, i çerdheve dhe kopshteve i informuar dhe i trajnuar për të diagnostikuar sa më heret fëmijët autik.</li> </ul>							
<b>c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)</b>						
Fëmijët autik dhe familjet e tyre, Staf i kopshteve, çerdheve dhe qendrave shëndetësore. OJF,	Bashkia e Shkodrës, Ojfe donatore të ndryshëm, Familjet e fëmijëve autik. etj						
e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)							
<b>Shpenzimet për çdo aktivitet 2017</b>	Totali ( mije lekë)	Nga kjo:					
A.1	Punime mirëmbajtje të çatise dhe të ambienteve të brendshme.	1000	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
	<b>Shuma</b>	<b>1000</b>			1000		
<b>f) Periudha e zbatimit</b> mars 2017 – dhjetor 2017	<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Strehimit dhe Shërbimeve Sociale.						

